

ROLI NDËRMJETËSUES I BASHKIMIT EVROPIAN NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI



Adnan Q. Limani

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Marrëdhëniet Ndërkombëtare
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”
Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Belina Budini

Numri i fjalëve: 55747

Tiranë, 23.12.2020



DEKLARATA E AUTORSISË

© E drejta e autorit: Adnan Q. Limani

Përmes kësaj deklarate premtoj se punimi në fjalë është punë e imja origjinale dhe se të gjitha idetë, të dhënat dhe gjuha e përdorur e cila mund t'i takojë një subjekti tjetër, është cituar me saktësi dhe sipas rregullave të kërkuara, duke ia atribuar autorsinë subjektit të cilit i jam referuar në punim.

ABSTRAKTI

Punimi doktoral "Roli ndërmjetësues i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë-Serbi" përqendrohet në hulumtimin e mëtejshëm të ndërmjetësimit, si njërit prej mjeteve të rëndësishme diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në mënyrë paqësore, me ndihmën e konceptit teorik dhe historikut të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. Në kuadër të punimit formësohet një kornizë analitike për hulumtimin e rolit, por në të njëjten kohë edhe të efektivitetit të Bashkimit Evropian si ndërmjetësues, në përshkrimin e studim rasteve të tjera për ndërmjetësim. Si studim rast i veçantë në interesin e hulumtimit, si dhe për verifikimin dhe besueshmërinë empirike, është aplikuar rasti i ndërmjetësimit të Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë-Serbi.

Punimi do të ofrojë përgjigje në pyetjet kërkimore se si do të mund të konceptohet roli dhe efektiviteti ndërmjetësues i Bashkimit Evropian, se si mund të dihet se një aktor i tretë, në rastin tonë Bashkimi Evropian, ka qenë i suksesshëm si ndërmjetësues në negociatat për paqe, a duhet të gjykohet si efektiv ndërmjetësuesi vetëm nëse përpjekjet ndërmjetësuese kanë shpjerë tek një përfundim i suksesshëm, se cilët do të ishin faktorët ndikues në rolin dhe në efektivitetin e Bashkimit Evropian si ndërmjetësues, si dhe a do të arrijë shteti i Kosovës që përmes këtij dialogu të fuqizojë integritetin territorial, të vendos marrëdhënie normale fqinjësore bashkëpunimi me shtetin serb, të arrijë përparimin e dëshiruar në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe të përmirësojë jetët e qytetarëve. Me fjalë të tjera, se si do t'mund ta definojmë dhe operacionalizojmë, si variabël të varur kryesor të këtij studimi, "rolin efektiv ndërmjetësues" të Bashkimit Evropian, në rastin konkret, në dialogun Kosovë-Serbi".

Në analizën empirike të dialogut Kosovë-Serbi, gjejmë se Bashkimi Evropian, gjer më tani, ka qenë pjesërisht i suksesshëm në drejtim të zgjidhjes së konfliktit dhe në arritjen e qëllimit të saj të definuar ngushtë, ndërsa mesatarisht efektiv në arritjen e qëllimeve më afatgjata, në lidhje me përpjekjet e ndërmjetësimit.

Ana metodologjike e këtij punimi reflektohet sidomos në qasjen analitike dhe sistematike të temës së ndërmjetësimit, që nga shqyrtimi i përgjithshëm teorik deri te marrja në konsideratë e praktikave më të mira ndërmjetësuese, në veçanti të Bashkimit Evropian, me ndihmën e metodave të hulumtimit cilësor. Si studim cilësor përqendrohet në një rast të vetëm, në rolin ndërmjetësues të BE-së, të studim rastit konkret, dialogut Kosovë-Serbi.

Ky hulumtim tregon se suksesi dhe efektiviteti i Bashkimit Evropian, në ndërmjetësimin në mes të Kosovës dhe Serbisë, mund të shpjegohet me mundësinë e ndikimit të fuqishëm dhe strategjisë ndërhyrëse ndërmjetësuese që Bashkimi Evropian mund ta ketë mes palëve në konflikt, nga shkak i aspiratave të tyre për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Për sukseset dhe arritjet e deritanishme të Bashkimit Evropian, në rolin e ndërmjetësuesit në dialogun Kosovë-Serbi, në vazhdimësi ka kontribuar mbështetja e jashtme nga palët e treta si dhe koha e duhur e iniciativës ndërmjetësuese.

Fjalë kyçe: ndërmjetësimi, strategjia, efektiviteti, konflikti, negocimi, paqja, dialogu, Bashkimi Evropian, Kosova, Serbia

ABSTRACT

Doctoral thesis "The European Union's mediating role in the Kosovo-Serbia dialogue" is focused on further research of mediation as an important diplomatic tool for solving international dispute in a peaceful way with the help of theoretical and historical concept of solving international dispute. An analytical framework for role research is formulated in the paper, but at the same time the effectiveness of the European Union as a mediator, in describing on other cases of mediation. As a special case study on the interest on research, also verification and empirical reliability, is applied on the mediation of European Union in Kosovo-Serbia dialogue.

The paper will offer answers in research questions on how will the role and the effectiveness conceived by the European Union mediation, on how can a third party, in our case the European Union, has been successful as mediator in negotiations for peace, should it be judged as effective mediator only if the mediation tries have brought at a successful conclusion, as what would be the influential factors in the role and effectiveness of the European Union as mediators and whether the state of Kosovo will achieve through this dialogue to strengthen its territorial integrity, to establish normal neighborly relations of cooperation with the Serbian state, to achieve the desired progress on the road to European Union and to improve the citizens' lives. In other words, as how could we define and operationalize as the key dependent variable of this study, "the effective mediation role" of the European Union, in this case, in the Kosovo-Serbia dialogue.

In the empirical analysis of Kosovo-Serbia dialogue, we find that the European Union so far, has been partly successful in the direction of solving conflicts and

achieving its narrow defined purpose, while average effective in achieving its long term goals, in relation to mediation efforts.

The methodological side of this paper reflects especially the analytical and systematic approach of the mediation thesis, from general theoretical review to considering the best mediation practices, in particular the European Union's, with the help of qualitative research methods. As a qualitative study it focuses on a single case, the EU's mediating role, of concrete study case, Kosovo-Serbia dialogue.

This research shows that the success and the effectiveness of the European Union in the mediation between Kosovo and Serbia can be explained with the possibility of powerful impact that the European Union may have between parties of conflict, due to their membership aspirations and mediating intervention strategies of the European Union. For the success and achievements so far of the European Union, in the mediator's role for the Kosovo-Serbia dialogue, both the external support from third parties and the timing of the mediation initiative have consistently contributed to the European Union's successes and achievements to date, in the role of mediator in the Kosovo-Serbia dialogue.

Keywords: mediation, strategy, effectiveness, conflict, negotiation, peace, dialogue, European Union, Kosovo, Serbia.

FALËNDERIME

Në këtë rrugëtim të gjatë hulumtues që kërkon kohë, durim dhe përkushtim të lartë, i falënderoj të gjithë ata që kontribuan dhe sado pak ndihmuan në realizimin e këtij punimi doktorat.

Për ta arritur cakun e nisur është e domosdoshme përkrahja e gjerë, si ajo akademike dhe kërkimore ashtu dhe ajo personale.

Për mbështetje akademike falënderoj mentoren, Prof. Asoc. Dr. Belina Budini. Profesorit të nderuar i shpreh mirënjohjen time më të thellë për udhëheqjen e saj shkencore në këtë ndërmarrje të vështirë. Me njohuritë, urtinë, përkujdesjen e vazhdueshme metodologjike dhe punën e papërtuar, ka kontribuar në sendërtimin e një kuadri të plotë dhe rigoroz metodologjik dhe analitik.

Falënderoj administratën e shkollës doktorale për gatishmërinë e treguar, për përgjigjet e tyre në çdo pyetje apo kërkesë timen, të bërë gjatë kohës së studimeve.

Falënderoj profesorët e drejtimit Shkencat Sociale-Marrëdhëniet Ndërkombëtare, të cilët pata nderin t'i takojë, të bashkëpunojë dhe të jem student i tyre, të cilët kanë ndjekur me interes të posaçëm ecurinë time, duke më nxitur vazhdimisht për të arritur objektivat e mia në kuadër të studimeve doktorale.

Falënderoj Profesorin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Besim Perjuci, për këshillat dhe sugjerimet në lekturën e tezës doktorale.

Falënderim i veçantë dhe nga zemra për familjen time, bashkëshortën Diana dhe fëmijët Lea dhe Lisi, për përkrahjen morale, kurajon e dhënë dhe durimin e shprehur.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

▪ Abstrakti	
▪ Falënderimi	
▪ Përmbajtja	
▪ Lista e tabelave	
▪ Lista e shkurtesave	
Kapitulli I: Hyrja	1
1.1. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore	6
1.2. Qasja	7
1.3. Metodologjia	8
1.4. Terminologjia dhe përkufizimet	12
1.5. Struktura e temës.....	20
Kapitulli II: Korniza teorike	23
2.1. Qasjet mbi studimin e ndërmjetësimit	25
2.2. Modeli i Kontigjencës dhe Modeli Meta-teorik.....	29
2.3. Qëndrimet relativiste - konteksti dhe procesi i ndërmjetësimit	32
2.4. Teoritë mbi ndërmjetësimin	34
2.5. Koncepti teorik mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar	37
2.6. Karakteristikat përcaktuese të ndërmjetësimit ndërkombëtar.....	40
2.6.1. Natyra e paqartë e paanshmërisë së ndërmjetësuesit	42
2.6.2. Kredibiliteti i ndërmjetësuesit.....	44
2.6.3. Përcaktuesit e kërkesës për ndërmjetësim.....	46
2.6.4. Kostot e pranimit të ndërmjetësimit dhe objektivat devijuese.....	47
2.6.5. Avantazhet e pranimit të ndërmjetësimit	48

2.6.6. Përcaktuesit e furnizimit të ndërmjetësimit	49
2.6.7. Arsyet humanitare dhe interesat e vetë ndërmjetësuesve	50
2.6.8. Palë të treta në cilësinë e ndërmjetësuesit.....	51
2.7.Përfundime	53
Kapitulli III: Kuptimi i suksesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar	55
3.1. Faktorët përcaktues të suksesit apo dështimit të ndërmjetësimit	56
3.1.1. Koncepti i levës në kontekstin e ndërmjetësimit.....	57
3.1.2. Anshmëria e ndërmjetësuesit.....	57
3.1.3. Ndikimi i asimetrisë në balancën e fuqisë.....	59
3.1.4. Strategjitë në procesin e ndërmjetësimit	60
3.1.4.1. Lehtësimi/komunikimi	64
3.1.4.2. Formulimi	67
3.1.4.3. Manipulimi	69
3.1.5. Marrëdhëniet mes palëve kundërshtare dhe palës së tretë	71
3.1.6. Konteksti kulturor dhe sukcesi i ndërmjetësimit	72
3.2. Faktorët kontekstualë.....	73
3.2.1. Kushtet gjeopolitike	74
3.2.2. Natyra e paqëndrueshme e konflikteve të ndërmjetësuara.....	74
3.3. Përfundime.....	77
Kapitulli IV: Bashkimi Evropian si ndërmjetësues i paqes	79
4.1.Koncepti i fuqisë dhe Bashkimi Evropian.....	80
4.1.1. Bashkimi Evropian dhe “fuqia e fortë”	80
4.1.2. Bashkimi Evropian dhe “fuqia e butë”.....	81
4.1.3. Bashkimi Evropian dhe “fuqia normative”	83

4.2. Qasjet e Bashkimit Evropian mbi ndërmjetësimin	85
4.3. Praktika e ndërmjetësimit - temat dhe konceptet	89
4.2.1. Inicuesit e ndërmjetësimit	89
4.2.2. Rolet dhe strategjitë e ndërmjetësimit.....	90
4.2.3. Efektiviteti i ndërmjetësimit	92
4.4. Rrugëtimi institucional në ndërmjetësim	93
4.3.1 Konceptualizimi i ndërmjetësimit	94
4.3.2 Arkitektura institucionale mbi aktivitetet e ndërmjetësimit.....	99
4.5. Efektiviteti ndërmjetësues në negociata paqeje	102
4.4.1. Faktorët ndikues në efektivitetin e ndërmjetësimit	104
4.4.2. Kushtet e efektivitetit të ndërmjetësuesit	106
4.4.2.1. Leva e ndërmjetësuesit	106
4.4.2.2. Strategjia e ndërmjetësimit	108
4.4.2.3. Koherenca	108
4.4.2.4. Konteksti i konfliktit.....	109
4.6. Konceptet dhe qasja e BE-së në dialogun Kosovë-Serbi	110
4.7. Koncepti i ambigualitetit apo i dykuptimësisë kreative në BE	111
4.1.1. Praktikrat dhe implikimet e ambigualitetit apo të dykuptimësisë kreative.....	113
4.1.2. Koncepti i rikontekstualizimit në BE	117
4.8. Qasja neutrale e Bashkimit Evropian ndaj statusit	119
4.9. Strategjitë ndërmjetësuese të BE-së	122
4.10. Përfundime	126
Kapitulli V: Procesi i zgjidhjes së konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë	129

5.1. Konteksti historik i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.....	129
5.1.1 Paqëndrueshmëria gjeopolitike në Ballkan.....	130
5.1.2 Çështja e Kosovës - konflikt politik mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb..	131
5.1.3 Rezistenca pasive dhe konflikti i armatosur	135
5.1.4 Marrëveshja e Rambujesë dhe fushata ushtarake e NATO-s	137
5.1.5 Propozimi gjithëpërfshirës për statusin përfundimtar të Kosovës.....	139
5.1.6. Kontestimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nga shteti serb.....	141
5.2. Dialogu Kosovë-Serbi dhe rruga drejt Marrëveshjes së Brukselit.....	143
5.2.1. Roli i BE-së si ndërmjetësues	145
5.2.2. Motivet e palëve në dialog	147
5.2.3. “Dialogu teknik”	148
5.2.4. “Dialogu politik”	151
5.2.5. Marrëveshja e Brukselit	153
5.2.6. Faza përmbyllëse e procesit të dialogut	157
5.2.6.1. Qëndrueshmëria e status quo-së.....	158
5.2.6.2. Pretendimet territoriale të shtetit të Serbisë ndaj shtetit të Kosovës.....	161
5.2.6.3. Idetë mbi korrigjimin e kufirit apo shkëmbimin e territoreve	163
5.3. Përfundime	167
Kapitulli VI: Konkluzione	169
Shtojca I: Intervistat	174
Shtojca II: Rezoluta 1244 (1999).....	177
Shtojca III: Pakoja e Ahtisaarit	177
Shtojca IV: Deklarata e Pavarësisë së Kosovës	178
Shtojca V: Kushtetuta e Republikës së Kosovës	178

Shtojca VI: Koncepti (i vitit 2009) për ndërmjetësim i Bashkimit Evropian	178
Shtojca VII: Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun	178
Shtojca VIII: Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë	178
Shtojca IX: Kosova dhe organizatat ndërkombëtare	178
Shtojca X: Lista e tabelave	179
Referencat	184

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AP	Asambleja e Përgjithshme
BDR	Blokimi Dëmtues Reciprok
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
CFSP	Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
COREPER	Komiteti i përfaqësuesve të përhershëm
CPR	Instituti Ndërkombëtar për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konflikeve
CSDP	Politikës e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
EEAS	Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm
EFP	Politika e Jashtme Evropiane
EIP	Instituti Evropian i Paqes
ENP	Politika Evropiane e Fqinjësisë
EPLO	Zyra Ndërlidhëse Evropiane për Ndërtimin e Paqës
EPMSS	Shërbimi Mbështetës për Ndërmjetësim i Parlamentit Evropian
ERMES	Burimet evropiane për mbështetje të ndërmjetësimit
ESDP	Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe e Mbrojtjes
EULEX	Misioni Evropian për Rend dhe Ligj
EUSR	Përfaqësuesit Special dhe të Dërguarit e BE-së
FAC	Këshilli i Punëve të Jashtme
GSC	Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
HR	Përfaqësuesi i Lartë

IcSP	Instrumenti kontribues i Stabilitetit dhe Paqes
IfS	Instrumenti i Stabilitetit
IMSD	Iniciativa për Mbështetje të Ndërmjetësimit
KE	Komisioni Evropian
KFOR	Forcat e Kosovës
KS	Këshilli i Sigurimit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
MEPs	Shërbimi Mbështetës për Ndërmjetësim
MN	Marrëdhëniet Ndërkombëtare
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSN	Rrjeti për Mbështetje të Ndërmjetësimit
MSS	Struktura Mbështetëse e Ndërmjetësimit
MST	Ekipi për Mbështetje të Ndërmjetësimit
MSU	Njësia për Mbështetje të Ndërmjetësimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PbP	Partneriteti për Ndërtimin e Paqes
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PE	Parlamenti European
PRISM	Divizioni për Parandalimin e Konflikeve
PSC	Komiteti për Politikë dhe Siguri

PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
SANU	Akademia Serbe e Shkencës dhe Artit
SKS	Mbretëria - Serbe Kroate Sllovene
SSR	Mbështetja e Reformës në Sektorin e Sigurisë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e OKB-së
UNHCR	Komisionari i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNOSEK	Zyra e Kombeve të Bashkuara e të dërguarit të posaçëm për Kosovën
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së

Kapitulli I: Hyrje

“Ndërmjetësimi është një formë arti, i cili ngërthen në vete intuitën, finesën dhe vizionin” (Amy L. Smith dhe David R. Smock, 2008).

Si aktorë themelorë në marrëdhëniet ndërkombëtare, shtetet e ndryshme i kanë edhe interesat dhe qëllimet e ndryshme. Qëllimi kryesor i çdo shteti është realizimi i interesave të tyre maksimale në marrëdhëniet me shtetet e tjera. Në përpjekje të ruajtjes dhe të zgjerimit të sferave të tyre të influencës dhe të realizimit të interesave maksimale në marrëdhëniet me shtetet e tjera, mes tyre mund të lindin konflikte dhe mosmarrëveshje të ndryshme. Është pikërisht njëra ndër detyrat më të rëndësishme të bashkësisë ndërkombëtare, që këto mosmarrëveshje dhe konflikte të përpiqet t'i zgjidhë në mënyrë paqësore, me mjetet më të përshtatshme të saj.

Origjina e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve mes shteteve është e vjetër po aq sa edhe vetë njerëzimi dhe ekzistimi i komunikimit mes tyre. Forma, llojet, palët dhe natyra e konfliktit kanë evoluuar në varësi të rrethanave të ndryshme historike, sociale, ekonomike, politike, teknologjike dhe ushtarake. Po ashtu edhe evoluimi i mënyrës së përfshirjes së palëve në zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve dhe ndryshimi i metodave apo perfeksionimi i tyre janë si rrjedhojë e kushteve të lartpërmendura.

Konfliktet dhe mosmarrëveshjet e ndryshme gjatë historisë njerëzore janë zgjidhë në mënyra të ndryshme, varësisht nga religjioni dhe nga traditat e vendit. Megjithatë, në kohën bashkëkohore, me përdorimin e mënyrave diplomatike dhe gjyqësore për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, i është dhënë fund përdorimit të forcës në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes shteteve. Promovimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përmes metodave diplomatike dhe gjyqësore, ka shënuar një kthesë të re në të drejtën ndërkombëtare, duke e bërë më të butë dhe duke evituar forcën si mekanizëm, që i karakterizonte marrëdhëniet ndërkombëtare në të kaluarën.

Në mesin e mjeteve diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare siç janë: bisedimet, shërbimet e mira, komisionet e hetimit dhe komisionet e pajtimit, është edhe ndërmjetësimi. Ndërmjetësimi ndërkombëtar, si mënyrë e zgjidhjes paqësore të konflikteve ka qenë i njohur që në mesjetë. Megjithatë, roli i ndërmjetësimit, si një ndër metodat kryesore diplomatike për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, në kohët bashkëkohore, sa vjen e rritet. Mjediisi ndërkombëtar i shekullit XXI, shumë më tepër sesa paraardhësit e tij, po përjeton konflikte dhe dhunë, si brenda shteteve ashtu edhe mes tyre. Konfliktet e tilla janë të kushtueshme, shkatërruese dhe shumë të rrezikshme për individët, komunitetet dhe rajonet e botës. Përveç konflikteve mes aktorëve të përcaktuar mirë, format e tjera të dhunës (si terrorizmi) dhe kërcënimet serioze (siç është degradimi i mjedisit) paraqesin një rrezik madhor për qëndrueshmërinë e sistemit ndërkombëtar. Ndërmjetësimi është bërë njëri nga mjetet më të fuqishme dhe më efektive diplomatike në marrëdhëniet ndërkombëtare për t'iu përgjigjur konflikteve përhapëse dhe kërcënimeve të shumta me të cilat ballafaqohemi sot në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh numrin e madh të aktorëve të mundshëm në ndërmjetësimin ndërkombëtar, koordinimi i afërt është thelbësorë për të përcaktuar se cilët nga aktorët, në një iniciativë të caktuar ndërmjetësimi, do të marrin rolin udhëheqës dhe cilët do të luajnë rol mbështetës. Ky vendim do të duhej të merrej në varësi të konsideratave të përparësisë krahasuese për rolin kryesor në një rast të veçantë.

BE-ja, si një nga aktorët më të mëdhenj e më të fuqishëm politik dhe ekonomik të botës, duke pasur një numër të madh instrumentash politik, ekonomik dhe ushtarak, të kombinuara me njohuritë mbi përpjekjet paqeruajtëse dhe me prezencën e saj në shumë vende të botës, përmes “fuqisë së butë”, ka ushtruar dhe ushtron ndikimin e vet në ruajtjen e paqes në Evropë, në ndërtimin e begatisë dhe në nxitjen e dëshirës së vendeve dhe të rajoneve të tjera të

Evropës, që t'i bashkohen si anëtare me të drejta të plota. Nga pikëpamja historike, roli i BE-së ka qenë një element i veçantë i marrëdhënieve të saja me pjesën tjetër të botës dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e reputacionit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

BE-ja, bazohet dhe promovon parimet e parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve përmes ndërmjetësimit, si një çështje me interes për te dhe fushën ku ajo konsideron se mund të luajë një rol të dobishëm. BE-ja, ka mundësi që, në mënyrë konstante, të luaj rol të rëndësishëm dhe proaktiv në përpjekjet e ndërmjetësimit për të parandaluar apo për t'i dhënë fund një konflikti. Por, për ta bërë këtë në mënyrën sa më efektive, ajo do të duhej të zhvillonte një ndërgjegjësim të motiveve dhe avantazheve që kishte me i sjell në përpjekjet e ndërmjetësimit. Roli ndërmjetësues i BE-së, në studim rastin konkret, në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, ku secilës palë i është ofruar një perspektivë anëtarësimi, synon të lehtësojë dialogun mes tyre si dhe të përdorë ndikimin e procesit të zgjerimit për të arritur një zgjidhje për konfliktin dypalësh. Qasja e BE-së në dialog, është që të përforcojë integritetin territorial të Kosovës, ndërkohë që mbetet neutrale ndaj pavarësisë dhe sovranitetit të saj. Ndërmjetësimi i saj fillimisht synonte të promovonte bashkëpunimin, të arrijë përparim në rrugën drejt BE-së, dhe të përmirësojë jetën e qytetarëve, përmes bisedimeve teknike për çështje me interes të përbashkët. Sidoqoftë, dialogu është fokusuar dukshëm në normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe. Për shumicën e Shteteve Anëtare më me ndikim të BE-së, të cilat e kanë njohur shtetin e Kosovës, normalizimi duhet të përforcojë legjitimitetin ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Shtetet Anëtare, të cilat ende nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës mbështesin masat që përmirësojnë jetën e qytetarëve, pa i dhënë legjitimitet ndërkombëtar shtetësisë së Kosovës. Nëse BE-ja synon tejkalimin e konfliktit Kosovë-Serbi dhe më gjerë, si dhe normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe, ajo do të duhej të ishte më koherente dhe më fleksibile në qasjen e

saj, nga arsyeja se edhe Kosova edhe Serbia janë dy shtete të BP, të një rajoni të trazuar i cili edhe pas tejkallimit të shumë konflikteve, ende mbetet i brishtë dhe i kërcënuar.

Në BP edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, pas tejkallimit të shumë konflikteve si dhe pas hyrjes në proceset shpresëdhënëse integruese dhe të globalizimit, mjedisi i sigurisë duket ende i brishtë dhe përmban kërcënime dhe rreziqe jo të pakta. Megjithatë, në kuadër të këtyre proceseve, rajoni i BP-së po përpiket t'i afrohet gjithnjë e më shumë Evropës. Proceset e demokratizimit dhe të transformimit evidentojnë tensione mes proceseve të integritimit në BE dhe fenomeneve të nacionalizmit dhe të patriotizmit në epokën e globalizimit. Tensionet e tilla në hapësirën e BP-së, të nxitura sidomos nga elemente populliste evropiane dhe nga sisteme të fuqishme autoritare, të cilat synim kanë shtrirjen e sferës së tyre të influencës në shtetet ballkanike (Rusia, Turqia, Irani), mundësojnë një ndryshim të perceptimit të identitetit vetjak kombëtar dhe kulturor me pasoja politike, të cilat njëkohësisht paraqesin shansë dhe sfidë, për rajonin e BP-së, por edhe për vetë BE-në, sidomos pas daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja.

Si rrjedhojë, ky potencial i BE-së dhe i Shteteve të saja Anëtare, të cilat ende nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, për t'i evituar kërcënimet dhe rreziqet e mjedisit të sigurisë në rajonin e BP-së dhe, për të ndërtuar paqe dhe mirëqenie stabile në të ardhmen, do të duhej që përmes njohjes së shtetësisë së Kosovës dhe procesit të integritimit të synojnë edhe zvogëlimin e dallimeve socio-politike mes rajonit të BP-së dhe rajoneve të tjera evropiane, e me këtë edhe jetësimin e rastit ideal për tejkallimin e konfliktit Kosovë-Serbi.

Tejkallimi i konfliktit Kosovë-Serbi dhe procesi i shtetformimit të Kosovës, u mundësua nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe ishte rezultat i një plani të negociuar ndërkombëtar, i njohur edhe si Plani i Ahtisaarit. Megjithatë, çështja e mosnjohjes nga shumë shtete të botës dhe nga pamundësia e anëtarësimit në mekanizmat dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, e kanë

bërë shtetin e Kosovës, të vazhdojë të jetë ende një lloj *sui generis* në marrëdhëniet dhe në të drejtën ndërkombëtare. Gjithashtu, çështja e veriut të vendit, e cila ende paraqet një çështje serioze politike, ekonomike dhe të sigurisë. Në këto, por edhe në shumë çështje të tjera të hapura, raporti i Serbisë karshi Kosovës, respektivisht kontestimi i shtetësisë së saj, mbetet faktor shumë i rëndësishëm. Prandaj, për të zgjidhur sfidat e brendshme socio-ekonomike dhe të rendit ligjor si dhe ato të jashtme, të cilat jo vetëm që e dëmtojnë Kosovën, por do ta lëjnë tërë rajonin të tensionuar dhe peng në proceset integruese evropiane, është paraqitur nevoja imediate e fillimit të negociatave mes dy shteteve për të gjetur zgjidhje të pranueshme për të dyja palët. Nisur nga përvojat historike, si dhe nga marrëdhëniet e acaruara mes Kosovës dhe Serbisë, ndërmjetësimi nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ka qenë më se i domosdoshëm. Në këtë rast, BE-ja morri rolin vendimtar si në ndërmjetësimin e bisedimeve ashtu edhe në garantimin e marrëveshjeve të arritura. Meqenëse, kjo nismë nuk do të ishte tërësisht pa kundërshtime të shumta politike, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, këto bisedime fillimisht u emërtuan me eufemizëm e me terma të butë diplomatik, u udhëhoqën nga nivelet më pak të rëndësishme zyrtare dhe u nisen nga çështje më pak delikate. Sidoqoftë, me kalimin e kohës u zhvilluan raunde të ndryshme bisedimesh dhe ky dialog filloi të merrë gjithnjë e më shumë karakter politik, duke kulmuar me takime mes kryeministrave dhe përfundimisht me marrëveshjen mes tyre me 19 prill 2013, e cila u emërua më vonë si “Marrëveshja e Brukselit”.

Roli i rëndësishëm ndërmjetësues, i fuqisë realpolitike të BE-së, në rastin e dialogut Kosovë-Serbi, do të duhej të ishte i ndërlidhur ngushtë me efektivitetin në proceset ndërmjetësuese, për mundësinë e garantimit të qëndrueshmërisë dhe të implementimit të marrëveshjeve të arritura, në mënyrë që të stimulojë apo shtyjë palët t’i respektojnë ato dhe t’u përmbahen. Një mbështetje e projektuar mirë dhe efektive për përpjekjet e ndërmjetësimit në këtë dialog, do të

luajë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e imazhit të mëtejshëm të politikës së jashtme të BE-së.

1.1. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Duke u nisur nga fakti se roli i BE-së si ndërmjetësues është temë komplekse dhe e një rëndësie të veçantë, e shtjelluar, analizuar dhe e hulumtuar, por që ka ende hapësirë dhe nevojë të studiohet dhe të thellohet, me të dhëna dhe me fakte të reja, që të jetë sa më gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh interesin tonë hulumtues për rolin, efektivitetin, mundësitë dhe sfidat e ndërmjetësimit të BE-së. Projekti doktorial në fjalë i përket shkencave juridike, diplomacisë, shkencës së politologjisë dhe MN, prandaj mendojmë se hipoteza rreth kësaj teme do të duhej të jetë e bazuar në argumenta që i përkasin shkencave në fjalë, si dhe në influencimin e studim rastit konkret, të dialogut Kosovë-Serbi.

Hipoteza – Riaktivizimi i rolit të BE-së përmes “fuqisë së butë” në ushtrimin e një roli ndërmjetësues në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, duke përdorur ndikimin e procesit të zgjerimit dhe qasjet e ambiguitetit e neutralitetit për zgjidhjen e konfliktit dypalësh.

Në pyetjet parësore hipotetike, studimi do të përpiqet të ofrojë përgjigjet e duhura gjatë hulumtimit:

- Si do të mund të konceptohej roli dhe efektiviteti ndërmjetësues i BE-së?
- Cilët do të ishin faktorët ndikues në rolin dhe në efektivitetin e BE-së si ndërmjetësues, në rastin konkret?
- A do të arrijë shteti i Kosovës që përmes këtij dialogu, të ndërmjetësuar nga BE-ja të përforcojë integritetin territorial, të vendos marrëdhënie normale me shtetin serb?

Pyetjet e shtruara ndërtojnë hipotezën e punimit dhe nxisin analizën e dhënë në kapitujt e këtij punimi.

1.2. Qasja

Kjo tezë trajton pyetjet e shtruara më lartë, duke u përqendruar së pari në historikun dhe anën teorike të ndërmjetësimit, si të një mjeti diplomatik, në përshtatshmërinë e qasjeve ndërmjetësuese, që ndërlidhen me arritjen e çfarëdo lloj marrëveshjeje, e më pas në analizën e ndërmjetësimit ndërkombëtar, në shtjellimin e kuptimit të suksesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar, në hulumtimin e rolit dhe të efikasitetit të BE-së, si ndërmjetësues i paqes, përmes konceptit të “fuqisë së butë”, me fokus të veçantë në studim rastin e punimit, në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Pas prezantimit të punimit, sa i përket abstraktit, hyrjes dhe qasjeve në tezë, të cilat jepen në kapitullin e parë, puna vazhdon me kapitullin e dytë i cili hulumton dhe analizon qasjet, modelet dhe teoritë mbi studimin e ndërmjetësimit, duke identifikuar teorinë e lehtësimit, si teorinë më të përshtatshme mbi hulumtimin e rolit të BE-së, si një palë e tretë ndërmjetësuese dhe të studim rastit tonë konkret, të dialogut Kosovë-Serbi. Në vazhdim përqendrohet në konceptin teorik mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, si dhe ofron një pasqyrë mbi karakteristikat përcaktuese të ndërmjetësimit ndërkombëtar. Kapitulli i tretë, shqyrton kuptimin e suksesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar me theks në faktorët përcaktues të suksesit apo dështimit të ndërmjetësimit dhe të faktorëve kontekstualë, për të vazhduar me kapitullin e katërt, i cili fillon me thelbin e këtij punimi, hulumtimin e rolit dhe efikasitetit të BE-së, si ndërmjetësues i paqes përmes “fuqisë së saj të butë”, duke sqaruar konceptin e fuqisë dhe praktikën e ndërmjetësimit, rrugëtimin institucional në ndërmjetësim, efektivitetin ndërmjetësues në negociata paqeje si dhe Konceptin mbi Fuqizimin e Kapaciteteve të Ndërmjetësimit dhe Dialogut të BE-së, e cila përfaqëson referencën kryesore konceptuale dhe politike për qasjen e BE-së ndaj ndërmjetësimit dhe përcakton role të ndryshme dhe parime udhëzuese të ndërmjetësimit të BE-së. Në vazhdim, analizon konceptet dhe qasjet e BE-së në dialog, ambigualitetin apo dykuptimësinë kreative dhe rikontekstualizimin e dialogut, përdorimin e tyre në politikat e BE-së dhe qasjen e saj

“neutrale ndaj statusit”, si dhe implikimet dhe ndikimin e tyre në dialog, duke u përmbyllur me strategjitë e përdorura të OKB-së dhe BE-së në konflikt dhe me dallimet mes tyre. Më pas kapitulli i pestë ngërthen analizën e procesit të zgjidhjes së konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë, kontekstin historik të marrëdhënieve si dhe analizën e studim rastit të punimit, procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, duke përfshirë ide dhe propozime për të kaluar në fazën përmblyëse të procesit të dialogut, mbështetur në intervistat e dhëna të faktorëve relevant vendor dhe ndërkombëtar, të analistëve dhe njohësve të çështjes, si dhe në reagimet dhe sugjerimet ndikuese të faktorit ndërkombëtar. Në fund, kapitulli i gjashtë përmblyës, ofron një pasqyrë konkluzionesh të dala nga punimi. Punimi do të marrë për bazë qëndrimet e studiuesve mbi ndërmjetësimin, në veçanti të Bercovitch, Gartner dhe Jackson, Touval dhe Zartman, Princen et al., duke u mbështetur edhe në qasjet psiko-sociale (nga arsyeja se ndërmjetësimi dhe paqebërja ende janë bastione të praktikuesve, që mbështeten kryesisht në qasjet psikologjike dhe sociologjike), në lidhjet mes tyre, në shqyrtimin e ndërmjetësimit si proces dhe si mjet diplomatik.

1.3. Metodologjia

Në funksion të qëllimit dhe të objektivave, kemi identifikuar e përzgjedhur metodat, teknikat dhe instrumentat e duhur që përbejnë aspektet metodologjike të kërkimit shkencor. Gjatë punës hulumtuese, mbi temën e studimit, kemi përdorur metodat e hulumtimit cilësor. Zgjedhja e metodave është bërë në bashkëpunim të ngushtë me mentorin si dhe në konsultim me profesorë ekspertë të lëmisë së hulumtimit. Punimi si studim cilësor, mundëson analizimin e procesit të ndërmjetësimit dhe kuptimin se çfarë është ndërmjetësimi në një kuptim teorik dhe shkencor dhe çfarë është ndërmjetësimi i BE-së dhe roli i saj, si ndërmjetësuese, në studim rastin konkret, të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Mendojmë se roli i BE-së dhe efektiviteti i saj si ndërmjetësuese, supozon analizën e hapësirës vepruese nga këndi i më

shumë disiplinave shkencore. Aty janë në radhë të parë shkencat juridike, diplomacia dhe MN, të cilat e cilësojnë atë si “fuqi të butë”. Si studim cilësor përqendrohet në një rast të vetëm, në rolin ndërmjetësues të BE-së, të studim rastit konkret, dialogut Kosovë-Serbi, me ç’rast herë-herë mund të jepen edhe shembuj të ngjashëm. Si i tillë, mënyra e mbledhjes së të dhënave, përfshin një gamë të mjaftueshme, me qëllim të formimit të një pasqyre më të thellë të studim rastit, përmes mundësive për diskutime intensive të ideve, të hipotezave dhe të evidencave empirike. Siç deklaroi Creswell (2003: 141-144), procedurat cilësore qëndrojnë në kontrast të thellë me metodat e hulumtimit sasior. Hulumtimi cilësor përdor kërkesa të ndryshme të njohurive, strategji të hulumtimit dhe metoda të grumbullimit dhe analizës së të dhënave. Megjithatë, proceset janë të ngjashme, procedurat cilësore që mbështeten në të dhënat e tekstit dhe imazhit, kanë hapa unik në analizën e të dhënave dhe përdorin strategji të ndryshme të hulumtimit. Hulumtimi cilësor përdor metoda të shumta që janë interaktive dhe humaniste. Metodatat e grumbullimit të të dhënave rriten dhe ato gjithnjë e më shumë përfshijnë pjesëmarrësit aktiv dhe ndjeshmërinë ndaj tyre në studim. Edhe pse studim rasti bazohet në kontekst specifik, me veçori kryesisht analitike e që i bën të mundshme interpretimet e mira, ky lloj studimi i ka edhe mangësitë e veta. Studimet cilësore të rasteve janë të kufizuara nga ana e ndjeshmërisë dhe integritetit të hulumtuesit. Studiuesi është instrumenti kryesor i mbledhjes së të dhënave dhe analizës. Të dhënat e nevojshme për t’iu përgjigjur pyetjeve kërkimore janë grumbulluar përmes metodave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave cilësore. Creswell (2003: 148-149) mbi të dhënat e nevojshme thekson se “ideja prapa hulumtimit cilësor është të përzgjedhë qëllimisht pjesëmarrësit, dokumentat ose materialet vizuale, që studiuesi të kuptojë çështjen dhe pyetjen kërkimore”. Përderisa jep shpjegime mbi hapat e grumbullimit të të dhënave, ai shton se “hapat e grumbullimit të të dhënave përfshijnë përcaktimin e kufijve të studimit dhe mbledhjen e informacionit”. Të gjitha këto, sipas tij,

realizohen “përmes vëzhgimeve të strukturuar dhe intervistave, dokumentave, materialeve vizuale, si dhe vendosjen e protokollit për regjistrimin e informacionit”. Me qëllimin e mbledhjes së informacioneve me vlerë, në këtë projekt janë përzgjedhur ato metoda kërkimore cilësore, duke përfshirë edhe metodën e studimit të rasteve dhe grumbullimin e të dhënave, të cilat përfshijnë literaturën e gjerë mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, me interes më të theksuar Konceptin e BE-së mbi ndërmetësimin, të vitit 2009, në kuptimin teorik dhe shkencor, si dhe artikuj revistash akademike, botime dhe burime të tjera, intervista indirekte të huazuara, dhe analizën e dokumentave, duke siguruar kështu njohuri domethënëse, fakte kredibile mbi rastin, si dhe marrjen e informacioneve me vlerë, sipas karakteristikave të procesit të hulumtuar.

Studiuesit cilësor, sipas Marshall dhe Rossmann (2006: 97), zakonisht mbështeten në katër metoda në grumbullimin e informacioneve: (a) pjesëmarrjen në mjedis, (b) respektimin direkt, (c) intervistimin në thellësi, dhe (d) analizimin e dokumenteve dhe materialeve kulturore. Pasi pjesëmarrja direkte e studiuesit të rastit në mjedis nuk ishte e mundur, atëherë është përdorë metoda e intervistimit. Duke hasur në vështirësi për realizimin e intervistave direkte, kemi huazuar intervista të ndryshme. Sipas gjykimit tim, ato intervista indirekte ishin me vlerë për ta kompletuar projektin me të dhëna të reja. Pastaj kemi bërë analizimin e tyre, të dokumentave dhe të materialit në dispozicion në dobi të rastit dhe me qëllim të kompletimit të studim rastit konkret. Poashtu, duke iu përmbajtur vëzhgimit bashkëkohor, si të “një metode thelbësore dhe shumë të rëndësishme në të gjitha hulumtimet cilësore” (Marshall dhe Rossmann, 2006: 99), kemi analizuar materiale publike ditore në dispozicion, mbi zhvillimet në bisedime të ndërmjetësuara mes dy delegacioneve zyrtare. Me qëllimin e përmbledhjes së historikut të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, kemi analizuar literaturë, dokumenta, shkrime akademike dhe deklarata zyrtare, nga organizata apo zyrtarë.

Literatura e shqyrtuar në këtë punim përqipet të nxjerrë në pah kuptimin teorik dhe shkencor të ndërmjetësimit ndërkombëtar, si të një mjeti të rëndësishëm diplomatik për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në mënyrë paqësore dhe në kuadër të saj edhe kuptimin e rolit dhe efektivitetit të BE-së si ndërmjetësues, në studim rastin konkret, në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, duke filluar nga zanafilla, mospajtimet mes palëve, dallimet në qëndrime, rritjes së mosmarrëveshjes e deri në përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Gjatë këtij studimi kemi gjetur gjurmët e interesit të studiuesve të ndryshëm për trajtimin teorik të ndërmjetësimit dhe koncepteve të ndërlidhura me të. Studimi është zhvilluar, duke nisur me përkufizimet dhe teoritë mbi ndërmjetësimin si proces, si të një mjeti diplomatik apo edhe si të një metode të bazuar në interes. Autorë të ndryshëm të rëndësishëm, tek të cilët kemi gjetur mbështetje teorike mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar dhe me interes të veçantë, mbi ndërmjetësimin dhe efektivitetin ndërmjetësues të BE-së, janë autorët e mirënjohur si, Bercovitch, Rubin, Touval, Zartman, Liebmann, Glenny, Eckstein, Fritz, Moore, Princen, Gartner, Hjuston, Kleiboer, Jackson, Anagnoson, Wille, Beardsley, Greig, Diehl, Wallenstein, Svensson, Young, Folberg, Taylor, Bergmann, Niemann, Girke, Davis, dhe të tjerë. Jacob Bercovitch në librin “Zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare: Teoria dhe praktika e ndërmjetësimit” dhe studimet e tij mbi ndërmjetësimin, paraqesin vlerësime të rëndësishme mbi ndërmjetësimin, si të një forme të menaxhimit ndërkombëtar të konfliktit. Përmes analizave dhe fakteve të ofruara prej tij, kemi arritur të kuptojmë më në thellësi konceptin e ndërmjetësimit. Derisa në dallimin e procesit të ndërmjetësimit, qoftë si koncept, qoftë si praktikë, nga alternativat e tjera të zgjidhjes së konfliktit, mbështetje teorike kemi gjetur edhe në studimet e autorëve Susskind, Stulberg, Riskin, Wehberg, Brown, Scott, Cervenak, Fairman. Ata qartësojnë edhe elementet që e bëjnë ndërmjetësimin të dallojë nga praktikat e tjera të zgjidhjes së konfliktit. Të rëndësishme janë edhe referencat e përfituara nga botimet

historike mbi Ballkanin, të autorëve të mirënjohur si, Brzezinski, Johnsen, Altmann, Batt, Nathanaili, Glenny, Blank, Whachetel, Weigall, dhe të tjerë. Të dhënat e mbledhura nga metoda e analizës së dokumentit janë ato historike dhe arkivore dhe ato me natyrë juridike ndërkombëtare, rezolutat e KS të OKB-së, marrëveshjet, progres raportet, intervistat si dhe çdo dokument tjetër, kanë qenë burime të vyera për studimin tonë. Në tërësinë e tyre, ato na kanë krijuar mundësinë e depërtimit shkencor në të gjithë elementet e zinxhirit të rastit tonë të studimit. Megjithatë, metodologjia e përdorur nuk është mbështetur në një analizë më të thelluar normative të akteve të ndryshme ndërkombëtare, që paraqesin kornizën bazë mbi të cilat zgjidhen mosmarrëveshjet e ndryshme mes shteteve, duke konsideruar se një analizë e tillë, më e thelluar, i përket së drejtës ndërkombëtare. Në mesin e tyre janë, Konventa e Hagës, mbi zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, Karta e OKB-së dhe një numër i madh i akteve normative dhe i rezolutave të AP dhe KS, në të cilën thirren shtetet në raste të ndryshme, kur shfaqet ndonjë mosmarrëveshje në marrëdhëniet mes tyre. Rëndësi e veçantë dhe më e detajuar i është kushtuar rezolutave të AP dhe KS, si dhe dokumentave të Këshillit dhe Komisionit të BE-së, të cilat kishin të bënin me Kosovën, me një analizë më të thelluar të dokumentit, të emëruar si “*Koncepti mbi Fuqizimin e Ndërmjetësimit dhe Kapaciteteve të Dialogut të BE-së*”.

Duke vazhduar arsyetimin teorik kuptimor për konceptet e përdorura në këtë studim si dhe bazuar në hulumtimin e librave, referencat e studiuesve të ndryshëm, në dokumenta, artikuj akademikë dhe intervista, të dobishme për studimin tonë, përmes përdorimit të metodave të lartpërmendura, është bërë e mundur arritja e kërkimeve më cilësore dhe identifikimi i çështjeve, të cilat janë objekt studimi dhe hulumtimi në këtë punim doktoral.

1.4. Terminologjia dhe përkufizimet

Në çdo shkencë, si njëra nga pikat thelbësore qëndron një terminologji e qëndrueshme dhe tërësisht e kuptueshme. Ndërmjetësimi, si një mjet diplomatik, rrallëherë ka mundur të përkufizohet në tërësinë e vet specifike, qoftë si proces, apo si një metodë e bazuar në interes. Ndërmjetësimi ende nuk është i lehtë për t'u definuar. Shumë prej vështirësive rrjedhin nga vetë fleksibiliteti i ndërmjetësimit, nga karakteri i tij vullnetar dhe ad hoc, dhe nga fakti se praktikohet në një larmi të gjerë mjedisesh.

Fillimisht, si e përkufizojmë dhe e dallojmë ndërmjetësimin nga format e tjera të ndërhyrjeve paqësore? Në literaturë ekziston pak konsensus se si do të duhej përcaktuar ndërmjetësimi, apo variablat tjera kyçe. Studiues nga disiplina të ndryshme ofrojnë përkufizime të ndryshme, duke shkaktuar konfuzion dhe fragmentim. Nëse i sintetizojmë disa aspekte nga literatura mbi ndërmjetësimin, do të formësojmë një përkufizim i cili do të lejojë krijimin e një kornize kontekstuale mbi procesin. Fjalori i Drejtësisë - Universiteti në Oksford - ndërmjetësimin e cilëson si një metodë e cila përpiqet të pajtojë pretendime të kundërta dhe të lehtësojë çdo ndjenjë pakënaqësie mes palëve (A Dictionary of Law, 2015: 394).

Për një kohë të gjatë, studimi i ndërmjetësimit ka vuajtur nga pasaktësi konceptuale dhe mungesa befasuese e informacionit. Praktikuesit e ndërmjetësimit, formal ose joformal, në arenën e brendshme ose ndërkombëtare, ishin të prirur të mbështesnin imazhin e tij si të një praktike misterioze, të ngjashme me një formë arti, duke u zhvilluar pas dyerve të mbyllura (Bercovitch, 1997: 130). Studiuesit janë të kujdesshëm edhe në dallimin e procesit të ndërmjetësimit, qoftë si koncept, qoftë si praktikë, nga alternativat e tjera të zgjidhjes së konfliktit (Susskind, 1981; Stulberg, 1981; Riskin, 1997). Ata qartësojnë edhe elementet, që e bëjnë ndërmjetësimin të dallojë nga praktikat e tjera të zgjidhjes së konfliktit. Në mesin e alternativave që përdoren për zgjidhjen e konflikteve, ndërmjetësimi përfaqëson vetëm njërin prej tyre. Ajo që e dallon, jo vetëm ndërmjetësimin nga alternativat e tjera, por edhe vetë

alternativat nga njëra tjetra, është karakteri imponues apo joiponues i zgjidhjes dhe karakteri vullnetar apo i detyruar i pjesëmarrjes në proces. Në këtë kuptim, ndryshe nga mjetet e tjera diplomatike e gjyqësore, që karakterizohen nga fuqia imponuese, ndërmjetësimi bën pjesë në grupin e atyre alternativave që kanë karakter joiponues dhe vihen në veprim vetëm kur ekziston vullneti i palëve për të zgjidhur konfliktin përmes pjesëmarrjes në proces. Hans Wehberg (1958: 202-207), shpjegon dallimin mes ndërmjetësimit dhe alternativave të tjera të zgjidhjes së konfliktit dhe konstaton se, “ndërmjetësimi ndryshon nga mjetet e tjera kryesisht në shkallën e iniciativës së lejuar jodetyruese të palës së tretë. Dallimi më i përgjithshëm i ndërmjetësimit nga alternativat e tjera është, se, ai i anashkalon procedurat tradicionale të ankimit dhe nuk është i varur nga respektimi i proceseve dhe procedurave të vendosura më parë. Gjithashtu, as nuk influencohet, as nuk merr parasysh proceset apo marrëveshjet e mëparshme ekzistuese mes palëve, nisur nga logjika se palët në konflikt, duhet të jenë të lira të negociojnë rezultatin e procesit dhe të mosmarrëveshjes mes tyre (Brown et al., 1998: 2-4). Studime të ndryshme akademike, në definimin e përkufizimit të ndërmjetësimit, përdorin edhe terminologji të caktuar, duke i specifikuar edhe termet e caktuara dhe duke e bërë dallimin mes tyre. Përveç përdorimit të terminologjisë së caktuar, studiuesit përmes përkufizimeve ofrojnë edhe ndryshime për nga termi i objekteve metodologjike dhe shpjegime dalluese mes kategorive. Studiuesi Omer Shapira, në librin e tij “A Theory of Mediators' Ethics” flet për ndërmjetësimin dhe etikën, dhe ofron të dhëna për ndryshimet terminologjike mes përkufizimeve, duke theksuar se,

“në mesin e përkufizimeve mbi ndërmjetësimin, disa nga ato ndryshojnë për nga termi i objekteve metodologjike dhe nëse ato janë normative ose përshkruese, përkufizimet mbi ndërmjetësimin pretendojnë të kapin thelbin e veprimeve dhe të kontribuutit të ndërmjetësuesit, duke u bazuar në këtë, të bëjnë dallimin në mes ndërmjetësimit dhe proceseve të tjera të ngjashme, si dhe të theksojnë atributet e ndërmjetësuesve” (Shapira, 2016: 83-176).

Si elemente kyçe të procesit të ndërmjetësimit, Bercovitch dhe Regan (1997: 188), e konsiderojnë natyrën, nivelin e pëlqimit dhe nivelin e shtrëngimit të kërkuar për të arritur një zgjidhje. Bercovitch dhe Rubin (1992: 2-29) konstatojnë se “ndërmjetësimi ndërkombëtar është ai i ndërveprimit kompleks, ndryshues dhe dinamik mes një të huaji ose një pale të tretë me interes në konflikt”. Touval dhe Zartman (2001: 427), pretendojnë se ndërmjetësimi duhet të kuptohet si një “proces politik, pa angazhim paraprak nga palët për të pranuar idetë e ndërmjetësuesit”. Kontribues në zhvillimin teorik të procesit të ndërmjetësimit është edhe Marian Liebmann. Ai në studimin e tij, “Mediation in Context”, ndërmjetësimin e përkufizon si, “një proces me të cilin një palë e tretë, e paanshme, ndihmon dy palët kundërshtare që të punojnë se si të zgjidhin një konflikt. Por, ai shton edhe se “palët kundërshtare, jo ndërmjetësuesit, vendosin kushtet e ndonjë marrëveshjeje të arritur. Ndërmjetësimi fokusohet në sjelljen në të ardhmen dhe jo në të kaluarën” (Liebmann, 2000: 10-38).

Sa i përket terminologjisë dhe termit “ndërmjetësimi ndërkombëtar”, ai përshkruan përpjekjet e ndërmjetësimit në të cilat ndërmjetësuesi ose njëra nga palët në konflikt është me shtetësi tjetër, në raport me palët tjera të përfshira në proces.

Në politikën ndërkombëtare, në *kommunikimin politik ndërkombëtar*, ndërmjetësimi nuk është një fenomen i ri dhe shfrytëzimi i tij për të zgjidhur konfliktet, daton që nga historia e Greqisë dhe Romës antike (Eckstein, 1988, 2002). Sipas ekspertit të së Drejtës Ndërkombëtare Publike, Zejnullah Gruda (2007: 483-485), “ndërmjetësimi ndërkombëtar ishte i njohur dhe përdorej përgjatë historisë, varësisht nga kërkesa dhe nga palët në konflikt”.

Sot, në kuadrin e ndërmjetësimit për zgjidhjen e krizave është rritur roli i Organizatave ndërkombëtare të tilla, si: OKB, NATO, BE, OSBE, si dhe Nismave Rajonale të iniciuara dhe të mbështetura nga Fuqitë e Mëdha. Në Kartën e OKB-së paqeruajtja përcaktohet nga Kapitulli IV, si një mjet që mund të kërkohej nga KS i OKB-së për zgjidhjen paqësore të

mosmarrëveshjeve. Neni 33 i Kartës përshkruan një sërë veprimesh që përfshijnë “negocimin, hetimin, ndërmjetësimin, pajtimin, arbitrazhin, zgjidhjen gjyqësore, mjetet për agjencitë rajonale dhe aranzhimet ose mjetet tjera paqësore të zgjedhjes së tyre” (Karta e OKB-së, neni 33, paragrafi 1: 8). Po ashtu, ky nen ka përcaktuar, se Shtetet Anëtare, krahas mjeteve të tjera, të përdorin edhe ndërmjetësimin si një nga mënyrat më të rëndësishme për zgjidhjen e konflikteve.

Derisa ndërmjetësimi ndërkombëtar është një proces reciprok, pjesa më e madhe e literaturës ka tendencë ta paraqesë atë si statik dhe të vetëm. Bercovitch (1996: 6) pretendon se, “shumë është humbur duke injoruar ndërveprimin reciprok mes palëve kundërshtare dhe ndërmjetësuesit”. Jan Marie Fritz, arrin të konstatojë se,

“ndërmjetësimi është një proces krijues jo kontradiktor, gjysmë i strukturuar, në të cilin një ose më shumë individë të paanshëm i ndihmojnë palët kundërshtare. Si proces është i ndërlidhur me shumë disiplina dhe është i disponueshëm në lloje të ndryshme mjedisesh” (Fritz, 2014: 49).

Në “formën e pastër” të tij, në analizat e studiuesit Moore (2003: 15), ndërmjetësimi konsiderohet si një metodë e bazuar - në interes. Prandaj, baza për përcaktimin e ndërmjetësimit do të ishte se, ndërmjetësimi është “një metodë e besueshme dhe vullnetare përmes një procesi të strukturuar, ku një apo palë të treta asistojnë palët të arrijnë një zgjidhje të kënaqshme të përbashkët”. Poashtu, konsiderohet e domosdoshme të theksohet se “ndërmjetësuesi siguron një kornizë dhe drejton ndërmjetësimin, por nuk bën sugjerime të konsiderueshme apo vendime në rast”. Thomas Princen (2014: 7-66), në studimin e tij “Intermediaries in International Conflict” konstaton se, roli i një ndërmjetësuesi është dinamik dhe “aftësia e ofrimit të informacioneve shpjen në atë që ndërmjetësuesi të ketë ndikim në strukturat e kompensimit të palëve kundërshtare”. Ai vëren se “kur ndërmjetësuesit i marrin informatat dhe e arrijnë ndikimin, ata rrezikojnë të humbasin statusin e tyre të paanshëm”. Gartner dhe Bercovitch (2006: 819–840) ndërmjetësimin e shohin si një zgjerim të konfliktit

bilateral me aspektet të cilat formësojnë dhe ndikojnë në përzgjedhjen, procesin dhe rezultatin e ndërmjetësimit. Derisa Bercovitch dhe Hjuston shtojnë se,

“për ta kuptuar procesin e ndërmjetësimit nevojitet një përkufizim i pranueshëm, i cili duhet të ngërthejë në vete tiparet e gjera dhe gjithëpërfshirëse të këtij procesi dhe të jetë relevant për studimet e mosmarrëveshjeve, luftërave dhe krizave, si një parakusht dhe një domosdoshmëri primare për të kuptuar këtë realitet kompleks” (Bercovitch dhe Hjuston, 2000: 171).

Por, në një definicion edhe më gjithëpërfshirës, duke i theksuar karakteristikat më përcaktuese të procesit të ndërmjetësimit, Bercovitch dhe Jackson mbajnë qëndrimin se afirmimi i ndërmjetësimit ndërkombëtar, si e një metode për menaxhim të konfliktit, mund të jetë në korelacion me karakteristikat e tij përcaktuese, në këtë rast ndërmjetësuesit sjellin me vete, idetë, njohuritë, burimet dhe interesat e tyre ose të grupit që përfaqësojnë dhe shpeshherë i kanë supozimet dhe agjendat e tyre rreth konfliktit në fjalë. Ata, në studimin e tyre, arrijnë të argumentojnë se,

“ndërmjetësimi përfaqëson një formë të ‘negociatave të asistuar’, në të cilën një aktor i jashtëm, si një palë e tretë, ndërhyr në një konflikt në mënyrë vullnetare, jodetyruese, që të ndikojë, ndryshojë dhe të ndalojë tendencat destruktive dhe karakterin e marrëdhënieve të mëparshme mes palëve kundërshtare. Si një aktivitet vullnetar, joshtrëngues dhe ligjërish jodetyrues, është veçanërisht praktik duke pasur parasysh dinamikën e ndërlikuar të marrëdhënieve ndërkombëtare që dominohen nga parimet e ruajtjes së pavarësisë dhe autonomisë së aktorëve” (Bercovitch dhe Jackson, 2009: 33-46).

Në metodën e ndërmjetësimit, me anë të cilit mundësohet që palët të arrijnë të zgjidhin një mosmarrëveshje, roli i palës së tretë është specifik dhe i veçantë. Kjo do të thotë se “ekziston një aktor i jashtëm” që është qendror, shpesh i përshkruar si një palë e tretë, i cili “nuk ka autoritet për të imponuar një rezultat” (Wall, Stark dhe Standifer, 2001: 375). Disa studiues ofrojnë fakte se, ndërmjetësimi është “një proces vullnetar, në të cilin palët mbajnë kontroll mbi rezultatin (ndërmjetësimi i pastër), edhe pse mund të përfshijë nxitje (ndërmjetësimi me muskuj) pozitive dhe negative” (Miall, Ramsbotham dhe Woodhouse, 1999: 21-22). Në mesin e studiuesve ka edhe debate nëse “ndërmjetësimi me muskuj” është më efektiv se llojet e tjera të ndërmjetësimit dhe nëse përpjekjet paqësore të ndërmjetësimit rriten ose dëmtohen nga përdorimi i forcës ushtarake të palës së tretë. Në fakt, ekziston një boshllëk i qartë në

hulumtimin e një pyetjeje të tillë specifike, megjithëse duhet të jetë e mundur të studiohen efektet e ndërmjetësimit në kombinim me, për shembull, përdorimin e sanksioneve, kërcënimeve për ndjekjen penale të krimeve të luftës. Beardsley (2011: 18) është shprehur qartë në përcaktimin e “mbështetjes së palës së tretë në taktikat e padhunshme”, derisa studiues të tjerë nuk specifikojnë qartë se çfarë lloj “ndihme” ofron pala e tretë. Autorët, Greig dhe Diehl (2012: 2), duke hulumtuar mbi procesin e ndërmjetësimit argumentojnë se “ndërmjetësimi është një instrument i menaxhimit të konfliktit që mund të zbatohet në një llojllojshmëri të gjerë të llojeve të konfliktit. Derisa Wallensteen dhe Svensson ” (2014: 315) konsiderojnë se “sikurse në konfliktet e dhunshme ashtu edhe në ato jo të dhunshme, ndërmjetësimi konsiderohet një instrument i rëndësishëm i paqebërjes ndërkombëtare”.

Baza e të Dhënave mbi Menaxhimin e Konflikteve Ndërkombëtare, si baza më e përdorur e të dhënave në kërkim të ndërmjetësimit, identifikon numër të lartë të përpjekjeve individuale të ndërmjetësimit në konflikte të ndryshme, që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Siç demonstrojnë Greig dhe Diehl (2012: 32-33), gjatë viteve të 1990-ta, kanë ndodhur më shumë përpjekje ndërmjetësimi, se sa gjatë tërë periudhës së Luftës së Ftohtë dhe sipas studiuesve, “kjo prirje si duket do të mbetet” (Themner dhe Wallensteen, 2013: 7-8)

Duke pasur parasysh larminë e konteksteve, në të cilat mund të zbatohet ndërmjetësimi, nuk është befasuese të gjendet një gamë e gjerë e përkufizimeve dhe konceptualizimeve të ndërmjetësimit, të përdorura në hulumtimin dhe në praktikën e ndërmjetësimit. Në burimet akademike, përkufizimet ndryshojnë kryesisht në lidhje me: (1) veçoritë e ndryshme të ndërmjetësimit në krahasim me mjetet e tjera të menaxhimit të konfliktit, (2) rolin dhe sjelljen e ndërmjetësuesit, dhe (3) qëllimin e përgjithshëm të ndërmjetësimit. Të tjerët e perceptojnë neutralitetin ose paanshmërinë e ndërmjetësimit të palëve të treta, si një karakteristikë kyçe të ndërmjetësimit (Folberg dhe Taylor, 1984: 7), duke u fokusuar në stilin e veçantë të

ndërmjetësimit. Në përgjithësi, shumica e përkufizimeve ndajnë sa vijon: karakteristikën e përfshirjes së një pale të tretë në menaxhimin e konfliktit; theksin mbi natyrën vullnetare dhe jo të dhunshme të ndërmjetësimit dhe të karakterit jodetyrues të rezultateve të ndërmjetësimit. Përkufizimi i BE-së mbi ndërmjetësimin, i formuluar në Konceptin e vitit 2009, është disi më i gjerë në kuptimin që e përcakton ndërmjetësimin si një mjet për transformimin e konfliktit, por edhe më saktësisht në përcaktimin e rolit të ndërmjetësuesit i cili “është i përfshirë në procesin dhe përmbajtjen e negociatave duke bërë sugjerime dhe propozime” (Këshilli i BE-së, 2009: 2-3). Bergmann dhe Niemann, në përkufizimin e tyre, i referohen ndërmjetësimit të BE-së, si “çdo përpjekje e aktorëve individual ose kolektiv që përfaqësojnë BE-në për të ndihmuar negociatat mes palëve në konflikt dhe për të ndihmuar ata të arrijnë një marrëveshje për konfliktin e tyre” (Bergmann dhe Niemann, 2015: 959). Ky përkufizim është i përshtatshëm për disa arsye. Së pari, ai specifikon më tej dimensionin e aktorëve të përpjekjeve të ndërmjetësimit të BE-së. Ashtu siç me të drejtë thekson Girke (2015: 513), “në sistemin e politikës së jashtme të BE-së nuk është krijuar asnjë procedurë formale e mandatimit për ndërmjetësim”, që nënkupton se ndërmjetësimi mund të zbatohet nga një varg aktorësh të ndryshëm, në nivele të ndryshme të politikës së jashtme të BE-së, duke përfshirë Përfaqësuesin e Lartë, EUSER-ët e BE-së, Shefat e delegacioneve të BE-së dhe personelin e CSDP-së, Presidencën e Këshillit dhe Anëtarët e PE-së (Davis, 2014: 97). Si pikë e rëndësishme për t’u theksuar, është fakti se këta aktorë veprojnë në cilësinë e tyre si përfaqësues të BE-së. Së dyti, ai kufizon fokusimin në përfshirjen e BE-së në negociata, e cila, nga ana tjetër, nënkupton që përpjekjet e diplomacisë lëvizëse (shuttle diplomacy) dhe të zyrave të mira, si instrumenta të menaxhimit të konfliktit, të cilat faktikisht nuk kërkojnë që palët të negociojnë me njëra tjetrën, më tepër do të konsiderohen si aktivitete mbështetëse të ndërmjetësimit.

Nga përkufizimet e dhëna, qartësohet se, realiteti i ndërmjetësimit, është ai i një ndërveprimi kompleks, ndryshues dhe dinamik mes një të huaji ose një pale të tretë, me interes në konflikt ose në rezultatin e tij dhe të protagonistëve apo përfaqësuesve të tyre, dhe po ashtu se ndërmjetësimi është një proces vendimmarrës në të cilin ndërmjetësuesit mund të ndryshojnë rolin apo identitetin e tyre, çështjet mund të ndryshojnë, madje mund të ndryshojnë edhe ata që janë përfshirë në të.

1.5. Struktura e temës

Tema në fjalë, mund të trajtohet si një gërshetim i teorive dhe i situatave reale, me qëllim të së mundëshmes të një ndërlidhjeje mes asaj se çfarë thuhet në teori dhe si vepohet në praktikë. Për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të kuptuar se si në të vërtetë funksionon procesi i ndërmjetësimit ndërkombëtar, dhe në interesin tonë të ndërmjetësimit të BE-së, brenda studim rastit konkret, është vepruar brenda një kornize të qartë teorike, janë miratuar qasje sistematike empirike dhe janë përdorur një larmi metodash për të identifikuar ndërveprimet, kontekstet dhe marrëdhëniet.

Studimi “Roli ndërmjetësues i BE-së në dialogun Kosovë-Serbi” ka në përbërje gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë paraqitet pjesa hyrëse e temës, ku jepet fokusi i temës dhe pyetjet që kërkojnë përgjigje dhe sqarime në këtë hulumtim. Është përshkruar qasja ndaj punimit dhe natyra e të dhënave të mbledhura me qëllim të ilustrimit të saktë të tyre dhe janë përshkruar konceptet kryesore të përdorura në fushën e ndërmjetësimit.

Duke trajtuar kornizën teorike, në kapitullin e dytë, shqyrtojmë qasjet, modelet, qëndrimet e debateve teorike, duke identifikuar teorinë e lehtësimit mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar të BE-së, si teorinë më të përshtatshme në studim rastin konkret. Në kapitull merren në shqyrtim qasje të ndryshme dhe kontribuesit kryesorë të qasjeve në fjalë, duke u përqendruar në konceptin teorik mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, si dhe karakteristikat përcaktuese të

ndërmjetësimit ndërkombëtar. Çdo argument, në të vërtetë argumenta të ndryshëm janë shqyrtuar e analizuar dhe pastaj janë dhënë arsyetimet për to. Në formësimin dhe zhvillimin e një kornize më kohezive mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, është dhënë mundësia e sintetizimit të Modelit të Kontigjencës të Bercovitch dhe Modelit Meta-teorik të Kleiboer si dhe qëndrimet relativiste, të fokusuara në kontekstin dhe në procesin e ndërmjetësimit, duke përfshirë këtu edhe teoritë dhe qëndrimet e debateve teorike mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, duke vazhduar diskutimin mbi konceptin teorik mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar si dhe karakteristikat e tij përcaktuese. Kuptimi i suksesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar vazhdon në kapitullin e tretë, duke ngërthyer në vete faktorët përcaktues të suksesit apo dështimit të ndërmjetësimit, siç janë: koncepti i levës, anshmëra e ndërmjetësuesit, ndikimi i asimetrisë në balancën e fuqisë dhe strategjitë në procesin e ndërmjetësimit, por edhe kontekstin kulturor me argumentimet për dhe kundër se procesi i ndërmjetësimit dhe rezultatet e tij ndikohen nga konteksti kulturor. Kapitulli i katërt, trajton ndërmjetësimin e BE-së, përmes “fuqisë së saj të butë”, praktikën, temat dhe konceptet, duke përfshirë inicuesit e ndërmjetësimit, rolet dhe strategjitë e ndërmjetësimit. Në vazhdim shpjegohet rrugëtimi institucional i BE-së në ndërmjetësim dhe arkitektura institucionale e saj mbi aktivitetet e ndërmjetësimit, por edhe efektiviteti i BE-së si ndërmjetësues paqjeje me kushtet e efektivitetit të ndërmjetësuesit. Kapitulli, poashtu, shënjestron konceptet dhe qasjet e BE-së në dialogun Kosovë-Serbi, duke ofruar njohuri mbi përdorimin e gjuhës dykuptimëshe të BE-së, të konceptit të ambigualitetit apo të “dykuptimësisë kreative”, praktikën dhe implikimet e tij, të konceptit të rikontekstualizimit të dialogut dhe të qasjes së BE-së si “neutrale ndaj statusit”, për të arritur deri tek një rezultat i suksesshëm. Në vazhdim është bërë analiza empirike e strategjive ndërmjetësuese të OKB-së dhe BE-së, me

ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Në përfundim të kapitullit flitet për një “fazë të re”, si fazë përmbyllëse të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Qasjet e BE-së mbi ndërmjetësimin si dhe rishikimi i literaturës, të pëfshira në këtë kapitull, sugjerojnë se ekzistojnë koncepte dhe qasje analitike në të dyja fushat (Studimet e Politikës së Jashtme Evropiane dhe Hulumtimet e Ndërmjetësimit Ndërkombëtar) për ndërtimin e një kornize më të plotë teorike të studimit të efektivitetit ndërmjetësues të BE-së. Kapitulli i pestë trajton procesin e zgjidhjes së konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë, përmes një pasqyrimi historik (të konfliktit politik mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb) dhe aktual mbi marrëdhëniet mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë dhe kontestimin e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nga shteti serb. Kapitulli i gjashtë, njëherit edhe kapitulli përmbyllës, jepen konkluzionet e punimit, të cilat pasqyrojnë tërë ecurinë e studimit në fjalë. Po ashtu, në kapitull, jepen edhe dokumenta dhe programe shtojcë, me qëllim të mundësisë për t'i shqyrtuar, mbase, edhe për ndonjë punim tjetër si dhe referencat dhe bibliografia e përdorur për hulumtimin në këtë temë.

Kapitulli II: Korniza teorike

Në Teorinë Politike ekzistojnë dy modele të politikave: Modeli politik i pajtueshmërisë ose i konsensusit dhe Modeli politik i konfliktit, "ndokush nga një konflikt afatgjatë përfiton"
(Kriesberg 2003: 215).

Tema mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, si një formë e menaxhimit të konfliktit, është interesante dhe shumë komplekse. Edhe pse luan një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, studimi teorik i ndërmjetësimit nuk është i integruar sa duhet në studimet e politikës ndërkombëtare. Në kontekstin historik, veprimtaria e ndërmjetësimit u shfaq në kohët e lashta dhe ishte pjesë e rëndësishme e marrëdhënieve dhe negociatave ndërkombëtare. Ndërkohë, ndërmjetësimi ka filluar të jetë më prezent gjatë periudhës së feudalizmit të zhvilluar, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat shfaqeshin mes shteteve evropiane, të cilat vendosnin se cilën formë do të përdornin për të zgjidhur mosmarrëveshjet që shfaqeshin mes tyre, a do të vinin në shprehje mjetet diplomatike për të arritur deri te zgjidhja, apo do të vendosej në funksion arbitrazhi ose do të vinte në shprehje përdorimi i forcës (Nathanaili, 2009: 84-85). Me miratimin e Konventës së Hagës (1899: 1-2), rregullimi paqësor i mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, do t'i japë një dimension tjetër.

Rëndësia e ndërmjetësimit, si proces dhe si mjet diplomatik, ka filluar të vihet në dukje gjatë dekadave të fundit të shekullit të kaluar, nga studiuesit: përfshirë veprat e Jackson (1952), Young (1967, 1972), Burton (1969), Doob (1970), Edmead (1971), Touval (1975), Campbell

(1976), Frei (1976), Fisher dhe Ury (1978), Kelman dhe Cohen (1979), Rubin (1981), Hill (1982), Touval dhe Zartman (1985).

Ndërmjetësimi, thënë ndryshe, është një mjet alternativ për të parandaluar konfliktin ose përshkallëzimin e tij (Charlton et al., 1995: 3-68), për të qenë efektiv në konflikte komplekse (Roche, 2003:630-44), për të arritur mirëkuptimin dhe pajtimin mes palëve kundërshtare (Tjosvold et al., 2005: 341-366), si dhe për të arritur në një zgjidhje të pëlqyeshme dhe të pranueshme nga të dyja palët.

Si një proces i rëndësishëm së veçantë, ndërmjetësimi bazohet mbi parimet e neutralitetit të ndërmjetësuesit, ku pala tjetër nuk konsiderohet si armik, por si palë kundërshtare, e disponimit bashkëpunues, reagimit të përgjegjshëm, vetëvendosjes dhe autonomisë, që palët marrin nga ndërmjetësuesi gjatë procesit, në funksion të arritjes së zgjidhjes së konfliktit dhe ofron privilegjin e mosparagjykit (Ridley-Duff, dhe Bennett, 2010: 11-21).

Nga ana e palëve në konflikt, rëndësia e ndërmjetësimit buron nga fakti, se garanton kontroll mbi procesin dhe rezultatin, reduktim të polarizimit, bashkëpunim dhe përfitim të dyanshëm, si dhe kohë të shkurtër e kosto të ulët të zgjidhjes së konfliktit. Dunn dhe Kriesberg, gjatë studimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve të ndryshëm në ndërmjetësim, arrijnë të vlerësojnë se,

“njohja e aftësive dhe kufizimeve të veçanta të llojeve të ndryshme të ofruesve të kombinuar me një vlerësim të kujdesshëm të përgjigjes më të përshatshme ose kombinimit të përgjigjeve, mund të lehtësojë bashkëpunimin efektiv në formimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për të sjellë rezultate konstruktive konfliktuale” (Dunn dhe Kriesberg 2002: 211).

Në mesin e studiuesve që kanë tentuar të vlerësojnë në mënyrë kritike rolin e ndërmjetësuesit në menaxhimin e konflikteve ndërkombëtare, është Thomas Princen (2014). Ai në mënyrë sistematike ka egzaminuar dimensionin e negociatave ndërkombëtare, që tradicionalisht është hulumtuar nga historianët dhe profesioni ligjor.

Gjatë dekadës së fundit edhe BE-ja është shfaqur në këtë fushë. Zhvillim domethënës në këtë drejtim, ishte miratimi i Konceptit mbi Fuqizimin e Kapaciteteve të Ndërmjetësimit dhe Dialogut të BE-së. Në këtë dokument, BE-ja formuloi planin për të përmirësuar në mënyrë sistematike kapacitetet ekzistuese të ndërmjetësimit dhe për të fuqizuar aftësinë e saj të përgjithshme për t'u angazhuar në parandalimin joushtarak të konflikteve dhe misionet e menaxhimit të krizave. Po ashtu, në Koncept theksohet se krahas rolit të saj si ndërmjetësuese “institucionale”, BE-ja mund të përmbushë edhe role të tjera të rëndësishme, me të cilat do të afirmojë praktikën e saj, duke e promovuar ndërmjetësimin, si një vlerë të bazuar në veprime joshtrënguese në fushën e zgjidhjes së konflikteve, duke siguruar leva për të arritur përkushtimin ndaj një procesi paqësor, si një mbështetëse e proceseve të ndërmjetësimit të udhëhequra nga aktorë të tjerë, dhe si bartëse e aktiviteteve të ndërmjetësimit nga aktorë joshitetërorë. Koncepti është formuluar në një mënyrë të tillë që i lejon të dyja praktikatat, aty precizohet se,

“termi ‘ndërmjetësim’ është formuluar me vetëdije që lejon qasjet e bazuara në fuqi, zakonisht duke u bazuar në mandatin nga palët në një konflikt, ndërmjetësuesi involvohet edhe në proces edhe në thelbin e negociatave duke bërë sugjerime dhe propozime, ndërsa Koncepti në mënyrë shprehimore i referohet dialogut i cili është i ngjashëm me ndërmjetësimin, por me më pak direktiva dhe është më pak i përfshirë në formësimin e thelbit të negociatave” (Koncepti i BE-së, 2009:3).

Për të zbatuar Konceptin dhe për të promovuar një qasje më sistematike të ndërmjetësimit, në vitin 2011, u krijua Ekipi për Mbështetje të Ndërmjetësimit (MST) përbrenda Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), si qendër kryesore e njohurive dhe ekspertizës ndërmjetësuese.

Megjithëse rolet, interesat dhe aktorët e ndryshëm mund të jenë më pak të paqartë në teori sesa në praktikë, është e rëndësishme të theksohet se çdo aktivitet paqeruajtës është kryesisht i kushtëzuar nga një përzierje adekuate e aktiviteteve të koordinuara mirë, të kryera nga aktorë ndërkombëtarë që ndajnë një qëllim të përbashkët në menaxhimin e një konflikti të caktuar.

Prandaj, kapitulli do të ofrojë një pasqyrë të qasjeve, në të vërtetë, të teorive kryesore që ndërlidhen me ndërmjetësimin, duke i shqyrtuar ato dhe duke shpjeguar se cila prej tyre i përshtatet më shumë studim rastit konkret, të dialogut Kosovë-Serbi dhe rolit të ndërmjetësuesit, përse është përzgjedhur dhe përse teoritë e tjera nuk ofrojnë mekanizma të fuqishëm shpjegues.

2.1. Qasjet mbi studimin e ndërmjetësimit

Qasjet në studimin e ndërmjetësimit, dallohen nga faktorët që theksojnë, supozimet që bëjnë, fokusi që kanë dhe konceptimi që i bëjnë ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit dhe palëve. Dallimet në qasje gjenerojnë edhe modele të ndryshme të ndërmjetësimit, të cilat kanë rëndësi të veçantë për ndërmjetësuesin dhe palët në konflikt. Në kushtet kur ekzistojnë modele të ndryshme ndërmjetësimi dhe kur disa prej tyre rezultojnë më efektive dhe më të suksesshme se disa të tjera, jo rrallëherë, si ndërmjetësuesi ashtu edhe palët në konflikt përballen me dilemën se cili model ndërmjetësimi është më i përshtatshëm për t'u përdorur në rastin e tyre të konfliktit.

Qasjet, modelet, strategjitë dhe teoritë mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar, kanë dallimet e tyre të rëndësishme edhe në kontekstin dhe kushtet në të cilat kryhet ndërmjetësimi. Por, qëllimi i tyre është që të shërbejnë si pikënisje për diskutimin mbi ndërmjetësimin. Në këtë rast, ndërmjetësuesit dhe palët në konflikt, së bashku, duhet të vendosin mbi llojin e tyre.

Ndërmjetësimi ka qenë prej kohësh një pjesë e rëndësishme e marrëdhënieve dhe negociatave ndërkombëtare. Por, vendi dhe roli i diplomatëve si negociatorë, ndërmjetësues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, do të rritet ndjeshëm gjatë kohës së feudalizmit të zhvilluar (Nathanaili, 2009: 74-76). Megjithatë, me Kongresin e Vjenës, të vitit 1815, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në mënyrë paqësore, do të marrë një dimension të ri. Në vitin 1899 në Hagë, do t'i zhvillojë punimet Konferenca e Hagës, në të cilën do të miratohet

Konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në formë paqësore, e cila do të plotësohet edhe njëherë gjatë vitit 1907. Mund të ceket se Konventa e Hagës, e vitit 1907, ka pasur ndikim të fuqishëm në të gjitha formulimet e mëvonshme mbi procesin e ndërmjetësimit, duke riafirmuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore (Nathanaili, 2009: 60-86).

Termi “ndërmjetësim” ka hyrë në përdorim gjatë viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, derisa hulumtimet mbi ndërmjetësimin janë shtuar në mënyrë dramatike në dekadën e fundit, gjë që ndoshta është një reflektim i përhapjes së shpejtë të ndërmjetësimit në praktikë. Kjo fushë e hulumtimit është jashtëzakonisht ndërdisiplinore, duke përfshirë kontribute të rëndësishme nga psikologë, ekonomistë, politologë, sociologë, antropologë dhe studiues nga fusha e së drejtës dhe e komunikimit. Numri më i madh i pjesëve të hershme teorike dhe empirike mbi ndërmjetësimin, kanë të bëjnë me konflikte ndërkombëtare.

Pikëpamjet, perceptimet apo perceptimet e gabuara të ndërmjetësuesit dhe të procesit të ndërmjetësimit, mund të paraqesin pengesë për një ndërmjetësim të suksesshëm, pavarësisht nëse suksesi përkufizohet si një marrëveshje për një zgjidhje kompromisi ose thjesht për krijimin e një kulture negociuese. Qasjet tradicionale të ndërmjetësimit kanë tendencë ta shohin atë nga një perspektivë e jashtme dhe për këtë arsye supozohet se një zgjidhje kompromisi është objektivi i të gjitha palëve të interesuara.

Touval dhe Zartman (2001), pretendojnë se çështja e kohës, nuk duhet të ketë theks të veçantë dhe as të neglizhohet. Supozimi i tyre është se me futjen e një pale të tretë, në kohën e duhur, në një konflikt, “pozicionet negociuese të palëve kundërshtarë ndryshohen menjëherë, pasi ata duhet të pranojnë konceptin e një kompromisi në krahasim me fitoren”. Derisa Jabri potencon se, “qasjet tradicionale të ndërmjetësimit e shohin atë si një proces të negociatave ndërmjetësuese dhe shtrënguese, që përshtatet në një kornizë pushtet-politike duke supozuar

racionalitetin” (Jabri, 1995: 54-55). Sidoqoftë, kuadri pushtet-politikë supozon se palët në konflikt kanë bërë një zgjidhje të thjeshtë mes konfliktit të dhunshëm dhe kompromisit. Palët në konflikt zgjidhin kompromisin, sepse fitorja perceptohet të jetë jashtë zotërimit të tyre dhe analizat tradicionale bien. Megjithatë, ndodh që palët të mos jenë të sinqerta, të kenë objektiva të tjerë, devijues, dhe mos të ndërlidhen me gjetjen e një kompromisi. Webb (1995: 7-31), duke e përdorur qasjen nga brenda-jashtë, (inside-out) e shqyrton ndërmjetësimin nga pikëpamja e palëve kundërshtare, të cilët mund të udhëhiqen nga objektiva që nuk ndërlidhen me gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi, edhe pse ata, në të njëjtën kohë, mund të jenë të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit me ndërmjetësuesin. Në këtë rast, sipas autorit, një kompromis mes palëve mund të jetë ende i mundur edhe pse ka pak gjasa të ndodhë.

Nëse, siç argumenton Webb, perceptimi i paprekshmërisë së konfliktit është kryesisht rezultat i veprimeve të palëve të treta ndërmjetësuese, e që si përgjigje, pala më e dobët do të provojë të rrisë numrin e aktorëve në konflikt, dhe me këtë do të mbështesë situatën në të cilën palët do të kenë në mendje objektiva devijues për ndërmjetësuesin dhe jo një zgjidhje kompromisi. Kështu që, fillimi do të jetë i vështirë, pasi që të dyja palët do të angazhohen në një betejë mbi mandatet e palës së tretë, në lidhje me objektivat e tyre devijues, jo të sinqertë. Sidoqoftë, sipas kësaj qasjeje ndërmjetësimi mund të shihet si një mjet për “objektiva devijues”. Marrëdhëniet Ndërkombëtare (MN) diskutojnë mbi perceptimin dhe keqperceptimin, si dhe mbi faktorët që e formësojnë dhe shtrembërojnë perceptimin. Lewicki (1994: 184-190), në hulumtimet e tij, si faktorë të rëndësishëm të këtij lloji i konsideron stereotipet, perceptimin selektiv (ku marrësi veçon informacionin që mbështet një besim të mëparshëm), projeksionin (në të cilin një individ krijon besimet e tij apo të saj mbi të tjerët) dhe mbrojtjen perceptuese (që rezulton në shfaqjen e informacionit kërcënues), të shkaktuara nga nevojat, motivet dhe

përvojat personale të vetë perceptuesit. Lewicki në librin e tij mbi faktorët ndikues në perceptim, konstaton:

Princen (1992: 5) konsideron se “zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga palët e treta është një nga sjelljet më të zakonshme në politikën ndërkombëtare”, duke shtuar se “shumica e konflikteve të dhunshme ose potencialisht të dhunshme në shekullin e njëzetë përjetuan përpjekje për ndërmjetësim, shpesh të shumëfishta”. Stedman (1995) pohon se disa konflikte doemos duhet “të përkeqësohen përpara se të njëjtit të përmirësohen, përmes procesit ndërmjetësues”, ai në vazhdim thekson se “insistimi për marrjen e aksionit parandalues – për të bërë diçka, çfarëdo qoftë – mund të shpien deri në politika të papërpunuara dhe në mungesë të aspektit strategjik”. Derisa analiza e negociatave është aktualisht bastion i shkollës racionaliste, ndërmjetësimi dhe paqebërja ende janë bastione të praktikuesve që mbështeten kryesisht në qasjet psikologjike dhe sociologjike. Teoritë socio-psikologjike përshkruajnë kufijtë e racionalitetit. Ato ofrojnë mjete për të na ndihmuar të përcaktojmë rastet në të cilat supozimi i racionalitetit nuk mund të zbatohet dhe të na ndihmojë të arrijmë përgjithësime edhe në rrethana të tilla. Në këtë kuptim ato janë shoqërues kryesorë për çdo përpjekje racionale të përzgjedhur. Duke theksuar vlerën e lidhjes së këtyre qasjeve, ne përpiqemi të krijojmë dialog produktiv mes çështjeve të ndryshme, mes teorisë dhe praktikës dhe shkollave teorike të ndryshme brenda teorisë së MN. Përparimet e pjesshme, të bëra nga qasjet e mësipërme, theksojnë nevojën për një teori më të qëndrueshme të ndërmjetësimit. Në dallim nga disiplinat e tjera, ku teoritë kundërshtarë dhe programet hulumtuese janë bërë disproporcionale (Banks, 1985: 7), qasjet e ndryshme në studimin e ndërmjetësimit duket se janë të ndërtuara mbi të metat e tjetrit.

2.2. Modeli i Kontigjencës dhe Modeli Meta-teorik

Modeli i Kontigjencës, i paraqitur nga Bercovitch et al., (1991) përpiqet të bëjë lidhjen e një serie të variablave me shpeshësinë e ndërmjetësimit duke shqyrtuar marrëdhënien në mes të

variablaqe që kanë të bëjnë me natyrën e mosmarrëveshjes, natyrën e palëve dhe natyrën e ndërmjetësuesit, për një rezultat të suksesshëm, si dhe të vlerësojë dhe shpjegojë efektivitetin e ndërmjetësimit në marrëdhëniet ndërkombëtare (Lista e tabelave 2 – Figura 2.1 Modeli i Kontigjencës). Për këta autorë, rezultatet e ndërmjetësimit janë të ndëlidhura nga faktorë të ndryshëm, me kritere specifike operacionale, secila prej të cilave mund të ndikojë në procesin e ndërmjetësimit dhe efektivitetin e tij. Nga kjo perspektivë, ekziston një marrëdhënie reciproke mes kontekstit të mosmarrëveshjes dhe procesit të ndërmjetësimit, i cili përcakton rezultatet e ndërmjetësimit. Konteksti i çdo ndërmjetësimi mund të përshkruhet sipas tre grupimeve variablash: (a) natyrës së mosmarrëveshjes; (b) natyrës së palëve; dhe (c) natyrës së ndërmjetësuesit, derisa procesi përcaktohet nga sjellja e ndërmjetësimit, e cila në thelb përcaktohet nga strategjitë aktuale ndërmjetësuese. Të gjithë faktorët e kombinuar ndikohen nga dallimet kulturore dhe më pastaj këta faktorë ndikojnë në suksesin apo dështimin e ndërmjetësimit (Bercovitch et al., 1991: 7-17). Marieke Kleiboer (1996: 360-389), studiuese domethënëse e studimit të ndërmjetësimit, përmes Modelit Meta-teorik, i ka vënë disa themele të fuqishme teorike. Një kuptim i mirë i faktorëve që përcaktojnë suksesin e ndërmjetësimit, pohon ajo, mund të arrihet vetëm duke problematizuar konceptin e “suksesit”. Modeli i Kleiboer gjeneron njësi teorikisht kohezive për studimin e ndërmjetësimit dhe për të ruajtur kohezionin e tij, mbështetet në llojet ideale të ndërmjetësimit, të cilat në mënyrë abstrakte krijojnë dhe nuk arrijnë të shfrytëzojnë pasurinë konceptuale të kapur përmes vëzhgimit empirik.

Për zhvillimin e një kornize më kohezive mbi ndërmjetësimin, është i mundur sintetizimi i Modelit të Kontigjencës të Bercovitch et al., dhe Modelit Meta-teorik të Kleiboer. Modeli i Kontigjencës, si një qasje e bazuar në proces, ndërlidhet me një gamë të gjerë të aspekteve kontesktuale me rezultatin e ndërmjetësimit. Për të provuar në mënyrë empirike këto

marrëdhënie, Bercovitch et al., ekstrapolojnë variablat operacionale nga konceptet e argumentuara në literaturën e ndërmjetësimit. Ajo që rezulton është një seri korelacionesh të dobëta, ndonjëherë kontradiktore mes variablave kontekstuale të përcaktuar në mënyrë arbitrare. Rezultatet e ndërmjetësimit, qofshin të suksesshme apo jo, logjikisht shihen si rezultate të ndërveprimit të kontekstit dhe variablave të procesit (Tabela 2: Modeli i Kontigjencës mbi Ndërmjetësimin). Modeli Meta-teorik, trajton studimin e suksesit të ndërmjetësimit përmes krijimit të llojeve ideale të ndërmjetësimit. Secili tip ideal, përbëhet nga një seri supozimesh rreth natyrës së konfliktit dhe kërkimeve sociale shkencore, që përcaktojnë përkufizimin e suksesit dhe variablat e përdorura për ta studiuar atë.

Sintetizimi i këtyre dy qasjeve, ka si synim të përfitojë nga pikat e tyre të forta dhe në mënyrë të njëjtë të minimizojë dobësitë e tyre. Në këtë mënyrë, themelet e fuqishme normative të këtij të fundit sigurojnë mbështjellësin e përsosur mbrojtës për pasurinë konceptuale të së parës.

Parametrat filozofik për krijimin e një kornize, rrjedhin nga studimi i Lakatos mbi falsifikimin e sofistikuar metodologjik (Lakatos, 1970: 35). Sipas tij, “evolucioni shkencor aktivizohet kur teoritë, të cilat i ndajnë të njëjtat supozime bazë si paraardhësit e tyre, e kanë mundësinë e shpjegimit të dukurive të reja”, dhe shton se “në vend se të zëvendësohet një teori me një tjetër, bëhet plotësimi i një teorie me një tjetër”. Duke ndjekur këtë logjikë, Modeli Meta-teorik furnizon supozimet kryesore të cilat mungojnë në funksionalizimin e variablave në Modelin e Kontigjencës. Me vendosjen e supozimeve kryesore në mënyrë eksplicite, kjo kornizë do të tregojë natyrën shumëdimensionale të çdo koncepti të ndërlidhur me ndërmjetësimin dhe në të njëjtën mënyrë të shpjegojë disa nga kontradiktat konceptuale të hasura në literaturë.

Përpjekja e Modelit të Kontigjencës, për të krijuar një teori më të fuqishme, dështon për shkak të mosrespektimit të bazave ontologjike të teorigjive me të cilat synon të ndërtohet. Si

rezultat i kësaj, Modeli i Kontingjencës paraqet një sërë ad-hoc testesh të ndara empirike për hipotezat tashmë të përcaktuara mbi faktorët e pavarur të cilët ndikojnë në rezultatet e ndërmjetësimit. Megjithatë, pavarësisht nga mospërputhjet ontologjike, ky Model siguron materialin ideal konceptual për krijimin e një kornize. Derisa, Dessler, në hulumimet mbi fuqinë shpjeguese të teorive dhe ndërlidhjen e tyre me ontologjinë, argumenton se “fuqia shpjeguese e një teorie është e ndërlidhur drejtpërdrejt me ontologjinë e saj” (Dessler, 1989: 445-447).

Kleiboer, nga ana tjetër, pretendon se pluralizmi teorik i propozuar nga Modeli i Kontingjencës fsheh një ‘vakum normativ’, në të cilin kriteret e ngurta, zëvendësohen nga paragjykimet implicite rreth natyrës së ndërmjetësimit dhe asaj që përbën suksesin e saj. Pasi ky vakum të plotësohet, pasuria konceptuale e Modelit të Kontingjencës do të bëhet bazë për një vlerësim të fuqishëm të përcaktuesve të ndërmjetësimit.

Informacionet e përmbledhura nga një numër i rasteve, ndihmojnë në identifikimin e faktorëve, që ndërlidhen ngushtë me suksesin apo dështimin e ndërmjetësimit. Rezultatet e analizës ofrojnë njohuri mbi faktorët më të rëndësishëm dhe janë të përmbledhura ((Lista e tabelave 3 - Figura 3.1 Faktorë të suksesit apo dështimit të ndërmjetësimit). Duket se, komponentët e të katër klasterëve të kornizës, kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatit e ndërmjetësimit. Rezultatet tregojnë se të gjithë faktorët, duke filluar nga vetë palët kundërshtarë, se cilët janë ata, marrëdhëniet e tyre në të kaluarën, normat dhe fuqia e tyre socio-politike, mosmarrëveshja aktuale, çështjet e përfshira, intensiteti dhe kohëzgjatja e saj, në ndërmjetësuesin dhe mënyrën se si ai ndikon në procesin e menaxhimit të konflikteve, përcaktojnë suksesin e ndërmjetësimit.

2.3. Qëndrimet relativiste - konteksti dhe procesi i ndërmjetësimit

Kompleksitetet rreth studimit të suksesshëm të ndërmjetësimit sollën zhvillimin e qëndrimeve të fuqishme relativiste. Praktikuesit, në veçanti, kanë tendencë që ndërmjetësimin ta shohin si një profesion të mësuar vetëm përmes vështirësive të praktikës, si të papërshtatshëm që përmblihet përbrenda një teorie rigoroze akademike (Kochan dhe Jick, 1978: 209-240). Simkin, njëri nga praktikuesit e parë, i cili ka reflektuar mbi procesin e ndërmjetësimit, çdo përpjekje për të përcaktuar “sjelljen tipike të ndërmjetësimit”, e ka karakterizuar si një “ushtrim në kotësi”, për shkak të numrit të pafund variablash që do të duhej të merreshin parasysh. Në vend që të përpiqet të zbulojë tendencat dhe dinamikën e tij, sukcesi i ndërmjetësimit, sipas Simkin, i takon aftësisë së ndërmjetësuesit për të ndier me mjedisin në të cilin ato zhvillohen (Simkin, 1971: 181). Kjo qasje pragmatike, ka relativizuar vlerën e çdo qasjeje sistematike në studimin e ndërmjetësimit dhe të suksesit të këtij procesi.

Si një përgjigje ndaj argumentit relativist, teoricienët kanë tentuar të aplikojnë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe arsyetimin socio-psikologjik për të zhvilluar një studim sistematik të ndërmjetësimit. Për të ndërmarrë një detyrë të tillë të ndërlikuar, teoricienët kanë ngushtuar fokusin e tyre në dy fusha të studimit: (a) *kontekstin e ndërmjetësimit* dhe (b) *procesin e ndërmjetësimit*. Studimi i kontekstit tregon se rezultati i ndërmjetësimit aktivizohet në mjedisin ku ai zhvillohet, ndërsa studimi i procesit bën që rezultatet të varen nga dinamikat që gjenerojnë sjelljen e ndërmjetësuesit. Edhe pse ndërvarësia e tyre rrallëherë është vënë në pikëpyetje, këto dy qasje të ndryshme kanë tentuar të ofrojnë teori paralele mbi faktorët që përcaktojnë suksesin e ndërmjetësimit.

Teoricienë të procesit të ndërmjetësimit duke tentuar të vendosin dominimin e ndërmjetësuesve, si një faktor determinues në suksesin e ndërmjetësimit, ata argumentojnë se ndërmjetësuesit mund të japin rezultate të suksesshme, pavarësisht nga situata, përmes përdorimit të teknikave specifike (Burton, 1986: 96-98; Fisher, Ury, 1991; Mitchell, 1993:

78– 94). Megjithatë, me qëllim të izolimit të variablave që i përkasin procesit, këto teori bazohen në supozime redukcioniste rreth kontekstit dhe lidhjes së tij me rezultatin. Barton, për shembull, pretendon se qëndrimet e kundërta janë përgjithësisht të nxitura nga nevojat themelore të njeriut, ndërsa Fisher dhe Ury ekzistencën e interesave themelore e mbajnë prapa çdo qëndrimi konfrontues. Thjeshtëzimi i natyrës së konfliktit lejon që këto teori të mbajnë kontekst konstant dhe tërësisht të përqendrohen në studimin e procesit të ndërmjetësimit, ndonëse në dëm të një qasjeje gjithëpërfshirëse në studimin e ndërmjetësimit.

Teoricienët e kontekstit të ndërmjetësimit, në mënyrë të ngjashme, kanë tentuar të zbulojnë marrëdhënien e drejtpërdrejtë në mes të rezultateve të ndërmjetësimit dhe mjedisit në të cilin zhvillohen aktivitetet ndërmjetësuese. Për të vërtetuar këtë lidhje, teoritë e tyre janë bazuar në testet dhe metodologjitë empirike. Disa janë përpjekur të krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë, gjithëpërfshirëse mes rezultatit dhe të një variable të vetme kontekstuale. Zartman, për shembull, thekson se “mundësia e suksesit në ndërmjetësim është drejtpërdrejt e varur nga fakti nëse aktorët e shohin se janë në një BDR” (Zartman, 1985: 230-232). Megjithatë, mbështetja në një variabël të vetme nuk arrin të ofrojë një tablo të qartë mbi atë se si variabla të ndryshëm kontekstual ndërlidhen me rezultatin dhe me njëri-tjetrin. Për ta trajtuar çështjen, disa teoricienë kanë provuar të bëjnë lidhjen e një serie variablash me shpeshtësinë e ndërmjetësimit, në atë që Nicholson quan “shpjegime të dobëta” (Nicholson, 1996: 49).

2.4. Teoritë mbi ndërmjetësimin

A mund të identifikojmë faktorët dhe variablat që prodhojnë rezultate dhe si do të mund të ndikonte ndryshimi i disa variablave në rezultate të ndryshme? Si do të mund ta kuptonim, sa më mirë, një pikëpamje më të zgjëruar të procesit të ndërmjetësimit, të krijojmë njohuri mbi faktorët të cilët llogarisin variantin e saj dhe të mësojmë se si të ndryshojmë disa nga këta faktorë, në mënyrë që t'i maksimalizojmë gjasat për sukses?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve dhe për të kuptuar me të vërtetë se si funksionon procesi i ndërmjetësimit ndërkombëtar, studimet duhet të veprojnë brenda një kornize të qartë teorike. Në formimin e një kornize të tillë ndihmojnë teori të shumta: (1) teoria preskriptive, (2) teoria normative, (3) teoria e pushtetit politik, (4) teoria e pjekurisë, (5) teoria e gatishmërisë, (6) teoria kritike e ndërmjetësimit si dhe (7) teoria e lehtësimit (Bell et al., 1989: 9-30).

(1) Teoria preskriptive e vendimarrjes në thelb ka vëzhgimin e problemeve reale përmes prizmës së teorisë normative, por duke marrë parasysh kufizimet që njohim nga teoria deskriptive. Teoria në fjalë shpjegon çdo ndryshim, duke theksuar një sërë normash të sjelljes, që palët në konflikt i ndjekin dhe arrijnë suksesin, ose nuk i ndjekin dhe kështu përjetojnë dështimin.

(2) Kur flitet për teorinë normative, kryesisht flitet për teorinë e vendimarrjes në mënyrë racionale, që nënkupton marrjen e një vendimi në racionalitet të plotë. Andrew Kydd lidhur me këtë teori thekson:

“Teoria normative ka koherencë, logjikë dhe konsistencë, por supozimet në të cilat ajo bazohet qartë e kufizojnë zbatueshmërinë e saj. Aktorët në konflikt nuk sillen si palë inteligjente dhe të ndjeshme, nuk kanë shumë informacione dhe është vështirë të shihet se si kjo qasje, e gjerë në kontributet e saja, është në përputhje me realitetin që e dëshirojmë” (Kydd, 2003: 597-611).

Derisa, Hansson Sven Ove, në studimin e tij “Decision theory: A brief introduction” thekson se “teoria e vendimarrjes, sipas mendimit të marrë, nuk hyn në skenë, derisa nuk vendosen normat morale dhe politike” (Hansson, 2005: 8-23).

(3) Teoria e pushtetit politik, hyn në mesin e teorive që pohojnë se shtetet janë aktorët e vetëm që mund të ndërhyjnë dhe të ndërmjetësojnë në një konflikt, si palë të treta. Kjo teori e vën theksin në levë, manipulim, shtrëngim, proceset e bisedimeve dhe të formave të pushtetit.

Siç pohon Richmond Oliver,

“teoria e pushtetit politik paraqet ndërmjetësimin si një proces negociimi shtrëngues. Palët në konflikt zgjedhin mes opsioneve të kompromisit dhe konfliktit të dhunshëm - zgjedhin të parën, sepse nuk mund të arrijnë fitoren dhe ndërmjetësuesi me ndërhyrjen, si palë e tretë, përdor strategji shtrënguese për të zgjidhur konfliktin” (Richmond, 1998: 707-772).

Në teorinë e pushtetit politik, sipas Jones Richard Wyn (2001: 173-174) “palët e treta janë shtete dhe ndërmjetësojnë për të rritur fuqinë e tyre në raport me aktorët e tjerë në arenën ndërkombëtare”, por shton se “përmes ndërmjetësimit, pala e tretë fiton pushtet dhe leva. Kostot dhe përfitimet perceptohen në aspektin e kontrollit mbi resurset ushtarake, ekonomike dhe politike”.

(4) Teoria e pjekurisë, konsiderohet të jetë njëra nga teoritë më me influencë mbi motivimin dhe zgjidhjen e konflikteve (Coleman et al., 2008a: 4). Derisa, sipas studiuesit W. Zartman janë dy faktorë me rëndësi qendrore për gjetjen e një zgjidhjeje përmes negociimit dhe ndërmjetësimit ndaj një konflikti ndërkombëtar: thelbi i propozimeve dhe korniza kohore e përpjekjeve. Por, fokusimi i tij mbetet në kohën e përpjekjeve. Zartman, justifikon faktin se, “pjekuria është një kusht i domosdoshëm për fillimin e negociatave, qoftë bilaterale ose të ndërmjetësuar dhe se ky moment duhet të shfrytëzohet nga palët ose nga ndërmjetësuesi (Zartman, 2000: 225-227).

Mbi teorinë e pjekurisë, janë botuar edhe një numër studimesh kritike, nga këndvështrime të ndryshme. Studiuesi O’Kane, në kritikën e tij thekson se pretendimet mbi parashikimet e teorisë së pjekurisë për momentin e duhur të zgjidhjes së një konflikti, janë të paqëndrueshme (O’Kane, 2006: 280-283). Amer, pretendon se qasja teorike e Zartman, mund të ketë disa vlera shpjeguese, në zgjidhjen e situatës së konfliktit në nivel të brendshëm, por asnjë vlerë shpjeguese nuk identifikohet në nivel rajonal dhe global (Amer, 2007: 739-740).

(5) Teoria e gatishmërisë së Pruitt është një rishikim dhe përpunim i teorisë së pjekurisë së Zartman. Kjo teori ndryshon nga ajo e pjekurisë, në atë se përdor variabla dhe jo domosdoshmërisht shtete dhe fokusohet vetëm në njerën, dhe jo në të dyja palët në konflikt. Sikurse teoria e pjekurisë ashtu edhe ajo e gatishmërisë, ndërlidhen kryesisht me fazën e parë ose paraardhëse të ndërmjetësimit ndërkombëtar. Të dyja qasjet, fokusohen në kornizën

kohore të përpjekjeve për negociata ose ndërmjetësim dhe ato pranojnë që palët të zgjidhin çështjen e tyre, kur ato të jenë të gatshme dhe ofrojnë dy korniza të rëndësishme për t'u marrë me këto lloje të konflikteve ndërkombëtare.

(6) Në teorinë kritike e ndërmjetësimit, theksi vihet në koalicione. Një ndërmjetësues kritik nuk është një njësi e vetme ose unitare. Jones Richard Wyn, si përfaqësues i kësaj teorie, potencon se “ndërmjetësuesit e shumëfishtë kanë interesa të përgjithshme. Ata janë të interesuar në zgjidhjen e një konflikti, duke përmirësuar marrëdhëniet mes palëve në konflikt dhe për të siguruar që paqja të rikthehet” (Wyn, 2001: 180).

Megjithatë, nga analizat e bëra arrijmë të konkludojmë se në mesin e teorive të ndërmjetësimit, (7) teoria e lehtësimit, i përshtatet më shumë hulumtimit të rolit të BE-së, si një palë e tretë ndërmjetësuese dhe të studim rastit tonë konkret, të dialogut Kosovë-Serbi. Kjo teori e vën theksin në konsensusin, paanshmërinë dhe neutralitetin e ndërmjetësuesit. Në kundërshtim me teoritë e tjera, të cilat nuk ofrojnë mekanizma shpjegues të fortë, teoria e lehtësimit thekson komunikimin, aktorët joshitetërorë në ndërmjetësim, lehtësimin, natyrën cilësore të rezultateve dhe çështjeve. Fokusi është se si “pengesat (perceptimet socio-psikologjike), mund të ndahen nga një palë e tretë” (Lloyd, 2000: 647-662). Ndërmjetësimi, në këtë rast, shihet edhe si lehtësues edhe si komunikues. Ata janë “iniciatorë të ndryshimit dhe mund të çojnë në zgjidhjen e konflikteve”. Asnjë konflikt nuk është shumë i vështirë dhe “ndërmjetësuesit, si palë e tretë, me përvojën e tyre të duhur, heqin pengesat në zgjidhjen e konflikteve” (Bercovitch et al., 1991: 7-17). Derisa Wyn (2001: 177) thekson se “ndërmjetësuesit, si palë e tretë, janë aktorë joshitetërorë të cilët janë të përkushtuar ndaj ndryshimeve sociale. Para se të ndërmerret ndonjë veprim, është e nevojshme që të ketë një marrëveshje të përbashkët për rregullat e jetës sociale”. Ai poashtu pretendon se mosgatishmëria e një pale, për t'u angazhuar në negociata, i atribuohet pengesave socio-

psikologjike dhe se “ndërmjetësuesi vepron kështu, si një psikoanalist për të ndihmuar palët të lëvizin përpara procesin e ndërmjetësimit”.

Nga teoritë e cekura, të cilat i kanë edhe dallimet e tyre në kontekstin dhe kushtet në të cilat kryhet ky proces, theksohet vlera e lidhjes së tyre në përpjekje për të krijuar dialog produktiv mes çështjeve të ndryshme, mes teorisë dhe praktikës dhe shkollave të ndryshme teorike brenda teorisë së MN.

2.5. Koncepti teorik mbi ndërmjetësimin ndërkombëtar

Praktika e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes ndërmjetësuesve ka pasur një histori të pasur në të gjitha kulturat. Edhe pse ekzistojnë dallime të konsiderueshme në mënyrën se si ndërmjetësuesit, nga kultura të ndryshme merren me një konflikt, të gjitha qasjet kanë vlerë në drejtim të menaxhimit ose zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në arenën ndërkombëtare, me sfidat e saj të përhershme të konflikteve në rritje, zvogëlimit të resurseve dhe rritjes së kërkesave etnike, dhe me mungesën e “rregullave të lojës” të pranuarra përgjithësisht, aplikimi potencial i ndërmjetësimit është me të vërtetë i pakufishëm (Gulliver, 1979: 64-65). Edhe pse ndërmjetësimi ndërkombëtar nuk ishte një zbulim i ri pas Luftës së Dytë Botërore. Bipolariteti dhe pengesa reciproke bërthamore e detyruan komunitetin ndërkombëtar dhe fuqitë e mëdha që të përpiqeshin të zgjidhnin konfliktet e shumta ndërshtetërore dhe brendashtetërore përmes përpjekjeve ndërkombëtare të ndërmjetësimit.

Sipas studiuesit Coleman, konfliktet mbi çështjet politike dhe ato të sigurisë ndodhin dhe zhvillohen “brenda një konteksti të politikës së fuqishme ndërkombëtare, dhe ky kontekst ka një ndikim të madh në ndërmjetësimin ndërkombëtar”, i cili ka disa karakteristika më të ndryshme nga llojet e tjera të ndërmjetësimit, ai po ashtu thekson se “shumë nga këto konflikte, si ndërshtetërore ashtu edhe ato brendashtetërore, janë afatgjata, të rrënjosura thellë dhe të papërshtatshme” (Coleman, 2003: 4). Derisa në studimin e tyre “Ndërmjetësimi në

marrëdhëniet ndërkombëtare”, Bercovitch dhe Rubin (1992), konsiderojnë, mes tjerash, se “ndërmjetësimi është një nga instrumentat primar të politikës së jashtme, përmes të cilit shtetet dhe organizatat ndërkombëtare përpiqen të menaxhojnë dhe zgjidhin një konflikt të dhunshëm”.

Si një formë e menaxhimit të konfliktit, ndërmjetësimi dallon nga format më detyruese të ndërhyrjes së palës së tretë, siç është arbitrazhi dhe gjykimi, pasi që inicimi bëhet me kërkesë të palëve dhe vendimmarrja përfundimtare iu takon palëve në konflikt (Folberg dhe Taylor, 1984 Moore, 1986).

Në arenën ndërkombëtare, ku një numër i madh dhe i larmishëm i aktorëve bashkëjetojnë dhe secili e ruan me zili sovranitetin dhe pavarësinë e vet dhe përdorimin e dhunës e sheh si një opsion të zbatueshëm, ndërmjetësimi me bazën e tij ad hoc, me natyrën vullnetare dhe karakterin jodetyrues, ofron një përgjigje domethënëse dhe të dobishme për problemet e paraqitura nga konfliktet e ndryshme etnike, rajonale dhe ato globale. Në një arenë të tillë, të gjerë ndërkombëtare, shtrirja e aktiviteteve ndërmjetësuese në arenën ndërkombëtare është me të vërtetë e madhe. Kjo është e pasqyruar në numrin e madh të përkufizimeve të ofruara nga studiues të ndryshëm të disiplinës. Doob, si njëri nga themeluesit e fushës, e përdor këtë term në një kuptim shumë më të gjerë. Ai e përkufizon ndërmjetësimin si “përpjekje të një ose më shumë personave, të ndikojnë në një ose më shumë persona të tjerë, kur të dyja palët e perceptojnë një problem që kërkon një zgjidhje” (Doob, 1993: 1). Ndërmjetësimi, në këtë mënyrë, synon të ofrojë një zgjidhje për çdo problem për të cilin palët në konflikt e konsiderojnë si të tillë. Përkufizime të tjera të ndërmjetësimit, siç është ai i Mitchel, theksojnë objektivat e tij. Ai e përkufizon atë si “çdo aktivitet ndërmjetësues...i ndërmarrë nga një palë e tretë me qëllimin parësor të arritjes së një zgjidhjeje kompromisi mbi çështjet në fjalë” (Mitchell, 1981: 287). Disa përkufizime të tjera, nxjerrin në pah disa cilësi të veçanta të

ndërmjetësimit ose strukturën dinamike të fazës. Kështu, Folberg dhe Taylor e shohin ndërmjetësimin si “një proces përmes të cilit pjesëmarrësit, në mënyrë sistematike izolojnë çështjet në mënyrë që të zhvillojnë mundësitë, dhe të arrijnë një zgjidhje konsensuale, që do të akomodoi nevojat e tyre” (Folberg dhe Taylor, 1984: 7).

Realiteti i ndërmjetësimit ndërkombëtar është në disa mënyra më afër me përkufizimin e Doob, por është edhe më i kufizuar. Ndërmjetësuesit mund të ndërhyjnë për të mbrojtur palët ose për të promovuar interesat e tyre. Ata mund ose nuk mund të posedojnë atributet e kërkuara të neutralitetit dhe të transparencës. Ata mund të jenë nga jashtë ose mund të vijnë nga mjedisi i mosmarrëveshjes. Ndërmjetësimi i tyre mund të jetë pasiv ose aktiv dhe mund të synojë të ndryshojë disa aspekte të sjelljes ose të ndikojë në perceptimet e palëve. Ndërmjetësuesit mund të veprojnë si individë ose si anëtarë të një grupi ad hoc më të madh. Duke marrë parasysh të gjitha këto karakteristika, ndërmjetësimi konsiderohet si një proces reaktiv i menaxhimit të konflikteve, ku palët e kërkojnë ose e pranojnë ofertën e ndihmës nga një shtet, organizatë apo nga një individ, për të ndryshuar sjelljen e tyre, për të zgjidhur konfliktin e tyre apo për të zgjidhur çështje të hapura mes tyre, pa përdorur forcën fizike ose autoritetet ligjore (Wall, 1981; Dryzek dhe Hunter, 1987; Bercovitch et al., 1991: 8).

Ky mund të jetë një përkufizim i gjerë, por terminologjia këtu është mjaft e rëndësishme. Një përkufizim i tillë na lejon të studiojmë rastet në kontekste të ndryshme, të përdorim metoda të ndryshme dhe të bëjmë krahasime mes rasteve. Mbi të gjitha, përmes tij kuptojmë se ndërmjetësimi ndërkombëtar është një proces social dinamik dhe kompleks, i cili përfshin palët në konflikt, mjedisin social ose kontekstin, një mosmarrëveshje të caktuar ose një çështje dhe një agjent ndërmjetësues. Argumentimi themelor nga hulumtuesit e çështjes është se suksesi apo dështimi i çdo ndërmjetësimi, varet nga secili prej këtyre grupimeve ose kategorive të faktorëve.

2.6. Karakteristikat përcaktuese të ndërmjetësimit ndërkombëtar

Derisa praktika e zgjidhjes së konflikteve, me ndihmën e palëve të treta, ka një histori të gjatë në shumë kultura, ndërmjetësimi mund të quhet i vjetër sa vetë konflikti. Ndërmjetësimi, ka një rol të rëndësishëm në mjedisin e tanishëm ndërkombëtar. Bercovitch dhe Gartner konsiderojnë se ndërmjetësimi është i përshtatshëm “për një mjedis ku aktorët i ruajnë interesat e tyre dhe pranojnë çdo ndërhyrje të jashtme në çështjet e tyre vetëm nëse është e nevojshme dhe e kufizuar në mënyrë eksplicite”. Derisa, në diskutimin mbi konceptin e ndërmjetësimit, autorët duke argumentuar se “ndërmjetësimi është larg nga format më të zakonshme të ndërhyrjes së palës së tretë në konflikte ndërkombëtare”, ata potencojnë se ndërmjetësimi ende luan një rol të rëndësishëm dhe është veçanërisht i dobishëm në disa raste:

“kur një konflikti ka vazhduar për një kohë, kur përpjekjet e palëve të përfshira kanë arritur një bllokim, kur palët nuk janë të gatshme të pranojnë më tej kostot ose përshkallëzimin e mosmarrëveshjes; kur palët janë të gatshme të angazhohen në dialog të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe janë të gatshme të pranojnë ndonjë formë të ndihmës së jashtme dhe të dorëzojnë disa kontrolle mbi procesin e menaxhimit të konfliktit” (Bercovitch dhe Gartner, 2006: 319-332).

Edhe pse fundi i Luftës së Ftohtë ka sjellë shumë ndryshime, sipas Touval dhe Zartman (2008: 427), ai “nuk ka reduktuar rastet e konflikteve ndërkombëtare dhe tendencën e palëve të treta për të ndërmjetësuar në konflikte të vështira”. Kjo do të thotë që, ndërmjetësimi mund të shihet si një qasje që e plotëson procesin e zgjidhjes së problemit, por që megjithatë, nuk e bën zëvendësimin e përpjekjeve të vetë palëve për zgjidhjen e konflikteve. Që do të thotë, se ndërmjetësimi ofrohet kur ekziston nevoja reale për të ndihmuar në procesin e zgjidhjes së problemit, por kjo ofertë nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë tërësisht përpjekjet vetanake të palëve për të zgjidhur konfliktin. Prandaj, një qasje e tillë e ndërmjetësimit është e përshtatshme për një mjedis, ku ndihma do të pranohet, kur aktorët vetë, nuk mund të arrijnë një marrëveshje, por janë ende aktivë në proces dhe dalin me mënyra të ndryshme për zgjidhjen e problemit, duke i ruajtur interesat e tyre. Kjo është gjithashtu e zbatueshme në studim rastin tonë, për dialogun Kosovë-Serbi. Edhe pse konflikti mes shqiptarëve të Kosovës

dhe shtetit serb ka qenë historikisht aktiv, është përkeqësuar edhe më shumë, sidomos pas konfliktit të fundit, por po ashtu edhe nga mosmarrëveshja mbi statusin politik të Kosovës. Duke pasur parasysh përplasjet dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme mes tyre, sidomos pasi Kosova shpall pavarësinë e saj, në vitin 2008, mundësitë për arritjen e çfarëdo lloj marrëveshjeje mes palëve, me përpjekjet e tyre vetanake, dukeshin minimale. Pavarësisht nga kjo, të dyja palët synonin një marrëveshje, e cila do të kënaqte, jo vetëm interesat e tyre rajonale, por do të tregonte gjithashtu gatishmërinë për të përmbushur kërkesat e BE-së, që do të thotë, për të adresuar sfidat rajonale në BP dhe për të arritur konsensusin politik, dhe në këtë mënyrë, marrjen e një perspektive të qartë për integrimin e ardhshëm në BE. Për më tepër, sipas Maoz dhe Terris, “ndërmjetësimi ndërkombëtar, si proces, është vullnetar, nuk mund të ndodhë pa pëlqimin e palëve kundërshtarë, as nuk mund të realizohet pa pëlqimin e palës së tretë” (Maoz dhe Terris, 2006: 415). Në diskutimin mbi ndërhyrjen së palës së tretë, si ndërmjetësues, dhe të ndërmjetësimit si të një forme më ndryshe të ndërhyrjes në konflikt, Touval dhe Zartman konkludojnë se,

“ndërmjetësimi është një formë më ndryshe nga format e tjera të ndërhyrjes së palëve të treta në konflikte, në atë që nuk bazohet në përdorimin e drejtpërdrejtë të forcës dhe nuk ka si qëllim të ndihmojë një pjesëmarrës për të fituar. Qëllimi i ndërmjetësimit nuk është vetëm arritja e një zgjidhjeje të pranueshme për palët e përfshira, por edhe që kjo zgjidhje të jetë në përputhje me interesat e vetë ndërmjetësuesit”. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që palët të vendosin, nëse zgjidhja ose idetë e ofruara nga ndërmjetësuesi, do të ishin për ta të pranueshme”(Touval dhe Zartman, 2006: 427).

Për të përdorur argumentin e paraqitur, ndërmjetësimi duhet kuptuar dhe definuar si një proces politik, pa angazhim paraprak nga palët për të pranuar idetë e ndërmjetësuesit.

Popullariteti i ndërmjetësimit, si një metodë diplomatike mbi menaxhimin e konfliktit, mund të ndiqet nga karakteristikat e tij përcaktuese. Prandaj, ndërmjetësimi, si proces, përfaqëson një formë të “negociatave të asistuara”, në të cilat një aktor i jashtëm, hyn në procesin e paqes në mënyrë që të ndikojë dhe ndryshojë karakterin e marrëdhënieve të mëhershme mes palëve kundërshtarë (Bercovitch dhe Jackson, 2009: 35-47). Si një aktivitet vullnetar, joshtrëngues

dhe ligjërisht jodetyrues, është veçanërisht praktik, duke pasur parasysh dinamikën e ndërlikuar të marrëdhënieve ndërkombëtare që dominohen nga parimet e ruajtjes së pavarësisë dhe autonomisë së aktorëve. Po ashtu, edhe shkalla e ulët ndërhyrëse dhe natyra ad-hoc e ndërmjetësimit, lejon që palët të ruajnë autonominë e tyre gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes (Bercovitch, 2005).

2.6.1. Natyra e paqartë e paanshmërisë së ndërmjetësuesit

Derisa studiuesit, me kalimin e kohës, kanë arritur një konsensus të mbingarkuar mbi karakteristikat e nevojshme, që një ndërmjetësues duhet të posedojë, për të ndihmuar me sukses palët në arritjen e një zgjidhjeje, një çështje ka mbetur e diskutueshme: paanshmëria e ndërmjetësuesit.

Studimet e hershme që pasuan logjikën e ndërmjetësimit të brendshëm, konsideronin paanshmërinë si një karakteristikë themelore dhe madje, edhe definitive të një ndërmjetësuesi, pasi pa te, nuk mund të flitet as për ndërmjetësim (Jackson 1952; Assefa 1987; Burton dhe Duker 1990; Miall 1992; Hume 1994). Sipas këtyre studimeve, ekzistonte një lidhje e qartë shkaksore mes paanshmërisë dhe efikasitetit të ndërmjetësimit: paanshmëria e ndërmjetësuesit ishte vendimtare në vendosjen e besimit tek palët kundërshtare, gjë që ishte e domosdoshme për pranimin e një ndërmjetësuesi. Kjo nga ana tjetër, ishte thelbësore për të prodhuar një rezultat të suksesshëm të ndërmjetësimit. Duke u mbështetur kryesisht në bindjet e tyre, ndërmjetësuesit do të duhej të lehtësonin komunikimin e dëmtuar mes palëve kundërshtare dhe të formulonin zgjidhjet e mundshme potenciale, bazuar në informacionet e dhëna. Për shembull, Raymond dhe Kegley (1985) e përcaktonin ndërmjetësimin, si një aktivitet, në të cilin një palë e tretë u ndihmon palëve kundërshtare të arrijnë një marrëveshje vullnetare, duke përdorur metoda lehtësuese, siç janë përcaktimi i rendit të ditës, thjeshtëzimi i komunikimit, sqarimi i pozicioneve përkatëse, ripërceptimi i çështjeve, lehtësimi dhe

mbështetja për marrëveshjen. Në mënyrë të ngjashme, për Moore, ndërmjetësimi duhet të shihet si,

“një zgjatim i procesit negociues, në të cilin “një palë e tretë e pranueshme, e paanshme dhe neutrale”, duke mos pasur pushtet “autoritativ”, ndihmon palët kundërshtarë në arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme reciproke” (Moore, 1986).

Vështirësitë që rrjedhin nga ndërmjetësimi në familje, janë ende themelore për kuptimin tonë të ndërmjetësimit ndërkombëtar dhe ekziston një marrëveshje e madhe e mbivendosjes në të kuptuarit teorik të dy dinamikave. Dallimet e veçanta, që mund të gjenden në mes të dy proceseve, janë rezultat i drejtpërdrejtë i kontekstit në të cilin ato zhvillohen. Në një sistem ndërkombëtar, ku nuk ka autoritet qendror, aktorë të ndryshëm kryejnë aktivitete ndërmjetësimi në kushte që ndryshojnë shumë nga ato që gjenden në nivel vendor.

Megjithëse, ekzistojnë ende ngjashmëri mes proceseve, mungesa e një strukture të qartë në nivel ndërkombëtar, ku aktorët kërkojnë të ruajnë pavarësinë e tyre me çdo kusht, i kanë bërë përpjekjet ndërkombëtare të ndërmjetësimit më të ndjeshme ndaj vetë interesave të veçanta, duke nxitur aktorë të ndryshëm, për t’u angazhuar në ndërmjetësimin e një konflikti të veçantë ndërkombëtar.

Hampson dhe Zartman (2012: 133) gjatë hulumtimit të tyre arrijnë në përfundimin se në disa mjedise të brendshme, ndërmjetësimi është përkufizim i kryer nga një palë e tretë e vetme, e besueshme, e cila nuk ka rol në mosmarrëveshje dhe se konfliktet ndërkombëtare zakonisht tërheqin dhe sjellin në procesin e ndërmjetësimit aktorë të ndryshëm të jashtëm, që janë “po aq të shumtë dhe shpesh të ndryshëm në interesat e tyre, si vetë palët kundërshtarë”, të cilët, sipas Bercovitch dhe Jackson (2009: 35), “ata sjellin me vete në mënyrë të vetëdijshme, idetë, njohuritë, burimet dhe interesat e tyre ose të grupit që përfaqësojnë rreth konfliktit në fjalë”.

2.6.2. Kredibiliteti i ndërmjetësuesit

Touval dhe Zartman, ndërmjetësimin e përcaktojnë si një proces negocimi për arritjen e një zgjidhjeje, që palët vetë nuk mund ta gjejnë, derisa kredibilitetin e ndërmjetësuesit e konsiderojnë si element të rëndësishëm të të gjithë procesit. Autorët, poashtu theksojnë edhe rëndësinë e bashkëpunimit në këtë proces, pasi ndërmjetësimi duhet të jetë i pranueshëm për palët e involvuara. Në këmbim, palët kundërshtare duhet të shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar në mënyrë diplomatike me ndërmjetësuesin. Megjithatë, ky nuk është gjithmonë rasti dhe ndërmjetësuesit mund të hasin në refuzimin fillestar. Prandaj, sipas studiuesve, detyra e parë për ndërmjetësuesin është “të bindë palët kundërshtare për vlerën e shërbimeve të veta, madje edhe para fillimit të procesit ndërmjetësues” (Touval dhe Zartman, 2008: 248). Dykuptimësia e dukshme e paanshmërisë, si një koncept, nxiti disa studiues të tjerë të zhvendosin fokusin e tyre analitik nga paanshmëria e perceptuar në një nocion më specifik të kredibilitetit të perceptuar të një ndërmjetësuesi. Sipas kësaj qasjeje, ndërkohë që ndërmjetësuesit mund të ruajnë qëndrimin e tyre të njëanshëm në proces dhe të kontribuojnë në efektivitetin përfundimtar të procesit, ata ende duhet të perceptohen si kredibil në mënyrë që të jenë të pranueshëm për palët kundërshtare. Maoz dhe Terris, potencojnë rëndësinë e kredibilitetit të ndërmjetësuesit:

“Kredibiliteti ka të bëjë me masën në të cilën palët kundërshtare mendojnë se (1) oferta e ndërmjetësuesit është e besueshme, që do të thotë se ndërmjetësuesi nuk blofon dhe/ose nuk mashtrohet nga pala kundërshtare dhe (2) ndërmjetësuesi mund të paraqes ofertën, që do të thotë, ndërmjetësuesi mund të bëjë ofertën. Kur të përfundojë ndërmjetësimi, kredibiliteti i një ndërmjetësuesi është një veçori që rrit gjasat për një zgjidhje të pjesshme ose të plotë” (Maoz dhe Terris 2009: 69-88).

Duke vlerësuar kredibilitetin, është logjike të merren parasysh edhe interesat e ndërmjetësuesit. Nëse ka një interes të fuqishëm për t'i dhënë fund një konflikti, ndërmjetësuesi do të konsiderohet si palë e tretë e përkushtuar dhe e besuar. Për më tepër, ndërmjetësuesit e tillë mund të tregojnë motivim shtesë, të jenë më të përgatitur dhe më të gatshëm të përdorin të gjitha resurset në dispozicion, në mënyrë që të marrin rezultatet e

dëshiruara. Lidhur me këtë, Maoz dhe Terris (2006: 411) theksojnë se “ndërmjetësuesit maksimalisht të angazhuar mund të kenë në mendje edhe zgjidhje shumë specifike, të cilat mund të mos përkojnë me interesat e palëve kundërshtare”. Bercovitch (2002: 228–257), lidhur me çështjen, konkludon se “një interes i drejtpërdrejtë me një prani më të palëkundur nga pala e tretë, e bën marrëveshjen më të përshtatshme dhe nxit palët t’i nënshtrohën kontratës”. Derisa, Touval dhe Zartman (2008: 434), konkludojnë se “ndërmjetësuesit të motivuar nga vetëinteresi, nuk do të ndërhyjnë deri kur një konflikt kërcënon interesat e tyre ose kur perceptojnë një mundësi për të avancuar interesat e tyre”.

Prandaj, sipas përkufizimeve të dhëna, konstatojmë se një palë e tretë mund të ndërhyjë më shumë në rastet që kanë arritur në një përshkallëzim më të gjerë të konfliktit. Në një situatë të tillë, palët, tashmë kanë arritur në fazën e kundërshtimeve të fuqishme, duke krijuar kështu një bazament të nevojshëm për ndërmjetësim. Për të ndërmjetësuar dhe ndërtuar një rezultat sa më të mirë për të dyja palët, ajo që e bën një ndërmjetësues të pranueshëm për palët në konflikt, është fuqia e tij potenciale. Megjithatë, Touval dhe Zartman (2008: 434-437) precizojnë se, “ndërmjetësimi është i mirëpritur vetëm deri në një farë mase - derisa të prodhojë rezultate të favorshme”.

Kredibiliteti i ndërmjetësuesit është i lidhur drejtpërdrejt me anshmërinë ndërmjetësuese. Nëse i shohim konfliktet si rezultat të informacioneve jo të plota mes palëve, aftësia e ndërmjetësuesve për të emituar informacionet e nevojshme mbi preferencat, aftësitë dhe zgjidhjet e palëve bëhen të dobishme në menaxhimin e konfliktit (Fearon, 1995; Powell, 2002). Në mënyrë që këto informacione të jenë të besueshme, sipas Kydd, “ndërmjetësuesit duhet të jenë të njëanshëm ndaj njërit prej aktorëve”. Një ndërmjetësues i paanshëm, rrallë besohet në dërgimin e mesazheve të cilat mund të rrisin apo të ulin gjasat e konfliktit. “Nëse ndërmjetësuesi ka si prioritet vetëm dhënien fund të armiqësive, ai do të këshillojë të dyja

palët në përmbajtje”. Pasi palët mund të parashikojnë preferencat e ndërmjetësuesit, ata deklaratat e tyre nuk do t’i shohin si kredibile. “Ndërmjetësuesit, të cilët janë të interesuar të bindin njerën nga palët për të bërë një koncesion”, sepse pala tjetër ka një vendosmëri të fuqishme, “duhet të jenë të njëanshëm ndaj palës që është duke marrë informacionin për të qenë të suksesshëm” (Kydd 2003: 607). Gjatë muajve të fundit të luftës në Bosnje, sukcesi i iniciativës amerikane, për të ndaluar ofensivën boshnjake dhe kroate pas fushatës së NATO-s kundër ushtrisë serbe, ishte kryesisht si pasojë e dezinformimit rreth rigrupimit dhe konsolidimit të ushtrisë serbe, që zyrtarët amerikanë, ua kanë dhënë partnerëve të tyre Boshnjakë dhe Kroatë. “Ky informacion, ka qenë i dobishëm për të nxitur palët të shqyrtojnë negociatat, si një alternativë të qëndrueshme për luftën” (Holbrooke 1998, Touval 2002).

Duhet theksuar, se ndonëse ndërmjetësuesit duket se janë të pranueshëm, pavarësisht nga anshmëritë e tyre të dukshme, disa studime ende mbeten me dyshime për përgjithësimin e shërbimeve të gjeneruara nga prania e një ndërmjetësuesi të njëanshëm. Sipas këtyre studimeve, konkluzionet në lidhje me efektivitetin e tyre “ende bazohen në një numër të kufizuar të rasteve dhe ende janë teknikë apo strategji e ndërmjetësuesit dhe jo karakteristikë e tij”, që kushtëzojnë rezultatin përfundimtar të procesit (Gent dhe Shannon, 2011; Beber, 2012).

Sidoqoftë, edhe në një përmbledhje, meqenëse paanshmëria dhe neutraliteti i ndërmjetësuesit nuk përfaqësojnë parakushtet e nevojshme të pranimit të ndërmjetësuesit ose të një rezultati të suksesshëm, ndërmjetësimi më së miri kuptohet si një proces negociimi vullnetar dhe ligjërishit jodetyrues i kryer ad-hoc, përmes së cilit një aktor i jashtëm ndihmon palët në arritjen e një zgjidhjeje, që ata nuk janë në gjendje apo nuk dëshirojnë të gjejnë.

2.6.3. Përcaktuesit e kërkesës për ndërmjetësim

Ndërmjetësuesit, zakonisht ballafaqohen, fillimisht me refuzimin nga palët kundërshtare. Kështu, siç theksojnë Zartman dhe Touval (1996: 446), “përpjekja e tyre e parë diplomatike duhet të jetë bindja e palëve mbi vlerën e shërbimeve të tyre, para se të fillojë ndërmjetësimi”. Refuzimi është “një produkt i dyshimit dhe mosbesimit reciprok” që karakterizojnë shumë konflikte (Svensson dhe Wallensteen 2010). Palët, do të angazhohen vetëm “me ata ndërmjetësues, që i konsiderojnë të besueshëm” dhe presin që aktorët e përfshirë ta kthejnë gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe të mos e shfrytëzojnë (Kydd, 2006).

Pranimi i palëve, bindja dhe futja e tyre në një ndërmjetësim, nuk është aspak detyrë e lehtë. Që ndërmjetësimi të ndodhë, sipas Maoz dhe Terris (2006), palët duhet ta perceptojnë ndërmjetësimin si një alternativë të arsyeshme dhe tërheqëse ndaj vazhdimit të aktiviteteve luftarake. Më konkretisht, palët kundërshtare do të pranojnë ofertën e një ndërmjetësuesi në masën që “përdorimi i prituri i një marrëveshjeje tejkalon dobinë e prituri të konfliktit të vazhdueshëm”.

Nga njëra anë, “palët do të pranojnë ndërmjetësimin, nëse e perceptojnë atë të jetë një proces që mund të prodhojë një rezultat më të mirë se ai që mund të arrihet duke luftuar”. Nga ana tjetër, ata gjithashtu, do të prisnin që “ndërmjetësimi të gjeneronte një rezultat më të mirë se, çdo zgjidhje tjetër, që mund të arrihet përmes negociatave të drejtpërdrejta”.

2.6.4. Kostot e pranimi të ndërmjetësimi dhe objektivat devijuese

Pranimi i ndërmjetësimi gjeneron edhe kosto (vendore dhe ndërkombëtare, substanciale dhe jomateriale) për palët kundërshtare. Së pari, palët mund të shqetësohen se, gatishmëria e tyre për të negociuar me “armikun”, mund të perceptohet si një shenjë dobësie, madje edhe të etiketohen si tradhëtarë. Së dyti, palët kundërshtare mund të joshën për të bërë koncesione të papritura, duke mohuar një nivel të caktuar kontrolli mbi procesin, gjë që rrit nivelin e përgjithshëm të pasigurisë në aspektin e rezultatit të dëshiruar. Si rezultat i kësaj, ata janë në

gjendje të pranojnë më pak se ajo, që fillimisht ishte planifikuar, për një rezultat reciprokisht të pranueshëm ose të ballafaqohen me degradimin e krijimit të lidhjeve politike dhe ekonomike me ndërmjetësuesin (Bercovitch dhe Gartner, 2006). Prandaj, pranimi i ndërmjetësimit dhe madje edhe i zbatimit të procesit, nuk duhet të ndërlidhet menjëherë me synimet e palëve, për të arritur një zgjidhje paqësore. Edhe kur ndërmjetësimi është në proces, palët nuk heqin dorë automatikisht nga aktivitetet luftarake. Siç vuri në dukje Sisk, “dhuna shpesh është dëshmuar të jetë më e dobishme nga taktika tryezës”, por ai precizon se “palët e përdorin dhunën për të përmirësuar pozicionin e tyre negociues në tryezën e bisedimeve, duke ndikuar kështu në situacionin në terren” (Sisk, 2009). Presidenti kolumbian Juan Manuel Santos, duke nxitur me forcë idenë e një procesi paqësor me FARC, gjithashtu kundërshtoi të nënshkruante një marrëveshje armëpushimi, si një hyrje për bisedimet e paqes në Havanë (Spiegel, 2014). Me sa duket, palët mund të përdorin ndërmjetësimin për “arsye të ndryshme devijuese”, që nuk kanë të bëjnë me arritjen e një marrëveshje paqeje. Sipas Richmond (1998), palët mund të përdorin ndërmjetësimin edhe si një taktikë zvarritëse për të blerë kohë për rigrupim dhe riorganizim në terren “duke blerë kohën ata mund të shtyjnë bërjen e koncesioneve të kushtueshme”. Po ashtu, “palët mund të shohin ndërmjetësimin si një platformë dhe si një mekanizëm, përmes të cilit ata, mund të fitojnë aleatë më të mëdhenj ndërkombëtarë”, duke konstatuar se “në këtë mënyrë procesi mund të japë një shkallë më të lartë të legjitimitetit për pretendimet e palëve dhe pozicionet e bisedimeve”.

2.6.5. Avantazhet e pranimi të ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi, sipas studiuesve, gjithashtu ofron një numër përparësish për palët. Para së gjithash, palët mund të përdorin ndërmjetësimin si një mbulim të përshtatshëm politik për të sjellë vendime jopopullore, të tilla si bërja e koncesioneve të nevojshme anës tjetër që do të ishte e paimagjinueshme në mungesë të një pale të tretë. Ndërmjetësuesit sigurojnë

informacionin e nevojshëm për të ndihmuar palët të fitojnë një pamje më të plotë mbi situatën dhe të kuptojnë më mirë preferencat, aftësitë dhe propozimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes tyre. Më e rëndësishmja, prania e ndërmjetësuesve nxit shpresën se, përdorimi i marrëveshjes që arrihet përmes ndërmjetësimit, tejkalon dobinë e një marrëveshjeje që palët do t'mund të arrinin nëse do të negoconin direkt. Ndërmjetësuesit, mund të përdorin resurset e tyre, të prekshme dhe të paprekshme, në mënyrë që të rrisin kostot e konfliktit në kontinuitet, të përmirësojnë atraktivitetin e zgjidhjes së negociuar dhe të nxisin palët që të jenë më fleksibël ndaj kompromiseve. Në të njëjtën kohë, palët e treta mund të japin garanci për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes dhe të ofrojnë ndihmë në fazën e pasmarrëveshjes (Princen, 1992; Bercovitch dhe Schneider, 2000; Beardsley, 2011). Stimujt mund të jenë të dobishëm në ndërprerjen e dhunës dhe në arritjen e një marrëveshjeje paqësore, nëse pala e tretë nuk e mban angazhimin e saj në afat më të gjatë, por, sipas Beardsley, këta stimuj mund të jenë artificialë dhe si të tillë do të mund të nxisnin rikthimin e dhunës.

2.6.6. Përcaktuesit e furnizimit të ndërmjetësimit

Para se të ofrojnë shërbimet e tyre, ndërmjetësuesit e mundshëm përcaktojnë kostot dhe përfitimet që ndërlidhen me ofrimin e ndihmës. Ofrimi i ndërmjetësimit mund të jetë i kushtueshëm. Ndërmjetësuesit shpesh japin mbështetje logjistike për procesin e paqebërjes: rregullimin e një vendi të përshtatshëm, strehimin për palët dhe aspektet e tjera teknike që ndërlidhen me bisedimet. Në të njëjtën kohë, së bashku me shpenzimet materiale, ndërmjetësuesit gjithashtu investojnë kapitalin e tyre jomaterial në procesin e paqes. Si të tilla, mund të jenë humbja e reputacionit, i publicitetit të pafavorshëm si dhe e një pjese të përgjegjësisë nëse procesi dështon. Ndërmjetësuesi është gjithashtu i ngarkuar me detyrat administrative dhe kostot që ndërlidhen me nxitjet dhe sanksionet (Carnevale, 1986; Schrodte dhe Gerner, 2004). Ngjashëm me këtë, ndërmjetësuesit mund të përballen me kosto të larta

politike në vendin e tyre për miratimin e një zgjidhjeje jopopullore. Së fundi, procesi i ndërmjetësimit gjithashtu kërkon investime të konsiderueshme në personelin dhe logjistikën, e cila mund të jetë një barrë pasi procesi i paqebërjes bëhet gjithnjë e më i gjatë. Prandaj, një proces efektiv i ndërmjetësimit varet fuqishëm nga motivimet e ndërmjetësuesve për t'u përfshirë dhe perceptimi se përfitimet e pritura tejkalojnë kostot e mundshme të përfshirjes në proces (Bercovitch dhe Schneider, 2000).

Hyrja e një ndërmjetësuesi në proces është rezultat i një përpjekjeje të sinkronizuar nga palët kundërshtare dhe pala e tretë, si palë ndërmjetësuese. Ndërmjetësuesit mund të ftohen nga palët në konflikt, ata mund të ofrojnë vetë shërbimet e tyre ose ndërmjetësimi mund të bazohet në një marrëveshje të vendosur më parë mes palëve kundërshtare dhe aktorëve të caktuar të jashtëm. Pavarësisht nga mekanizmat me të cilat palët e treta janë të përfshirë, ata kurrë nuk e bëjnë atë pa një qëllim.

2.6.7. Arsyet humanitare dhe interesat e vetë ndërmjetësuesve

Publikisht, palët e treta shpesh e justifikojnë përfshirjen e tyre në baza humanitare. Në situatat në të cilat përshkallëzimi i një konflikti mund të sjellë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, ndërmjetësuesit mund të përballen me presione të fuqishme publike dhe të zhvillojnë një ndjenjë të imperativit moral për të ndërhyrë (Seymour, 2014). Nuk është e pazakontë që në këto rrethana, ndërmjetësuesit të bëhen aktorë, të cilët janë më shumë të interesuar për fatin e popullatës civile, sesa për vetë palën kundërshtare (Crocker et al., 2004: 28).

Megjithëse, promovimi i paqes dhe zbutja e vuajtjeve njerëzore, mund të mos japin përfitime të drejtpërdrejta dhe në disa raste, aktorët që ndërmjetësojnë në konflikte të tilla, mund të mos kenë një interes të fuqishëm strategjik në atë rajon, por mund të pritet që ata të përfitojnë në përmirësimin e reputacionit ndërkombëtar dhe në fuqizimin e rolit të tyre në çështjet ndërkombëtare (Greig dhe Diehl, 2012: 82).

Siç do të tregojë shtjellimi vijues, shqetësimet humanitare janë në thelb të motivimit të aktorëve të ndryshëm për të ndërhyrë. Në radhë të parë, këto janë organizata ndërkombëtare dhe OJQ-të, qëllimi dhe arsyeja e të cilave është promovimi i parimeve të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në fakt, ashtu siç konfliktet mund të përfshijnë aktorë shtetërorë dhe joshetërorë, po aq të ndryshme mund të jenë edhe palët e treta, që mund të kenë interes në ndërmjetësimin e konflikteve (shtetet, organizatat ndërkombëtare globale dhe rajonale, OJQ-të globale dhe individët).

Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e aktorëve ndërkombëtarë, do të ishte e paimagjinueshme të pritët që ndërmjetësuesit të nxiten vetëm nga shqetësimet humanitare për të ndërhyrë, por, në të njëjtën kohë, edhe investimin e konsiderueshëm të resurseve, që kërkon ndërmjetësimi, është e arsyeshme të supozojmë se ndërmjetësuesit nuk janë më pak të motivuar nga interesi vetjak sesa nga impulset humanitare (Touval dhe Zartman, 1985: 8). Ndërmjetësuesit, luajnë rolin e tyre në negociata dhe shpenzojnë resurse, jo vetëm për shkak se ata synojnë të zgjidhin një mosmarrëveshje, por sepse kërkojnë të përfitojnë gjithashtu diçka nga ajo (Greig, 2005). Për shumë aktorë, ndërmjetësimi ndërkombëtar është një instrument i dobishëm i politikës së jashtme, përmes të cilit ata mund të ndjekin disa nga interesat e tyre pa krijuar shumë opozita (Touval, 1992).

Në thelb, përfshirja e një ndërmjetësuesi është nxitur nga përlogaritjet e kostove dhe përfitimeve. Young vëren se “është krejtësisht e mundur që të ketë situata me një rol të veçantë për një ndërmjetësues, por në të cilin asnjë palë e tretë nuk e konsideron si të vlefshëm marrjen e një roli të tillë” (Young, 1972b: 55). Prandaj, fakti që një ndërmjetësues ka interes në menaxhimin e një mosmarrëveshjeje, është një tregues i drejtpërdrejtë se ai ka gjithashtu një interes në këtë mosmarrëveshje.

2.6.8. Palë të treta në cilësinë e ndërmjetësuesit

Në çështjet ndërkombëtare duket se termi dhe koncepti i ndërmjetësimit, është duke shënuar fillimin e gatishmërisë për të zgjidhur një konflikt me mjete paqësore, përmes një pale të tretë, kryesisht përmes negociatave, por jo duke përdorur një metodë ose një praktikë specifike. Zejnullah Gruda, duke numëruar pjesëmarrjen aktive të palëve të treta, në cilësinë e ndërmjetësuesit, specifikon detyrat dhe obligimet e tyre në realizimin e procesit të ndërmjetësimit:

“Ndërmjetësimi konsiston në aksionin e një shteti të tretë, të një grupi shtetesh, të një organizate ose të ndonjë personi autoritativ me qëllim që të gjendet zgjidhja e një konflikti mes dy shteteve. Shteti i tretë, në cilësinë e ndërmjetësuesit, merr pjesë në bisedime mes palëve në konflikt, përpiqet t’u japë atyre kontakteve kohë për zgjidhjen paqësore, jep këshilla, sugjerime, i përcjell kërkesat dhe ndërhyt që t’i pajtojë qëndrimet e kundërta” (Gruda, 2007:483).

Si palë të treta ndërmjetësuese në zgjidhjen e një konflikti ndërkombëtar me mjete paqësore, studiusit dallojnë tri grupime të gjera ndërmjetësuesish: përfaqësuesit e shteteve, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare globale dhe rajonale dhe grupimi i fundit i palëve të treta potenciale, përfaqësuesit e OJQ-ve globale dhe individë, të cilët shpesh janë etiketuar si “ndërmjetësues kyç të nivelit të ulët”, me një reputacion ndërkombëtar në menaxhimin e konflikteve ndërkombëtare dhe në gjendje të veprojnë si ndërmjetësues pa mandat formal nga një shtet apo organizatë ndërkombëtare.

Thomas Princen (2014: 9-49) në hulumtimin e tij eksploron, se në cilën fushë të praktikës diplomatike përshtatet më së miri ndërmjetësimi, duke shkuar përtej fokusit të zakonshëm shtetëror, për të llogaritur aktivitetet ndërmjetësuese të një game të gjerë aktorësh, nga superfuqitë në shtete të vogla, nga individë tek OJQ-të. Edhe pse rolet, interesat dhe aktorët e ndryshëm mund të jenë më pak të paqartë në teori sesa në praktikë, është e rëndësishme të theksohet se çdo aktivitet paqëruajtës kryesisht është i kushtëzuar nga një përzierje adekuate e aktiviteteve të koordinuara mirë, të kryera nga aktorë ndërkombëtarë që ndajnë një qëllim të përbashkët në menaxhimin e një konflikti të caktuar. Dhe për të arritur nivelin e kërkuar të

bashkëpunimit dhe koordinimit mes këtyre aktorëve, do të duhej trajtuar aftësitë, interesat dhe kufizimet e çdo aktori, në çdo aktivitet të menaxhimit të konfliktit.

2.7.Përfundime

Në analizën e bërë, arrijmë në përfundimin se studimi teorik i ndërmjetësimit ndërkombëtar nuk është i integruar aq sa duhet në studimet e politikës ndërkombëtare, edhe pse luan një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, si një formë e menaxhimit të konfliktit. Rëndësia e tij, si proces, ka filluar të vihet në dukje gjatë dekadave të fundit të shekullit të kaluar.

Studiues të ndryshëm kanë tentuar të vlerësojnë në mënyrë kritike rolin e ndërmjetësuesit në menaxhimin e konflikteve ndërkombëtare. Si pikënisje për diskutimin mbi ndërmjetësimin, përmes qasjeve, modeleve, strategjive dhe teorive, të cilat i kanë edhe dallimet e tyre në kontekstin dhe kushtet në të cilat kryhet ky proces, theksohet vlera e lidhjes së tyre në përpjekje për të krijuar dialog produktiv mes çështjeve të ndryshme, mes teorisë dhe praktikës dhe shkollave të ndryshme teorike brenda teorisë së MN. Shtrirja e madhe e aktiviteteve të ndërmjetësimit në arenën ndërkombëtare, është e pasqyruar përmes përkufizimeve të shumta, të ofruara nga studiues të ndryshëm të disiplinës.

Mjedisi ndërkombëtar i shekullit XXI, shumë më tepër sesa paraardhësit e tij, po përjeton konflikte dhe dhunë, si brenda shteteve ashtu edhe mes shteteve. Konfliktet e tilla janë të kushtueshme, shkatërruese dhe shumë të rrezikshme për individët, komunitetet dhe rajonet e botës. Përveç konflikteve mes aktorëve të përcaktuar mirë, format e tjera të dhunës (si terrorizmi) dhe kërcënimet serioze (siç është degradimi i mjedisit dhe sëmundjet) paraqesin një rrezik madhor për qëndrueshmërinë e sistemit ndërkombëtar. Ndërmjetësimi, përmes paanshmërisë dhe kredibilitetit, është duke u bërë mjeti më i fuqishëm diplomatik në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe njëri nga mjetet më efektive për t'iu përgjigjur konflikteve

përhapëse dhe kërcënimeve të shumta, me të cilat ballafaqohemi sot në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përfundimet e pafavorshme të konfliktit mund të jenë veçanërisht të rrezikshme në mjedisin ndërkombëtar, ku ekzistenca e aktorëve politikë mund të kërcënohet. Nga kjo arsye buron edhe rëndësia e menaxhimit të konfliktit ndërkombëtar. Në menaxhimin e marrëdhënieve komplekse njerëzore, ndërmjetësimi është afirmuar, duke hyrë nga jeta e përditshme në arenat kryesore ndërkombëtare. Si palë të treta ndërmjetësuese në zgjidhjen e një konflikti ndërkombëtar me mjete paqësore, është theksuar se mund të jenë: shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, individët privatë dhe OJQ-të. Në të njejtën kohë, është gjetur se ndërmjetësimi zbatohet më lehtë në negociata specifike sesa në çështjet që ndërlidhen me vlerat ose parimet themelore. Nga gjetjet empirike, në hulumtimin e ndërmjetësimit ndërkombëtar, është konstatuar se strategjia e caktuar ka ndikim në efektivitetin e ndërmjetësuesit. Poashtu, është konstatuar se ndërmjetësimi është përdorur në mënyrë të vazhdueshme për t'i dhënë fund luftrave civile dhe konflikteve të tjera të dhunshme gjatë dy dekadave të fundit, në këtë mënyrë, ajo ka zhvilluar një përshtatje të re në situata të ndryshme konfliktive, që përfshijnë çështje të tilla si vetëvendosja, sovraniteti dhe mosmarrëveshjet territoriale. Bercovitch (1997: 131) thekson se “ndërmjetësimi mund të jetë gjëja më e afërt që kemi për një teknikë efektive për t'u marrë me konfliktet në shekullin njëzet e një”.

Kapitulli III: Kuptimi i suksesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar

Në literaturë ka pak marrëveshje për atë se çfarë përbën një rezultat të suksesshëm të ndërmjetësimit, ose se si ta identifikojë atë. Suksesi i një procesi të ndërmjetësimit, mund të perceptohet në mënyra të ndryshme nga palët e përfshira. Rregullat për të përcaktuar dhe vlerësuar suksesin, pas një procesi të ndërmjetësimit, nuk janë as rregulla standarde. Për më tepër, ajo çfarë mund të përcaktohet në një moment si ndërmjetësim i suksesshëm, më vonë mund të konsiderohet si i pasuksesshëm. Ndonjëherë dështimi është më i lehtë për t'u njohur, pasi zakonisht qëllimi i dëshiruar nuk është arritur. Lidhur me këtë, studiues të ndryshëm kanë ndërtuar kriteret e tyre për ndërhyrje të suksesshme ndërmjetësuese. Në një përpjekje për të mbajtur fleksibilitetin në këtë koncept, Bercovitch et al., (1991: 16) theksojnë se “një ndërmjetësim i suksesshëm ndërkombëtar ekziston në rastin kur palët kanë arritur një armëpushim, një zgjidhje të pjesshme ose një zgjidhje të plotë”. Me fjalë të tjera, kjo nënkupton kur të paktën një ndryshim i vogël ka ndodhë në nivel të konfliktit për shkak të përpjekjeve për ndërmjetësim. Nga ana tjetër, bazuar në qasjen që ka si bazë qëllimet, një grup tjetër i studiuesve e ka barazuar suksesin e ndërmjetësimit, me kënaqësinë e shprehur nga palët, në fund të procesit, bazuar në objektivat e tyre fillestare (Smith 1985; Touval dhe Zartman, 1985; Kleiboer, Marieke, 1996: 361-362). Në analizën e tyre të përpjekjeve dhe të suksesit të ndërmjetësimit studiuesit, Svensson dhe Wallensteen (2010: 109), arrijnë të argumentojnë situatat kur “ndërmjetësimi nuk rezulton gjithmonë me marrëveshje të plota dhe të qëndrueshme të paqes mes palëve, pasi një rezultat i tillë nuk mund të jetë as qëllimi i

ndërmjetësimit”. Objektivat e tyre në suksesin e ndërmjetësimit, në përgjithësi, përfshijnë qëllime të tilla, si përmirësimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit mes palëve kundërshtare, zbutjen e krizave humanitare si dhe eksplorimin e elementeve, që do të mund të përdroeshin, në të ardhmen, për një marrëveshje përfundimtare në aktivitetet e mundshme të ndërmjetësimit.

4.1. Faktorët përcaktues të suksesit apo dështimit të ndërmjetësimit

Pjesa e hulumtimit të paraqitur, sugjeron, se sukcesi në ndërmjetësim asnjëherë nuk i atribuohet vetëm një shkakut ose një faktori të vetëm. Aq më shumë, çdo faktor mund të shtojë një element të nevojshëm për të arritur suksesin. Në të njëjtën mënyrë, literatura sugjeron se ka edhe nivele të ndryshme, në të cilat përpjekjet ndërmjetësuese kontribuojnë në dështim. Kuadri i emergjencave të ndërmjetësimit, ofron një qasje empirike për të kuptuar ndërmjetësimin, si proces kompleks dhe jo statik, ku rezultatet e tij të suksesshme janë të ndërlidhura ngushtë me natyrën dhe karakteristikat e mosmarrëveshjes si dhe me sfondin dhe strategjitë e ndërmjetësuesit. Literatura mbi ndërmjetësimin, fokusohet kryesisht në studimin e variablave, që ndikojnë në probabilitetin e ndërmjetësimit të suksesshëm. Hulumtuesit përpiqen të përcaktojnë ndërveprimin mes strukturës së konfliktit, identitetit dhe karakteristikave të ndërmjetësuesit, strategjive ndërmjetësuese që ndërmjetësuesi zgjedh për të aplikuar dhe suksesit të ndërmjetësimit në menaxhimin dhe zgjidhjen e konfliktit. Vlerësimi i shkallës së suksesit të ndërmjetësimit është problematik, pasi nuk është gjithmonë e qartë se çfarë përbën sukcesi. Kriteret mund të shkojnë nga reduktimi i dhunës në nivele endemike, jo akute, deri në përfundimin e dhunës, në qëllimin ambicioz të krijimit të një zgjidhjeje politike, që efektivisht, mbyll pritjet e dhunës në të ardhmen. Sipas Touval dhe Zartman (1989: 177) ndërmjetësimi është “një ndërhyrje e pranueshme për palët kundërshtare, të cilët bashkëpunojnë në mënyrë diplomatike me ndërmjetësuesin ...”. Ndërmjetësimi në rrethana të

tilla, është shpesh i qetë dhe modest, me më pak ndikim të jashtëm të ndonjë ndjenje krize, duke e bërë kështu, praktikisht të pamundur, të lidhet universi i rasteve veçanërisht për të identifikuar sukseset. Sidoqoftë, ndërhyrja e palës së tretë është gjithashtu e përdorur gjerësisht, pasi dhuna është bërë intensive, si një mjet për të sjellë një armëpushim dhe, përfundimisht, një zgjidhje paqësore. Studiuesit, Fearon (1994a) dhe Smith (1996) precizojnë se dallimet në fazat e procesit të paqebërjes, na paralajmërojnë për një problem të përgjithshëm në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, për “rreziqet analitike dhe empirike të paragjykitimit të përzgjedhjes”. Në secilën fazë të përshkallëzimit të një konflikti, çdo vlerësim empirik i përfitimeve nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve të palëve të treta, kërkon marrjen në konsideratë, jo vetëm të suksesit dhe të dështimeve të ndërhyrjes në atë fazë, por edhe të rrethanave në të cilat është tentuar ndërhyrja, në krahasim me ato, në të cilat nuk është bërë ndonjë përpjekje. Në këtë kontekst, Kriesberg (1998) shton se “kushtet dhe ndikimet, që kontribuojnë në suksesin e një faze, mund të jenë shumë të ndryshme nga ato të një faze më të hershme”.

4.1.1. Koncepti i levës në kontekstin e ndërmjetësimit

Në literaturën e ndërmjetësimit, hasim një konsensus të përgjithshëm ku thuhet se, identiteti i ndërmjetësuesit përcakton fuqinë apo “sistemin e levës” që ai e ka. Megjithatë, mund të thuhet se sistemi i levës është një nga konceptet më të pakapshme dhe të nënspecifikuara në hulumtimet e ndërmjetësimit (Kleiboer 1996: 371-372).

Hulumtimet mbi procesin e ndërmjetësimit, e theksojnë rëndësinë e levave të palës së tretë në ndërmjetësim. Bercovitch et al., (1991: 15) dhe Smith (1994: 446) argumentojnë se, “meqenëse leva rrit aftësinë e ndërmjetësuesit për të ndikuar në një rezultat, ndërmjetësimi shihet si një “proces që përfshin ushtrimin e forcës”. Derisa Touval dhe Zartman (2006: 436), në këtë kontekst, pretendojnë se “shtrirja relative e ndikimit të një ndërmjetësuesi,

përgjithësisht është i ndërlidhur me resurset që i ka në dispozicion, të cilat, nga ana tjetër, janë përkthyer në levë apo fuqi”, duke precizuar se “leva në ndërmjetësim është aftësia për të lëvizur një palë në drejtimin e synuar”.

4.1.2. *Anshmëria e ndërmjetësuesit*

Efektet e paanshmërisë, kundrejt anshmërisë së ndërmjetësuesit, gjithashtu renditen në mesin e prioriteteve të suksesit të ndërmjetësimit. Preferencat, që ndërmjetësuesit sjellin me vete në proces, reflektohen në disa lloje të anshmërive, të cilat mund të ndiqen nga interesat që i udhëheqin ndërmjetësuesit për të hyrë në proces. Supozimet dhe agjendat, që ndërmjetësuesit i kanë në lidhje me konfliktin, mund të formësojnë preferencat e tyre për llojin e rezultatit që ndjek përmes ndërmjetësimit. Anshmëria në rezultat, mund të konsiderohet si një burim serioz i problemeve, në aspektin e dinamikës së negociatave, “pasi që minimizon gamën e rezultateve të mundshme për palët kundërshtare”. Sipas Touval, kjo anshmëri krijon një shkallë më të lartë të parashikueshmërisë për procesin dhe një ndjenjë drejtimi për palët. Kur diplomati i njohur, Richard Holbrooke (1998), në luftën civile të Bosnjës, takoi përfaqësuesit e tre popujve, ai menjëherë hodhi planin e tij për të ardhmen e Bosnjës, e cila u përdor si bazë për negociatat pasuese mes palëve. Në këtë mënyrë u “eliminuan mundësinë e eksplorimit të opsioneve të tjera”, të tilla si ndarja, integrimi i pjesëve të veçanta në vendet fqinje ose rishikimi i plotë i kufijve bazuar në parimin e përkatësisë etnike.

Disa studime të tjera dëshmojnë për përfitime të mundshme të anshmërisë, kur ndërmjetësuesit mund të kenë marrëdhënie të afërta personale dhe lidhje të ngushta politike ose ekonomike me njëren nga palët kundërshtare, por edhe në rastet e karakterizuara nga asimetria e pushtetit mes palëve në konflikt. Në mënyrë të ngjashme, një ndërmjetësues i njëanshëm mund të jetë i pranueshëm për një palë të pafavorizuar, sepse ajo palë e tretë, e veçantë, mund të jetë e vetmja e aftë të grumbullojë resurset e nevojshme, për të prodhuar

stimujt që mund të sjellin një ndryshim në proces. Këtë e argumenton edhe Kleiboer (1996: 370) dhe disa studiues të tjerë, kur theksojnë se “ndërmjetësuesit e njëanshëm mund të fuqizojnë palët më të dobëta në interes të zgjidhjes së drejtë, për t’i dhënë fund mjerimit njerëzor”. Në këtë kontekst, palët e pafavorizuara dhe më të dobëta, pranojnë ndërmjetësues të njëanshëm “sepse mund të jenë në gjendje t’i bëjnë presion partnerit të tyre drejt pranimit të një zgjidhjeje, që përndryshe do të ishte e paarrtshme. Me fjalë të tjera, “ndërmjetësimi mund të përdoret për të përmirësuar marrëdhëniet mes palës së pafavorizuar dhe ndërmjetësuesit” (Zartman dhe Berman, 1982: 68; Sick, 1985; Carnevale dhe Arad, 1996; Kydd, 2003; Touval dhe Zartman, 2006: 433; Svensson, 2014).

4.1.3. Ndikimi i asimetrisë në balancën e fuqisë

Efektet e asimetrisë në balancën e fuqisë mes palëve kundërshtare, konsiderohen, po ashtu variabël i rëndësishëm në suksesin e procesit të ndërmjetësimit. Nëse është vërtet e drejtë të supozohet se “vendimmarrësit kanë tendencën të perceptojnë botën në mënyrë të pasaktë” (Jervis, 1976: 3-7), atëherë duhet pyetur se çfarë janë gjasat që palët në konflikt t’i drejtohen një pale të tretë për ndihmë, në zgjidhjen e një konteksti, kur kjo mund të përfshijë kompromise të kushtueshme.

Një supozim fillestar, bazuar në studiues të shumtë, është se, të gjitha konfliktet në thelb janë asimetrike. Megjithatë, analizat e ndërmjetësimit dhe negociimit kryesisht përqendrohen në rastet kur ka pasur një simetri relative mes palëve në konflikt. Nga kjo argumentohet se ndërmjetësimi është më efektiv në një situatë të një bllokimi apo të një krize. Por, kjo do të ishte një thjeshtëzim, sepse nuk ka dy palë ose grupe të njëjta resursesh. Prandaj, nga kjo arsye përcaktimi dhe përmasat e tyre relative, duken të vështira, pasi konflikti është rezultat i një asimetrie fillestare.

Kritika kryesore, e studiuesve, ndaj realizmit është pretendimi se, “fuqia nuk mund të përcaktohet” dhe duket se kjo do të vështirësojë detyrën e përcaktimit të simetrisë në konflikt (Aguirre, 1995; Habeeb, 1988: 11). Kështu, nëse supozojmë se konflikti është asimetrik, kjo fuqizon propozimin, që palët kundërshtarë, do të kenë tendencë të shohin ndërmjetësimin si rezultat nul. Kjo, për shkak se ndërmjetësimi, do të shihet si një shtrirje e përpjekjeve të palëve për të “fituar”, ose të paktën për të shmangur humbjen.

Wall (1981: 163) saktëson se “marrëdhëniet në mes të negociatorëve dhe ndërmjetësuesit, si dhe shpërblimet dhe kostot që dalin nga procesi i ndërmjetësimit, janë pjesërisht një produkt i perceptimit i të dyja palëve”. Nënkuptimi i kësaj, është se perceptimet e të trija palëve lidhur me pozicionimin dhe fuqinë e njëri tjetrit, synimet, marrëdhëniet dhe procesi i ndërmjetësimit, janë përcaktues jetik për rolin e ndërmjetësuesit, që palët në kontest e dëshirojnë, si dhe për “suksesin” e procesit.

Disa studiues, në hulumtimet e tyre mbi llojin e konfliktit, i ndajnë konfliktet në kategori, sipas përmbajtjes së tyre, si në ato territoriale, fetare apo edhe etnike (Regan, 1996; Bercovitch dhe Houston, 2000). Këto taksonomi, edhe pse të precizuara, shpesh nuk arrijnë të trajtojnë karakteristikat analitike, që i nënshtrajnë situatat konfliktuale.

4.1.4. Strategjitë në procesin e ndërmjetësimit

Gjetjet empirike në hulumtimin e ndërmjetësimit ndërkombëtar, tregojnë se strategjia e caktuar, të cilën ndërmjetësuesi e miraton për të nxitur një marrëveshje në mes të palëve në konflikt, ka ndikim në efektivitetin e ndërmjetësuesit (Bercovitch dhe Houston, 1996; Beardsley et al., 2006; Beardsley, 2008). Siç është cekur edhe më lartë, rezultati i ndërmjetësimit është i kushtëzuar, si nga variablat kontekstuale, ashtu edhe nga vetë procesi. Prosesi i ndërmjetësimit, mund të shihet si sjellje ndërmjetësuese ose strategji. Në literaturën mbi konfliktet, janë identifikuar qasje të ndryshme të roleve ndërmjetësuese. Tipologjitë e

ndryshme, në njëfarë mënyre, janë modele të ndryshme për të kuptuar ndikimin e ndërmjetësuesit mbi palët, procesin dhe rezultatet. Pjesa më e madhe e literaturës e sheh ndërhyrjen si një vazhdimësi ose “spektër teknikash”, ku palët e treta, janë palë të jashtme ndaj konfliktit. Palët e treta mbajnë një ndikim të konsiderueshëm mbi konfliktin dhe mbeten jashtë tij. Në këtë këndvështrim, vihen në lëvizje teknikat e ndryshme të palës së tretë, në pika të ndryshme përbrenda një konflikti (Lund, 1996). Në fund të një spektri intervenues qëndron ndërmjetësimi i pastër, lehtësimi i një zgjidhjeje të negociuar përmes bindjes, kontrollit të informacionit dhe identifikimit të alternativave, nga një palë që është perceptuar të jetë e paanshme.

Strategjitë, me efektet dhe karakteristikat e tyre, renditen në mesin e prioriteteve të suksesit të ndërmjetësimit. Në literaturë, strategjia është definuar edhe si “një plan i gjerë veprimi i projektuar për të treguar se cilat masa mund të ndërmerren për t’i arritur objektivat e dëshiruara në konflikte”, ndërsa sjellja i referohet “taktikave, teknikave ose instrumentave” reale në dispozicion të një ndërmjetësuesi (Bercovitch, 2005: 113). Tipologjia më e pranueshme klasifikon sjelljen e ndërmjetësuesit dhe strategjitë përkatëse në një shkallë intervenimi dhe vlerëson nivelin e kredibilitetit të ndërmjetësuesve në procesin e paqes. Por, si do ta vëjnë në lëvizje ndërmjetësuesit procesin dhe të krijojnë kushte për vendimmarrje më efektive, pa pasur fuqinë për të ndërmarrë vendime të detyrueshme dhe cilat strategji dhe taktika mund të përdoren nga një ndërmjetësues?

Pasi është prezent një numër i madh aktorësh, të aftë për të filluar misionin ndërmjetësues, nuk është e lehtë të kuptohet vargu i sjelljeve të ndërmjetësimit. Kjo është arsyeja përse janë prezente kategoritë e gjera të roleve, strategjive dhe taktikave të ndërmjetësimit. Fillojmë me përpjekjet për të kuptuar domethënien e qasjes së ndërmjetësimit të palëve të treta dhe përse rëndësia e politikës së saj është domethënëse. Sipas Carment dhe Harvey (2000), duhet të jetë

e qartë, se “përgjegjësia primare e një pale të tretë, është zakonisht për të parandaluar konfliktin destruktiv përmes një sërë kanalesh dhe veprimesh politike, jodetyruese”. Kjo pikëpamje është në përputhje me parimet e “diplomacisë preventive” dhe të parandalimit, ku qëllimi kryesor strategjik është pjesëmarrja aktive e një pale të tretë për deeskalimin e konfliktit, para se ai të bëhet i dhunshëm ose për të parandaluar përsëritjen e një dhune.

Një qasje e tillë, mund të duket e paefektshme, pasi armiqësitë kanë shpërthyer dhe dhuna është përhapur. Në realitet, ka pak marrëveshje brenda disiplinës për llojet e strategjive të bisedimeve të nevojshme për përfundimin e konflikteve. Kritikët kanë sugjeruar se “format shtrënguese dhe të njëanshme të ndërhyrjes, shërbejnë vetëm për të shkatërruar normat ndërkombëtare të përmbajtjes reciproke mes shtetesh”. Të tjerë, më provokues, kanë argumentuar se “mënyra më e shpejtë për të ndërprerë një konflikt ndëretnik, me sa më pak viktima, është të favorizojnë anën më të fuqishme në çdo konflikt” (Licklider, 1995; Regan, 1996; Carment dhe Rowlands, 1998).

Për Young, roli kyç i ndërmjetësuesit është të bëjë një ndryshim të vërtetë në një mosmarrëveshje, dhe kjo është arsyeja përse ndërmjetësuesi ndërhyt në mes palëve kundërshtare. Ky ndryshim mund të jetë në mënyra të ndryshme. Kaufman dhe Duncan (1992: 690) i grupojnë këto mundësi, që do të thotë: (1) duke siguruar informacionin - faktik ose normativ; (2) duke transferuar informacione në mes palëve në konflikt; dhe (3) duke ndryshuar procedurat e procesit të negociimit, me përfshirjen edhe të mjedisit fizik në të cilin zhvillohen negociatat. Nga ky këndvështrim ekziston një shkallë e kujdesshme, por në rritje, e përfshirjes së ndërmjetësuesit me palët, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi i tyre dhe të arrihet një marrëveshje e kënaqshme.

Touval dhe Zartman (2006: 435-437) i drejtohen procesit të ndërmjetësimit të suksesshëm nga një perspektivë tjetër. Ata vendosin tri mënyra, që ndërmjetësuesit përdorin për të konsideruar

interesat e të gjitha palëve, të përfshira drejt një zgjidhjeje të pranueshme reciproke për konfliktin: lehtësimin apo komunikimin, formulimin dhe manipulimin. Secila prej këtyre tri mënyrave i referohet një niveli të ndryshëm pengesash për kryerjen e negociatave të drejtpërdrejta për të ndihmuar palët të arrijnë qëllimet, të cilat ata vetë nuk mund t'i arrijnë. Në fazat e hershme të negociatave, sipas autorëve, “ndërmjetësuesit kanë tendencë të përqëndrohen në ndihmën e komunikimit mes palëve”, duke përcjellë porosi dhe duke ndihmuar palët të kuptojnë porositë e përcjella. “Derisa negociatat vazhdojnë, ndërmjetësuesit mund të veprojnë si formulatorë”. Palët i drejtohen ndërmjetësuesit për të siguruar një formulë për negociatë, që do të thotë, një “kuptim i përbashkët i problemit dhe zgjidhja e tij ose nocioni i përbashkët i drejtësisë për të qeverisur një rezultat”. Këtë tipologji e konsiderojmë veçanërisht të dobishme, si pjesë të një kornize të përgjithshme të ndërmjetësimit e cila lejon të kuptojmë, se çfarë në të vërtetë bëjnë ndërmjetësuesit, kur ata përfshihen në një konflikt dhe sa mund të jenë të suksesshëm, si dhe të analizojmë se si modelet e ndryshme të sjelljes shpiejnë në rezultate të ndryshme.

Studiuesi, Dean Pruitt, (2000: 245–254) në “The Tactics of Third-Party Intervention” analizon proceset përmes të cilave, palët e treta, mund të kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve me palët e papajtueshme dhe argumenton se palët e treta, në konflikte të zgjata dhe të rënda, duhet të përdorin taktika më të fuqishme, të cilat nënkuptojnë përdorimin e një varg hapash të ndërlidhura me “shkurtimin e zinxhirëve”, duke shtuar se “konfliktet serioze shpesh lëvizin në prag të zgjidhjes nga zinxhirët e ndërmjetësuesve duke u ndërtuar në rrugën e dy diplomacive”. Hulumtimi i Pruitt, nxjerr në pah një problem themelor në literaturë. Ekziston një problem domethënës konceptual dhe teorik i identifikimit të efekteve të pavarura të strategjive individuale. Disa e shohin procesin si negociatë me luftëtarët në një varg të fuqishëm të strategjive të ndërlidhura, ndërsa të tjerët e shohin atë si të aplikuar njëkohësisht.

Këto dallime janë pjesërisht për shkak të konfuzitetit konceptual lidhur me ndërhyrjen e termave. Dixon (1996: 358) potencon se “ndërhyrja nuk i referohet thjesht pranisë fizike të një agjenti menaxhues”, që synon përdorimin e shtrëngimit, për të dekurajuar luftëtarët nga përdorimi i forcës për të zgjidhur dallimet e tyre dhe as “nuk është kufizuar në përfshirjen e shteteve apo organizatave përmes mjeteve ushtarake”. Derisa, Bercovitch (1996) pretendon se “ndërhyrja e palës së tretë përfshin një gamë të gjerë të teknikave”, megjithëse është vështirë të gjendet pajtueshmëri për atë se cilat mund të jenë ato.

Për qëllime deskriptive dhe analitike, është e zakonshme që studimet të konceptojnë gamën e veprimeve ndërmjetësuese sipas tri strategjive të gjëra: lehtësimit ose konsultimit, formulimit dhe të manipulimit, (Bercovitch dhe Gartner, 2006; Beardsley et al., 2006). Modelet i ndajnë veprimet ndërmjetësuese sipas qëllimeve të tyre strategjike (Tabela 1: Strategjitë në procesin e ndërmjetësimit), si dhe sipas mënyrës në të cilën ato tentojnë të kontribuojnë në procesin e negociatave (Wilkenfeld et al., 2005; Höglund dhe Svensson, 2011). Përkufizimi i Kolb mbi strategjitë e ndërmjetësimit argumenton më së miri rëndësinë e tyre kyçe në menaxhimin e një konflikti:

“Strategjia e ndërmjetësimit është një plan i përgjithshëm, qasje ose një metodë që ka një ndërmjetësues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. . . është mënyra se si ndërmjetësuesi synon të menaxhojë rastin, palët dhe çështjen (Kolb, 1983: 249).

Në pajtueshmëri me këtë definicion është edhe Bercovitch (1992), kur thekson se, “strategjia e ndërmjetësimit nënkupton një plan të përgjithshëm të ndërmjetësuesit, për zgjidhjen dhe menaxhimin e konflikteve”.

Dallimet në zbatimin e strategjive të ndryshme të ndërmjetësimit, mund t’i atribuohen asaj, se si një ndërmjetësues përzgjedh të merret me procesin e ndërmjetësimit dhe kontekstin specifik të konfliktit. Në esencë, praktika dhe procesi i ndërmjetësimit, në masë të madhe, varen nga përzgjedhja e sjelljes strategjike të ndërmjetësuesve. Ndërmjetësuesit për një ndërmjetësim të suksesshëm dhe për arritjen e një kompromisi, ndjekin objektivin e tyre të zgjidhjes së

konflikteve, duke hyrë në një konflikt dhe duke miratuar një strategji të veçantë, e cila në fazat e mëvonshme edhe mund të ndryshojë.

4.1.4.1. Lehtësimi/komunikimi

Lehtësimi apo komunikimi është forma më pasive e ndërhyrjes. Në këtë rast, ndërmjetësuesi si lehtësues, merr një rol shumë pasiv në procesin e paqes, duke shërbyer kryesisht si një kanal komunikimi dhe ofruar informacionesh mes palëve në konflikt (Touval dhe Zartman, 1985; Hopmann, 1996; Bercovitch dhe Houston, 2000).

Ndërmjetësuesi, përmes kësaj strategjie, mund të shërbejë si komunikues, në një situatë, ku konflikti ka bërë “të pamundur kontaktin e drejtpërdrejtë mes palëve, duke penguar, kështu, palët të bisedojnë me njëra-tjetrën dhe të bëjnë lëshime pa u shfaqur si të dobët ose të humbur” (Touval dhe Zartman, 2006: 435).

Ndërmjetësuesi, si lehtësues, fokusohet kryesisht në ndihmën e palëve në komunikimin më të lehtë dhe lehtëson bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë, gjatë ushtrimit të kontrollit modest mbi procesin aktual të ndërmjetësimit, vepron si një kanal i dyanshëm informativ, duke i kanalizuar informatat mes palëve. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të mosbesimit, që zakonisht prodhojnë konfliktet, vendimet e palëve kundërshtarë preken nga informacione të paplota, në lidhje me preferencat dhe mundësitë e kundërshtarëve të tyre, gjë që i pengon ata të identifikojnë alternativa reciprokisht të pranueshme ndaj marrëdhënieve të tyre konfliktuale (Fearon, 1995; Hopmann, 2001; Powell, 2002; Beardsley et al., 2006).

Përmes kësaj strategjie, ndërmjetësuesi, u siguron palëve kundërshtarë informacione të cilat janë thelbësore për të tejkaluar dallimet mes tyre dhe për të vlerësuar gamën e rezultateve reciprokisht të pranueshme (Lista e tabelave 1 - Figura 1.1 Lehtësimi/komunikimi). Megjithatë, sipas Touval dhe Zartman, për të qenë në gjendje të veprojnë si komunikues, janë

të nevojshme tiparet e karakterit si “takti, formulimi dhe simpatia, të përziera në doza të barabarta me saktësi dhe konfidencialitet”.

Me fjalë të tjera, duke përdorur strategji lehtësuese dhe komunikuese, ndërmjetësuesit ndihmojnë palët kundërshtare të pranojnë se ata aktualisht kanë interesa të pajtueshme. Taktikat që zbatohen janë të papërfillshme dhe ndërmjetësuesi lehtësues shfaq kontrollin minimal mbi procesin ose substancën e negociatave (Bercovitch dhe Gartner, 2006). Veprimet janë të kufizuara në forma më pak aktive të ndërmjetësimit, të tilla siç është sigurimi i zyrave për shërbime të mira, transferimi i informatave ose zbulimi i njohurive të reja mbi palët kundërshtare (Beardsley et al., 2006).

Strategjia lehtësuese është e ndërlidhur ngushtë me parimet integruese të menaxhimit të konfliktit. Ndërmjetësuesit synojnë të krijojnë një sasi më të madhe “vlerash”, që do të ndahen mes palëve në konflikt, duke i zbuluar kështu mundësitë për përfitim reciprok. Ata ndihmojnë palët në vendosjen e kontaktit, qoftë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përmes diplomacisë lëvizëse (shuttle diplomacy), sqarojnë situatën e përgjithshme për të dyja palët, identifikojnë çështjet përkatëse dhe promovojnë masat për ndërtimin e besimit dhe disponueshmërinë e zgjidhjeve reciprokisht të pranueshme përmes negociatave. Në vend që të ridisenjohë zonën e marrëveshjes, strategjia e ndërmjetësimit lehtësues ndihmon palët të gjejnë një zgjidhje nga grupimi ekzistues i marrëveshjeve të pranueshme (Kressel, 1972; Carnevale, 1986).

Strategjia e ndërmjetësimit lehtësues quhet edhe strategjia e konsultimit. Në përgjithësi, sipas Bercovitch dhe Gartner (2006), qasjet lehtësuese kanë më shumë gjasa të prodhojnë rezultate pozitive “në rastet më pak sfiduese, me më pak viktima, ku angazhimi më i bezdisshëm nga ndërmjetësuesit mund të perceptohet si ndërhyrje”.

Efektiviteti i ndërmjetësuesve lehtësues, është kryesisht i bazuar në aftësinë për t’i reduktuar asimetritë e informacionit (Savun, 2008). Shërbimi i ndërmjetësuesve varet nga aftësia për të

bindur palët, që të ndajnë informacionet mbi rezervat e tyre. Duke i kontrolluar dhe plotësuar informacionet e nxjerra nga palët, të mbledhura në mënyrë të pavarur, ndërmjetësuesit mund të ndihmojnë në minimizimin e dezinformimit, të injorancës dhe të keqperceptimit, që shpeshherë parandalojnë përfundimin e suksesshëm dhe nënshkrimin e marrëveshjes (Fisher, Ury, dhe Patton, 1982; Dixon, 1996; Kydd, 2003; Savun, 2008; Beardsley et al., 2006; Rauchhaus, 2006).

4.1.4.2. Formulimi

Formulimi, si një formë më aktive e paqebërjes, përfshin ndërmjetësuesin si formulues, i cili kryen kontrollin e aspekteve kyçe të procesit të paqes, duke luajtur një rol më aktiv në strukturimin e procesit të negociatave dhe ofrimit të propozimeve për zgjidhje të mundshme kompromisi.

Touval dhe Zartman (2006: 437-440) theksojnë se kjo strategji e ndërmjetësimit “kërkon që ndërmjetësuesi të hyjë në thelbin e negociimit”. Meqenëse një konflikt mund të jetë arsyeja për të ndaluar çdo komunikim mes palëve, ato mund të kenë nevojë për një ndërmjetësues si formulues. Studiuesit konsiderojnë se “formulat janë çelësi i një zgjidhjeje të negociuar për një konflikt, ato ofrojnë një kuptim të përbashkët të problemit dhe zgjidhjen e tij ose një nocion të përbashkët të drejtësisë për të qeverisur një rezultat”. Kjo strategji kërkon që ndërmjetësuesit të jenë në gjendje të mendojnë mbi “mënyrat për të deblokuar të menduarit e palëve në konflikt dhe mënyrat për t’i tejkaluar zotimet që i kufizojnë palët”.

Edhe kur palët pranojnë se ndajnë një sërë zgjidhjesh të mundshme, ato ende duhet të bien dakord për një përfundim të caktuar brenda saj. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të mosbesimit që gjeneron konfliktin, palët mund të perceptojnë zgjidhjet e mundshme (edhe pse

ato janë aktualisht në kuadër të këtyre fushave reciprokisht të pranueshme) si reciprokisht përjashtuese, duke krijuar kushtet e nevojshme për një bllokim (Beardsley, 2006: 63).

Të ballafaquar me perceptime dhe qëndrime të paarsyeshme lidhur me negociimin e vijës së ashpër nga ana e palëve, duke manipuluar me elementet e negociatave për një mjedis sa më pozitiv, “ndërmjetësuesit duhet të marrin një rol më aktiv në proces, duke përfshirë vendndodhjen, kohën dhe ritmin e diskutimeve” (Bercovitch dhe Gartner, 2006). Gjithashtu, “ndërmjetësuesit, mund të kontrollojnë shpërndarjen e informacionit, ripërcaktimin e çështjeve të kontestuara dhe futjen strategjike të alternativave inovative” (Hopmann, 1996). Kjo aftësi, mund të jetë veçanërisht e dobishme “në kontekstin e negociatave të pezulluara, në të cilat ndërmjetësuesit mund të ndihmojnë duke krijuar pika të reja kontakti rreth të cilave mund të gjenden zgjidhjet për mosmarrëveshjen” (Beardsley et al., 2006, Svensson, 2007).

Strategjia e tillë, me të cilën ndërmjetësuesit ndihmojnë palët për të ripërcaktuar çështjet dhe për të propozuar zgjidhje specifike përgjithësisht konsiderohet të jetë formulimi (Lista e tabelave 1 - Figura 1.2 - Formulimi).

Lehtësimi dhe formulimi, si modele të strategjive të negociatave integruese ndihmojnë aktorët të identifikojnë në mënyrë korrekte zgjidhjet brenda intervalit të mbivendosur të rezultateve të mundshme, jo të dhunshme (Carnevale 1986; Beardsley et al., 2006: 63). Në përdorimin e strategjisë së këtyre dy modeleve, palët gradualisht heqin dorë nga perceptimet me zero-sum dhe angazhohen në qasjet e zgjidhjes së problemeve, përmes së cilave ata njohin përfitimet e përbashkëta. Në konflikte të caktuara, lehtësimi i komunikimit dhe formulimi i zgjidhjeve të mundshme nuk janë të mjaftueshme që palët të ndryshojnë qëndrimet e tyre dhe të arrijnë një kompromis.

Siç tregojnë studimet e shumta, strategjitë më pak imponuese, janë më të suksesshme në konfliktet me intensitet të ulët, në të cilin palët janë të gatshme të zgjidhin, por nuk janë në

gjendje të komunikojnë këtë gatishmëri me njëri tjetrin (Bercovitch dhe Gartner, 2006; Beardsley et al., 2006). Sidoqoftë, në rastet kur palët kundërshtare nuk e kanë motivimin për zgjidhje dhe tregojnë mosgatishmëri për kompromis, nevojitet një ndërhyrje më e fuqishme e një pale të tretë (Rubin, 1980; Hiltrop, 1989; Carnevale dhe Pruitt, 1992; Carnevale, 2002; Sisk, 2009; Bercovitch, 2009) .

Marrë në përgjithësi, ndërmjetësuesit gjithashtu mund të sinjalizojnë domosdoshmërinë e koncesioneve ndaj audiencës vendore dhe të marrin përgjegjësinë për veprime jopopullore. Në këtë mënyrë, ndërmjetësuesit rrisin gjasat e paqes duke e “drejtuar ndërhyrjen kundër reagimit të brendshëm” (Beardsley, 2010).

Formulimi vepron në të dyja rastet me intensitet të lartë dhe me intensitet të ulët, edhe pse me një masë të ndryshme suksesi. Në kontestet me intensitet më të lartë, formulimi rrit shanset për trazira të pjesshme, ndërsa në kontestet me intensitet më të ulët, ka të ngjarë të rezultojë me një zgjidhje të plotë (Bercovitch dhe Gartner, 2006)

4.1.4.3. Manipulimi

Manipulimi, e quajtur edhe si “ndërmjetësim me muskuj” ose “ndërmjetësim i fuqisë”, konsiderohet si strategjia më aktive, që një ndërmjetësues, si manipulues, mund ta përdorë (Lista e tabelave 1 - Figura 1.3 – Manipulimi). Përmes saj, palët e treta ushtrojnë ndikim më të fuqishëm, si në përbajtjen ashtu edhe në substancën e procesit negociues. Kjo strategji shkon përtej formulimit, në mënyrën që përdor masa shtrënguese ose nxitje pozitive (qasja “shkopi dhe karrota”), për të lëvizur palët në drejtim të marrëveshjes (Fisher dhe Keashly, 1991; Bercovitch dhe Gartner, 2006; Svensson, 2007; Beardsley, 2009; Bergmann dhe Niemann, 2015: 962).

Në vend se të gjejë pikat ekzistuese të zgjidhjes, një ndërmjetësues si manipulues përdor nxitje pozitive dhe negative për të ngritur zonën e marrëveshjes. Kur ndërmjetëson me

muskuj, ndërmjetësuesi bëhet “pjesëmarrës i plotë”, i cili është në gjendje të ndikojë në thelbin e procesit të bisedimeve duke paraqitur stimuj ose duke dhënë ultimatume për palët kundërshtare (Touval dhe Zartman, 1985; Bercovitch et al., 1991; Bercovitch dhe Houston, 2009).

Sipas Touval dhe Zartman, strategjia manipuluese kërkon që një ndërmjetësues ”të përdorë fuqinë e vet për të sjellë palët në një marrëveshje, duke i shtyrë dhe tërhequr ata nga konflikti në zgjidhje”. Me fjalë të tjera, ndërmjetësuesi duhet të manipulojë me të gjitha levat e disponueshme për palët në konflikt, duke marrë shkallën maksimale të përfshirjes dhe duke i bindur palët që të pranojnë vizionin e saj për një zgjidhje. Ndërmjetësuesi duhet ta bëjë zgjidhjen atraktive, “duke e rritur vlerën e tij me shtimin e përfitimeve nga rezultati dhe duke e prezantuar në mënyrë të tillë që të tejkalohen pabarazitë mes palëve”. Poashtu, për të nxjerrë koncesione nga palët në konflikt, “ndërmjetësuesi ofron sugjerime dhe formula që ndërliiden me thelbin e mosmarrëveshjes dhe, përmes presionit, ushtron ndikim dhe ofron stimuj për kompromise” (Touval dhe Zartman, 2006: 436).

Në të njëjtën kohë, “ndërmjetësuesit mund të manipulojnë perceptimet e palëve duke ofruar stimuj për të rritur atraktivitetin e një zgjidhjeje të negociuar”. Këta stimuj mund të jenë të natyrës materiale dhe përfshijnë dispozita të ndihmës financiare dhe humanitare, asistencë zhvillimi, garanci sigurie dhe monitorim të zbatimit, ose më pak stimuj të prekshëm, si përmirësimi i reputacionit ndërkombëtar, legjitimimi i shkakut të tyre ose ngritja e marrëdhënieve me aktorë të veçantë të jashtëm (Zartman, 2009; Sisk, 2009). Kërcënimet dhe premtimet ose karrotat dhe shkopinjët, sipas disa studiuesve, kanë për qëllim të ndryshojnë llogaritjet e kostove dhe përfitimet e palëve dhe t’i nxisin ata të njohin alternativa të qëndrueshme dhe të pranueshme për konfliktin, duke krijuar mundësi, për zgjidhjet të cilat nuk do të ishin të mundshme në mungesë të ndërmjetësimit. Këto elemente i bëjnë format

aktive të ndërmjetësimit një mjet efikas për ndërprerjen e një konflikti të dhunshëm (Beardsley et al., 2006: 64; Bercovitch dhe Gartner, 2006). Mbi këtë pikëpamje sfiduese, Wilkenfeld et al., gjejnë se modeli i ndërmjetësimit manipulues, ka më shumë gjasa të rezultojë në zgjidhje të negociuara, kriza më të shkurtra dhe kënaqësi më të madhe me rezultatet mes palëve, në krahasim me stilet tradicionale dhe më kufizuese të ndërmjetësimit (Wilkenfeld et al., 2003: 279-301). Të dy strategjitë e para përdorin një sërë metodash, në mënyrë që palët të mund të identifikojnë një zgjidhje ekzistuese reciproke të pranueshme brenda mundësive të tyre në dispozicion. Megjithatë, strategjia manipuluese përdoret me qëllim të zgjerimit të spektrit të zgjidhjeve të mundshme ku të dyja palët e shohin si të preferuar për një konflikt të vazhdueshëm. Sidoqoftë, me gjithë dallimet e dukshme mes strategjive të analizuara, ato, reciprokisht, nuk e përjashtojnë njëra tjetren.

4.1.5. Marrëdhëniet mes palëve kundërshtare dhe palës së tretë

Kalkulimet fillestare të bëra nga palët në konflikt dhe ndërmjetësuesit nuk përfshijnë vetëm një zgjidhje të suksesshme të një mosmarrëveshjeje. Këto llogaritje përfshijnë edhe marrëdhëniet mes palëve kundërshtare dhe palës së tretë, si palë ndërmjetësuese, si dhe kostot dhe përfitimet për të gjithë ata së bashku në konflikt dhe në pajtim.

Touval dhe Zartman (2006: 442) theksojnë se edhe proceset e suksesshme të ndërmjetësimit “mund të shkurtojnë vetëm disa prej këtyre shtresave, duke siguruar mjete për palët që të jetojnë së bashku pavarësisht nga mosmarrëveshja e tyre, por kjo nuk ofron pajtim të thellë ose anulim të shkaqeve të konfliktit”. Prandaj, një ndërmjetësues jo vetëm që do të duhej të ndihmonte në arritjen e një marrëveshjeje mes palëve në konflikt, por për të arritur një zgjidhje sa më të suksesshme, do të duhej të mbetej i përfshirë edhe pas procesit të ndërmjetësimit, të mbetet i përfshirë edhe në situatën e paszgjidhjes së konfliktit dhe të shqyrtojë zbatimin e kushteve të marrëveshjes. Autorët arrijnë në konkludimin se “më shumë

interes dhe më pak leva janë të përfshira në ndërmjetësimin e palëve të treta sesa që supozohet zakonisht”.

Bercovitch dhe Gartner mbështeten në tre lloje kryesore të literaturës mbi menaxhimin e konfliktit, në atë normative, preskriptive dhe përshkruese, në mënyrë që të kërkojnë një pasqyrë mbi faktorët dhe variablat që ndikojnë në procesin e ndërmjetësimit. Ata në veçanti i theksojnë studimet empirike, të cilat “mund të ofrojnë informata shumë të dobishme mbi vendin, rolin, performancën dhe efektivitetin e ndërmjetësimit në marrëdhëniet ndërkombëtare”. Për më tepër, gjetjet e tyre dëshmojnë se,

“ndërmjetësuesit e fuqishëm ndërkombëtarë (shtetet e mëdha, OKB, BE), të cilët përdorin strategji aktive dhe ndërhyrëse të zgjidhjes dhe mund të angazhojnë resurse të rëndësishme dhe leva në mbështetje të përpjekjeve të tyre, janë më efektive në menaxhimin e konflikteve intensive. Derisa, ndërmjetësuesit e profilit më të ulët, të cilët përdorin strategji më pasive dhe shfrytëzojnë më pak resurse, e bëjnë më mirë menaxhimin e konflikteve, më pak sfidues dhe më pak të vështirë” (Bercovitch dhe Gartner, 2006: 320-323).

Bazuar në analizën e literaturës përkatëse akademike, bëhet e qartë se nuk ka formulë të përcaktuar mirë ose një grup rregullash, të cilat do të përcaktonin, nëse një proces ndërmjetësimi do të rezultonte të jetë i suksesshëm. Sidoqoftë, ekzistojnë disa karakteristika të cilat do të konsideroheshin si të nevojshme për ndërmjetësuesit që të kenë mundësi për një rezultat të suksesshëm në procesin ndërmjetësues. Një ndërmjetësues i suksesshëm do të duhej të kishte një levë të konsiderueshme mbi palët në konflikt, në mënyrë që ata të jenë të interesuar dhe të gatshëm të angazhohen në zgjidhjen e ofruar dhe në kompromis. Megjithatë, ndërmjetësuesi duhet të ketë kapacitetin për të zbatuar ofertën e tij pas arritjes së një zgjidhjeje në mënyrë që të mbajë të dyja palët të interesuara, ndërsa në të njëjtën kohë edhe të jetë në gjendje të monitorojë dhe kontrollojë zbatimin. Ndërmjetësuesi i suksesshëm, duhet të jetë në gjendje të punojë në mënyra të ndryshme, duke filluar nga komunikimi i thjeshtë dhe finalizimi i procesit të ndërmjetësimit me përfshirje substanciale dhe po ashtu të jetë në

gjendje të vendosë zgjidhjen në një perspektivë e cila është e favorshme edhe për vetë ndërmjetësuesin.

4.1.6. Konteksti kulturor dhe sukcesi i ndërmjetësimit

Çështja e ndikimit të kulturës, në suksesin apo dështimin e ndërmjetësimit ndërkombëtar, është një pyetje e hapur. Mbi ndikimin e kulturës, në ndërmjetësimin ndërkombëtar, në mesin e studiuesve, nuk ka ende një mendim unanim. Në hulumtimet e bëra mbi çështjen ka argumenta kundërtshëm se nëse një ndërmjetësues i njëanshëm është më shumë apo më pak i efektshëm në zgjidhjen e një mosmarrëveshje (Betts, 1994: 20-33), duke konsideruar se “palët e shqyrtojnë performancën një ndërmjetësuesi të njëanshëm para se të hyjnë në një ndërmjetësim”. Prandaj, “një ndërmjetësues i cili perceptohet si i njëanshëm do të jetë i papranueshëm në ndërmjetësim”. Disa të tjerë pretendojnë se, “kultura nuk ka fuqi shpjeguese, ose se ka fuqi të papërfillshme” dhe apriori cilësohet si faktor negativ, nga arsyeja se “ndryshimet kulturore e vështirësojnë komunikimin mes palëve kundërshtarë dhe palës së tretë, si palë ndërmjetësuese”:

“dallimet kulturore mund të përkeqësojnë procesin e ndërmjetësimit duke ndikuar në perceptimin dhe reagimet ndaj anshmërisë së ndërmjetësuesit. Që një ndërmjetësim të ndodhë, të dyja palët duhet të pranojnë ndërhyrjen e një pale të tretë. Nëse ndërmjetësuesi është më i afërt në aspektin kulturor me njerëz nga palët, në këtë rast, pala tjetër, mund ta perceptojë atë si të njëanshëm dhe do të ketë më pak të ngjarë të pranojë ndërmjetësimin” (Adam, Shirako dhe Maddux, 2010: 882–889).

Derisa, Carnevale dhe Choi argumentojnë se, “procesi i ndërmjetësimit dhe i rezultateve të tij, ndikohet nga konteksti kulturor, i cili mund të përshkruhet si pjesa njerëzore e mjedisit” dhe njëkohësisht, është i pozicionuar lartë në hulumtimin e tyre. Ata kondiderojnë se “palët me kultura të ndryshme ka më pak të ngjarë të vazhdojnë me ndërmjetësimin, sa më të ndryshëm të jenë, aq më pak ka të ngjarë të ketë ndërmjetësim”. Kjo, sipas tyre, ndodh për shkakun se “sa më larg të jenë palët, aq më i madh është ndryshimi potencial kulturor në mes të ndërmjetësuesve dhe palëve”, duke rritur kështu gjasat që të paktën njëri nga palët ta

perceptojë ndërmjetësimin si potencialisht të njëanshëm dhe do ta refuzojë atë (Carnevale dhe Choi, 2000: 105-110).

Zartman (1993: 17–21) minimizon ndikimin e dallimeve kulturore, si impakt në ndërveprimet ndërkombëtare, duke pretenduar se “ekziston një gamë normash diplomatike ndërkombëtare, të cilat i përcaktojnë negociatat, përfshirë edhe ndërmjetësimin mes palëve kundërshtare”.

Në analizën e faktorëve relevantë për formësimin e rezultateve të ndërmjetësimit, arritëm në konkluzionin se, kultura, është një element i pashmangshëm i çdo konflikti dhe rrezaton efektet e saj mbi procesin dhe rezultatet e ndërmjetësimit.

4.2. Faktorët kontekstualë

Për të vlerësuar aktivitetet e ndërmjetësimit, është e rëndësishme të merret parasysh konteksti i përgjithshëm dhe kushtet që mbarështrajnë konfliktin.

4.2.1. Kushtet gjeopolitike

Grupimi i parë i faktorëve relevantë kontekstualë ndërlidhet me kushtet gjeopolitike që qeverisin çështjet ndërkombëtare. Këto karakteristika janë më rezistente ndaj çdo forme ndryshimi dhe si të tilla krijojnë kornizën operacionale, brenda së cilës zhvillohen aktivitetet e menaxhimit të konfliktit. Shpërndarja dhe balancimi i pushtetit mes aktorëve ndërkombëtarë, së bashku me mënyrat e shtrirjes strategjike, kanë një ndikim të fuqishëm në efektivitetin e procesit të ndërmjetësimit. Studiuesi, Jacob Bercovitch (2005), në hulumtimet e tij mbi këtë çështje argumenton:

“Mbështetja e ofruar nga aleatët ose klientët e jashtëm mund të shtrembërojë perceptimin e një BDR-je, nga arsyeja se duke e bërë konfliktin më të tolerueshëm, kufizimet e jashtme mbështesin atraktivitetin e një zgjidhjeje të ndërmjetësuar, nxit palët të marrin pozita gjithnjë e më të palëkundura, duke kontribuar kështu në 'ngrirjen' e konfliktit”

Sipas autorit, konflikti në Qipro, është një shembull tipik i një situatë të tillë, në të cilën “mbështetja pa kompromis e palëve të jashtme, nxiti palët që të shohin bllokimin e tyre si të durueshëm” (Bercovitch 2005: 108).

4.2.2. Natyra e paqëndrueshme e konflikteve të ndërmjetësuara

Grupimi i dytë i faktorëve kontekstualë, ndërlidhet me natyrën e konfliktit në fjalë. Ndërmjetësimi kryhet në rastet më rezistuese, ku palët nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të arrijnë një zgjidhje. Këto mosmarrëveshje kanë tendencë të jenë të gjata, komplekse dhe intensive (Bercovitch dhe Jackson, 2001; Beardsley, 2010). Natyra e tyre e tejzgjatur dhe destruktive, e dëshmuar me akte të dhunshme dhe me përdorimin e mjeteve ushtarake, kontribuon në manifestimin e urrejtjes psikologjike, ndjenjave të thella të frikës dhe mosbesimit, stereotipeve të ekzagjeruara dhe dyshimeve mes palëve të përfshira. Identitetet e palëve bëhen të polarizuara, shpesh të ndërlidhura me një luftë ekzistenciale ku ekzistenca e “tjetrit”, është një kërcënim i drejtpërdrejtë për mbijetesën e ndokujt tjetër. Çështjet konfliktuale integrohen në identitetin e secilës palë. Ata krijojnë simbole dhe sisteme besimi, të cilat pasqyrojnë një perceptim të paqartë mbi konfliktin dhe ngjarjet e kaluara. Rrëfimet historike riafirmohen pasi “plagët e reja shndërrohen në plagë të vjetra” dhe në prova të armiqësive të mëhershme (Zartman, 2005: 49). Pozicionet dhe zgjidhjet e promovuara janë të kushtëzuara nga perceptimet zero-sum (fitorja e njëres palë baraspeshohet nga humbja e palës tjetër) të palëve dhe qëndrimet konkurruese. Edhe nëse në një moment ka pasur një zgjidhje unike, ajo e ka humbur rëndësinë për shkak të dështimit për ta zbatuar. Me kalimin e kohës, konflikti zhytet në rutinën e përditshmërisë njerëzore dhe një sjellje e tillë bëhet e institucionalizuar (Kriesberg, 2005). Në kushte të tilla të papërshtatshme, këmbëngulja në status quo, ofron një mundësi unike për disa palë, që të ruajnë fuqinë e tyre socio-politike dhe ekonomike. Rëndësia në rritje e çështjes, e shoqëruar me natyrën potencialisht fitimprurëse të

konfliktit, inkurajon liderët që të pranojnë kosto më të larta. Kostot e humbura bëhen burime të kapjes, të cilat nuk mund të injorohen lehtë (Meerts, 2004). Si pasojë e kësaj, palët në konflikt janë më të përgatitura të bëjnë kompromise, duke e bërë punën e ndërmjetësuesit edhe më sfiduese.

Me sa duket, arritja e pjekurisë së konfliktit nuk është një detyrë e lehtë. Siç vëren Bercovitch (2005: 109) se, “që të ketë çfarëdo mundësie për sukses dhe përpjekje për ndërmjetësim, kërkohen resurse, përvojë, mbështetje e fuqishme politike dhe një masë e fatit”. Derisa Greg (2005: 249) pretendon se, “në vend se të zgjidhen me rastësi rastet që do të ndërmjetësohen, palët në konflikt dhe aktorët e jashtëm, vendimin e vet mbi zbatimin e ndërmjetësimit, do të duhej ta ndërlidhnin me gjasat mbi suksesin”.

Përvoja e kaluar e ndërmjetësimit mund të përbëjë një sfidë serioze për përpjekjet e ardhshme të ndërmjetësimit. Nga njëra anë, sipas Kriesberg, me dështimin e procesit paqësor “negociatat e humbasin atraktivitetin e tyre si rrugëdalje, palët hyjnë në dinamikën e fajsisë ndaj njëri tjetrit për dështimin dhe në këtë mënyrë mosbesimi bëhet normë” (Kriesberg, 2005). Nga ana tjetër, Melin (2013: 78-90) pretendon se përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë ngjarje të izoluar “përvoja e mëparshme e ndërmjetësimit ose historia e ndërmjetësimit inkurajon përpjekjet e ardhshme”, dhe po ashtu se “palët kundërshtare krijojnë një raport me ndërmjetësuesin dhe zhvillojnë gatishmërinë për të punuar me një të huaj”. Me fjalë të tjera, sipas saj “përvoja e kaluar në ndërmjetësim në mosmarrëveshje të tjera ngre tundimin mbi ndërmjetësimin, si të një mjeti diplomatik mbi menaxhimin e konfliktit”.

Shanset e suksesit të ndërmjetësimit ngriten, nëse palët në konflikt janë demokraci të hapura. Brenda vendit, këta aktorë kanë përfshirjen e institucionalizuar të palëve të treta në menaxhimin e konfliktit dhe kanë më shumë përvojë për negociata dhe kompromise. Këta faktorë i bëjnë ata më të prirë të pranojnë kostot politike të ndërmjetësimit (Dixon, 1993).

Meqenëse normat dhe praktikat e përbashkëta demokratike mes palëve dhe ndërmjetësuesve ngrisin efektivitetin e ndërmjetësimit, niveli i ndërkombëtarizimit të konfliktit gjithashtu kushtëzon pranueshmërinë e përpjekjeve për ndërmjetësim.

Ndërmjetësimi ka më shumë gjasa në konflikte ndërshtetërore sesa në ato brendashtetërore, ngase qeveritë e përfshira në luftërat civile, mund t'i rezistojnë legjitimitetit të kauzës rebele, duke e pranuar ndërmjetësimin (Melin dhe Svensson, 2009). Rezistenca për të pranuar ndërmjetësimin, e bën një konflikt më afatgjatë dhe nxit kokëfortësinë dhe palëkundshmërinë ndaj tij. Megjithatë, edhe kur konfliktet bëhen shumë të dhunshme dhe kur ndërmjetësuesit e tregojnë gatishmërinë për të ndërmjetësuar, palët ende mund të refuzojnë ndërmjetësimin, “sepse kjo do të mund të sinjalizonte gatishmërinë e tyre për të përballuar kostot në rritje”, por po ashtu edhe “vendosmërinë për të qëndruar në arritjen e synimeve të tyre” (Melin et al., 2013).

Sipas Bercovitch et al., (1991: 13) “konfliktet e vështira menaxhohen më mirë në fazat e hershme të konfliktit, përpara se identitetet të polarizohen dhe të shfaqen ankesa të reja” me arsyetimin se “me kalimin e kohës, bëhen edhe më të vështira për t'u menaxhuar, duke u bërë gjithnjë e më pak të ndjeshme ndaj çdo përpjekjeje të mëvonshme të ndërmjetësimit”. Në situata të tilla, duket më e arsyeshme të synohet menaxhimi i konfliktit sesa zgjidhja. Pasi që kjo e fundit do të nënkuptonte jo vetëm eliminimin e sjelljeve konfrontuese, por në radhë të parë adresimin e shkaqeve themelore dhe mekanizmave nxitës që gjeneruan konfliktin. Për më tepër, pretendohet se “qëllimi kryesor në adresimin e një konflikti të tillë është menaxhimi i tij, duke kërkuar përmbajtje nga eskalimi i mëtejshëm” (Bercovitch, 2005: 104). Kjo nuk duhet kuptuar si një qasje gjysmë e pjekur. Siç vëren Kriesberg (2005: 75) “një konflikt i menaxhuar mirë mund të jetë një hyrje mbi një transformim fundamental të konfliktit”.

Me kalimin e kohës, shumë konflikte tentojnë të ulin intensitetin për një varg arsyesh. Palët mund të kuptojnë se qëllimet e tyre të dëshiruara janë bërë të paarritshme ose se metodat për arritjen e tyre kanë provuar të jenë të mbingarkuara dhe të kushtueshme. Prandaj, duke ndjekur logjikën e teorisë së pjekurisë, derisa palët fillojnë të perceptojnë një bllokim të dhimbshëm, në të cilën veprimet unilaterale nuk japin përfitimet e pritura, ato mund t'i ripërcaktojnë pritjet e tyre dhe të pranojnë alternativa për të luftuar. Gjatë gjithë këtij procesi transformues, ndërmjetësimi mund të jetë i një rëndësie vendimtare dhe të kontribuojë në arritjen e niveleve të ndryshme të suksesit.

4.3. Përfundime

Në pyetjen e shtruar se, kur ka më shumë gjasa që ndërmjetësimi ndërkombëtar të jetë i suksesshëm, që praktikuesit dhe studiuesit e kanë hulumtuar për shumë vite, gjatë shtjellimit dhe analizës së temave në kapitull, arritëm në përfundimin se, për të qenë i suksesshëm një ndërmjetësimi ndërkombëtar, ai duhet të ndodhë në kohën apo në momentin e duhur. Me këtë nënkuptojmë se, një ndërmjetësues duhet të sigurojë, që palët janë vërtet të gatshme të zgjidhin konfliktin mes tyre. Kjo zakonisht ndodh kur palët e gjejnë veten në një situatë të papëlqyer dhe kur njihen me mundësitë për një zgjidhje të ndërsjellë. Po ashtu, arritëm në përfundimin se, koha e ndërmjetësimit dhe perceptimi mes palëve, që mundësitë mund të humbasin nëse ata nuk arrijnë të njohin sjelljen e tyre reciprokisht të dëmtuar, është një faktor tjetër kyç që ndikon në suksesin e ndërmjetësimit. Lidhur ngushtë me këtë është edhe motivimi i fuqishëm dhe i vërtetë nga palët për t'u angazhuar në një ndërmjetësim serioz. Në ndërkohë, nëse palët në konflikt i drejtohen ndërmjetësimit thjesht në përpjekje për të blerë kohë ose për të parandaluar një humbje të mundshme, atëherë çdo përpjekje e ndërmjetësimit do të përfundojë me dështim. Në të njëjtën kohë, arrijmë të përfundojmë se ndërmjetësimi funksionon më mirë, kur të dyja palët janë të gatshme, të interesuara dhe sinqerisht të

angazhuara në një proces ndërmjetësimi. Këtu përsëri, një ndërmjetësues mund të krijojë kushtet, në fazat e hershme të një ndërmjetësimi, ku të dyja palët janë optimiste për procesin dhe janë vërtetë të përkushtuara ndaj saj. Po ashtu, edhe se ndërmjetësimi në marrëdhëniet ndërkombëtare duket se funksionon më së miri, kur nuk ka pabarazi të mëdha të fuqisë mes palëve, kur të dyja palët janë fuqi të vogla ose të mesme dhe kur të dyja kanë vlera të ngjashme politike. Normat e përbashkëta, ngjashmëria politike dhe barazia relative, në fuqinë ushtarake dhe ekonomike, rrisin gjasat për një ndërmjetësim të suksesshëm.

Pasi është theksuar se ndërmjetësimi është një përpjekje për të ndryshuar perceptimin dhe sjelljen e palëve, ne në këtë analizë kemi konkluduar se ndërmjetësuesit mund të ndikojnë tek palët përmes një game të gjerë ndërhyrjesh, përmes të cilave kanë më shumë gjasa të kenë sukses në një proces ndërmjetësimi, si dhe faktorë të tjerë të cilët mund të kenë ndikim në suksesin ose dështimin e ndërmjetësimit ndërkombëtar. Në mesin e tyre janë edhe marrëdhëniet mes palëve dhe natyra e konfliktit mes tyre. Cilido qoftë motivi i tyre, arrihet në përfundimin se ndërmjetësimi mbetet një mjet i fuqishëm, i rëndësishëm dhe shpesh i suksesshëm në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Kapitulli IV: Bashkimi Evropian si ndërmjetësues i paqes

Përpjekje dhe burime domethënëse shpenzohen nga organizatat ndërkombëtare dhe regjionale, përfshirë edhe BE-në, që konfliktet e dhunshme t'i transformojnë në paqe të qëndrueshme. Derisa politikat e shekullit XXI janë globalizuar, vlerat dhe interesat e të ashtuquajturës bashkësi ndërkombëtare janë të sfiduara brenda shteteve, të bazuara në resurse apo konflikte etnike, kryesisht të drejtuara kundër civilëve (Kaldor, 2006). Në ditët e sotme, përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhjen e konfliktit kanë objektiva afatgjatë dhe afatshkurtër: ndërprerjen

e menjëhershme të armiqësive dhe ndihmë afatgjate për shoqëritë e shkatërruara nga lufta, për të krijuar paqe të qëndrueshme dhe për të siguruar që dhuna nuk do të përsëritet.

Ndërmjetësimi ndërkombëtar i paqes, si një instrument për menaxhimin ndërkombëtar të konflikteve, përmes të cilit palët e treta përpiqen të kontribuojnë në zgjidhjen paqësore të konflikteve, në dekadat e fundit po merr gjithnjë e më shumë vëmendje politike globale. Konsiderohet si një mjet kosto-efektiv dhe i dobishëm për zgjidhjen e konflikteve. Edhe pse shtetet janë ofruesit kryesorë dhe më të shpeshtë të ndërmjetësimit, edhe organizatat ndërkombëtare nuk janë shumë prapa. BE-ja, si një lojtar relativisht i ri në këtë fushë përmes “fuqinë së butë”, vepron po ashtu si ndërmjetësues, por edhe si anëtar i mekanizmave kolektiv të koordinimit për të mbështetur proceset e paqes. Si një ndërtues paqeje në vetvete, BE-ja është me të vërtetë një aktor i përshtatshëm në promovimin e praktikës së ndërmjetësimit në tërë botën. Megjithatë, në shumë mënyra, edhe pse me një “prani” të pamohueshme, ajo nuk i ka shfrytëzuar plotësisht atributet natyrore të fuqisë së saj të butë përmes ndërmjetësimit. Në masë të madhe ajo ka qenë e shtyrë nga mendimi tradicional diplomatik, që të pozicionojë veten si një aktor për të projektuar fuqi, në mënyrë që të ruajë peshën e saj në bashkësinë ndërkombëtare. Më shumë ka preferuar të përdorë instrumentat tradicionalë të sanksioneve dhe lëshimit të listave të zeza, dhe të ofrojë ndihmë të konsiderueshme financiare për skenarët e pas konfliktit. Përgjigja, për krizën përmes ndërmjetësimit, nuk ishte funksion i shfaqur nga BE-ja: në tërësi ishte lënë për Shtetet Anëtare.

4.1. Koncepti i fuqisë dhe Bashkimi Evropian

Neorealizmi në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare mbështetet kryesisht në të kuptuarit e fuqisë nga aspekti i aftësive me të cilat disponon një aktor. Fuqia e kuptuar nga aspekti i aftësisë flet për fuqinë e një aktori, dhe mundësinë së tij për të ndikuar ose për të kontrolluar

rezultatet e politikës ndërkombëtare. Fuqia mund të kuptohet edhe si një lloj marrëdhënie, në ç'rast kapacitetet janë vetëm parakusht për "aktualizimin" e ndonjë marrëdhënie. John Mearsheimer (2012) thekson se, "fuqia është valutë politike e fuqive të mëdha, dhe shtetet konkurrojnë për të. Ajo çfarë është paraja në ekonomi, në marrëdhëniet ndërkombëtare është fuqia".

Si çështje problematike në kuptimin e tillë të fuqisë është fakti se ajo nuk mund të matet me saktësi, por vetëm paraqitet si një vlerësim se me çfarë aftësish disponon një aktor. Problem shtesë paraqet shkalla e "konvertimit të fuqisë", me të cilën disponon një aktor. Fuqia e fortë i referohet përdorimit të mjeteve (ushtarake dhe ekonomike), me qëllim të detyrimit me të cilin sigurohet sjellja e dëshiruar e aktorit tjerër. Për dallim nga fuqia e fortë, fuqia e butë i referohet ushtrimit të ndikimit me ndihmën e mjeteve të cilat nuk nënkuptojnë ushtrimin e detyrimit.

4.1.1. Bashkimi Evropian dhe "fuqia e fortë"

Nëse do të përdornim kuptimin realist të fuqisë në shembullin e BE-së dhe në kapacitetet e saja prej aktori - është e qartë se një entitet i kuptuar në këtë mënyrë nuk posedon me mjetet e saja të cilat do të mund t'i projektonte në nivelin global dhe të zbatonte detyrimin ndaj aktorëve të tjerë, ashtu siç veprojnë fuqitë e mëdha.

CFSP dhe shfrytëzimi i kapaciteteve të parapara në qëllimet parësore të Helsinkut nuk argumentojnë se BE-ja është e gatshme që në nivelin global në mënyrë kredibile do të veprojë me "fuqinë e saj të fortë" autonome. Një progres është arritur në dekadën e fundit përmes zhvillimit të politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë, të identitetit evropian të sigurisë dhe të pjesëmarrjes së forcave të BE-së në operacione civile dhe të kufizuara ushtarake në mbarë botën.

Por, privilegjet e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes ende mbeten në duart e shteteve anëtare, me ç`rast BE-ja në aspektin e fuqisë së fortë nuk mund të kualifikohet si një aktor i barabartë global as edhe me vendet e saja anëtare që janë ushtarakisht të afta, siç është Franca apo Britania e Madhe (derisa ishte Shtet Anëtarë i BE-së) - të cilat janë të afta për projektimin e pavarur të fuqisë së fortë në kontekstin rajonal dhe pjesërisht edhe në atë global.

4.1.2. Bashkimi Evropian dhe “fuqia e butë”

E ashtuquajtura “fuqia e butë”, i referohet ushtrimit të ndikimit me ndihmën e mjeteve të cilat nuk nënkuptojnë ushtrimin e detyrimit. “Fuqia e butë” është e karakterit të tërthortë, ajo bazohet në aftësinë e përcaktimit të agjendës politike në mënyrën e cila i formëson preferencat e të tjerëve. BE-ja posedon me potencialin tërheqës dhe kontribuon në përcaktimin e kushteve sistemore të cilat mundësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara - ku shtete të tjera bien dakord të bëjnë atë që është në interesin e poseduesit të fuqisë së butë.

BE-ja ka ushtruar ndikimin e vet përmes “fuqisë së butë” në ruajtjen e paqes në Evropë, në ndërtimin e begatisë dhe në nxitjen e dëshirës së vendeve e të rajoneve të tjera të Europës që t’i bashkohen asaj si anëtare me të drejta të plota. Nga pikëpamja historike, roli i BE si një “fuqi e butë” ka qenë një element i veçantë i marrëdhënieve të BE-së me pjesën tjetër të botës dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e reputacionit të saj në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Përmes librit të tij, tashmë të njohur “*Soft Power: The Means to Success in World Politics*” (Fuqia e butë: Mjetet për sukses në politikën botërore, 2004) profesori i Universitetit të Harvardit, Joseph Nye, e përcaktoi konceptin e “fuqisë së butë” si një mjet për të tërhequr dhe për të ndryshuar politikën e vendeve të tjera jo nëpërmjet forcës, por përmes aftësisë së modelit:

“universaliteti i kulturës së një shteti dhe aftësia e tij për të krijuar një sërë rregullash dhe institucionesh të favorshme të cilat i rregullojnë fushat e aktiviteteve ndërkombëtare përfaqësojnë burimet kyçe të fuqisë” (Nye, 2004:78-90)

Kommentar [EA1]:

Në literaturë mund të gjenden studime që flasin për BE-në si për një posedues të fuqisë së butë apo të “fuqisë civile”. Mungesa e përdorimit të fuqisë ushtarake nuk do të thotë se fuqia e butë dhe fuqia civile janë terma identik. Fuqia ekonomike dhe burimet e fituara në këtë mënyrë nuk i përkasin pushtetit të butë, në mënyrën siç e përcakton Nay. Prandaj, për BE-në si për një fuqi të butë mund të flitet vetëm nëse e kemi parasysh potencialin tërheqës të politikës së saj të zgjerimit dhe arritjet të deritashme në projektin e integritimit. Ideja tërheqëse e BE-së është në vlerat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe të liberalizmit ekonomik.

Ndonëse BE vazhdon ende të vuajë dy elementët bazë të ushtrimit të një pushteti të fortë siç është mungesa e një ushtrie unike të fuqishme apo e një ministrie të jashtme të fuqishme, kjo nuk e ka penguar atë të ushtrojë ndikimin e saj në vendet e tjera. Gjithnjë e më shumë mund të dëgjohet se mungesa e kapaciteteve ushtarake dhe mungesa e perceptimit të BE-së, si të një aktori të pavarur dhe të fuqishëm, i dobëson mundësitë e afirmimit të plotë të fuqisë së butë në arritjen e objektivave të politikave të jashtme të BE-së. Instrumentat e ushtrimit të politikës së jashtme të BE-së gjithnjë janë endur mes konceptit të “fuqisë së butë”. Një nga instrumentat kryesore përmes të cilave BE-ja ushtron “fuqinë e butë” është politika e saj e zgjerimit.

Megjithatë një nga sfidat kryesore të BE-së vazhdon të mbetet testimi i suksesit të pushtetit të “fuqisë së butë” me vendet e Ballkanit Perëndimor. Përballë një rajoni që trashëgon gjurmë të gjenocidit etnik të fundshekullit të XX-të, “fuqia e butë” e BE-së ka filluar të provohet sërish përmes rolit ndërmjetësues në rajon dhe në vecanti, në dialogun Kosovë-Serbi. Mentaliteti ballkanik, ashpërsia dhe problematika e rajonit nuk e kanë bërë BE të ndryshojë qasjen përkundrejt kësaj politike, me gjithë vërejtjet e pafundme karshi saj. Në të vërtetë raporti i politikës së fuqisë së butë të BE-së karshi vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk është një keqkuptim kulturor për disa që kërkojnë një politikë më të vrazhdë kushtëzuese ndaj tyre. Në këtë rast, alegoria e shkopit dhe karotës për BE-në përmbliidhen vetëm në një. Karota vepron

si shkop kur ajo nuk u ofrohet këtyre vendeve përmes bllokimit apo mosavancimit të statusit të tyre. Me vendet e Ballkanit Perëndimor, BE-ja ka rastin të krijojë një histori suksesi, duke përdorur elementët më të qenësishëm të fuqisë së butë. Ajo po përpiqet ta bëjë këtë në mënyrën e saj, e cila mund të ngjallë padurim për shumëkënd në rajon.

Nga ana tjetër, koncepti i fuqisë së butë tërhoqi në mënyrë të dukshme studiuesit e BE-së të tillë si Manners dhe Diez, që po përpiqeshin të studionin rolin e BE-së si fuqi normative) në mënyrë të veçantë pas viteve '90 kur procesi i zgjerimit të BE filloi të shtrihet drejt vendeve të Europës Qendrore e Lindore si një përpjekje për të provuar "pushtetin" që ajo ushtronte nëpërmjet instrumenteve të fuqisë së butë (Manners, 2002; Diez, 2005).

Koncepti i fuqisë së butë është i lidhur ngushtë me konceptin e "fuqisë normative", e cila nga perspektiva konstruktiviste shpjegon se si BE-ja me ndihmën e faktorëve jomaterialë paraqet aktorin global në politikën botërore.

4.1.3. Bashkimi Evropian dhe "fuqia normative"

Politikologu britanik Ian Manners konsideron se BE-ja "e ndryshon normalitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare", për këtë arsye ajo paraqet "fuqinë normative". Me fjalorin e teorisë së politikës ndërkombëtare, BE-ja ndikon në sistemin ndërkombëtar përmes promovimit të asaj që ajo vetë e prodhon, dhe ato janë normat dhe standardet me ndikim global. Ajo ndikon në ndryshimin e normave, standardeve dhe në përgjigjet e zakonshme në pyetjen se si funksionon politika botërore, e pakufizuar në premisat shtetocentrike.

Për dallim nga perceptimi i "fuqisë së fortë", "fuqisë së butë" apo "fuqisë civile" - për të cilat është e rëndësishme të përcaktohet se deri në çfarë mase BE-ja është formë shtetërore, sipas

Manners në 'Normative Power Europe':

"fuqia normative ka tendencë të lëvizë vëmendjen e analizës nga hulumtimi empirik i institucioneve apo i politikave të BE-së në drejtim të proceseve konjitive, së bashku me komponentat e tyre substanciale dhe simbolike"
(Manners, 2002: 236-7).

Edhe pse ideja mbi fuqinë normative nuk është e re dhe shembuj të ngjashëm mund të gjenden në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, Manners thekson se, “konteksti i veçantë historik, forma e përzier e komunitetit politik dhe rregullimi politiko-juridik është ajo çfarë e bën "dallimin normativ". Sipas tij,

“Bashkimi Evropian përfshin vlerat post-Vestfaliane të cilat të tjerët duan t’i imitojnë, duke përfshirë kështu parimin suprem të paqes së qëndrueshme, parimet kyçe të lirisë, të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit si dhe vlerat e barazisë, të solidaritetit social, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të qeverisjes së mirë” (Manners, 2002: 240)

Si pasojë e kontekstit të veçantë në të cilin zhvillohet, BE-ja në marrëdhëniet me Shtetet e saja Anëtare dhe me vende të tjera aplikon normat dhe parimet universale dhe vepron në “mënyrë normative” pa mbështetje në fuqi dhe në resurset e përgjithshme me të cilat disponon, me ç`rast arrihet “dallimi normativ”. Ndikimi i BE-së në organizata rajonale apo në shtete të tjera arrihet përmes fuqisë normative, ato kulturën organizative dhe normat i miratojnë me vetëdëshirë. BE-ja kapacitetin e saj prej aktori e konfirmon përmes fuqisë normative duke bërë përpjekje të ndryshojë normat në sistemin ndërkombëtar, që është “kuantitet pozitivist”, derisa “kualiteti normativ” përcakton vetëdijen për nevojën e veprimit e cila do të promovojë norma të caktuara brenda sistemit ndërkombëtar – me të cilat ndryshon kuptimi i "normales" në politikën ndërkombëtare. Ndikimi i fuqisë normative (Manners, 2002: 241-252) arrihet në bashkëveprim me instrumentet ‘civile’, me ç`rast evidentohen efektet në planin e politikës së jashtme, dhe konfirmohet kompatibiliteti i fuqisë civile dhe asaj normative të BE-së.

4.2. Qasjet e Bashkimit Evropian mbi ndërmjetësimin

Në kuptimin tonë të ndërmjetësimit, i referohemi ndërmjetësimit të BE-së, si përpjekje e aktorëve të vetëm ose kolektiv, që përfaqësojnë BE-në për të ndihmuar negociatat mes palëve në konflikt dhe për t’i ndihmuar ata të sjellin një zgjidhje për konfliktin e tyre. Ky përkufizim nënkupton që, përpjekjet e ndërmjetësimit të BE-së, mund të jenë dhe janë de facto

të kryera nga aktorë të ndryshëm, në nivele të ndryshme të politikës së jashtme të BE-së.

Rrjedhimisht, ndjekim përkufizimin e Bercovitch dhe Hjuston:

“një proces reaktiv të menaxhimit të konflikteve, të lidhur, por të ndryshëm nga përpjekjet e palëve, me ç'rast palët kundërshtarë ose përfaqësuesit e tyre kërkojnë ndihmë ose pranojnë ofertë ndihme nga një grup individual, shtet apo organizatë për të ndryshuar, ndikuar ose influencuar në perceptimet ose sjelljet e tyre, pa përdorur forcën fizike ose duke u thirrur në autoritetin e ligjit” (Bercovitch dhe Hjuston, 2000: 171).

Disa shembuj të tjerë veprave që përqendrohen në mënyrë eksplicite në ndërmjetësimin e BE-së në negociatat e paqes (Grono, 2010; Forsberg dhe Seppo, 2010), sigurojnë përshkrimet specifike të rasteve të sjelljes së ndërmjetësimit të BE-së, por nuk kontribuojnë në ndërtimin e teorisë. Megjithë këtë fakt, si literatura e Politikës së Jashtme ashtu edhe hulumtimi ndërkombëtar i ndërmjetësimit, ofrojnë njohuri të frytshme, që mund të shfrytëzohen për të hulumtuar efektivitetin e BE-së, si ndërmjetësues në negociatat e paqes dhe që kontribuojnë në ndërtimin e teorisë.

Në fushën e Studimeve të Politikës së Jashtme Evropiane, gjenden së paku tri pjesë të literaturës, të cilat janë relevante për studimin e efektivitetit të BE-së, si ndërmjetësues në negociatat e paqes. Së pari, ekziston një literaturë e gjerë që fokusohet në rolin e BE-së, si një menaxher global i konfliktit, me një fokus të veçantë në operacionet ushtarake dhe misionet e menaxhimit të krizave civile në kontekstin e ESDP/CSDP (Ginsberg, 2001; Howorth, 2011; Ginsberg dhe Penksa, 2012; Whitman dhe Wolff, 2012). Një pjesë e konsiderueshme e këtyre studimeve, fokusohet në atë se si vendimmarrja e brendshme e BE-së, ndikon në sjelljen e saj si një aktor i politikës së jashtme (Ginsberg, 2001; Klein, 2010; Gross dhe Juncos, 2011). Studiuesit Whitman dhe Wolff (2012b: 9) në shkrimet e tyre, theksojnë se shqyrtimi i ngushtë i zhvillimit të institucioneve dhe i politikave, ndërlidhet e tyre, divergjenca dhe konvergjenca e preferencave të Shteteve Anëtare, ishin prej kohësh fokus kryesor i studimeve në këtë fushë. Kjo për faktin se, zona më thelbësore e politikave të jashtme të BE-së, Politika e CSDP-së, nuk ka qenë plotësisht operationale para vitit 2002. Whitman dhe Wolff kanë botuar edhe një

vëllim të titulluar “BE-ja si një Menaxher Global i Konflikteve”, i cili përbëhet nga disa studime të rastit të përfshirjes së BE-së në aktivitetet e menaxhimit të konflikteve, duke analizuar një gamë të gjerë instrumentash, përfshirë edhe ndërmjetësimin, që BE-ja i ka aplikuar në konflikte të ndryshme për t’i kontribuar marrëveshjeve apo për t’i zgjidhur ato.

Në krahasim me shumicën e studimeve të përmendura që fokusohen kryesisht në dinamikën e brendshme dhe në motivimin e BE-së, që të angazhohet në zgjidhjen e konflikteve, studiuesit e cituar janë veçanërisht të interesuar edhe për shkaqet e suksesit apo të dështimit të ndërhyrjeve të tilla të BE-së. Përderisa studimi i tyre nuk përqëndrohet veçanërisht në përpjekjet e ndërmjetësimit të BE-së, studiuesi Peen Rodt (2012) ofron një kornizë të dobishme mbi vlerësimin e performancës së BE-së, në menaxhimin e konflikteve ushtarake, që në pikëpamjen tonë, mund të jetë e dobishme për shpjegimet mbi konceptualizimin e efektivitetit të BE-së në ndërmjetësimin ndërkombëtar dhe ofron terren të frytshëm, si për konceptimin e efektivitetit të ndërmjetësuesit të BE-së, ashtu edhe për definimin dhe operacionalizimin e kushteve të brendshme të efektivitetit të ndërmjetësuesit si levave/aftësive dhe koherencës. Së dyti, ka një numër të konsiderueshëm studimesh, që analizojnë se si BE-ja kontribuon në zgjidhjen e konflikteve, përmes mjeteve të marrëdhënieve kontraktuale me palët në konflikt, veçanërisht në aspektin e zgjerimit të BE-së dhe të ENP-së (Coppeters et al., Diez et al., 2008; Tocci, 2008, 2010). Kjo literaturë ofron njohuri mbi atë se si “dhënia ose tërheqja e një dobie nga BE-ja ose shkaktimi i saj ose përndryshe ndëshkimi, ndryshon kalkulimin e kostos dhe përfitimeve me të cilat ballafaqohen politikëbërësit në kontekstin e konfliktit” (Tocci, 2010: 66). Kushtëzimi dhe efektet e tij, janë gjithashtu shumë të rëndësishme në kontekstin e ndërmjetësimit, pasi ndërmjetësuesit shpesh përdorin stimuj pozitivë dhe sanksione negative, për të lëvizur palët drejt një marrëveshjeje (Touval dhe Zartman, 1985: 11).

Përfundimisht, hulumtuesit e politikës së jashtme të BE-së, kanë analizuar aktivitetin dhe efektivitetin e BE-së në institucione ndërkombëtare dhe në negociata shumëpalëshe (Laatikainen dhe Smith, 2006; Groenleer dhe van Schaik, 2007; Jorgensen et al., 2011; Thomas, 2012; Niemann dhe Bretherton, 2013). Megjithëse, studimet në këtë fushë, nuk e adresojnë aktivitetin e BE-së në negociata të paqes, supozohet se ekzistojnë kushte dhe modele të sjelljes së BE-së, që zbatohen në të gjitha format e negociatave shumëpalëshe, pavarësisht nga çështja në fjalë. Rrjedhimisht, sugjerohet se disa njohuri të kësaj literature, siç është konceptualizimi i efektivitetit si arritje e qëllimit, janë gjithashtu të dobishme për të formuluar sjelljen e BE-së në negociata të paqes.

Interesi i studiuesve të ndërmjetësimit, në përfshirjen edhe të përpjekjeve ndërmjetësuese të BE-së, ka qenë i kufizuar. Studimet e rasteve të lartpërmendura nga Grono (2010) dhe Forsberg dhe Seppo (2010) mbështesin disa koncepte të hulumtimit të ndërmjetësimit, të tilla si levat e ndërmjetësuesit dhe strategjitë e ndërmjetësimit. Në përgjithësi, një pjesë e konsiderueshme e hulumtimit aktual të ndërmjetësimit merret me çështjen e suksesit të ndërmjetësimit dhe kushteve të saja themelore. Studimet empirike kanë gjeneruar një varg gjetjesh në lidhje me kushtet e veçanta, nën të cilat ndërmjetësimi është i suksesshëm. Përveç tjerash, është diskutuar mbi faktorët në vijim: intensitetin e konfliktit, llojin e çështjes së konfliktit, karakteristikat e brendshme të palëve në konflikt, gradën dhe statusin e ndërmjetësuesit, paanshmërinë dhe kredibilitetin e ndërmjetësuesit, inicimin dhe kohën e një përpjekjeje ndërmjetësimi dhe strategjitë e ndërmjetësimit (Kleiboer, 1998: 18-23; Hellman, 2012; Wallensteen dhe Svensson, 2014). Me më pak fjalë, ky rishikim i literaturës sugjeron se ekzistojnë koncepte dhe qasje analitike në të dyja fushat (Studimet e Politikës së Jashtme Evropiane dhe Hulumtimet e Ndërmjetësimit Ndërkombëtar) për ndërtimin e një kornize të plotë teorike të studimit të efektivitetit ndërmjetësues të BE-së.

Për të përmirësuar kuptimin mbi ndërmjetësimin e BE-së, si në mënyrë empirike ashtu edhe në atë konceptuale, është i nevojshëm hartimi i fushës së praktikës së ndërmjetëimit të BE-së, dhe sigurimi i njohurive të nuancuara empirike dhe të pasura në lidhje me ndërmjetësimin e saj dhe mbështetjen e ndërmjetëimit në rajone të ndryshme konfliktit. Në terma konceptuale, të identifikohen dhe diskutohen qasjet e përshtatshme teorike dhe mjetet konceptuale për të analizuar praktikën e ndërmjetëimit të BE-së dhe në këtë mënyrë të tejkalohet ndarja mes konfliktit dhe Studimeve të Politikës së Jashtme. Në këtë mënyrë, do të adresohet një hendek i rëndësishëm kërkimor në literaturën akademike mbi ndërmjetësimin dhe do t'i kontribuonte një hulumtimi më sistematik të kësaj fushe specifike të politikës së jashtme të BE-së.

Në arritjen e synimeve të përmendura dalin në ndihmë kontributet mbi këtë fushë specifike, si motivet dhe nxitësit institucionalë të angazhimit të BE-së në ndërmjetësimin ndërkombëtar, rolet dhe strategjitë e ndryshme të BE-së në formën e praktikës së saj të ndërmjetëimit, efektiviteti i BE-ja në ndërmjetësimin dhe aktivitetet mbështetëse të ndërmjetëimit.

Kontributet mbi këtë fushë specifike reflektojnë qasjen gjithëpërfshirëse mbi çështjen për të vënë një fokus të barabartë në dimensionin e inputit, procesit dhe outputit të ndërmjetëimit të BE-së. Ato pasqyrojnë tri temat kryesore në ndërmjetësimin ndërkombëtar: (1) *fillimin e ndërmjetëimit*, (2) *procesin e ndërmjetëimit* dhe (3) *rezultatet e ndërmjetëimit* (Hellman, 2012, Wallensteen dhe Svensson, 2014). Fokusimi në të tre dimensionet e ndërmjetëimit, reflekton ambicjen për të dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të angazhimit të BE-së, si ndërmjetësues ndërkombëtar. Përmes tyre, në mënyrë implicite, ngrihet çështja e kapaciteteve institucionale të BE-së dhe synohet elaborimi mbi të dyja implikimet, si në ato teorike ashtu edhe në ato empirike për ndërmjetësimin e BE-së. Edhe pse kontributet mbi këtë fushë nuk i shterojnë aspektet e mundshme të aktiviteteve të ndërmjetëimit të BE-së me vlerë studimi,

megjithatë vëjnë në dukje rrugët dhe temat e rëndësishme, që na lejojnë “të gërmojmë më thellë”, në fushën e praktikës së ndërmjetësimit të BE-së.

4.3. Praktika e ndërmjetësimit të BE-së - temat dhe konceptet

Disa nga mënyrat potenciale për adresimin e çështjes së angazhimit të BE-së, si ndërmjetësues, përfundimisht mund të shpiejnë në ndërtimin e një kornize konceptuale për studimin e praktikës së ndërmjetësimit të BE-së në një fazë të mëvonshme.

4.3.1. Inicuesit e ndërmjetësimit

Sikurse studimet mbi ndërmjetësimin, ashtu edhe studimet e BE-së mbi politikën e jashtme, ofrojnë disa pika të dobishme për të adresuar çështjen e motivimit të BE-së, për t’u angazhuar në aktivitete ndërmjetësimi. Në literaturën mbi ndërmjetësimin, çështja e motivimit të ndërmjetësuesve në përgjithësi është pak e hulumtuar, por ekzistojnë disa hulumtime të cilat pjesërisht janë të ndërlidhura me çështjen (Touval dhe Zartman, 1985: 8-10; Touval, 2003; Bercovitch, 2009: 345-346; Beardsley, 2011: 22-25; Greig dhe Diehl, 2012: 78-90).

Sipas Greig dhe Diehl (2012: 79-90) motiv i mundshëm për ndërmjetësuesit mund të jetë “dëshira për të dhënë një kontribut pozitiv në ruajtjen ose restaurimin e paqes, por që mund të ndërlidhet edhe me shqetësimet specifike humanitare”. Studiuesit, si inicues të mundshëm të ndërmjetësimit, përmendin edhe organizatat: “organizatat ndërkombëtare dhe rajonale mund të jenë të motivuara për të ndërmjetësuar për shkak të mandatit të tyre organizativ, për ruajtjen e paqes mes shteteve të tyre anëtare”.

Përsa i përket motivimit esencial të BE-së, për angazhimin në ndërmjetësim, kjo mund të ndërlidhet me literaturën mbi “Fuqinë Normative të Evropës” (Manners, 2002; Whitman, 2011) ose Fuqinë Civile të Evropës (Bull, 1982; Smith, 2004), si dhe me hulumtimin mbi qëndrimin e BE-së ndaj Përgjegjësisë për të Mbrojtur (Franco et al., 2015). Përsa i përket avancimit të interesit vetjak, ka motive të ndryshme që janë të mundura, duke filluar nga interesat e sigurisë, në interesa ekonomike dhe tregtarë apo edhe në kërkimin e reputacionit

ndërkombëtar. Sipas Touval dhe Zartman, ndërmjetësuesit nxiten nga dëshira për të kontribuar në zgjidhjen paqësore të konfliktit në nivelin abstrakt dhe për të ndikuar në substancën specifike të marrëveshjes në mënyrën që t'iu shërbejë interesave të tyre. Përveç kësaj, ndërmjetësuesit janë gjithashtu shumë rrallë indiferentë në aspektin e kushteve konkrete të marrëveshjes:

“Ndërmjetësuesit, ka të ngjarë të kërkojnë kushte që do të rrisin perspektivat e stabilitetit dhe do të mohojnë mundësitë e rivalëve për ndërhyrje. Ata gjithashtu mund të dëshirojnë të sigurohen që kushtet e një zgjidhjeje, do t'u mundësojnë të vazhdojnë 'të kenë fjalën' në marrëdhëniet mes palëve kundërshtarë” (Touval dhe Zartman, 1985: 9).

Në varësi të konstelacionit të aktorëve të përfshirë, mund të ketë edhe kombinime të motiveve, në mënyrë që BE-ja të kyqet në praktikën e ndërmjetësimit. Hulumtimi i motiveve, konsiderohet të jetë një ushtrim i rëndësishëm, për sa kohë lejon të kuptojmë më në thellësi rolet dhe strategjitë që BE-ja i përdor.

4.3.2. Rolet dhe strategjitë e ndërmjetësimit

Në literaturën mbi ndërmjetësimin, koncepti i rolit ndërmjetësues i referohet të paktën dy aspekteve të ndryshme të ndërmjetësimit. Në kuptimin më të ngushtë, roli ndërmjetësues i BE-së, mund të kuptohet duke iu referuar llojit të varieteteve ndërmjetësuese, në të cilat BE-ja është e përfshirë në një aktivitet ndërmjetësimi:

- BE-ja si ndërmjetësuese e vetme,
- BE-ja si pjesëmarrëse në ndërmjetësim multilateral dhe
- BE-ja si mbështetëse financiare ose politike e aktiviteteve të palëve të treta.

Hulumtimi i mëtejshëm i varieteteve të ndërmjetësimit të BE-së, në të gjitha rastet, na lejon të kuptojmë më mirë shumëllojshmërinë dhe fushëveprimin e praktikës së saj ndërmjetësuese. Në kuptimin më të gjerë, roli i ndërmjetësimit i referohet strategjisë dhe taktikave, që një ndërmjetësues përdor në përpjekjet e tij, për të ndërmjetësuar një marrëveshje mes palëve në një konflikt. Përderisa vargu i veprimeve të mundshme taktike nga ndërmjetësuesi mund të

jetë enorm. Capelos dhe Smilovitz (2008), identifikojnë më shumë se gjashtëdhjetë taktika të mundshme ndërmjetësuese, por edhe studiuesitë të tjerë të ndërmjetësimit kanë bërë disa përpjekje për të sistematizuar format e ndryshme të sjelljes ndërmjetësuese përmes zhvillimit të llojeve ideale. Në studimin e Isak Svensson (2007: 229–248), hasim argumentimin për një dallim klasik në mes ndërmjetësimit të pastër dhe ndërmjetësimit të bazuar në fuqi. Edhe pse ka një debat të gjatë në literaturën e ndërmjetësimit mbi çështjen e qasjes më efektive, Svensson argumenton se “ndërmjetësimi i bazuar në fuqi dhe ndërmjetësimi i pastër janë më shumë komplementare se sa që, reciprokisht, e përjashtojnë njëra tjetrën”. Një tjetër klasifikim i shquar i strategjisë së ndërmjetësimit, nga Touval dhe Zartman (1985), dallon tre role ndërmjetësuesish: lehtësues, formulues dhe manipulues. Klasifikime të ngjashme janë propozuar edhe nga studius të tjetër (Bercovitch dhe Houston, 1993, 1996, 2000; Beardsley et al., 2006; Beardsley, 2011). Ngjashëm me dallimin klasik mes ndërmjetësimit të pastër dhe ndërmjetësimit përmes fuqisë, konceptualizimi i Touval dhe Zartman bazohet në shkallën e kontrollit, të cilën ndërmjetësuesi e ushtron mbi procesin negociues. Por, strategjinë e ndërmjetësimit e koncepton më shumë si një kontinuitet të shkallës sesa një variabël dikotomik.

Edhe pse debati mbi efektivitetin e roleve të ndryshme të ndërmjetësuesit mbetet i pazgjidhur, studimet e fundit sugjerojnë se, një ndërmjetësim përmes fuqisë, mund të jetë më i përshtatshëm për të prodhuar marrëveshje mes palëve në konflikt, por mund të ketë efekt negativ në qëndrueshmërinë më afatgjate të marrëveshjeve, pasi ndërmjetësuesit manipulues rrezikojnë të ndërmjetësojnë “marrëveshje artificiale”, të cilat nuk respektohen sapo të pushojë angazhimi i palës së tretë ndërmjetësuese, në zbatimin e marrëveshjes së ndërmjetësuar (Beardsley et al., 2006; Beardsley, 2011; (Wallensteen dhe Svensson, 2014).

Përfundimisht, një hulumtim i roleve të ndërmjetësisimit të BE-së, mund të nxjerrë njohuri nga teoria e rolit. Në kuadër të studimeve të integrimi evropiane, koncepti i rolit është i bazuar në literaturën mbi rolet e politikës së jashtme të BE-së, duke trasuar rrugën për mënyrën se si konceptet e rolit të BE-së dhe pritshmëritë e aktorëve të jashtëm formësojnë veprimin e jashtëm të BE-së. Prandaj, teoria e rolit mund të zgjerojë kuptueshmërinë se si perceptimet e jashtme të BE-së mund të ndikojnë në qasjen dhe strategjitë e saj si një ndërmjetësues (Elgström dhe Smith, 2006).

4.3.3. Efektiviteti i ndërmjetësisimit

Konceptimi dhe vlerësimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve është një çështje e debatuar shumë, si në literaturën mbi politikën e jashtme të BE-së, ashtu edhe në ndërmjetësimin ndërkombëtar. Në studimet mbi politikën e jashtme, efektiviteti i BE-së në politikën ndërkombëtare, është një temë kyçe e shumë publikimeve të viteve të fundit (Jørgensen et al., 2011; Niemann dhe Bretherton, 2013; van Schaik, 2013; da Conceição-Heldt dhe Meunier, 2014; Bergmann dhe Niemann, 2015). Edhe pse kjo nuk është e padiskutueshme, arritja e qëllimit në kuptimin e aftësisë së BE-së, për të realizuar qëllimet e saja në lidhje me një politikë apo masë të caktuar, duket të jetë bërë pikë themelore referuese për vlerësimin e efektivitetit.

Në hulumtimin e ndërmjetësisimit, shumë studime sasiore kanë aplikuar standardin e zgjidhjes së konflikteve për të vlerësuar efektivitetin e ndërmjetësisimit. Zgjidhja e konflikteve në këtë mënyrë është kuptuar si rezultat i dukshëm i drejtpërdrejtë i përpjekjeve ndërmjetësuese, shpesh të vlerësuar në aspektin e pesë rezultateve potenciale: zgjidhja e plotë, zgjidhja e pjesshme, marrëveshja mbi armëpushimin, marrëveshja mbi procesin dhe pa marrëveshje (Bercovitch, 2005: 293-294). Studime të tjera kanë sugjeruar që të shkohet përtej këtij

konceptualizimi dhe të merret në konsideratë edhe stabiliteti afatgjatë, si një tregues i suksesit në ndërmjetësim (Beardsley et al., 2006; Svensson, 2009; Beardsley, 2011).

Bergmann dhe Niemann (2015: 957–975) propozojnë një konceptualizim dydimensional të efektivitetit të ndërmjetësuesit, duke diferencuar në mes të a) perspektivës specifike për BE-në, e cila vlerëson nëse ajo ka qenë në gjendje të arrijë objektivat e saja në lidhje me një përpjekje të caktuar ndërmjetësimi dhe b) perspektivës specifike për konfliktin, e cila shtron pyetjen nëse përpjekjet e ndërmjetësimit të drejtuara nga BE-ja kontribuan në zgjidhjen e konfliktit. Perspektiva specifike e konfliktit, mund të eksplorojë, gjithashtu, edhe efektet më të gjera të ndërmjetësimit të BE-së mbi dinamikën e konfliktit, që do të thotë, se si perceptohet dhe si interpretohet angazhimi dhe rezultatet e ndërmjetësimit nga palët në konflikt (Autesserre, 2017). Në përgjithësi, janë trajtuar disa nga çështjet kyçe, që kanë të bëjnë me efektivitetin e ndërmjetësimit të BE-së, që mund të shërbejnë si rrugë eksplorimi, për hulumtime të mëtejshme mbi çështjen.

4.4. Rrugëtimi institucional në ndërmjetësim

Si një projekt paqeje, BE-ja që nga fillimi i saj ka kryesuar në parandalim të konflikteve, në ndërmjetësim dhe në dialog, si pjesë të përbërjes së saj të brendshme. Promovimi i paqes dhe parandalimi i konflikteve, gjithashtu, potencojnë angazhimin e saj me pjesën tjetër të botës.

Që nga fillimi i viteve 2000, kemi qenë dëshmitarë të rritjes së mbështetjes direkte të BE-së për negociata të paqes në një varg konfliktesh ndërshtetërore dhe brendashtetërore në rajone të ndryshme. BE-ja ka krijuar një rekord të angazhimit të drejtpërdrejtë të ndërmjetësimit në një numër konfliktesh ndërkombëtare, në veçanti, në anën e saj Lindore (Bergman dhe Niemann, 2015: 971-972). Përveç përfshirjes së saj, si një udhëheqës i drejtpërdrejtë ose si bashkëndërmjetësues në negociata paqeje, BE-ja gjithashtu ka mbështetur edhe proceset e paqes, duke ofruar informacione dhe kanale komunikimi për palët në konflikt, duke lehtësuar

dialogun mes palëve politike kundërshtare në krizat paszgjedhore ose duke mundësuar dhe promovuar përpjekjet e ndërmjetësimit të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë (Gündüz dhe Herbolzheimer, 2010). Këto qëllime kanë qenë gjithmonë të sanksionuara në traktatet, të cilat ofrojnë bazën kushtetuese të BE-së. Ky zhvillim ka filluar me miratimin e Programit për Parandalimin e Konfliktëve të Dhunshme, të vitit 2001, ku thuhet se “BE-ja është përgjegjëse për identifikimin e hershëm të konflikteve të dhunshme, si dhe për gamën e opsioneve për veprim”. Në vitin 2007, BE-ja themeloi Instrumentin e Stabilitetit (IfS), përmes të cilit ka intensifikuar përpjekjet e saja në fushën e parandalimit të konfliktit, menaxhimit të krizave dhe ndërtimit të paqes. Pas themelimit të IfS-së, Komisioni Evropian (KE), ka themeluar Partneritetin për Ndërtimin e Paqes (PbP), me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të nevojshme, për t’iu përgjigjur situatave të krizave në mbarë botën (Berisha, 2014). Traktati i Lisbonës (2009), e fuqizoi BE-në me një rol edhe më aktiv politik në nivel global. Ristrukturimi institucional i cili pasoi, kishte për qëllim rritjen e rolit dhe të kapaciteteve të BE-së, në mbështetje të proceseve paqësore, duke e përfshirë edhe ndërmjetësimin.

4.4.1. Konceptualizimi i ndërmjetësimit

Si donatori më i madh botëror, aktiv në menaxhimin e fushës së krizave, zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e tyre me një rekord jo të papërfillshëm të misionëve për CSDP-në në të gjithë botën, BE-ja ka filluar vetëm decenien e fundit të reflektojë mbi kapacitetin dhe resurset e veta në ndërmjetësimin ndërkombëtar të paqes. Një zhvillim kyç në rrugëtimin institucional dhe në zhvillimin e rolit të BE-së, si të një ndërmjetësuesi të mundshëm në skenën ndërkombëtare, ka qenë miratimi i dokumentit *“Koncepti mbi Fuqizimin e Ndërmjetësimit dhe Kapaciteteve të Dialogut të BE-së”* (Këshilli i BE-së, 2009). Në këtë dokument, BE-ja formuloi planin për përmirësimin e kapacitetëve ekzistues të ndërmjetësimit në mënyrë sistematike dhe fuqizimin e aftësive të saja të përgjithshme, për t’u

angazhuar në parandalimin joushtarak të konflikteve dhe në misionet e menaxhimit të krizave. Koncepti, gjithashtu, përcakton role të ndryshme dhe parime udhëzuese të ndërmjetësisimit, duke adresuar kështu nevojën për një koherencë të brendshme më të madhe dhe bashkëpunim më të ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë. Një rol kyç në ndërmjetësim, i atribuohet Përfaqësuesve të Posaçëm, mandatet e të cilave përfshijnë aktivitete të ndërlidhura me ndërmjetësimin dhe shpesh janë aktorët kryesorë të BE-së në rajonin e konfliktit.

Sqarimi i Konceptit të BE-së, vendosja e relevancës së saj politike dhe analizimi i perceptimeve dhe qëndrimeve ekzistuese, kanë si qëllim identifikimin e sfidave kryesore dhe propozimin e masave dhe modeleve specifike të institucionalizuara, të cilat do të mund ta përmirësonin potencialin e “fuqisë së butë” të BE-së, në këtë fushë. Janë tri parime (Meurs, 2010: 303-357) që ofrojnë një argument për avokim të një roli më të fuqishëm të BE-së, si të një aktori ndërkombëtar:

- Siguria njerëzore, përfshirë këtu shqetësimin humanitar për lehtësimin e vuajtjeve njerëzore të shkaktuara nga konflikti i dhunshëm apo dështimit të shtetit për plotësimin e nevojave themelore të njeriut;
- Zhvillimi, i cili ka të bëjë me efektivitetin e ndihmës në një perspektivë afatgjate, duke marrë parasysh rreziqet me potencialë të lartë dhe kostot e ndërlidhura me donatorët që braktisin vendin për një periudhë të gjatë;
- Siguria globale, lidhur me rreziqet e izolimit të një vendi dhe rritjen e ekstremizmit dhe terrorizmit në shtete të dështuara.

Futja e Konceptit, tregoi aspiratën e BE-së për të rritur dhe sistematizuar kapacitetet e saja në ndërmjetësim dhe për të theksuar dhe përforcuar profilin e saj, si ndërmjetësues ndërkombëtar. “Koncepti, si dokumenti i parë, që merret ekskluzivisht me rolin e saj, si ndërmjetësuese në

konfliktet ndërkombëtare, përbën pikën kyçe referuese për aktivitetet e ndërmjetësimit të BE-së” (Këshilli i BE-së, 2009: 6-9).

Për të kuptuar plotësisht rolin e BE-së, në ndërmjetësimin ndërkombëtar, argumentojmë marrjen në konsideratë të rolit të saj, si udhëheqëse në ndërmjetësim ose si bashkëndërmjetësuese në negociata paqeje, por, po ashtu edhe të formave të tjera, siç është forma indirekte e përfshirjes së saj në ndërmjetësim, e përcaktuar në Koncept. Përveç marrjes së rolit të ndërmjetësuesit në negociatat e paqes, Koncepti specifikon edhe llojet indirekte të ndërmjetësimit, duke diferencuar ndërmjet *ndërmjetësimit promovues, shfrytëzues, mbështetës dhe të ndërmjetësimit financues* (Këshilli i BE-së, 2009: 6). Përndryshe, mbështetja e ndërmjetësimit nga BE-ja, i referohet të gjitha aktiviteteve që synojnë të mbështesin përpjekjet e ndërmjetësimit nga palët e treta, qofshin ato shtete, organizata ndërkombëtare dhe rajonale apo aktorë joshitetërorë. Më konkretisht, Koncepti identifikon tri masa që korrespondojnë me konceptualizimin e mbështetjes ndërmjetësuese:

- Financimin e proceseve të ndërmjetësimit të udhëhequra nga palët e treta;
- Nxitjen e përpjekjeve ndërmjetësuese, duke ofruar mbështetje diplomatike dhe stimulime ekonomike, për një zgjidhje kompromisi dhe mbështetjen e implementimit të marrëveshjeve, përmes instrumentave të CFSP/CSDP-së dhe të Komunitetit;
- Mbështetjen e ndërmjetësimit, duke iu referuar kontributit në ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimit, si dhe ofrimit të ekspertizës për ndërmjetësuesit dhe palët në konflikt.

Përveç kësaj, Koncepti identifikon edhe ndërmjetësimin promovues, si lloj të katërt të përfshirjes së ndërmjetësimit, i cili i referohet një angazhimi më të përgjithshëm për të promovuar përdorimin e ndërmjetësimit, si instrument jo të dhunshëm të menaxhimit të konfliktit. Koncepti nuk e vendos ndërmjetësimin brenda një sfere të veçantë të politikës së marrëdhënieve të jashtme të BE-së, duke theksuar natyrën e saj nënsektoriale, e cila përfshin

një sërë instrumentash të CFSP/CSDP-së dhe të Komunitetit. Në këtë mënyrë ofrohet mundësia e aplikimit të ndërmjetësimit në të gjitha fazat e konfliktit (Këshilli i BE-së, 2009: 4-6). Siç vëjnë në dukje Haastруп et al. (2014: 3) “konceptualizimi i ndërmjetësimit në BE është qëllimisht i gjerë, sepse lejon vendosjen e ndërmjetësimit në të gjitha fazat e ciklit të konfliktit”. Koncepti ishte i nevojshëm dhe ishte nxjerrë në kohën e duhur, pak para fillimit të EEAS-it. BE-ja deri në miratimin e Konceptit nuk është konsideruar në vetvete dhe as nga të tjerët si një aktor i plotfuqishëm në fushën e ndërmjetësimit, pavarësisht se si dhe sa ka qenë e përfshirë, sa ka vepruar dhe sa ka mbështetur një llojllojshmëri të përpjekjeve për ndërmjetësim. Në të njëjtën kohë, Koncepti lejon, që BE-ja të jetë më e vetëdijshme për rolin e saj, gjë që nuk ka qenë rasti deri në atë kohë. Gjatë viteve të fundit, diskutimet dhe debatet mbi rolin e BE-së, kanë treguar format e një njohjeje në rritje të rëndësisë së zgjidhjes së konflikteve, si të një praktike të saj profesionale. Duke themeluar institucionin për fushën e veprimit të jashtëm, BE-ja ka krijuar një strukturë globale, duke marrë rolin e vëzhguesit edhe në vendet e treta. Për më tepër, në dritën e zbatimit të Traktatit të Lisbonës dhe në veçanti të EEAS-it, BE-ja ka bërë përpjekje të mëtejme për të konsoliduar dhe fuqizuar praninë e saj, si të një aktori ndërkombëtar, duke e siguruar fqinjësinë e saj dhe duke ndihmuar në sigurimin e paqes globale. Në mesin e funksioneve të shumta të tij, EEAS ndihmon në sigurimin e konsistencës dhe koordinimit të veprimit të jashtëm të BE-së, si dhe në përgatitjen e propozimeve të politikave dhe zbatimin e tyre pas miratimit nga Këshilli. Ai, gjithashtu, ndihmon Presidentin e KE, si dhe anëtarët e Komisionit në funksionet e tyre përkatëse në fushën e marrëdhënieve të jashtme dhe siguron bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare. Rrjeti i delegacioneve të BE-së anembanë botës është pjesë e strukturës së EEAS-it. Përfaqësuesi i Lartë, i cili ushtron autoritet mbi EEAS-in dhe mbi delegacionet e BE-së në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, në përputhje me mandatin e tij, gjithashtu

“përfaqëson BE-në në çështjet që kanë të bëjnë me CFSP-në dhe udhëheq dialogun politik me palët e treta në emër të BE-së, duke shprehur qëndrimin e tij në forume ndërkombëtare” (EEAS, “What We Do”, 2013). Po ashtu, edhe MST-ja e krijuar në vitin 2011, si qendër kryesore e njohurive dhe ekspertizës ndërmjetësuese, në kuadër të EEAS-it nuk është risi e vetme institucionale që pasoi në Konceptin e vitit 2009. Themelimi i Shërbimit Mbështetës të Ndërmjetësimit të Parlamentit Evropian (MEPs) për të ndihmuar nismat e ndërmjetësimit të ndërmarra nga anëtarët e PE-së dhe krijimi i Institutit Evropian të Paqes (EIP), ilustron rëndësinë që i është dhënë ndërmjetësimit në diskursin dhe praktikën e politikës së jashtme të BE-së. Koncepti, siguron një bazë politike për angazhimin e tij në fushën e ndërmjetësimit dhe të dialogut, dhe bën propozime konkrete për të fuqizuar kapacitetin dhe mbështetjen ndaj BE-së dhe ndërmjetësuesve të saj. Koncepti e përcakton ndërmjetësimin si “një mjet për reagim të parë në situata krize, të cilat janë në zhvillim e sipër apo të atyre që tanimë janë zhvilluar”, por, poashtu thekson edhe ambicjen e BE-së për t’u përfshirë në ndërmjetësim dhe në lehtësim të drejtpërdrejtë apo të udhëhequr nga të tjerët. Është me rëndësi të theksohet se, Koncepti krijon një përkufizim të gjerë të ndërmjetësimit, i cili, gjithashtu, përfshin lehtësimin e proceseve të dialogut politik në nivele të ndryshme. Kjo do të thotë se, ndërmjetësimi nga ana e BE-së, nuk ka të bëjë vetëm me ndërmjetësim të profilit dhe të nivelit të lartë të bisedimeve formale të paqes, i cili shpesh kryhet nga politikanë të shquar. Ai, është gjithashtu i angazhuar edhe rreth dialogut joformal politik dhe mbështetjes së aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, ose lokalë, të cilët janë më mirë të pozicionuar, ose më të pranueshëm për palët në konflikt, për të lehtësuar apo ndërmjetësuar bisedimet në një kontekst specifik. Në Koncept theksohet qartë se,

“BE-ja përmes këtij dokumenti, i ka krijuar kapacitetet e saja të ndërmjetësimit dhe është e angazhuar në të gjithë spektrin e proceseve të ndërmjetësimit, lehtësimit dhe të dialogut. Ndërsa, në praktikë, ndërmjetësimi është tashmë një pjesë integrale e veprimt të jashtëm të BE-së” (GSC, 2009: 4).

Përfaqësuesit e posaçëm të BE-së (Delegacionet, misionet e CSDP-së), janë të angazhuar në përpjekjet për lehtësim dhe ndërmjetësim në zonat konfliktuale në mbarë botën. BE-ja, sot, e sheh veten si aktor të rëndësishëm në çështjet ndërkombëtare, duke luajtur një rol të rëndësishëm përmes mjeteve të ndryshme, diplomacisë, tregtisë, ndihmës ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me organizatat globale.

Sipas Këshillit, BE-ja ka shumë për të ofruar si ndërmjetësues, sepse “është në pozitë të shkëlqyer për të ofruar stimuj për palët në konflikt, të cilat mund të mbështeten në praninë e gjerë të saj në terren” (GSC, 2009: 4). BE-ja tregon gatishmërinë e saj për të mbështetur proceset e ndërmjetësimit dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura përmes të gjitha mundësive dhe mjeteve në dispozicion, bazuar në përvojën e saj të akumuluar dhe gamën e gjerë të instrumentave për menaxhimin e krizave.

Edhe pse ndërmjetësimi nuk është një fushë e re për BE-në, numri i përpjekjeve të saj ndërmjetësuese, është ende relativisht i ulët, në krahasim me përfshirjen e ndërmjetësimit të OKB-së. Megjithatë, për BE-në, ndërmjetësimi është bërë një element gjithnjë e më i rëndësishëm i mjeteve të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë, por që me një qasje edhe më të koordinuar dhe më të përqendruar, do të arrinte të përmironte edhe më tej aftësinë e saj, për të luajtur një rol edhe më aktiv ndërkombëtar në këtë fushë.

4.4.2. Arkitektura institucionale mbi aktivitetet e ndërmjetësimit

Arkitektura institucionale, në mbështetje të aktiviteteve të ndërmjetësimit të BE-së, bazohet kryesisht në aktorët e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) dhe të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP), por gjithashtu ia përcakton një rol edhe KE (Këshilli i BE-së, 2009: 4-5). Në kuadër të strukturave të CFSP-së, Komiteti për politikë dhe siguri (PSC) është organi më i rëndësishëm, kur bëhet fjalë për përcaktimin e mandateve të ndërmjetësuesve të BE-së dhe kontrollin e drejtimit strategjik të përpjekjeve për

ndërmjetësim (Traktati i BE-së, 2009: 38, 43). Pikërisht në PSC, ku vendet anëtare përditësohen rregullisht mbi përpjekjet e ndërmjetësimit të BE-së nga Përfaqësuesi i Lartë, EUSER-ët e BE-së apo aktorë të tjerë, diskutohet dhe vendoset mbi mandatet e ndërmjetësuesve (Këshilli i BE-së, 2009: 4). Derisa PSC-ja, është në varësi të Komitetit të Përfaqësuesve të Përhershëm, (COREPER) në lidhje me përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit për Punë të Jashtme (FAC), vendimet dhe qëndrimet e miratuara nga PSC-ja, zakonisht nuk ndryshohen nga COREPER-i (Keukeleire dhe Delreux, 2014: 69).

Lidhur me udhëheqjen e ndërmjetësimit të BE-së, Përfaqësuesi i Lartë/Zëvendës-presidenti i Komisionit, EUSER-ët e BE-së, EEAS-ët dhe delegacionet e BE-së ishin në “linjën e parë” të aktiviteteve të ndërmjetësimit. Përfaqësuesit e Lartë të CFSP-së, janë përfshirë personalisht dhe kanë udhëhequr një sërë përpjekjesh të spikatura të ndërmjetësimit të BE-së. Baronessa Catherine Ashton, personalisht është angazhuar në udhëheqjen e bisedimeve të nivelit të lartë mes kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë, në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi (Pifer, 2007; Ilievski dhe Taleski, 2010; Sauer, 2015: 107-116; Bergman dhe Niemann, 2015: 965; Bergmann, 2017; Pinfari, 2018: 278–298).

Edhe pse Përfaqësuesit e Lartë kanë qenë figurat udhëheqëse në përpjekjet e ndërmjetësimit të nivelit të lartë, Koncepti, fuqishëm thekson rëndësinë e EUSR-ëve, si ofrues të një numri të detyrave që ndërlidhen me ndërmjetësimin dhe dialogun dhe si aktorët kryesorë institucional të BE-së të përfshirë në aktivitetet e ndërmjetësimit në të gjitha nivelet (Këshilli i BE-së, 2009: 5). “EUSR-ët janë lojtarë të rëndësishëm në udhëheqjen e përditshme të politikës së jashtme të BE-së, me një spektër të gjerë përgjegjësish, në fushën e parandalimit të konflikteve dhe menaxhimit të krizave” (Adebahr, 2012: 165; Elgström, 2006; Davis, 2014; Pinfari, 2018).

Organi më i rëndësishëm në lidhje me politikën e ndërmjetësimit të BE-së, është Divizioni për Parandalimin e Konflikteve, Sundimin e Ligjit, Qasjen e Integruar, Stabilizimin dhe Ndërmjetësimin (PRISM). Divizioni është përgjegjës për zhvillimin e politikave për çështje “të tilla si monitorimi i situatave të mundshme të krizës, ndërmjetësimi dhe vendosja e ndërmjetësuesve ose vëzhguesve në terren në zonat potenciale të konfliktit” (Middleton et al., 2011: 16). Në veçanti, MST-ja në kuadër të divizionit, u zhvillua në një trup mbështetës dhe koordinues kyç në fushën e ndërmjetësimit (Brandenburg, 2017: 7). Përderisa vetë MST-ja nuk është e angazhuar si palë ndërmjetësuese në konflikte të dhunshme, ajo ka ofruar një sërë aktivitete trajnuese për EEAS-in dhe stafin e delegacioneve të BE-së dhe kështu, shërben si një ofruar i rëndësishëm i “ekspertizës dhe njohjes së ndërmjetësimit”. Përveç kësaj, ajo ka ofruar mbështetje operacionale për aktorët e angazhuar në përpjekjet ndërmjetësuese dhe ka filluar të zhvillojë një rrjet bashkëpunimi me aktorë të tjerë ndërkombëtarë publikë dhe privatë, veçanërisht me Njësinë e Mbështetjes së Ndërmjetësimit të OKB-së (Sherriff dhe Hauck, 2012; EEAS, 2013).

Përveç organeve të CFSP-së, KE ka qenë nxitësi kyç i zhvillimit dhe i institucionalizimit të politikës së BE-së, për parandalimin e konflikteve, që përbën kornizën gjithëpërfshirëse të qasjes së BE-së për ndërmjetësim (Stewart, 2008). Ndërmjetësimi i BE-së, gjithashtu, mund të përfshijë instrumenta dhe aktorë të Komunitetit në rastet kur përpjekjet e ndërmjetësimit të BE-së, janë të ndërlidhura me fusha të tjera të politikës së jashtme, të tilla si politika e zhvillimit ose zgjerimit (Keukeleire dhe Delreux, 2014: 61-63). Një shembull i tillë mund të jetë përfshirja e ngushtë e zyrtarëve të KE në ekipin e ndërmjetësimit të BE-së në dialogun Kosovë-Serbi. Përveç kësaj, mekanizmi kyç për financimin e aktiviteteve mbështetëse të ndërmjetësimit të BE-së, është Instrumenti kontribues i Stabilitetit dhe Paqes (IcSP). Fondet e IcSP-së menaxhohen dhe mbikëqyren nga Shërbimi për Instrumentat e Politikës së Jashtme,

një organ i Komisionit nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë për CFSP-në të BE-së (Bergmann, 2017: 199-200). Aktiviteti më i shquar i IcSP-së, në lidhje me aktivitetet e ndërmjetësimit të BE-së, është projekti: Resurset Evropiane për Përkrahjen e Ndërmjetësimit (ERMES), si rrjet i reagimit të shpejtë, për referimin e ndërmjetësuesve dhe ekspertëve në parandalimin e konflikteve në situatat e krizave akute, si dhe për trajnimin e stërvitjen e palëve të treta në ngritjen e aftësive për ndërmjetësim (KE, 2016).

Arkitektura institucionale, përfshin edhe një numër institucionesh dhe aktorësh në nivele të ndryshme, brenda sistemit të politikës së jashtme të BE-së. Aktivitetet ndërmjetësuese të BE-së ngërthejnë në vete edhe marrëveshje të përkohshme, që përfshihen në politikë dhe institucione, gjë që e bën koordinimin në përpjekjet e ndërmjetësimit një sfidë të veçantë (Davis, 2014; Pinfari, 2018).

4.5. Efektiviteti ndërmjetësues në negociata paqeje

Kjo pjesë e punimit fokusohet në rolin e nënvizuar të BE-së, si ndërmjetësues në negociata paqeje. Është eksplorues dhe kryesisht konceptual. Qëllimi kyç i kësaj pjese, është të zhvillojë një kornizë analitike që na mundëson të hulumtojmë kushtet e mundshme të efektivitetit të BE-së, si ndërmjetësues në negociata paqeje.

Se sa është BE-ja efektive në përpjekjet e saja të ndërmjetësimit, është një çështje që ende duhet të adresohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, në studimet kërkimore mbi paqen dhe konfliktin. Përgjigjja në pyetjen e efektivitetit të BE-së varet gjithashtu nga mënyra e konceptimit të efektivitetit dhe suksesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar.

Se sa do të jetë BE efektive dhe e suksesshme në ndërmjetësimin ndërkombëtar, Julian Bergmann (2016), në hulumtimin e tij, “The EU as a peace mediator”, potencon se krizat e brendshme, si zgjerimi dhe reformimi, si dhe ato të jashtme, siç është dalja e Britanisë së Madhe nga Bashkimi, si njëri nga Shtetet Anëtare më me ndikim, mund të pengojnë BE-në që

të fuqizojë edhe më tej kapacitetet dhe burimet e saja institucionale për një ndërmjetësim efektiv dhe të suksesshëm dhe në angazhimin e saj në fushën e ndërmjetësimit të paqes:

“Zgjerimi, reformimi dhe Brexit-i do ta shtyejnë BE-në drejt një udhëkryqi vendimtar në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë, duke ndikuar potencialisht edhe në angazhimin e saj në fushën e ndërmjetësimit të paqes”

Përkundër një interesi në rritje dhe një angazhimi praktik të pjekur të BE-së në ndërmjetësimin ndërkombëtar, nga analistë dhe praktikues të politikave (Grono, 2010; Herrberg, 2009), literatura akademike nuk i ka kushtuar shumë vëmendje rolit të saj në negociata paqjeje, sikurse sferave të tjera të politikave. Për pasojë, nuk dihet shumë për kontributin BE-së në fushën e ndërmjetësimit ndërkombëtar, veçanërisht në aspektin e efektivitetit dhe ndikimit të këtij aktori relativisht të ri. Për të trajtuar këtë boshllëk hulumtimi, kërkohen përgjigjet në disa pyetje kërkimore. Në pyetjen se si mund të konceptohet në mënyrë adekuate efektiviteti dhe cilët janë faktorët ndikues në efektivitetin e ndërmjetësuesit të BE-së, dhe lidhur më këtë, sa efektive ka qenë ajo gjer më tani si ndërmjetësuese në dialogun Kosovë-Serbi?

Për Bergman, ndërhyrja relativisht efektive e BE-së, në konfliktin Kosovë-Serbi (krahasuar me përpjekjet e OKB-së), mund të shpjegohet përmes strategjisë së saj të manipulimit, e cila lejoi që të përdorte levat e saj përballë palëve në konflikt. Krahasuar me rastet e ndërmjetësimit të paefektshëm të BE-së, si në Egjipt, Bosnje, në konfliktin izraelito-palestinez apo edhe në Ukrainë (Pinfari, 2013: 83-101), BE-ja duket se ka levën e duhur në dialogun Kosovë-Serbi, pasi ndoshta palët kanë perspektivën më konkrete të anëtarësimit. Kjo do të sugjeronte, që ndërmjetësimi është efektiv, vetëm kur mbështetet përmes levave substanciale dhe të besueshme.

Për të studiuar efektivitetin e ndërmjetësuesit të BE-së është e nevojshme një kornizë, nga arsyeja se në fushën e studimeve të Politikës së Jashtme Europiane (EFP), ka një numër në rritje të analizave mbi efektivitetin e BE-së në institucionet ndërkombëtare dhe negociatat

shumëpalëshe, të cilat kanë paraqitur koncepte të ndryshme mbi efektivitetin e BE-së (Ginsberg 2001; Laatikainen dhe Smith 2006; Groenleer dhe van Schaik 2007, Jørgensen et al. 2011; Thomas 2012; Niemann dhe Bretherton 2013). Studimet e cekura argumentojnë se kornizat e vendosura për të studiuar efektivitetin e BE-së si ndërmjetësues, nuk mund të aplikohen në mënyrë të barabartë për studimin e efektivitetit të saj si ndërmjetësuese, pa modifikime thelbësore. Së pari, efektiviteti si ndërmjetësues mes palëve në konflikt, është konceptualisht i ndryshëm nga efektiviteti, si një palë e drejtpërdrejtë në negociata. Ndërmjetësuesit hyjnë në negociata “për të ndihmuar ata që janë të përfshirë të arrijnë një rezultat më të mirë, sesa ata do të mund të arrinin vetë” (Bercovitch, 2009: 342). Së dyti, ndërmjetësimi përbën një lloj të veçantë negociatash që zhvillohen në një kontekst shumë specifik, që ndryshon nga ajo në negociatat “civile”, siç është, për shembull, fusha e tregtisë dhe ajo e ndryshimeve klimaterike. Faktorët e kontekstit, të tillë, si intensiteti i dhunës në konflikt, perceptimi i çështjeve me rrezik të konfliktit dhe historiat (i dhunshëm) i marrëdhënieve mes palëve kundërshtare, mund të kenë një ndikim domethënës në dinamikën e negociatave.

4.5.1. Faktorët ndikues në efektivitetin e ndërmjetësimit

Për të qenë në gjendje të dallojmë faktorët që përcaktojnë, nëse ndërmjetësimi është i suksesshëm apo jo, atë duhet parë si një proces, i cili preket nga shumë variabla. Bercovitch dhe Gartner tentojnë të identifikojnë faktorët dhe variablat që shpjegojnë në rezultate të ndryshme në procesin e ndërmjetësimit, “do të ishte e mundur të krijohet një pasqyrë me faktorët që ndikojnë në procesin e ndërmjetësimit”, por autorët kërkojnë edhe që ajo pasqyrë të mund të ndryshohet, në mënyrë që të maksimalizohet mundësia e suksesit”. Si proces i menaxhimit të konfliktit ndonjëherë mund të jetë i rrezikshëm, megjithatë, ka shumë të ngjarë që është një proces politik racional me kosto dhe përfitime të parashikuara:

“Ndërmjetësimi është një proces reciprok i cili ndikon dhe ndikohet si dhe është përgjegjës për kontekstin, palët, çështjet, historinë dhe mjedisin e një konflikti, i cili funksionon përbrenda një sistemi këmbimi dhe ndikimi social, parametrat e të cilit janë aktorët, komunikimi i tyre, pritjet, përvoja, resurset, interesat, dhe situata brenda së cilës ata të gjithë e gjejnë veten” (Bercovitch dhe Gartner, 2006: 332).

Maoz dhe Terris (2006: 411-412) identifikojnë variablat dhe konkludojnë se, “studimet sasiore kanë ekzaminuar efektet e një vargu të variablave që besohet të ndikojnë në ndodhjen dhe suksesin e ndërmjetësimit në mosmarrëveshjet ndërkombëtare”, duke i klasifikuar ato në tri grupime: (1) faktorët që përshkruajnë palët kundërshtare (pabarazia e fuqisë, llojet e regjimit), (2) faktorët që përshkruajnë ndërmjetësuesin dhe procesin e ndërmjetësimit (aftësia e ndërmjetësuesit, koha e ndërmjetësimit), si dhe (3) faktorët që përshkruajnë mosmarrëveshjen (kohëzgjatja, lloji i çështjes, niveli i dhunës). Për më tepër, ata pajtohen me idetë e autorëve të tjerë se, “sa më shumë leva që posedon ndërmjetësuesi, të vlerësuara si të tilla nga palët kundërshtare, aq më e lartë është aftësia për të ndikuar në palët në konflikt”, por, sipas tyre “ndërmjetësuesit duhet të kenë fuqinë përkatëse në mënyrë që të jenë të aftë për të arritur një zgjidhje”. Në anën tjetër, Touval dhe Zartman vendosin: lehtësimin/komunikimin, formulimin dhe manipulimin, si tri mënyra që ndërmjetësuesit përdorin për t’i vazhduar interesat e të gjitha palëve të përfshira drejt një zgjidhjeje të pranueshme reciproke për konfliktin. Poashtu, kornizat ekzistuese për të studiuar ndërmjetësimin në studimet e paqes dhe konfliktit, kërkojnë modifikime kur aplikohen në BE.

Derisa sukcesi i ndërmjetësimit në aspektin e zgjidhjes së konflikteve është variabël e varur standarde, në hulumtimin e ndërmjetësimit, efektiviteti i ndërmjetësuesit është më i përshtatshëm për të studiuar përpjekjet e një ndërmjetësuesi të veçantë, sepse mundëson integrimin e më shumë dimensioneve subjektive, siç është arritja e qëllimeve të ndërmjetësuesit në kornizë. Për më tepër, koherenca kontestuese e veprimit të jashtëm të BE-së është shfaqur si një faktor vendimtar në literaturën e politikës së jashtme të BE-së dhe, kështu, duhet të llogaritet si kusht potencial i efektivitetit të ndërmjetësuesit të BE-së

(Meunier 2000; Gebhard 2011; Thomas, 2012). Kjo kornizë, poashtu, fiton vlerë shtesë duke tubuar literaturë të ndryshme strategjike, që rrallë komunikojnë njëra me tjetrën: literaturën mbi paqen dhe konfliktet me atë të politikës së jashtme të BE-së, duke gjeneruar kështu njohuri të reja dhe në të njejtën kohë duke kontribuar në “ndërtimin e urës” në mes të këtyre dy fushave të ndryshme të hulumtimit.

4.5.2. Kushtet e efektivitetit të ndërmjetësuesit

Studiuesit, Kressel dhe Pruitt (1989), por edhe Bercovitch dhe Langley (1993: 686), kanë identifikuar dhe diskutuar një spektër të gjerë faktorësh që besohet të ndikojë në suksesin e ndërmjetësimit. Hulumtimi i kushteve të efektivitetit dhe rolit të BE-së, në ndërmjetësimin ndërkombëtar, fokusohet në variabla që kanë të bëjnë me identitetin e ndërmjetësuesit dhe me sjelljen e tij ndaj negociatave. Duke i kombinuar gjetjet e dy studimeve ndërkombëtare të ndërmjetësimit dhe të hulumtimeve mbi përvojat e BE-së, dallojmë katër grupe kushtesh, të cilat i gjykojmë si më të rëndësishmet në kontekstin e ndërmjetësimit: (1) levën e ndërmjetësuesit, (2) strategjinë e ndërmjetësimit, (3) koherencën dhe (4) kontekstin e konfliktit.

4.5.2.1. Leva e ndërmjetësuesit

Në literaturën mbi ndërmjetësimin, hasim një konsensus të përgjithshëm, ku thuhet se identiteti i ndërmjetësuesit përcakton fuqinë apo “levën e sistemit” që ai e posedon. Touval dhe Zartman (1989: 12), të cilët ishin ndër të parët që sollën konceptin e levave në kontekstin e ndërmjetësimit ndërkombëtar, e përcaktuan levën si “burim të fuqisë, të ndikimit, dhe të bindjes që mund të sjellë palët të lëvizin drejtë një marrëveshjeje”. Levat janë definuar si resurse dhe instrumenta të BE-së që mund të sjellin palët kundërshtare në tryezën e bisedimeve dhe “të nxjerrin” nga ata një marrëveshje të caktuar. Poashtu, edhe Greig dhe

Diehl (2012: 121) pretendojnë se “ndërmjetësuesit kanë të ngjarë të jenë më efektiv kur ata sjellin diçka në procesin e ndërmjetësimit, që ndryshon dinamikën mes palëve në konflikt”. Sipas kësaj, mund të argumentohet, se niveli minimal i levës është parakusht i nevojshëm për efektshmërinë e ndërmjetësimit, sepse pa posedimin e ndonjëres nga resurset, gjasat që të ushtrohet ndikim tek palët në konflikt janë praktikisht baraz me zero. Ka lloje të ndryshme të resurseve të mundshme që ndërmjetësuesi mund të sjellë në tryezën e bisedimeve. Së pari, një ndërmjetësues mund të nxjerrë instrumentat tradicionalë “të fuqisë ndërmjetësuese” (Heemsbergen dhe Siniver, 2010), të tilla si masat shtrënguese dhe stimujt pozitiv, të cilat ndërtojnë logjikën e kushtëzimit pozitiv ose negativ (Tocci, 2008: 882-883). Masat shtrënguese përfshijnë kërcënimin apo përdorimin aktiv të forcës ushtarake si dhe vendosjen e sanksioneve ekonomike, të dyja me qëllim të krijimit të situatave sa më të pakëndshme dhe më të kushtueshme për palët në konflikt. Në anën tjetër, masat joshtrënguese apo stimujt pozitiv paraqesin “shtesa konkrete ndaj kushteve të një marrëveshjeje në mes të palëve kundërshtarë” (Touval dhe Zartman, 1989:13). Supozimi themelor është se stimulimet pozitive ndryshojë kalkulimet e palëve në konflikt mbase për t’i bindur ata për një rezultat sa më të qetë, pa konflikt. Masat joshtrënguese, mund të përfshijnë edhe stimuj ekonomikë, të tillë si tregtinë e lirë dhe marrëveshjet e asociimit, heqjen e rregullave për vizat apo edhe premtimit për investime të drejtpërdrejta në të ardhmen. Së dyti, “kapaciteti institucional, është një lloj tjetër i resursit që një ndërmjetësues mund të nxjerrë në përpjekjet e tij për të promovuar një marrëveshje mes palëve në konflikt”. Kapaciteti institucional mund të përfshijë kontaktet diplomatike të mirëthemeluara dhe rrjetet me palët kundërshtarë, një aparat efektiv të inteligjencës që monitoron konfliktin dhe siguron informata private për interesat dhe strategjitë e palëve kundërshtarë, si dhe mjete të mjaftueshme financiare për të financuar përpjekjet e ndërmjetësimit gjatë një periudhe më të gjatë kohore (Greig dhe Diehl, 2012:

127). Përveç kësaj, mundësia për të nxjerrë një grup ekspertësh të ndërmjetësimit dhe këshilltarësh mund të përmirësojë ekspertizën e negociatorëve të palës së tretë dhe aftësitë e tyre të ndërmjetësimit. Këto janë gjithashtu resurse të vlefshme për ndërmjetësim, që rrisin ndikimin e një ndërmjetësuesi.

Me pak fjalë, nga literatura e cituar mbi ndërmjetësimin, konkludojmë se, sa më shumë leva që posedon një ndërmjetësues, aq më shumë ka të ngjarë se, do të jetë një ndërmjetësues i qëlluar dhe shumë më efikas.

4.5.2.2. Strategjia e ndërmjetësimit

Gjetjet empirike në hulumtimin e ndërmjetësimit ndërkombëtar tregojnë se strategjia e caktuar, të cilën ndërmjetësuesi e miraton për të nxitur një marrëveshje në mes të palëve në konflikt, ka ndikim në efikasitetin e ndërmjetësuesit (Beardsley 2011; Bercovitch dhe Houston 1996).

Pas klasifikimit standard të llojeve ideale të sjelljeve të ndërmjetësuesve kemi dalluar tri strategji të ndryshme të ndërmjetësimit që, në këtë rast, BE-ja mund t'i adoptoj: lehtësimin/komunikimin, formulimin dhe manipulimin (Touval dhe Zartman 1989; Princen 1992; Bercovitch dhe Houston 2000; Beardsley et al. 2006; Bercovitch 2009).

4.5.2.3. Koherenca

Duke u bazuar në literaturën mbi rolin si aktor dhe mbi aktivitetin dhe efikasitetin e BE-së, në negociata ndërkombëtare dhe në ato multilaterale, supozojmë se koherenca e politikave është gjithashtu relevante në kontekstin e involvimit të BE-së në negociata paqeje. Koherenca, këtu, është kuptuar si një koherencë vertikale, (Bretherton dhe Vogler 2008) duke përfillur shkallën e koordinimit në mes të politikave individuale të Shteteve Anëtare ndaj një konflikti dhe aktivitetit të ndërmjetësimit të kryer nga institucionet e BE-së, si nga KE, nga Përfaqësuesi i

Lartë i CFSP-së ose nga EUSR-ët për një rajon të veçantë të konfliktit. Si mund të ndërliiden mes veti koherenca vertikale dhe efikasiteti i ndërmjetësimit?

Supozojmë se një qasje e lartë koherente e BE-së ndaj një konflikti të veçantë, që implikon mbështetjen e Shteteve Anëtare, për pozicionime dhe politika të përbashkëta, dërgon një sinjal të fuqishëm për përcaktimin e saj, që të ndihmojë palët kundërshtarë për zgjidhjen e konfliktit të tyre dhe në të njëjtën kohë, nuk lë hapësirë për interpretim në lidhje me preferencat e BE-së lidhur me përmbajtjen e një zgjidhjeje të negociuar (Maoz dhe Terris 2008; Thomas 2012). Me të njëjtën logjikë, presim që një shkallë e ulët e koherencës vertikale ka një efekt negativ në efikasitetin e ndërmjetësuesit të BE-së, për dy arsye. Së pari, nëse BE-ja nuk e ka mbështetjen e veçantë të një Shteti Anëtar ose të një grupi të Shteteve Anëtare (mosnjohja e shtetësisë së Kosovës nga 5 Shtetet Anëtare) për politikën e saj të përbashkët drejt një konflikti, palët kundërshtarë, që janë në konflikt, mund të kenë dyshime në lidhje me aftësinë e saj për të mbajtur premtimet e bëra gjatë procesit negociator, siç janë për shembull premtimet për ndihma financiare që i ofrohen palëve, si një nxitje pozitive për të bërë lëshime ndaj anës tjetër. Kjo, nga ana tjetër, edhe do të minonte besueshmërinë e angazhimit të BE-së. Së dyti, një nivel i ulët i koherencës në anën e ndërmjetësuesit mund të gjenerojë ose të intensifikojë përpjekjet për shkatërrimin e procesit paqësor (Stedman, 1997).

Nga arsyet e cekura, kuptojmë se, me sa më pak koherencë të veprojë BE-ja, ndaj një konflikti të veçantë, më pak perceptohet edhe besueshmëria nga vendet që janë të prekura nga konflikti dhe shanset janë më të mëdha, që palët opozitare ose grupet ekstremiste, përbrenda këtyre shteteve, që kërkojnë të shkatërrojnë procesin paqësor, e shfrytëzojnë këtë situatë duke rënduar dyshimet për pranueshmërinë e BE-së si të një ndërmjetësuesi dhe pakësojnë gjasat për një rezultat të kënaqshëm të negociatave.

4.5.2.4. Konteksti i konfliktit

Nëse atributet e identifikuar më lartë, do t'mund të përktheheshin në efektivitetin e ndërmjetësuesit, varet edhe nga konteksti i konfliktit. Në literaturën e ndërmjetësimit është e padiskutueshme se shkalla e kohezionit të brendshëm të palëve në konflikt, mund të ketë efekt domethënës në mundësinë e zgjidhjes së konflikteve. Kohesiviteti ose është operacionalizuar si strukturë e brendshme e palëve ose si natyrë dhe numër i zonave të tyre elektorale (Kleiboer 1996: 365-366). Nocioni i dytë i kohezionit, ndërlidhet me atë që Stedman (1997: 5) i quan “probleme spoiler” në procese. Autori, “spoiler-ët”, (minuesit e procesit) i përkufizon si “liderë dhe palë që besojnë se paqja që del nga negociatat kërcënon fuqinë, botëkuptimin dhe interesat e tyre dhe përdor dhunën për të minuar përpjekjet për ta arritur atë”.

Një faktor i rëndësishëm i kontekstit të konfliktit, që ndërlidhet me gatishmërinë e palëve në konflikt, për të bërë lëshime në negociata, sipas Kleiboer (1998: 20), paraqet kohën e duhur për ndërmjetësim. Greig dhe Diehl (2012: 122), potencojnë se “ndërmjetësimet e provuara, më herët apo më vonë, kanë tendencën e shkurtimit të kohëzgjatjes së konfliktit”. Arsyet për “kohën e duhur” ose për “kohën jo të duhur” mund të jenë të shumëfishta, jo vetëm në varësi të intensitetit të konfliktit, por edhe të politikave vendore apo të brendshme në anën e palëve kundërshtare.

Të katër kushtet e identifikuar dhe të trajtuara të efektivitetit të ndërmjetësuesit të BE-së: levat ndërmjetësuese, strategjitë e ndërmjetësimit, koherenca dhe konteksti i konfliktit, edhe pse janë të trajtuara veçmas, për qëllime analitike, ato në fakt janë të ndërlidhura. Veçanërisht, zgjidhja e strategjisë së ndërmjetësimit varet kryesisht nga disponueshmëria e levave përkatëse. Prandaj, një ndërmjetësues, mund të përdorë me kredibilitet një strategji manipuluese, kur ka resurse dhe instrumenta të nevojshëm, për të ofruar nxitje pozitive ose për të kërcënuar me përdorimin e fuqisë shtrënguese.

4.6. Konceptet dhe qasja e BE-së në dialogun Kosovë-Serbi

Konceptet dhe qasjen të cilën BE-ja e përdorë në marrëveshjet mes palëve, në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, si një teknikë negociuese, për të arritur deri tek një pajtueshmëri më e lehtë, janë: koncepti i dykuptimësisë kreative, koncepti i rikontekstualizimit të dialogut, si dhe qasja neutrale ndaj statusit. Studiuesit, Papadimitriou dhe Petrov, janë të mendimit se, “dykuptimësia kreative, rikontekstualizimi i dialogut dhe qasja e neutrale e BE-së ndaj statusit, jo vetëm që kanë arritur kulminacionin e tyre të ‘përdorimit’, në dialogun mes Kosovës dhe serbisë, por ato gjithashtu kanë bërë të pamundur vazhdimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjeve të reja pa u marrë me çështjen kryesore, që është, statusi i Kosovës”. Konceptet dhe qasja e përdorur si dhe mungesa e unitetit mes Shteteve Anëtare e pengojnë rolin e BE-së në Kosovë, por edhe më gjerë në rajon” (Papadimitriou dhe Petrov, 2012).

Duke i zbatuar konceptet dhe qasjen e BE-së në procesin e dialogut, apo siç e quajnë, dialogu mbi “normalizimin e marrëdhënieve”, duket qartë se kemi të bëjmë me përdorimin strategjive dhe të një gjuhe aq dykuptimëshe, sa të mund të sigurojë një hapësirë veprimi për palët kundërshtare, por edhe për vetë BE-në, si palë e tretë ndërmjetësuese, në mënyrë që të gjithë ta kenë mundësinë e interpretimit të një marrëveshjeje, si të një dakordësie të lartë mes tyre.

4.7. Koncepti i ambigualitetit apo i dykuptimësisë kreative në BE

Në negociata, mbi krizat ndërkombëtare, është praktikë e zakonshme, që në marrëveshjet, të cilat i rregullojnë regjimet e paskrizës, (Fischhendler, 2008: 111-136) të “përdoret gjuha dykuptimëshe, si një strategji tipike negociuese, për të arritur “blerjen” e palëve kundërshtare dhe përparimin gradual drejt stabilizimit të marrëdhënieve”. Khaled Elgindy (2019: 135), në hulumtimin e tij, thekson se “dykuptimësia kreative arrihet me përdorimin e formulimeve të shumta, qëllimisht dykuptimëshe”, duke nënvizuar se, “dykuptimësia gjithashtu mund të çojë në keqkuptime, tensione dhe përkeqësim konsekuent të marrëdhënieve mes palëve në konflikt”. Jegen dhe Mérand (2013), potencojnë përdorimin e dykuptimësisë në disa raste

specifike, duke precizuar se “dykuptimësia në proceset negociatore politike është një strategji tipike për të arritur një zgjidhje”, se dykuptimësia zakonisht përdoret “në rastet kur qëllimi i palëve të përfshira është heterogjen dhe qartësia potenciale e marrëveshjeve do të ballafaqohet me kundërshtime të ashpra”.

Në politikat e BE-së, dykuptimësia kreative përdoret në situatat kur Shtetet Anëtare apo palë të tjera të një negociate të caktuar, nuk mund të pajtohen plotësisht mbi një çështje dhe marrëveshjet e formuluar në mënyrë të dykuptimtë, ndihmojnë, sepse mund të interpretohen ndryshe në kontekste të ndryshme nacionale.

Qëllimi i qasjes hap pas hapi mbi çështjen e njohjes, që disa studiues (Hehir, 2007: 243-261) e quajnë “dykuptimësi apo paqartësi konstruktive” (që BE-ja në shumë mënyra e trashëgoi nga OKB-ja, si paraardhësi i saj në rajon), në rastin e dialogut Kosovë-Serbi, nënkuptonte që aspektet me rëndësi politike (sidomos ato që ndërlidheshin me veriun e Kosovës) do të trajtoheshin, pasi që të dyja palët të kishin përparuar në aspektet më teknike. Logjika e dykuptimësisë kreative, e propozuar në vitin 2000 nga Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, në thelb ishte bazuar në supozimin se politika mund të rifokusohej në çështje më pak emocionale (papunësia dhe arsimi) në vend të “çështjes së statusit”.

Shpesh jemi dëshmitarë të dhënies së deklaratave të ndryshme për shtyp për takime të njëjta, të lëshuara nga delegacioni kosovar dhe ai serb. Po ashtu, si i tillë është edhe roli i BE-së si ndërmjetësuese, e cila dialogut gjithnjë i referohet me “dialogu i normalizimit”, si një mënyrë për të legjitimuar kërkesat, nevojat dhe llojet e ndryshme të kushteve të saja, të vendosura për palët në dialog. Kjo ia mundëson, të bëjë veprime multivokale, mundësisht edhe veprime të fuqishme në terren. Për më tepër, BE-ja me vetëdije e lë mundësinë që palët t’i përcaktojnë kushtet e normalitetit, pavarësisht faktit që ato, këtë mënyrë të marrëdhënieve normale e konsiderojnë gjendjen të cilën BE-ja do ta pranojë si të tillë. Studiuesit e konsiderojnë tërë

konceptin e dialogut në thelb të jetë “artificial”, “sipërfaqësor” dhe “tepër të ngushtë për arritjen” e objektivave të përcaktuara nga palët (Musliu dhe Orbie, 2016: 179–195). Shtrohet pyetja, se në çfarë mase dialogu me qasjen e dykuptimësisë kreative, do të sigurojë rezultate pozitive në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë apo ka disa aspekte ku dykuptimësia e tillë shpjen në keqkuptime dhe në minim të besimit?

Studiuesit, Papadimitriou dhe Petrov (2012: 746–763) potencojnë se “dykuptimësia kreative” e BE-së dhe qasja e saj “neutrale ndaj statusit”, ishte e rëndësishme vetëm në thyerjen e pengesës në vitin 2011. Megjithatë, ata gjejnë se “dykuptimësitë, i kanë edhe efektet e veta anësore”. Poashtu, Florian Bieber (2015: 280–295), thekson se “derisa dykuptimësitë kanë dhënë disa rezultate, ato gjithashtu përmbajnë edhe rreziqe, pasi lënë hapësirë për interpretime divergjente dhe konfliktuale nga palët”.

4.7.1. Praktikrat dhe implikimet e ambigualitetit apo të dykuptimësisë kreative

Dialogu, këtu, kuptohet si një mjet për pajtimin e logjikës institucionale konkurruese të sipërpërmendur. I nisur në vitin 2011, mund të konceptohet si një mekanizëm i BE-së për menaxhimin e konflikteve. Dialogu, synon të iniciojë dhe të nxisë bashkëpunimin mes Kosovës dhe Serbisë, të ndihmojë të dyja vendet të arrijnë përparim në procesin e integritimit në BE, si dhe të ketë efekt domethënës dhe praktik në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë dhe Serbi (CFSP, 2015). Në përkufizimin dhe filozofinë e tij mbi Dialogun, Robert Cooper thekson:

“Mandati i BE-së në procesin e dialogut, mes Kosovës dhe Serbisë, bazohet në ‘bashkëpunimin’ ... për të përmirësuar jetën e qytetarëve të zakonshëm dhe se kjo reflekton atë që njerëzit ndonjëherë e quajnë ‘mënyra evropiane’, duke kërkuar paqen përmes bashkëpunimit praktik, dhe jo përmes një retorike boshe mbi vëllazërinë e njerëzimit” (Cooper, 2015).

Procesi i dialogut është ngulitur në kontekstin e integritit evropian, pasi që Kosova dhe Serbia e konsiderojnë pranimin në BE, si qëllimin kryesor të politikës së tyre të jashtme. Një qasje e tillë e vendos BE-në në një pozitë më të fuqishme, për të ndërmjetësuar në dialog, kryesisht për shkak të levave që ka ndaj palëve (Schimmelfennig dhe Sedelmeier, 2004: 661–679). Por, Bergmann dhe Niemann argumentojnë se sukcesi i BE-së, nuk bazohet vetëm në levat e saj ndaj palëve, por edhe në një strategji “manipulimi dhe formulimi” që buron nga ato leva.

Përkundër të qenit një “objektiv i lëvizshëm”, tanimë ekzistojnë disa vlerësime paraprake akademike, që kanë tentuar të kuptojnë atë, që BE-ja është duke bërë në përpjekjet e saja, për të qetësuar dhe “normalizuar” marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Që BE-ja të paraqesë marrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë në një dokument të vetëm, kjo do të thoshte se duhej vendosur ambigualitetin apo “dykuptimësinë kreative” në gjuhën e saj (Ernst, 2014: 122–126). Përveç kësaj, dykuptimësitë i kanë shërbyer BE-së për të fuqizuar pozitën e saj ndaj palëve. Praktika ka dëshmuar se, edhe pse marrëveshja e vitit 2013, supozon që sistemi ligjor i Kosovës është suprem në territorin e saj, këmbëngulja e Serbisë për karakterin e “statusit neutral” të marrëveshjeve është bërë barrierë e pakalueshme për zbatimin e dispozitave të saja dhe të marrëveshjeve të tjera pasuese. Po ashtu, edhe qasja e BE-së “neutrale ndaj statusit”, është bërë një pengesë e madhe për Kosovën, në rrugën e saj drejt integritit në BE.

Mbi atë se çfarë është diskutuar gjatë bisedimeve, për publikun janë lëshuar vetëm kumtesa dhe informacione të kufizuara. Bisedimet janë të ngarkuara me sekrete dhe zakonisht mbahen në rrethin e ngushtë të zyrtarëve të lartë të BE-së dhe Kryeministrave ose ministrave të Kosovës dhe të Serbisë, përgjegjës për dialogun. Madje, edhe komentet e zyrtarëve të BE-së, për pyetjet pasuese, janë lakonike dhe për nga natyra janë dykuptimëshe. Një interpretim të rezultatit të bisedimeve, BE-ja rrallë e lë për palë të tjera, në këtë rast, autoriteteve të Kosovës

dhe të Serbisë. Cooper e pranon faktin se në të vërtetë ekziston një element i dykuptimësisë, i cili përfshihet në tërë procesin dhe i cili krijon fleksibilitet dhe lë hapësirë për të manovruar në të ardhmen, sidomos kur palët nuk mund të arrijnë cakun (BalkanInsigh, 2015).

Marko Prelec (2013), në studimin e tij “Marrëveshja Kosovë-Serbi: Përse më pak është më shumë”, gjithashtu e pranon ambigualitetin në këtë proces duke e definuar strategjinë negociatore të BE-së si “stili i Shtëpisë së Brukselit: për të detyruar palët të hyjnë publikisht në një marrëveshje, përmbajtja e së cilës do të plotësohet më vonë, zakonisht nga zyrtarë të BE-së...”. Zyrtarët e KE, përgjegjës për menaxhimin e marrëdhënieve me Kosovën dhe Serbinë, nuk e ndajnë domosdoshmërisht këtë interpretim, por këmbëngulin se procesi i normalizimit nuk ka kërkesa specifike të vendosur nga BE-ja dhe se palëve u lejohej të vendosin kriteret e tyre mbi atë çfarë konsiderohet si një situatë e normalizuar (Bátora, 2016). Ndonëse, dykuptimësia lejon progresin në çështje të vështira, ajo gjithashtu i ka edhe kostot e veta, kryesisht nëse në plotni i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të dakorduara. Natyra dykuptimëshe e procesit të dialogut, gjithashtu, manifestohet edhe në mohimin e qëndrimeve se kush në fakt përfiton prej saj. Në një sondazh Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) arriti të përcaktojë se,

“rreth 73% e qytetarëve nga komuniteti shqiptar vlerësojnë se elementi kryesor për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është kërkimfalja për krimet e luftës nga Serbia. Rreth 60% e qytetarëve të komunitetit serb të Kosovës e interpretojnë normalizimin, duke mos i ndërhyrë njëri-tjetrit në rrugën evropiane apo anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, pa pasur nevojë që shtetet ta njohin njëra-tjetrën” (KDI, 2017).

Si pasojë e perceptimeve të tilla të kundërta publike, përfaqësuesit politikë në të dyja anët e dialogut, marrin goditje të rënda politike nga palët politike në opozitë, në sferat e tyre përkatëse politike dhe akuzohen për lëshimet dhe koncesionet e bëra (Navrátil, 2017). Përgjegjshmëria është diçka që edhe Cooper (2015) e pranon të jetë një detyrim, sepse kur gjërat shkojnë keq, kryeministrat janë ata që marrin fajin, “derisa në të vërtetë janë ata që e meritojnë tërë kredinë”. Në përgjithësi, dinamika e politikës së brendshme ka ndikim në

zhvillimin e dialogut. Ciklet zgjedhore dhe periudhat e gjata të tranzicionit paszgjedhor, në të dyja anët, ndërhyjnë në proces dhe zakonisht pengojnë çdo përparim (Navrátil dhe Bátora, 2017). Në situata të tilla, është e dobishme kur të negociohen pako të veçanta të marrëveshjeve nga BE-ja. Në gusht të vitit 2015, Marrëveshja e Brukselit u rigjallërua përmes Pakos së Marrëveshjes së Brukselit, e cila përfshinte Marrëveshjen për Telekomunikacionin, ku palët u pajtuan që Kosova të ketë një kod të vetëm telefonik (Sertolli, 2016). Pakoja, përfshinte edhe Marrëveshjen për energjinë, normalizimin e marrëdhënieve në rajonin e Mitrovicës, themelimin e Asociacionit, rihapjen e urës së Mitrovicës, si dhe vazhdimin e shpërbërjes së strukturave udhëheqëse paralele.

Ajo çfarë është e rëndësishme për argumentin tonë të propozuar është, mënyra se si është interpretuar ajo nga palët e pranishme. Para së gjithash, të gjitha palët e përfshira në dialog, madje edhe BE-ja, pretendonin mbi suksesin. Përfaqësuesja e Lartë Mogherini marrëveshjen e quante një “pikë referimi i arritjeve”, duke pranuar në mënyrë implicite rolin e domosdoshëm të cilin BE-ja e luante në dialog (Phillips, 2017). Menjëherë pas arritjes së marrëveshjes, Kryeministri serb Vuçiç, kishte deklaruar se,

“marrëveshja është e mirë për popullatën serbe në Kosovë. Krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe, do të vendosë mbi katër çështje... duke filluar që nga shëndetësia, arsimit, planifikimi urban dhe rural dhe zhvillimi ekonomik, e deri tek financimet nga Serbia. Serbia ka të drejtë të financojë atë, pa taksa dhe tarifa” (BalkanInsight, 2015).

Nga ana tjetër, deklaratat e Thaçit, në cilësinë e Ministrit të Jashtëm të Kosovës, u përqendruan në faktin se,

“duke qëndruar në tryezën e negociatave ballpërballë me përfaqësuesin e shqiptarëve të Kosovës, udhëheqësi serb në fakt e njohu Kosovën, si një partner të barabartë, dhe Serbia, në një farë forme, e njohu Kosovën, si një shtet të pavarur” (BBC, 2015).

Shumë detaje të marrëveshjes nuk u publikuan asnjëherë nga asnjëra palë, gjë që vetëm prodhuan spekulime se për çfarë në të vërtetë janë dakorduar, duke ndikuar në rritjen e dykuptimisë së tërë procesit. Raportet zyrtare mbi ecurinë e zbatimit të dialogut të nxjerra

nga të dyja qeveritë, rrjedhimisht rezultuan me interpretime kontradiktore. Situatat e tilla, mund të shpiejnë në devijimin e procesit të normalizimit. Kjo u bë e qartë në vitin 2017, kur u zvarrit puna mbi disa hapa të rëndësishëm të miratuar në kuadër të dialogut. Një shembull konkret është Ura Kryesore në Mitrovicë, e cila duhej të ishte hapur për qarkullim trafiku në vitin 2016, por për shkak të rritjes së tensioneve në nivelin lokal dhe problemeve të ndryshme teknike, ura edhe sot, në vitin 2020, ende nuk është hapur (Bátora et al., 2017).

Gjatë vitit 2017, dialogu pothuajse u ndal në nivelin politik, pasi që nuk kishte takime të nivelit të lartë në periudhën janar-tetor 2017. Takimet në nivelin teknik u organizuan si ngjarje të veçanta në Kosovë dhe në Serbi, ku zyrtarët e BE-së, do të takoheshin me të dyja palët veç e veç. Raportet e Qeverisë së Serbisë mbi mungesën e përparimit, që prej nëntorit të vitit 2017, shërbejnë më së miri për të kuptuar për së afërmi dykuptimësinë e tërë këtij procesi dialogues.

Siç është tashmë e qartë, se qasja e hapur dhe e ambigualitetit të BE-së ndaj procesit të dialogut, u lejon palëve të zhvendosin fajin tek njëri-tjetri. Qeveria e Kosovës bën deklarata të ngjashme, lidhur me atë se, kush duhet të fajësohet për stagnimin e procesit të dialogut. Raporti i fundit mbi progresin e dialogut, rendit arsyt përse janë “marrëveshjet e bllokuara apo të ndërprera nga Serbia” të pasuara nga një përmbledhje e shkurtër e arsyeve se përse ato janë “të vonuara” nga ana e Kosovës. Sipas qeverisë së Kosovës, qëndrimi konformues i serbëve dhe provokimet e vazhdueshme janë arsyt përse zbatimi i marrëveshjes është ende në pritje.

Emëruesi i përbashkët i këtyre vlerësimeve është se dialogu është dëmtuar nga dykuptimësitë, qoftë në substancën e asaj që është arritur, qoftë si proces në tërësi. Kjo ka vënë në pikëpyetje si qëndrueshmërinë ashtu edhe vazhdimësinë e procesit.

4.7.2. Koncepti i rikontekstualizimit në BE

Konceptin e rikontestualizimit e zhvilluan Theo Van Leeuwen dhe Ruth Wodak. Ata argumentuan se çdo përfaqësim gjithmonë përfshin rikontestualizimin, pasi aktorët nuk përfaqësojnë pjesëmarrësit, proceset dhe mjediset duke dhënë një shpjegim të qartë të ngjarjeve, një proces që përmban fshirje, zëvendësime dhe shtesa. Përmes konceptit të rikontestualizimit, kuptimet ndryshojnë në pikën ku “diçka qëndron për diçka tjetër”:

“Zëvendësimi është transformimi më themelor i praktikës që mund të ndodhë përmes diskursit. Gjatë përfaqësimit, elementët e praktikës zëvendësohen me shenja ku kuptimet ndryshojnë deri në atë masë sa “diçka qëndron për diçka tjetër”. Natyra komplekse lidhur me aktorë, veprime dhe praktika zëvendësohet me përgjithësime ose abstraksione dhe anasjelltas. Kur ndodh një zëvendësim i tillë, shtohen kuptime të reja” (Leeuwen, 2008: 17-118)

Zëvendësime të tilla përdoren edhe nga ana e BE-së, “sipas parazgjedhjes”, në komunikatat mbi dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Zëvendësimi i parë është i dukshëm në emrin e vetë dialogut dhe është mjaft drastik. Në vend që ta quante atë një dialog mes Kosovës dhe Serbisë, BE-ja ka përzgjedhur të redukojë emrin në një dialog mes Beogradit dhe Prishtinës. Ky zëvendësim për ta quajtur një proces politik mes dy shteteve me emrat e kryeqyteteve të tyre përkatëse, tregon pozicionimin neutral të BE-së ndaj statusit të Kosovës. Ky neutralitet ndërtohet edhe më tej duke i aranzhuar emrat e kryeqyteteve sipas renditjes alfabetike, me qëllim të shmangies së çdo lloj perceptimi të anshmërisë. Ajo që zëvendësohet në mënyrë diskursive është “shtetësia” e të dyja palëve, edhe pse kontestuese është vetëm shtetësia e Kosovës. Në diskursin e BE-së, Beogradi dhe Prishtina janë vetëm “palë”, funksioni i të cilave reduktohet në “normalizimin e marrëdhënieve” me njëri tjetrin (Bieber, 2015: 285-319). Ajo çfarë është e qartë në këtë formë zëvendësimi, është sfondi dhe madje edhe reduktimi i shtetësisë për të dyja palët, ku si Kosova ashtu edhe Serbia nuk shfaqen si agjentë shtetërorë. Sovraniteti i tyre, qoftë i diskutueshëm ose i zhvilluar plotësisht, është i evituar.

Megjithatë, ajo që është në këtë rast në plan të parë, është aspirata e tyre për t'u bashkuar me BE-në, duke qenë pjesë e këtij dialogu, pavarësisht se në të dyja rastet, aspiratat për anëtarësim në BE, janë shumë të ndryshme dhe të fragmentuara. Për dallim nga Serbia, një nga arsyet përse Kosova kërkon integrimin në BE, është për të vërtetuar shtetësinë e saj. Ndryshe nga Kosova, e cila ka mbështetje të madhe politike dhe sociale për anëtarësim në BE, opinioni publik në Serbi tregon shumë më pak ndjenja pozitive për BE-në dhe elitat e saj politike janë të fragmentuara në krahasim me rrugëtimin e Serbisë drejt BE-së. Ajo çfarë insistohet të prezantohet këtu është, nga njëra anë, barazia kinse e Beogradit dhe e Prishtinës, si kryeqytete dhe palë, dhe nga ana tjetër, prezantimi i tyre si kohezive dhe lineare në kërkimin e tyre për anëtarësim në BE. Kjo performancë diskursive është problematike kryesisht sepse simulon premisën se nuk bëhet fjalë për agjenci shtetërore, ose mungesa e asaj që është e rëndësishme në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, edhe kur këto mosmarrëveshje në thelb janë mosmarrëveshje ndërshtetërore (European Western Balkans, 2016).

Sidoqoftë, “dykuptimësia kreative”, edhe pse është ofruar si një politikë e krijuar qëllimisht për të mundësuar stabilizimin e situatës brenda Kosovës, ajo njëkohësisht ka nxitur mosmarrëveshje mes Shteteve Anëtare të BE-së mbi çështjen e statusit të Kosovës, gjë që nuk ka shërbyer në të mirë të Kosovës. Nga njëra anë, ajo nuk i ka bërë trysni Shteteve Anëtare të BE-së, që të dalin me një qëndrim të unifikuar mbi Kosovën dhe, nga ana tjetër, nuk ka bërë trysni as tek udhëheqësitë në Serbi, që të adresojnë çështjen e vështirë të pavarësisë së Kosovës dhe as tek liderët në Kosovë, për të trajtuar frustrimet e mosnjohjes dhe forcave nacionaliste që janë kundër një dialogu të tillë të Brukselit. Disa studiues argumentojnë se kjo qasje ka çuar në politizimin e çështjeve, që BE-ja i ka definuar si teknike (Troncotă, 2016). Thënë më konkretisht, edhe gjatë vazhdimit të “Dialogut të Brukselit”, marrëdhëniet mes

Kosovës dhe Serbisë asnjëherë nuk kanë qenë stabile, por janë luhatur dhe në vazhdimësi kanë qenë dhe akoma janë të tensionuara. (Emini dhe Stakić, 2018).

4.8. Qasja neutrale e Bashkimit Evropian ndaj statusit

Dialog mes dy shteteve të pavarura dhe sovrane. Kështu do të donte Kosova dhe vendet që e kanë njohur shtetësinë e saj ta shohin dialogun. Por, “BE-ja nuk e sheh si të tillë, sepse janë 5 Shtetet e saja Anëtare që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, prandaj Kosova nuk mund të trajtohet si shtet nga BE-ja” (Palokaj, 19 Mars 2011).

Statusi i Kosovës u zgjodh me shpalljen e njëanshme të pavarësisë, bazuar në miratimin e pashprehur të SHBA-ve dhe Shteteve kryesore Anëtare të BE-së. Shpallja e pavarësisë së Kosovës përçau BE-në dhe NATO-n. Shumica e Shteteve Anëtare e kanë pranuar propozimin e të dërguarit të posaçëm të OKB-së, Martti Ahtisaari, që të njihet Pavarësia e Kosovës, si alternativa më e mirë. Një pakicë e Shteteve Anëtare të BE-së dhe NATO-s, nuk e njohën pavarësinë e Kosovës, më saktësisht, Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Bazuar në këtë, BE-ja dhe institucionet e saja, në dialogun Kosovë-Serbi, mbajnë pozitë neutrale karshi statusit të Kosovës. Studiuesi Wolfgang Koeth (2010: 127–247), potencon se “BE-ja ka një marrëdhënie të vështirë me Kosovën, pasi që Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, rezultoi në një ndarje të thellë brenda vetë BE-së. Autori në vazhdim precizon se “kjo ndarje ndodhi kryesisht për shkak të faktit se 5 Shtetet Anëtare të BE-së, nuk e njohën pavarësinë e Kosovës nga Serbia”, duke konstatuar se “mosnjohjet nga këto Shtete Anëtare ndikojnë që BE-ja të ketë një status neutral ndaj shtetësisë së Kosovës”.

Derisa, Ker-Lindsay me një analizë unike dhe domethënëse të rasteve të Shteteve Anëtare, mosnjohëse të BE-së, merr në konsideratë njohjet, por duke mos i injoruar edhe marrëdhëniet dhe sidomos angazhimet që ato shtete i kanë me shtetin e Kosovës:

“Shumica e Shteteve Anëtare të BE-së e kanë njohur Kosovën dhe kanë pasur marrëdhënie të rëndësishme me të, dhe ka Shtete Anëtare që refuzojnë të njohin Kosovën (Spanja dhe Qiproja) dhe të mos kenë fare kontakte me të”, megjithatë edhe mes këtyre dy poleve

qëndrojnë edhe dy ndarje të tjera, të Shteteve Anëtare që refuzojnë të njohin Kosovën (Greqia, Rumania dhe Sllovakia), por që vendosën marrëdhënie relativisht të mira me të dhe të Shteteve Anëtare (Republika Çeke dhe Polonia), të cilat edhe pse e njohën Kosovën, në të vërtetë kanë relativisht pak ndërveprime diplomatike me autoritetet e Kosovës". Në vend të dy kampeve të ndryshme, tani kemi katër grupime të gjera Shtetesh Anëtare. Kjo tregon se edhe brenda këtyre grupimeve - të cilat edhe mund t'i quajmë: "njohëse dhe angazhuese", "njohëse, por jo angazhuese", "jo njohëse, por angazhuese", dhe "jo njohëse dhe jo angazhuese"- ka ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si ato sillen" (Ker-Lindsay, 2012: 2-186).

Ndërkohë, studiuesi Tomash Dopita (2016), në hulumtimet mbi arsyet për ndryshime në pozicione ndaj Kosovës, arrin të argumentojë se ato janë komplekse dhe ndryshojnë nga njëri Shtet Anëtarë tek tjetri dhe se, "në të shumtën e rasteve, ndryshimet në pozicione të Shteteve Anëtare të BE-së, pasqyrojnë ndryshimet e brendshme politike, por ato mund të jenë të nxitura edhe nga shqetësimet e politikës së jashtme". Duke vepruar kështu, dalin në pah dy pika të rëndësishme dhe të ngjashme. Së pari, njohja, megjithëse e rëndësishme, nuk është e tëra, sepse po ashtu edhe angazhimi ka rëndësinë e vet. Nëse shtrohet pyetja: Çfarë është më e rëndësishme dhe më dobiprurëse, një vend që e njeh Kosovën, por pastaj ka pak të bëjë me të, ose një vend që nuk e njeh atë, por mban marrëdhënie aktive ekonomike dhe politike? Shumë shpesh theksi është në të parën, në vend se në të dytën. Për të qenë të sigurtë, tek studiuesi Iser (2015) hasim në argumentin se "njohja është e rëndësishme, por vlera e saj duhet të vihet në kontekstin e duhur". Së dyti, vendi i Kosovës në botë është shumë më shumë sesa numrat në OKB, veçanërisht pasi vetoja e vazhdueshme e Rusisë apo edhe e Kinës ka gjasa ta mbajnë Kosovën jashtë OKB-së për një kohë të gjatë. Ndërkohë, që Kosova medoemos duhet të ketë bashkëpunim domethënës me faktorë relevantë në bashkësinë ndërkombëtare.

Për qytetarët e zakonshëm, besojmë se shumë më të rëndësishme dhe më domethënëse, janë investimet e një kompanie të suksesshme, nga një shtet që nuk e njeh Kosovën, sesa shtimi eventual i numrit të njohjeve.

Megjithatë, studiuesit Lindemann dhe Ringmar (2012: 25-38) në hulumtimin e tyre mbi lëvizjen e pozicionimeve të shteteve theksojnë se "pozicionimet e shteteve nuk janë të

palëvizshme, pozicionimi i marrë sot, nuk do të thotë se do të jetë pozicionimi që ai shtet e miraton edhe në të ardhmen”.

Në përpjekjet që të lëvizë Shtetet mosnjohëse Anëtare të BE-së, nga mosnjohja në njohje, Kosova në të njëjtën kohë do të duhej të shikonte mundësitë se si do t’mund t’i inkurajonte ato drejt një angazhimi më të madh. Në disa raste, ka të bëjë me përpjekjen për të inkurajuar ato shtete që të rinovojnë angazhimin e tyre, ose edhe ta intensifikojnë atë. BE-ja i ka ofruar Kosovës perspektiva evropiane, por hulumtuesi Miruna Troncota (2016) potencon se, “perspektiva evropiane mbetet deklarative derisa nuk bëhen hapa konkret në lëvizjet praktike drejt proceseve integruese dhe të njohjes së Kosovës nga shtetet mosnjohëse”. Derisa Bergmann dhe Niemann, potencojnë domosdoshmërinë e ndryshimit dhe të modifikimit të qëndrimit neutral të BE-së:

“Në fillimin e dialogut, edhe pse neutrale, BE-ja e ka luajtur një rol më të fuqishëm formulues në negociata...Megjithatë, nëse BE-ja edhe më tutje vazhdon me neutralitetin e saj në dialog, ky qëndrim nuk do t’i kontribuonte zhvillimeve pozitive, si në Kosovë ashtu edhe më gjerë, në BP. Trajtimi i Kosovës nga një pozitë neutraliteti nuk është treguar i suksesshëm as për vetë BE-në” (Bergmann dhe Niemann, 2015: 967-968).

Dështimi i BE-së që të flas me një zë, sipas njohësve të çështjes, bëri që në kohën kur tenton të bëhet një fuqi politike edhe në skenën globale, “dëshmia se BE-ja nuk është në gjendje të flasë me një zë as për një çështje evropiane, siç është Kosova, ndikon që të mos merret seriozisht as në disa çështje të tjera” (Palokaj, 15 Maj 2019).

Mosnjohjen nga 5 Shtetet Anëtare të BE-së, Christopher Hill e arsyeton duke e ndërlidhur me çështjet e tyre të brendshme: “më vjen keq që në vitin 2019 ende janë 5 Shtete Anëtare të BE-së, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. I kuptoj arsyet, sepse secila e ka Kosovën e vet” (Intervista H).

Megjithatë, pavarësisht çështjeve të tyre të brendshme, duke mos e njohur pavarësinë e Kosovës, këto shtete veprojnë në kundërshtim edhe me frymën dhe qëllimet e vetë BE-së. Kjo politikë e tyre mund të konsiderohet si politikë diskriminuese, nga arsyeja se shtetësia e

Kosovës është një fakt i pamohueshëm, e cila medoemos do të duhej respektuar, pos tjerash edhe nga arsyeja se shteti i Kosovës është dëshmuar si garantues i paqes dhe stabilitetit në BP. Mendojmë se, mosnjohja e pavarësisë së Kosovës, nuk i ndihmon as proceseve të demokratizimit dhe as proceseve të përgatitjes së BP, për të qenë pjesë përbërëse e BE-së.

4.9. Strategjitë ndërmjetësuese të BE-së

Një analizë empirike në mes të strategjisë ndërmjetësuese të BE-së dhe OKB-së, rezulton me faktin se të dyja ekipet ndërmjetësuese, kishin aplikuar taktikat e formulimit, të tilla si strukturimi i procesit të ndërmjetësimit dhe vendosja e propozimeve të ndryshme për zgjidhje kompromisi në tryezën negociuese. Pavarësisht nga kjo ngjashmëri, hasen edhe disa dallime kyçe në mes të qasjeve ndërmjetësuese të BE-së dhe OKB-së në konfliktin Kosovë-Serbi. Së pari, pasi që ndërmjetësuesi i OKB-së, Ahtisaari, zgjodhi një qasje të orientuar drejt rezultatit. Ai në shtator të vitit 2012 kishte deklaruar se nuk ndjehet fajtorë që serbët e kanë humbur Kosovën (Intervista X). Ahtisaari u përpoq të ushtronte presion mbi Serbinë në një përfundim të paracaktuar “dhe në vend që të krijonte besimin ose ofrimin e të dyja palëve në një kompromis, të gjitha përpjekjet e tij i kishte përqendruar në shtrëngimin e Serbisë drejt një rezultati të paracaktuar” (Fridl 2009: 81; Ker-Lindsay 2010, 2011). Në analizën e tij të negociatave mbi statusin e Kosovës, Ker-Lindsay konkludon:

“Pasi u emërua, Ahtisaari nuk bëri pothuajse asnjë përpjekje për të fshehur faktin që ai besonte se pavarësia ishte rezultati i vetëm i procesit (...) Në këtë kuptim, Ahtisaari ishte më pak ndërmjetësues dhe më shumë si një arbitër. Ai nuk kërkoi kompromis mes palëve mbi çështjen e statusit, duke besuar se kjo nuk ishte e mundur, por në vend të kësaj, kërkoi të përdorte bisedimet si një mjet për të hartuar propozime për një Kosovë multietnike dhe të pavarur” (Ker-Lindsay 2009: 110 -111).

Për dallim nga qasja ndërmjetësuese e OKB-së, strategjia ndërmjetësuese e BE-së, ishte shumë më e fokusuar në procese, pa paracaktuar se si do të përfundonte dialogu Kosovë-Serbi (Bieber, 2015: 315-316). Në fakt, institucionet e BE-së deklarorin se objektivi kryesor i dialogut ishte “normalizimi i marrëdhënieve” mes Kosovës dhe Serbisë, por e linin të hapur

nëse kjo në fund do të nënkuptonte njohjen e pavarësisë së shtetit Kosovës nga ana e shtetit të Serbisë (Bergmann dhe Niemann, 2015: 965–966).

Së dyti, orientimi i BE-së drejt proceseve dhe stili më gjithëpërfshirës ndërmjetësues, në krahasim me qasjen e OKB-së, i mundësoi BE-së të pozicionohet si një “ndërmjetësues i dëshiruar” dhe i paanshëm mes palëve. Paradoksalisht, ndarja e brendshme e BE-së në mes të 23 Shteteve Anëtare njohëse dhe 5 mosnjohëse, të pavarësisë së Kosovës, i siguroi një kredibilitet shtesë paanësisë së BE-së, lidhur me çështjen e statusit, si çështje kyçe e konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë (Bergmann, 2017). Në krahasim me këtë qasje, qëndrimi i ndërmjetësuesit të OKB-së mbi çështjen e statusit kishte ndikuar tek pala serbe që të ulë nivelin e besueshmërisë në të. Ahtisaari, nga pala serbe, ishte perceptuar si një kundërshtar dhe jo si një ndërmjetësues i paanshëm (Fridl, 2009: 82; Ker-Lindsay, 2010: 58). Së treti, BE-ja ishte në gjendje të inkurajonte palët në drejtim të marrëveshjes së kompromisit, ndërkohë që ekipi i ndërmjetësimit të OKB-së nuk ishte në gjendje të përdorte çfarëdo lloji të levave. Në vend të kësaj, ekipi i Ahtisaarit ishte i varur nga aktorë të jashtëm, siç janë anëtarët e Grupit të Kontaktit, për të ushtruar presion shtesë ndaj palëve ose për të ofruar stimuj shtesë për kompromis. Një strategji e tillë ndërmjetësuese ishte e destinuar të dështonte, sepse pa përdorimin e levave, nuk kishte nxitje për të dyja palët për të ndryshuar qëndrimet e tyre, veçanërisht për delegacionin serb. Megjithatë, as shtetet perëndimore dhe as Rusia nuk ishin të gatshme të mbështetnin ekipin e ndërmjetësimit në aspektin e levave, por ky ekip “më tepër e luajti rolin e një avokati mbrojtës të njërit nga palët” (Perritt, 2011: 127-130).

Duke marrë parasysh strategjinë e lartpërmendur ndërmjetësuese, BE-ja, i ka përmbushur aspektet teorike, kur ka vepruar si ndërmjetësues mes palëve në konflikt. BE-ja, ka zbatuar aktivitete që janë në përputhje me kornizën teorike të proceseve të suksesshme të ndërmjetësimit, sepse mban virtytet e një ndërmjetësuesi të suksesshëm, e cila përmes levave

që i posedon, ka një ndikim të konsiderueshëm në të dyja anët dhe është në gjendje të përfshijë palët në masën që ato i pranojnë kushtet e zgjidhjes dhe gjithashtu të jenë të përfshira në aktivitete të mëtejme të pajtimit. BE-ja, jo vetëm që është në gjendje të ofrojë një zgjidhje të pranueshme për palët, por besohet se ajo tashmë ka aftësinë për të negociuar dhe ofruar mundësi të ardhshme integruese, të cilat mendohet se do të jenë tërheqëse, si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë.

Në kontrast të plotë me rastin e ndërmjetësimit të OKB-së, strategjia e ndërmjetësimit të BE-së ngërthen në vete elemente të manipulimit në formën e nxitjeve pozitive për marrëveshje. Për shkak të aspiratave të fuqishme të palëve për anëtarësim, BE-ja ka një shkallë të lartë “të fuqisë” apo të levave përballë palëve. Në këtë kuptim, një kushtëzim shtesë ndaj Serbisë është zbatuar nga disa Shtete Anëtare. Siç theksojnë Economides dhe Ker-Lindsay, “veçanërisht Gjermania kërcënoi të bllokonte pranimin e Serbisë, nëse nuk do të kishte progres në dialog dhe në zbatimin e marrëveshjeve të arritura” (Economides dhe Ker-Lindsay, 2015: 1036). Këto taktika janë tipare tipike të një stili manipulues të ndërmjetësimit.

Në të njëjtën kohë, strategjia e ndërmjetësimit të BE-së mund të jetë efektive, vetëm nëse palët janë të gatshme për kompromis dhe të sigurojnë një terren të frytshëm për marrëveshjet e negociuara. Me fjalë të tjera, duhet të pranohet se një faktor tjetër i favorshëm ishte edhe interesi i përbashkët i të dyja palëve në përmirësimin e situatës së status quo-së në Kosovën Veriore, si dhe ecja përpara në rrugën drejt anëtarësimit në BE (Bieber, 2015: 312).

Qëllimet kryesore të Qeverisë së Kosovës, ishin vendosja e Pjesës Veriore nën kontrollin formal të Kosovës, sigurimi i integritetit të saj në kornizën ligjore dhe politike të Kosovës, si dhe përshpejtimi i procesit të integritetit në BE, dhe me këtë, arritja e njohjes nga 5 Shtetet Anëtare mosnjohëse. Përsa i përket palës serbe, “qeveria ishte e gatshme të bënte lëshime në procesin e dialogut, kryesisht për shkak të motiveve ekonomike, duke pasur parasysh se BE-ja

në Serbi shihet si një nxitëse kryesore e rritjes ekonomike nacionale”. Përveç kësaj, “zyrtarët e palës serbe duket që e kanë kuptuar se normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën, është çelësi për të ecur përpara drejt anëtarësimit në BE” (Economides dhe Ker-Lindsay, 2015: 1036-1039).

Megjithatë, gatishmëria e palëve për kompromise i ka edhe kufijtë e saj. Të gjitha kompromiset kanë qenë në zonën e marrëveshjes jashtë “vijave të kuqe”, të vendosura nga palët në konflikt - refuzimi i fuqishëm i pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe këmbëngulja e Kosovës për pavarësinë dhe integritetin territorial të saj, si dhe parimin që çdo marrëveshje duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe me Planin e Ahtisaarit për Zgjidhjen Gjithëpërfshirëse (Kuvendi i Kosovës, 2011: 1). Përderisa Serbia e ka modifikuar qasjen e saj drejt qeverisjes së Pjesës Veriore, mosnjohja mbetet një vijë e kuqe e fuqishme në bisedimet me Kosovën. Sipas disa vëzhguesve, me kalimin e kohës, kundërshtimi ndaj njohjes, madje është ngurtësuar (Grupi i Krizave, 2013: 10). Përpjekjet ndërmjetësuese të BE-së në dialogun Kosovë-Serbi, që nga viti 2011, nuk kanë kontribuar që të sjellin normalizim të plotë të marrëdhënieve në mes të dyja shteteve, por çuan vetëm në suksese të pjesshme, të shquara sidomos në tre vitet e para. Megjithatë, edhe pse ende nuk ka arritur në nivelin që të ndërmjetësojë një marrëveshje gjithëpërfshirëse mbi të gjitha çështjet e të dyja palëve, prapseprap mund të thuhet se përpjekja ndërmjetësuese e BE-së mundësoi një sërë marrëveshjesh mes palëve, të cilat edhe pse me shumë vonesa dhe me mospëfillje në zbatimin e tyre, vështirë se do të arriheshin pak vite më parë. Provat empirike sugjerojnë se strategjitë e kombinuara të formulimit dhe manipulimit të BE-së, kanë qenë një faktor kyç në nxitjen e palëve ndaj marrëveshjeve, duke shfrytëzuar gatishmërinë e tyre për të bërë kompromise, të bazuara në përfitimet e pritshme për anëtarësimin e ardhshëm në BE. Në të njëjtën kohë, zbatimi i mbetur i marrëveshjeve ka rezultuar me një stagnim domethënës të procesit të

ndërmjetësim, sidomos në vitet e fundit, gjë që rrezikon sukseset fillestare si dhe vetë procesin e dialogut. Me fjalë të tjera, strategjitë e BE-së për ndërmjetësim, të bazuara në përdorimin e levave, kanë qenë të domosdoshme për arritjen e marrëveshjeve mes palëve mbi një sërë çështjesh që ishin të pamundura për t'u arritur në bisedimet për statusin e Kosovës në vitet 2006/7, edhe pse ato nuk çuan në një transformim të madh në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë (Economides dhe Ker-Lindsay, 2015: 1038).

Përsa i përket ndikimit të strategjive ndërmjetësuese në efektivitetin e ndërmjetësim, vërehet se shkalla e lartë e kontrollit mbi procesin ndërmjetësues, të ushtruar nga BE-ja, kishte një efekt pozitiv, në drejtim të zgjidhjes së konfliktit, por nuk ishte e mjaftueshme për të ndërmjetësuar një marrëveshje kompromisi, mbi çështjen e statusit të Kosovës, që më në fund do të zgjidhte konfliktin mes Kosovës dhe Serbisë. Kështu, Kosova dhe Serbia deri më sot mbesin të bllokuara në kontestin e tyre politik dhe diplomatik në lidhje me shtetësinë e Kosovës dhe statusin e saj ndërkombëtar.

4.10. Përfundime

Që BE-ja të paraqesë marrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë në një dokument të vetëm, kjo do të thoshte se duhej vendosur “dykuptimësinë kreative” në gjuhën e saj. Përveç kësaj, këto dykuptimësi i kanë shërbyer BE-së për të fuqizuar pozitën e saj ndaj palëve. Sipas studiuesve të çështjes, “dykuptimësia kreative” e BE-së ishte e rëndësishme vetëm në thyerjen e pengesës në vitin 2011, nga arsyeja se, dykuptimësitë, i kanë edhe efektet e veta anësore, se derisa japin disa rezultate, ato gjithashtu përmbajnë edhe rreziqe pasi lënë hapësirë për interpretime divergjente dhe konfliktuale nga palët. Sidoqoftë, “dykuptimësia kreative”, edhe pse është ofruar si një politikë e krijuar qëllimisht për të mundësuar stabilizimin e situatës brenda Kosovës, ajo njëkohësisht ka nxitur mosmarrëveshje mes Shteteve Anëtare të BE-së mbi çështjen e statusit të Kosovës, gjë që nuk i ka shërbyer për të mirë Kosovës. Poashtu, qasja e

BE-së, si “neutrale ndaj statusit”, është bërë një pengesë e madhe për Kosovën, në rrugën e saj drejt integritimit në BE.

Përsa i përket qasjes dhe strategjive ndërmjetësuese të BE-së, kemi konkluduar qartë se ato ishin në kontrast të plotë me qasjen dhe strategjitë ndërmjetësuese të OKB-së. Ndërmjetësuesi i OKB-së, Ahtisaari, zgjodhi një qasje të orientuar drejt rezultatit, duke ushtruar presion mbi Serbinë, në vend që të krijonte besimin ose ofrimin e të dyja palëve në një kompromis. Për dallim nga qasja ndërmjetësuese e OKB-së, qasja dhe strategjitë ndërmjetësuese të BE-së, janë më të fokusuar në procese, pa paracaktuar se si do të përfundojë dialogu Kosovë-Serbi. Në fakt, institucionet e BE-së kanë deklaruar se objektivi kryesor i dialogut është normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, por e kanë lënë të hapur nëse kjo në fund do të nënkuptojë njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë.

Nga literatura e shfletuar është konstatuar se shtetet janë ofruesit kryesorë dhe më të shpeshtë të ndërmjetësimit, por gjatë hulumtimit është arritur në përfundimin se edhe organizatat ndërkombëtare nuk janë shumë prapa. BE-ja, edhe pse është shfaqur si një lojtar relativisht i ri në këtë fushë, vepron si ndërmjetësues dhe si anëtar i mekanizmave kolektiv të koordinimit për të mbështetur proceset e paqes. Iniciativat aktuale, siç është studim rasti i hulumtimit, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, shpresojmë se do të demonstrojnë potencialin dhe rolin e BE-së si të një ndërmjetësuesi të suksesshëm të paqes. Po ashtu, konceptualizimi i ndërmjetësimit në BE, me futjen e Konceptit të vitit 2009, i cili merret ekskluzivisht me rolin ndërmjetësues të BE-së, në konflikte ndërkombëtare, përbën pikën kyçe referuese për aktivitetet e ndërmjetësimit, tregon aspiratën e BE-së për të rritur dhe sistematizuar kapacitetet e saja në ndërmjetësim dhe për të theksuar dhe përforcuar profilin e saj si ndërmjetësues ndërkombëtar.

Edhe pse numri i përpjekjeve ndërmjetësuese të BE-së është ende relativisht i ulët në krahasim me përfshirjen e ndërmjetësimit të OKB-së, megjithatë BE-ja ka arritur një rekord të konsiderueshëm dhe ndërmjetësimi është bërë një element gjithnjë e më i rëndësishëm i mjeteve të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë. Megjithatë, arrihet në përfundimin se krizat e jashtme dhe të brendshme mund të pengojnë BE-në, që të fuqizojë edhe më tej kapacitetet dhe burimet e saja institucionale për një ndërmjetësim të suksesshëm, të shpiejnë në një ndryshim në CFSP-në e BE-së, drejt një qasjeje më tradicionale “të sigurisë së fortë”, e cila përqendrohet në zhvillimin e instrumentave ushtarak dhe bashkëpunimin e mbrojtjes.

Kapitulli V: Procesi i zgjidhjes së konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë

Konflikti i armatosur në Kosovë ndodhi gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar. Megjithatë, Kosova ka qenë një arsye për mosmarrëveshje mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb për breza të tërë. Edhe pse kanë kaluar më shumë se dy dekada, konflikti ende është prezent. Paqartësitë lidhur me statusin ligjor të Kosovës dhe betejat lidhur me zgjidhjen e çështjes, e mbajnë konfliktin në vazhdim.

Aktualisht, Kosova është njohur zyrtarisht nga më shumë se gjysma e Shteteve Anëtare të OKB-së, ndër të cilat 23 janë edhe Shtete Anëtare të BE-së. (Kosovo Thanks You, 2013). Kjo tregon që jo vetëm komuniteti i gjerë ndërkombëtar ka mendime të ndryshme mbi statusin ligjor të Kosovës, por ka dallime edhe brenda vetë BE-së.

6.1. Konteksti historik i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë

Një vështrim historik do të ndihmonte për të kuptuar situatën aktuale në lidhje me paqëndrueshmërinë gjeopolitike në Ballkan, mosmarrëveshjet mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb dhe në kuadër të saj marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

Pas dy luftërave ballkanike, shteti shqiptar fitoi pavarësinë, ndërsa Serbia filloi sundimin e saj mbi territorin e Kosovës. Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore u karakterizuan nga ripsedimi i kontrollit mbi Kosovën nga forcat serbe/jugosllave, me tendencën të zgjasnin edhe pas përfundimit të luftërave globale (Clark, 2000: 46).

Kohët që ndoqën këto luftëra, e para që ishte koha e Mbretërisë së SKS-së dhe e dyta e Jugosllavisë Socialiste, ishin kohët e thellimit të distancave ndëretnike dhe injorancës ndaj zgjidhjes së ndonjë çështjeje madhore që ndërlidhej me Kosovën, të pasuara nga valët e dëbimeve të detyruara dhe me ndryshimet demografike drastike dhe të ringjalljes së tyre të dhunshme, në fund të shekullit XX (Herscher, 2010).

6.1.1. Paqëndrueshmëria gjeopolitike në Ballkan

Sipas studimeve të shumta mbi Ballkanin, arrihet në përfundimin se gjatë shekullit të kaluar, BP ishte vendi më i paqëndrueshëm në Kontinentin Evropian.

Megjithatë, Misha Glenny (1999: 661), në studimin e tij, flet për prezencën dhe ndërhyrjen ndërkombëtare në BP, e cila sipas tij “ka ofruar zgjidhje për disa çështje delikate, ashtu sikurse në raste të tjera, ka influencuar dhe ashpërsuar rivalitetet ndërshtetërore dhe pasojat

kanë qenë evidente”. Ai më tej pretendon se “arritjet dhe dështimet e ballkanasve nuk u përkasin vetëm atyre, por edhe Fuqive të Mëdha, për shkak të interesave e rivaliteteve ndërmjet tyre gjatë prezencës së gjatë në rajon”. Stephen Blank (1995: 115-118) konstaton se, “gjatë shekullit XX, në BP, kishte konflikte të armatosura lokale dhe luftëra të koalicioneve me ndërlikim kontinental”. Blank përmend edhe forma të ndryshme të dhunës, që i kanë trazuar, pothuajse rregullisht, periudhat e paqes në rajon, si terrorizmin, revoltat, revolucionet, grushtshtetet, dëbimet masive të popujve, gjenocidin, si dhe forma të tjera. Derisa, studiuesi Johnsen thekson:

“Pasi që i tërë rajoni, gjatë shekujve ka qenë i ndarë ndërmjet disa perandorive, kjo është njëra nga arsyet kyçe se, përse Ballkani nuk ka mundur kurrë të bëhet rajon i suksesshëm dhe koherent në kuptimin kulturor, ekonomik ose politik. Pas shpartallimit të perandorive dhe tërheqjes së tyre, Ballkani u shndërrua në një mozaik politik të komplikuar, të cilit i mungonte qendra e gravitetit” (Johnsen, 1995: 9-60).

Andrew Baruch Whachetel (2012: 18) arrin të konkludojë se “Ballkani, gjithnjë nga të huajt, është vëzhguar si një zgjua popujsh të vegjël e inatçinj, si një rajon i konflikteve të përhershme”. Ai citon kontin gjerman, Hermann Keyserling, i cili në hulumtimin e tij theksonte se “Ballkani është një rajon, fryma e të cilit është ajo e sherrit të përjetshëm”. Por, autori flet edhe mbi konfliktualitetin gjatë historisë së rajonit, në veçanti në Ballkanin Perëndimor të kohëve më të reja:

“Konfliktualiteti i përjetuar gjatë historisë së rajonit e në veçanti gjatë pjesës më të madhe të kohëve më të reja në BP, mund të kuptohet, në radhë të parë, si orvatje për të sinkronizuar kufijtë e kombit dhe të shtetit, duke shmangur heterogjenitetin në emër të fuqizimit të kombit. Nga arsyeja se asnjëra nga grupet kombëtare nuk qe aq e fuqishme sa ta realizonte këtë qëllim me forcat e veta, secili i ktheu sytë për ndihmë nga fuqitë e huaja, të cilat i kishin arsyet dhe interesat e veta që kazani ballkanik të vijonte të ziente dhe punuan edhe më shumë për ta acaruar se sa për ta qetësuar gjendjen” (Whachetel, 2012: 19).

Në kushtet dhe rrethanat e zhvillimeve të fundit në BP, Fuqitë e Mëdha, dhe përmes tyre, organizatat ndërkombëtare (NATO, KSBE/OSBE dhe OKB), aktivizuan Diplomacinë Imponuese për zgjidhjen e krizave dhe konflikteve të armatosura, duke përfshirë edhe rastin e konfliktit mes Kosovës dhe Serbisë. Diplomacia e aktivizuar Imponuese, e cila, që nga

përfundimi periudhës së Luftës së Ftohtë, paraqitet si fushë me interes studimi teorik e praktik, për rezultatet dhe efektet parandaluese, në menaxhimin e krizave, brenda shteteve ose mes shteteve (Weigall, 2002: 46).

Shpërbërja e RSF të Jugosllavisë, në vitin 1991-1992, ngriti dukshëm numrin e shteteve në BP. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte zhvillimi i fundit në këtë drejtim. Megjithëse, mundësia për ndarje të tjera politike në rajon nuk është zbehur në tërësi.

Sipas studiuesit Altmann, Franz-Lothar, “shtetet më të vogla, që kanë rezultuar nga ndarja, sot janë më pak heterogjene për sa u përket pikëpamjeve etnike, religjioze dhe kulturore, në krahasim me ish Jugosllavinë”, por sipas autorit, “nga pikëpamja ekonomike, ndryshimet dramatike, luftërat dhe zhvillimet e tjera, i kanë shkaktuar rajonit çrregullime dhe dëme të mëdha ekonomike” (Altmann, 2004: 69-84).

Derisa, Judy Batt, duke hulumtuar mbi stabilitetin social, vështirësitë ekonomike dhe shqetësimet politike në BP, shton se,

“historia e traumatizuar e rajonit ka shërbyer si një mekanizëm i fuqishëm për mobilizimin masiv të parullave nacionaliste, religjioze dhe ksenofobe”. Si rezultat i gjithë kësaj kanë ndodhur tragjeditë në Bosnje dhe në Kosovë” (Batt,2004: 7-19).

6.1.2. Çështja e Kosovës - konflikt politik mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb

Çështja e Kosovës prej shekujsh ka qenë një arsye për mosmarrëveshje dhe e raporteve të acaruar mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb. Edhe shqiptarët edhe serbët kanë pikëvështrimet e tyre kundërshtuese mbi atë se kush e ka të drejtën mbi Kosovën. Disa analistë çështjen e analizojnë si një paralelë në mes të popullit palestinez dhe shtetit hebre apo luftë ndërmjet dy popujve për një territor (Judah, 2000: 80).

Në vitin 1913, Fuqitë evropiane të kohës (Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Italia) i kishin lejuar Serbisë dhe Malit të Zi mbajtjen e pjesëve lindore të okupuara nga pronat otomane, të banuara kryesisht me shqiptarë, myslimanë, maqedonas sllavë dhe të tjerë (Kola, 2003: 10-18). Në këtë mënyrë, këto vende (Sanxhaku i Novi Pazarit, Kosova e

sotme dhe Maqedonia Perëndimore) ishin përvetësuar nga Serbia, pa ndonjë proces të duhur aneksimi. Posedimet e reja serbe, në vitet 1918-1919 kishin kaluar nën administrimin e Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene (Malcolm, 1998: 43-63), e cila më vonë u emërua si Mbretëria e Jugosllavisë.

Në mes dy luftërave botërore, çështja e Kosovës ishte një çështje politike dhe sigurie destabilizuese, e cila kontribuoi në shpërbërjen e Mbretërisë Jugosllave, në vitin 1941. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, edhe pas vitit 1945, Kosova vazhdoi të mbetet një çështje e pazgjidhur në kuadër të Jugosllavisë komuniste (Reka, 1996: 109). Në korrik të vitit 1945, statusi i Kosovës u përcaktua, kur një asamble e dominuar nga komunistët jugosllav, në kundërshtim me vullnetin e popullsisë shqiptare, votoi bindshëm për bashkimin “vullnetar” të Kosovës me Republikën e Serbisë, përbrenda RFJ-së (Bideleux, 1998). Megjithatë, në të njëjtën kohë shqiptarët iu nënshtruan mbikëqyrjes rigoroze dhe torturave të papara nga sigurimi i brendshëm i shtetit, që udhëhiqej nga Ministri i brendshëm dhe nënkryetari i Presidiumit të RFJ-së, serbi, Aleksandër Ranković. Qëllimi i regjimit ishte spastrimi etnik i Kosovës nga popullata autoktone shqiptare dhe ndryshimi i balancës në përbërjen e popullsisë, ku shqiptarët përbënin shumicën. Në këtë mënyrë, në periudhën mes viteve 1945 dhe 1966, mbi 200,000 shqiptarë, kishin emigruar, shumica prej tyre në Turqi (Bideleux, 1998).

Në teori, sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, fati i Kosovës ishte ende i përcaktuar, në fillim si një “provincë autonome” dhe më vonë, si një “krahinë autonome”, ku shqiptarët de jure trajtoheshin si të barabartë, por de facto, në praktikë, ata torturoheshin dhe dëboheshin, derisa pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse, dominoheshin nga zyrtarë serbë dhe malazias.

Me kalimin e viteve gjërat ndryshuan, një kompromis u vendos në Kushtetutën e vitit 1974 të RSF të Jugosllavisë, në të cilën Kosova kishte statusin e një Krahine Autonome Socialiste

(KSAK), në kuadër të RSFJ-së, por përbrenda shtetit të Serbisë, me një autonomi të plotë. Si e tillë, ajo ishte pothuaj e barabartë me njësitë e tjera federale, me gjashtë republikat, që e përbënin RSFJ-në. Me Kushtetutën e vitit 1974, shqiptarët e Kosovës përjetuan një ngritje domethënëse të të drejtave të tyre. Por, “këto ndryshime pozitive, në statusin dhe pozitën e popullsisë shumicë shqiptare, kishin shqetësuar nacionalistët serb, të udhëhequr nga Kisha Ortodokse Serbe” (Malcolm, 1998: 326).

Në vitin 1980 ishte një pikë kthese. Faktorët që ndikuan në ngritjen e rolit shqiptar, siç ishin arritjet në arsimin e lartë dhe ndryshimet në demografi, u bashkuan, dhe në vitin 1981, shpërthyen trazirat. Ato u shtypën me dhunë. Shqiptarët kërkonin ngritjen e statusit të Kosovës, të barabartë me gjashtë republikat e tjera të RSFJ-së, nën parrullën – “Kosova Republikë” (Bideleux, 1998).

Një grup intelektualësh nacionalistë serbë, nën ombrellën e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Artit (SANU) kishin deklaruar publikisht se “serbët po vuanin gjenocid”, gjë që rezultoi me dokumentin famëkeq, “Memorandumi SANU”(KODI, 2003: 42) ku propagandoheshin temat e vjetra të nacionalizmit dhe shovinizmit serb. Në tekstin e këtij memorandumi, të botuar në vitin 1986 dhe i përfunduar në vitin 1989, thuhet se që nga viti 1981 shqiptarët në Kosovë kishin kryer gjenocid fizik, politik, juridik dhe kulturor kundër serbëve të Kosovës (Malcolm, 1998: 340). Ky dokument përmbante gjithë hidhërimin dhe urrejtjen ndaj popullatës autoktone shqiptare. Në këtë mënyrë, kuzhinat e nacionalizmit serb, me ndihmën e SANU dhe të Kishës Ortodokse Serbe, që nga viti 1986, deri në vitin 1989, kishin përgatitur nisjen e një projekti me rregullim të ri, që do të provonin ta realizonin përmes Sllobodan Millosheviq (Beach, 2000). Komunisti Millosheviq, u kthye në një udhëheqës nacionalist dhe arriti të bëhej figura kyçe, si në Serbi ashtu edhe në RSF të Jugosllavisë (Malcolm, 1998: 341-342).

Deri në vitin 1989, sipas Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, Kosova ende gëzonte një shkallë të lartë autonomie brenda RSF të Jugosllavisë. Me ardhjen në pushtet të udhëheqësit komunist serb, Slobodan Millosheviq, nën ndikimin e SANU dhe të memorandumit propagandues nacionalshovinist serb dhe me ndihmen e Kishës Ortodokse Serbe, ky kompromis mbi autonominë e plotë të Kosovës, me forcë dhe me dhunë u ndryshua, duke e futur Kosovën nën kontrollin e drejtpërdrejt të Serbisë. Një hap i tillë ekstrem u pasua nga shuarja e plotë e autonomisë, dhe kjo u bë një nga faktorët kyç që shkaktoi ndryshime tektonike brenda RSFJ-së. E gjithë struktura administrative, e ndërtuar ndër vite, u çmontua praktikisht brenda natës. Popullata shqiptare iu ekspozua abuzimeve masive të të drejtave të njeriut dhe lirive civile. Ata ose do të duhej të nënshtroheshin dhe të nënshkruanin se ishin qytetarë lojalë ndaj shtetit serb, ose në të kundërtën ishin të detyruar të largoheshin nga vendet dhe pozitat tyre të punës. Arsimimi lejohej, por vetëm sipas sistemit dhe kurrikulave të shtetit serb. Pas revokimit të autonomisë së Kosovës, shqiptarët u angazhuan në trazira masive që rezultuan me viktima të mëdha dhe arrestime (Malcolm, 1998: 344-345). Kosova, de de jure dhe de facto, ishte shndërruar në një koloni të shtetit serb, edhe pse 90 përqind e popullsisë ishte shqiptare dhe vetëm 10 përqind e serbëve dhe të tjerëve (Wentz, 2002: 16). Ky akt brutal i njëanshëm nga Serbia, i shoqëruar nga makineria ushtarako-policore në rrugët e Kosovës, e theu tmerrësisht rregullin kushtetues të RSFJ-së.

6.1.3. Rezistenca pasive dhe konflikti i armatosur

Shqiptarët e Kosovës kundërshtnin fuqishëm masat e ndërmarra nga shteti serb. Duke miratuar një strategji të rezistencës pasive, krijuan një lëvizje gjithëpopullore paqësore të rezistencës nën drejtimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), të udhëhequr nga Dr. Ibrahim Rugova. Në ndërkohë organizuan referendum, zhvilluan një fushatë joviolente për të

fituar të drejtën për vetëvendosje dhe krijuan një shtet paralel (Beach, 2000) me shpresën se do të mbështeteshin nga bashkësia ndërkombëtare. Megjithatë, një politikë e tillë paqësore nuk u shpërblye, as nga bashkësia ndërkombëtare dhe aq më pak nga autoritetet e shtetit serb. Pavarësisht, shumë paralajmërimeve se, konflikti i vazhdueshëm mund të përshkallëzohej në një konflikt të hapur dhe të armatosur, nuk u ndërmorrën hapa për ta parandaluar atë (Wentz, 2002: 17).

Pas rënies së komunizmit, në të gjithë Europën Lindore, RSF e Jugosllavisë nuk ishte immune ndaj valës së re të ndryshimeve, kështu që vendi federal u shpërbë në një zinxhir të përleshjeve të dhunshme ndëretnike (Nakarada, 2008). Pas shpërbërjes së RSFJ-së, në vitet 1991-1992, çështja e Kosovës u injorua tërësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Mesi i viteve të 1990-ta ishte një pikë kthese për strategjinë e rezistencës pasive të popullit shqiptar të Kosovës, me idenë thelbësore të një qasjeje jo të dhunshme në arritjen e synimeve të popullit shqiptar. Në vitin 1995, marrëveshja e Dejtonit (Ohajo, SHBA) e kishte njohur federatën e re jugosllave të përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, brenda kufijve të saj ekzistues, pa asnjë njohje të veçantë për statusin e ardhshëm të Kosovës (Beach, 2000). Në këtë mënyrë, kishte humbur një mundësi e madhe për të zgjidhur çështjen e statusit të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare kishte dështuar të parandalonte krizën e ardhshme në rajon.

Lëvizja paqësore në Kosovë, çdo ditë e më shumë e kuptonte se nuk do ta realizonte kërkesën gjithpopullore për liri dhe pavarësi nga okupatori serb, se përmes politikës së saj paqësore nuk do t'i arrinte objektivat e përcaktuara. Poashtu, nuk kishte arritur të vënte në lëvizje faktorët relevantë ndërkombëtar, për një rezistencë të armatosur (Beach, 2000). Në pyetjen se a kishte ende kohë për një zgjidhje paqësore, Rugova kishte tërhequr vërejtjen, duke paralajmëruar se “numri i radikalëve është duke u rritur nga ditë në ditë, fatmirësisht e mbaj akoma situatën nën kontroll, por me shumë vështirësi” (intervista A).

Gjatë vitit 1998, në Kosovë shpërtheu konflikti i armatosur. Ishte ky konflikti i hapur mes forcave ushtarake dhe policore të shtetit serb dhe forcave të krijuara dhe të përkrahura nga populli shqiptar i Kosovës, siç thuhej: “për të ruajtur pragun e shtëpisë” (Wentz, 2002: 17). Forcë kjo, e sapokrijuar, e dalë nga populli, me kalimin e kohës, u shndërrua në formën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Sipas studiuesit, Blerim Reka (2003), çështja e Kosovës u rishfaq në vitet 1997-1998, “si një problem politik rajonal i pazgjidhur, si rrjedhojë e një vargu luftërash në RSFJ-së”. Duke hulumtuar mbi çështjen, Reka konkludon:

“Çështja e Kosovës ishte, në thelb, një konflikt politik ndërmjet dëshirës së shqiptarëve të Kosovës, për të qenë një shtet i emancipuar e me të drejtë vetëvendosjeje dhe, në anën tjetër, i përpjekjeve të shtetit serb për të vazhduar sundimin mbi këtë vend nga Beogradi. Për elitën kulturore dhe politike serbe, Kosova ishte një simbol me vlerë i triumfit të kaluar të tyre” (Reka, 2003: 71).

Komuniteti ndërkombëtar ishte i shqetësuar për përshkallëzimin e konfliktit dhe për pasojat e tij humanitare, me frikën e përhapjes në vendet e tjera të rajonit. Shqetësimet ishin shtuar kur shteti nacionalist serb, në krye me Millosheviqin, në mënyrë të qartë kishte refuzuar çdo përpjekje për të zgjidhur krizën në mënyrë paqësore (Wentz, 2002: 17). KS i OKB-së, në mars të vitit 1998, kishte vendosur embargon e armëve në zonë, duke miratuar kështu Rezolutën 1160 (KS i OKB-së, 31 Mars, 1998).

Në fund të vitit 1998, Millosheviq haptazi i kishte konfirmuar qëllimet e tij dhe ushtria dhe policia e shtetit serb, e rregullt dhe ajo rezervë, ishte lëshuar në një fushatë brutale ushtarake dhe policore, kinse kundër UÇK-së, duke përfshirë mizoritë më brutale kundër popullatës civile. Në shtator KS i OKB-së zyrtarisht kishte bërë thirrje për një armëpushim, duke miratuar Rezolutën 1199 të OKB-së (KS i OKB-së, 23 Shtator, 1998) dhe duke insistuar në mbikëqyrjen ndërkombëtare të territorit. Megjithatë, sulmet e dhunshme dhe terrori serb kishin vazhduar pa ndërprerje (Beach, 2000).

Regjimi serb, përmes aparatit të vet shtetëror, ushtrisë dhe policisë së rregullt dhe nga ajo rezervë e krijuar nga serbët e armatosur lokalë, që nga viti 1989 deri në vitin 1999, kishin kryer qindra krime kundër popullatës shqiptare, si popullatë shumicë e Kosovës. Shqiptarët, në mënyrë sistematike, janë detyruar nga autoritetet serbe ta lëshojnë Kosovën. Vlerësohet se deri në fund të majit, të vitit 1999, mbi 90% e popullsisë, kryesisht shqiptare, ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre (NATO, 15 korrik 1999). Më pas, një pjesë e madhe e tyre, ishin larguar nga Kosova (Krasniqi, 2006: 24). Shumë prej tyre ishin masakruar, dhunuar dhe ekzekutuar (Kola, 2003: 363).

6.1.4. Marrëveshja e Rambujesë dhe fushata ushtarake e NATO-s

Bashkësia ndërkombëtare, e alarmuar, kishte organizuar një konferencë ndërkombëtare të paqes në Rambuje (Rambouillet) të Francës, nën kryesimin e përbashkët të Britanisë së Madhe dhe Francës, “me synimin që të arrihej një kompromis”. Pala Kosovare, edhe pse me ngurrim, i kishte pranuar propozimet e Rambujesë, pala serbe i kishte hedhur poshtë (Weller, 1999: 211-251).

Marrëveshja e Rambujesë, sipas hulumtuesit Ramë Buja, edhe pse “nuk ofroi një zgjidhje për statusin përfundimtar të Kosovës”, megjithatë, ishte një hap pozitiv, ajo ofroi mundësinë e paqes dhe të kompromisit:

“Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të jetë një takim ndërkombëtar për të determinuar një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare për Kosovën, bazuar në vullnetin e popullit, mendimet e autoriteteve relevante, përpjekjet e secilës palë që ndërlidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe Aktin final të Helsinkit” (Buja, 2007: 354).

Pas përpjekjeve të shumta, të pasuksesshme, nga OKB-ja, OSBE-ja dhe BE-ja, si dhe pas përmbylljes së pasuksesshme të negociatave mes delegacionit serb dhe të atij kosovar, në kështjellën franceze Rambuje, rrjedha e ngjarjeve në Kosovë kishte marrë një kthesë dramatike.

Akademik, Fehmi Agani, udhëheqës i lartë i LDK-së, rrëfente mbi detajet pas nënshkrimit të marrëveshjes. Ai theksonte se, “pala serbe gjatë tërë kohës ishte destruktive, megjithatë, Marrëveshja në Rambuje është një hap pozitiv drejt përmirësimit të gjendjes së qytetarëve të Kosovës” (intervista B)

Dështimi i Millosheviçit, për të rënë dakord me Marrëveshjen e Rambujesë, nxiti një fushatë ushtarake të NATO-s, për të ndaluar dhunën, ndaj popullatës shqiptare, në Kosovë. Ky ndryshim i madh pozitiv u arritë përmes internacionalizimit me sukses të çështjes së Kosovës, rezistencës paqësore dhe përmes luftës së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, në veçanti, me përkrahjen nga NATO, me sulmet ndaj forcave serbe që zgjatën plot 78 ditë dhe rezultuan me tërheqjen përfundimtare të forcave serbe dhe përfundimin e luftës në Kosovë (Gashi, 2004: 258). Studiuesi Steven Burg, mbi ndërhyrjen politike dhe ushtarake të Forcave Perëndimore, thekson:

“Pas hezitimeve të konsiderueshme Forcat Perëndimore vendosën të ndërhynin politikisht dhe ushtarakisht në Ballkan. Fundi i konflikteve të armatosura në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Serbi, Kosovë dhe Maqedoni, erdhi si pasojë e politikave të avancuara demokratike” (Burg,2005: 204).

Me pezullimin e bombardimeve të NATO-s, më 10 qershor 1999, KS i OKB-së kishte miratuar Rezolutën 1244 (UNSC S/RES/1244), dhe kishte njoftuar mbi vendimin e Këshillit për të zëvendësuar autoritetet e RFJ-së me vendosjen e pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë, përkatësisht Misionit të Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe NATO-s i udhëhequr nga Forcat e Kosovës (KFOR), përgjegjëse për sigurimin e paqes. Përveç kësaj, Rezoluta 1244 parashikonte emërimin e një Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) përgjegjës për administrimin e Kosovës dhe koordinimin me KFOR-in. E gjithë kjo ishte e garantuar me Marrëveshjen teknike ushtarake të nënshkruar në Kumanovë (Maqedoninë e Veriut), në vitin 1999 (Yannis, 2004: 67-81).

Marrëveshja e Kumanovës (1999), e cila u pretendua të ishte një marrëveshje paqeje për luftën në Kosovë, nuk solli zgjidhje konkrete për popullatën lokale të Kosovës. Për më tepër, vetë emri - Marrëveshja Teknike Ushtarake - tregonte se fokusi kryesor i marrëveshjes së nënshkruar në 1999 ishte rregullimi i çështjeve ushtarake, ndërsa të tjerat ishin lënë mënjanë (NATO, 2017). Marrëveshja e Kumanovës dhe prania e institucioneve të udhëhequra nga OKB-ja nuk sollën paqe faktike në Kosovë. Edhe Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, e cila garantonte sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë dhe mbi të gjitha përcaktonte mekanizmat e stabilizimit dhe krijimit të mjedisit paqësor në Kosovë, nuk arriti të ketë ndikim vendimtar (dhe pozitiv) në rajon.

Duke u bazuar në këtë Rezolutë, Kosova, që nga qershori i vitit 1999, u vu nën Administrimin e Përkohshëm të UNMIK-ut. Tim Judah, si njohës i mirë i rrethanave, duke e vlerësuar Rezolutën, thekson se “ky nuk ishte një dokument i hartuar për të përshkruar të ardhmen afatgjate të Kosovës, por një marrëveshje diplomatike për të përfunduar fushatën e bombardimeve” (Judah, 2001: 55). Sipas studiuesit Morag Goodwin, administrimi nga UNMIK-u ishte joefikas dhe i dëmshëm për Kosovën:

“Me kalimin e viteve misioni i OKB-së po dëshmohej të jetë jo vetëm joefikas por edhe pengues i proceseve qeverisëse dhe të atyre demokratike. Është e domosdoshme zgjidhja përfundimtare e statusit juridik e politik të Kosovës në mënyrë që këto procese të vëhen në lëvizje” (Goodwin, 2007: Vol. 5: 11-19).

Nëse këto të dhëna merren parasysh, nuk habit fakti se nga të gjithë aktorët e interesuar që kishin të bënin me çështjen kërkohej një zgjidhje tjetër për Kosovën.

6.1.5. Propozimi gjithëpërfshirës për statusin përfundimtar të Kosovës

Në fillim të vitit 2006, subjektet relevante, si OKB-ja dhe grupi i kontaktit, nxitën veprime për të përcaktuar dhe finalizuar statusin e Kosovës, si një mënyrë për të krijuar paqe solide dhe të qëndrueshme në rajon, duke filluar negociatat mes palës kosovare dhe asaj serbe. Këto negociata, të njohura si “Negociatat e Vjenës për statusin përfundimtar të Kosovës”, u

ndërmjetësuan nga Zyra e Kombeve të Bashkuara e të dërguarit të posaçëm për Kosovën (UNOSEK). Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së emëroi Martti Ahtisaarin, ish Presidentin e Finlandës, si Emisar Special për Procesin e Statusit të Ardhshëm për Kosovën, me detyrën e ndërtimit të një propozimi të vlefshëm që do të plotësonte interesat e Kosovës dhe Serbisë si dhe të komunitetit më të gjerë ndërkombëtar. Roli kryesor i Martti Ahtisaarit, si dhe i zëvendësit të tij, diplomatit austriak Albert Rohan, ishte krijimi i një Propozimi për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, duke bashkëpunuar ngushtë me shtetet e Grupit të Kontaktit dhe aktorë të tjerë relevantë ndërkombëtar, i cili, kur do të finalizohet, do të paraqitet në KS të OKB-së (Perritt, 2010: 163). Ahtisaari, qysh në fillim të mandatit kishte deklaruar se “procesi i ndërtimit të paqes nuk është diçka që bëhet i vetëm, por nevojitet një ekip dhe një grup më i gjerë që kanë ndikim mbi çështjen” (intervista C). Marc Weller, si njohës i çështjes, shpjegon se “parimi themelor i ndërmjetësuesve ishte se nuk do të kishte kthim prapa në situatën që kishte ekzistuar në Kosovë, para vitit 1999, dhe se çdo zgjidhje e njëanshme dhe e bazuar në përdorimin e forcës do të ishte e papranueshme”.

Edhe pse gjatë procesit negociues kishte progres mbi disa çështje teknike, mbi statusin përfundimtar të Kosovës, të dyja palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta. Pas katërmëdhjetë muajsh negociatash diplomatike dhe të konsultimeve e diskutimeve me elitat politike të Kosovës dhe Serbisë, duke përfshirë ekspertë dhe udhëheqës të shumtë ndërkombëtarë, i dërguari special i OKB-së për Kosovën, Martti Ahtisaari, më 2 shkurt të vitit 2007, i paraqiti KS të OKB-së propozimin gjithëpërfshirës, lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës. Propozimi u bë publik dhe në thelb “përcaktoi një kornizë për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës gjatë një periudhe të caktuar kohore” (Weller, 2008: 659–681). Zëvendësndërmjetësuesi i OKB-së për statusin e Kosovës, Albert Rohan, duke folur mbi çështjen bazike të statusit theksonte se, “mësimet që i kemi përvetësuar gjër më tani janë se

mund të arrihet një marrëveshje, vetëm nëse ka një minimum të vullnetit politik nga të dyja palët” (intervista Ç).

Propozimi gjithëpërfshirës, lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës, ishte kundërshtuar nga shteti serb (Qeveria e Republikës së Serbisë, 2007). Pala serbe, sikurse në negociatat në Rambuje, po ashtu edhe të atyre që pasuan, për të fituar në kohë, si gjithnjë, i kthehej strategjive bojkotuese ose kërkesave për rinegociata dhe propozime të reja. Në gusht të vitit 2007, një Treshe (e përbërë nga BE-ja, Federata Ruse dhe SHBA-të) do të propozonte dhe do të organizonte negociata të mëtejme mbi statusin e ardhshëm të Kosovës (Troika Proposal, 2007). Pavarësisht përpjekjeve dhe forcave të tyre të bashkuara, negociatat përfunduan në dhjetor të vitit 2007, pa ndonjë marrëveshje apo rezultate thelbësore.

Pas kalimit të një periudhe tre mujore, që nga shqyrtimi i KS të OKB-së të propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, më 17 Shkurt të vitit 2008, Institucionet e Kosovës, në koordinim të plotë me faktorin mbështetës ndërkombëtar, shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe sovran (BBC, 2007). Pas shpalljes së pavarësisë, mbështetja perëndimore për Kosovën rezultoi me njohjen e statusit të Kosovës nga shumica e vendeve të NATO-s dhe të BE-së.

Përfshirja e forcave ndërkombëtare ka qenë e dobishme për të dyja palët në konflikt. Jo vetëm që ka përfunduar dhuna masive, të paktën dhuna në shkallë të gjerë, por është përcaktuar edhe stabiliteti i gjithë rajonit.

6.1.6. Kontestimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nga shteti serb

Shteti serb konsideronte se brenda OKB-së, Rusia, Kina dhe shtetet e tjera aleate, do të mund ta ndihmonin në parandalimin e njohjes së Kosovës dhe Shpalljen e Deklaratës për Pavarësi, ligjërisht dhe ndërkombëtarisht si të pavlefshme. Për këtë betejë, si në aspektin diplomatik ashtu edhe në atë ligjor, Serbia arriti të bindë një numër shtetesh të BE-së që të rishqyrtojnë

propozimin mbi legjitimitetin ndërkombëtar të shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës nga GjND-ja, përmes AP të OKB-së. Në gusht të vitit 2008, shteti serb edhe zyrtarisht i është drejtuar OKB-së me një “Kërkesë për një opinion këshilldhënës nga GjND-ja mbi legjitimitetin ndërkombëtar të shpalljes të njëanshme të pavarësisë nga Kosova” (Bieber, 2016: 285-319). Shteti serb pretendonte se shpallja e pavarësisë së Kosovës shkelte disa parime: a) parimin e respektimit të integritetit territorial të shteteve, b) parimin e vetëvendosjes dhe c) Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, e cila parakuptonte sovranitetin e vazhdueshëm të RFJ-së mbi Kosovën (Desku, 2013: 47).

Në shtator të vitit 2008, AP e OKB-së, kërkesën e Serbisë e dërgoi në GjND për procedim të mëtejshëm” (Reka, et al., 2016: 202). Më 8 tetor 2008, AP-ja e OKB-së miratoi Rezolutën 63/3 (UNGA A/RES/63/3, 8 tetor 2008). Goldstein, lidhur me këtë thekson: “përmes Rezolutës 63/3, AP-ja kërkoi nga GjND-ja një opinion këshilldhënës rreth legjitimitetit ndërkombëtar të shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga Kosova”. Ai precizon kërkesën AP-ja e OKB-së nga GjND-ja, si në vijim: “A është deklarimi unilateral i pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare” (Goldstein, 2003: 310). Edhe pse Kosova nuk ishte anëtare e OKB-së, rasti i saj mbi ligjshmërinë e Pavarësisë mund të gjykohej me kërkesë të AP-së (Karta e OKB-së, 1945: Neni 96, Paragrafi 1-2). Zejnullah Gruda, ekspert i së drejtës ndërkombëtare, kishte deklaruar se “Kosova ka çfarë thotë për çështjen e saj. Para së gjithash, duhet të përdorë argumentat historik” (intervista D). GjND-ja, më 22 korrik të vitit 2010, e përbërë nga 14 gjyqtarë, kishte konfirmuar se, “pavarësia e Kosovës nuk është një akt ‘secesioni’, por rast i koordinimit ndërkombëtar për zgjidhjen e konfliktit territorial mes Serbisë dhe Kosovës” (Knudsen, 2013: 204). Derisa, mbi aktin e Pavarësisë së Kosovës, GjND-ja e kishte nxjerrë opinionin e saj këshilldhënës, jodetyrues. Aty theksohej se,

“miratimi i Deklaratës së Pavarësisë për Kosovën, më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur asnjë rregull të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999) apo Kornizën Kushtetuese të instaluar nga Misioni i OKB-së-UNMIK (GJND, 2010: 53).

Timothy Waters, profesor i së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me ndikimin dhe rëndësinë e vendimit të GJND-së mbi Kosovën kishte theksuar se “vendimi i GJND-së mbi Kosovën nuk do të ndihmojë, por as nuk do të dëmtojë” (intervista Dh).

Bazuar në faktet e dhëna, pavarësia e Kosovës ishte një veprim logjik zinxhiror që nga Rambujea, Rezoluta 1244 e KS, Korniza Kushtetuese e vitit 2001, Plani i Ahtisaarit e deri tek Deklarata e Pavarësisë (Blerim Reka et al., 2016: 202).

6.2. Dialogu Kosovë-Serbi dhe rruga drejt Marrëveshjes së Brukselit

Pritej se opinionin këshilldhënës i dhënë nga GJND-ja, do të hapte një fazë të re në marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Shteti serb, përkatësisht parlamenti serb për pasojë, në vend që të respektojë opinionin e GJND-së, të cilin e kërkoi vetë, dhe thirrjet e BE-së për dialog, me shumicën dërrmuese, miratoi një vendim me të cilin përsëriste politikën e Serbisë për mosnjohjen e Kosovës dhe mbështetjen e nismës së qeverisë për ta ngritur këtë çështje në AP të OKB-së, duke bërë thirrje për një rezolutë për bisedime të reja mbi statusin e Kosovës (Economides dhe Key-Lindsay, 2015). Pa dyshim, kjo masë e Serbisë hasi në kundërshtim të fuqishëm nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Qeveria serbe, e vënë nën presion nga BE-ja dhe jo vetëm, për të mos ndërmarrë hapa të mëtejshëm për minimin e efektit të opinionit këshilldhënës të GJND-së, më në fund ra dakord me propozimin e BE-së për një projekt-rezolutë të përbashkët të AP-së të OKB-së, e cila bënte thirrje për dialog mes Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së (Tannam, 2013: 955-956). Një proces dialogu teknik, por tejet politik, që synonte të zgjidhte shumë prej çështjeve të pazgjidhura, që i kishte lënë konflikti i vitit 1999, nisi zyrtarisht në Bruksel, me ndërmjetësimin e BE-së. Nisja e dialogut bazohej në Rezolutën e AP-së të OKB-së (UNGA A/RES/64/298, 13 tetor). Rezoluta e

miratuar e pranonte përmbajtjen e mendimin këshillëdhënës nga GND-ja, pasi që AP-ja e OKB-së e kishte kërkuar dhe e mirëpriti rolin e BE-së në ndërmjetësimin e dialogut mes palëve në konflikt. Aty precizohej se,

“procesi i dialogut në vetvete do të ishte faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, dhe do të shërbente për promovimin e bashkëpunimit, për arritjen e progresit në rrugën drejt BE-së dhe do të përmirësonte jetën e qytetarëve” (AP e OKB-së, 2010: 2).

BE-ja duke qenë e përkushtuar dhe e vendosur për t'i menaxhuar çështjet e shumta dhe për ta drejtuar rajonin e BP drejt stabilitetit, kishte pranuar thirrjen nga OKB-ja dhe kishte shprehur gatishmërinë për të ndërmjetësuar dialogun, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. BE-ja duhej të angazhohej në formësimin e shteteve që kishin synim anëtarësimin, duke zbatuar një pushtet transformues mbi shtetet kontestuese (Meurs, 2003: 16-20).

Jacques Rupnik (2011), në studimin e tij “Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian: Ora e Evropës”, angazhimin e BE-së si ndërmjetësues, e cilëson si një parakusht të kujdesshëm për të siguruar që çështjet e ndërlidhura me shtetësinë, në veçanti në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, “të zgjidhen gjatë procesit të pranimit, kur levat e BE-së të jenë më të fuqishme”. Derisa, Bergmann dhe Niemann, si njohës dhe hulumtues të çështjes, konstatojnë se “dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së, paraqet një prej proceseve më të rëndësishme bashkëkohore në BP” (Bergmann dhe Niemann, 2015: 957–975).

Megjithëse axhenda e bisedimeve ende nuk ishte përcaktuar, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për CFSP-së, Catherine Ashton, deklaronte se “e ardhmja e Serbisë qëndron në BE. E ardhmja e Kosovës po ashtu qëndron në BE. [...] Prandaj BE-ja është gati të lehtësojë një proces dialogu mes Kosovës dhe Serbisë. Palët, nga ana tjetër, kishin konfirmuar se “do të angazhoheshin në një dialog konstruktiv” dhe do të kërkonin një mënyrë për të zgjidhur problemet e qytetarëve në rajon (Topalova, 2011).

Përmes një ndërmjetësimi balancues, por që vërtet të jetë balancues i BE-së, jo vetëm që do të arrinte të zgjidhte mosmarrëveshjet në lidhje me statusin e Kosovës, por gjithashtu do të reduktonte edhe situatat konfliktuale në rajonin i cili monitorohet nga BE-ja. Njëri nga udhëzimet për EEAS-in thekson rolin e “një fqinji të përgjegjshëm”, që tregon dëshirën e BE-së, për t’u përfshirë dhe për të ndikuar në çështjet jashtë kufijve të saj, veçanërisht në çështjet e vendeve fqinje.

6.2.1. Roli i BE-së si ndërmjetësues

Roli i ndërmjetësuesit, është padyshim një potencial i konsiderueshëm dhe evolues për BE-në, i cili ka qenë në gjendje të përfshihet në shumë procese komplekse jashtë kufijve të saj, duke siguruar zbatimin e proceseve të ndërtimit të paqes dhe zgjidhjes së konflikteve. Megjithatë, qasja ndaj përpjekjeve të ndërmjetësimit është ende e paqartë dhe nganjëherë e paqëndrueshme në drejtim të vendosjes së një opinioni të unifikuar mes aktorëve brenda vetë BE-së. Lidhur me dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, BE-ja ka shfaqur mosmarrëveshje të brendshme. Këto mosmarrëveshje kanë ndikim në procesin e ndërmjetësimit. Meqenëse statusi i Kosovës është temë e mosmarrëveshjes mes Shteteve Anëtare, BE-ja nuk mund të zhvillojë një përkufizim të përbashkët të politikës së saj mbi Kosovën. Megjithatë, siç ceket në vazhdimin e punimit, BE-ja ka gjetur një zgjidhje të përkohshme në trajtimin e Kosovës, si “neutrale ndaj statusit”, megjithëse mund të vihet në pikëpyetje e madhe nëse një zgjidhje e tillë do të jetë efiçase në një afat më të gjatë, pasi në përgjithësi opinioni i 5 vendeve, që nuk njohin Kosovën, ndikon në natyrën dhe në marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës.

Sipas, Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit (GSC), “BE-ja e konsideron ndërmjetësimin si një mënyrë për të ndihmuar negociatat mes palëve në konflikt dhe transformimin e konflikteve me mbështetjen e një pale të tretë të pranueshme” (GSC, 2009: 2). Edhe pse *qëllimi i përgjithshëm* i ndërmjetësimit, i përcaktuar nga BE-ja, ishte që palëve t’u ofrojë

mundësinë për arritjen e një marrëveshjeje të cilën ata e konsideronin të pranueshme dhe të jenë vërtetë të gatshme për ta zbatuar, *qëllimet më specifike* kanë më shumë gjasa të varen nga natyra e konfliktit dhe nga pritjet e veçanta të palëve dhe ndërmjetësuesit. Qëllim kryesor i BE-së, është ndërprerja e armiqësive ose marrëveshja për armëpushim “për t’i dhënë fund ose për të parandaluar dhunën dhe për të siguruar paqen dhe stabilitetin afatgjatë”. Sidoqoftë, GSC-ja ka përcaktuar qëllimin dhe konceptin e ndërmjetësimit, gjithashtu për të bërë një dallim mes termave të tjerë të ngjashëm si, ndërmjetësimi dhe lehtësimi:

“Derisa ndërmjetësimi zakonisht bazohet në një mandat formal nga palët në një konflikt dhe ndërmjetësuesi përfshihet në procesin dhe thelbin e negociatave, duke bërë sugjerime dhe propozime, në anën tjetër, lehtësimi është i ngjashëm me ndërmjetësimin, por ka më pak direktivë dhe është më pak i përfshirë në formësimin e thelbit të negociatave” (GSC, 2009: 3).

Dialogu, në këtë kontekst, ndryshon nga dialogu i institucionalizuar politik, të cilin BE-ja e zhvillon me vendet partnere. Dialogu politik, mund të ofrojë pikat e hyrjes për dialog dhe për procese ndërmjetësimi, që synojnë parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Për më tepër, duke iu referuar konceptit të dialogut, ai konceptohet si,

“një proces i hapur që synon kryesisht krijimin e një kulture të komunikimit dhe kërkimit të një baze të përbashkët, që shpjen në krijimin e besimit dhe përmirëson mirëkuptimin ndërpersonal në mesin e përfaqësuesve të palëve kundërshtarë. Mund të thuhet se ndihmon në parandalimin e konfliktit dhe mund të jetë një mjet i procesit të pajtimit dhe ndërtimit të paqes” (GSC, 2009: 3).

Sipas Johan Galtung, dialogu, në thelb është një marrëdhënie horizontale që nënkupton komunikimin ndërmjet të gjithë aktorëve. Palët në konflikt së pari duhet të bëjnë një dialog të brendshëm për të sqaruar qëndrimet dhe supozimet e tyre dhe më pastaj atë të jashtëm. Dialogu më shpesh nënkupton edhe pjesëmarrjen e aktorëve të jashtëm dhe përbëhet nga një sërë seminaresh/punëtorish në të cilat marrin pjesë përfaqësues të ndryshëm të palëve në konflikt (përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile, të ushtrisë, të shoqërisë akademike etj.). Qëllimi i dialogut është arritja e një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse, përgjithësisht të qëndrueshme të konfliktit në të cilën arrijnë vetë palët në konflikt. Pala e jashtme, si pale e tretë, në raste të

tilla, nuk propozon zgjidhje dhe roli i saj reduktohet në lehtësimin e konfliktit (facilitimin). Në dialog, ndërmjetësuesi do të duhej të përdorë metodën e testimit, duke mos hyrë në asnjë mënyrë në diskutime duke proklamuar debatin (Galtung, 2004:139).

Në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, është e qartë se BE-ja e ka përcaktuar veten si ndërmjetësues, sipas përkufizimeve të veta, duke treguar kështu se, duhet të përfshihet në procesin dhe thelbin e negociatave duke bërë sugjerime për perspektiva të suksesshme të rezultatit. Roli i një ndërmjetësuesi në një perspektivë të tillë ilustron nga prania aktive e ekipit ndërmjetësues të BE-së, Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për CFSP-në. Në rrethana të tilla, BE-ja vendosi të merrte një rol aktiv dhe të ndërmjetësonte mes Kosovës dhe Serbisë. Nga njëra anë ishte BE-ja, e shtyrë në mënyrë efektive nga OKB-ja, derisa nga ana tjetër ishin Kosova dhe Serbia, të drejtuara ekskluzivisht nga integrimet evropiane.

6.2.2. Motivet e palëve në dialog

Nisja e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë do të duhej zhvilluar si dialog mes dy shteteve të pavarura dhe sovrane. Por, shtrohen pyetjet nëse ky dialog do të zhvillohej mes të barabartëve, me çfarë motivesh kishin hyrë palët në dialog, si dhe cili ishte motivi i BE-së për të pranuar rolin e një pale të tretë ndërmjetësuese? Së pari, derisa Serbia prezanton veten si delegacion shtetëror i Serbisë, delegacionin e Republikës së Kosovës e sheh si delegacion të shqiptarëve të Kosovës dhe Metohisë, sipas tyre, si pjesë përbërëse të shtetit të Serbisë. Motivi kyç për të cilin Serbia kishte hyrë në dialog ishte integrimi në BE dhe se, sipas analistit Augustin Palokaj, “ky dialog nga Serbia shihet para së gjithash si dialog për të përmirësuar raportet me BE-në, dhe jo aq shumë për të përmirësuar raportet me Kosovën” (Koha Ditore, 2011). Së dyti, motivi për të cilin Kosova kishte hyrë në dialog ishte për të fituar joshjen e BE-së dhe për të marrë disa përfitime të vogla. Bazuar në pëlqimin e të dyja palëve, BE-ja vendosi të fillonte negociatat duke diskutuar së pari mbi “çështjet teknike”. Dialogu teknik synonte të nxiste

bashkëpunimin mes Kosovës dhe Serbisë dhe të përmirësonte jetën e qytetarëve të zakonshëm. Megjithatë, pothuajse është e pamundur të ndahen çështjet teknike nga çështjet politike, “nganjëherë është e dobishme të përqendrohemi tek çështjet teknike dhe të pretendojmë se nuk kanë të bëjnë fare me politikën” (Robert Cooper, 2015). Së treti, edhe BE-ja, dialogun Kosovë-Serbi nuk e sheh si dialog mes dy shtetesh të pavarura dhe sovrane, nga arsyeja se janë 5 Shtete Anëtare të saj, që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, prandaj Kosova nuk mund të trajtohet si shtet. Në BE, kur 23 Shtete Anëtare njohëse janë pro dhe 5 Shtete Anëtare mosnjohëse janë kundër, fitojnë ato vende që janë kundër, sepse vendimet për raporte me shtete jashtë bllokut merren me unanimitet dhe të drejtë vetoje të secilit Shtet Anëtar.

BE-ja, si palë neutrale, ka pranuar rolin e një pale të tretë ndërmjetësuese për të “përmirësuar jetën e rëndomtë të qytetarëve dhe për të promovuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin në BE”. Lidhur me këtë, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për CFSP-në, theksonte se “tani është momenti i duhur për të filluar dhe jam e bindur se Beogradi dhe Prishtina bashkë mund të gjejnë mënyra praktike për të siguruar që jeta e rëndomtë e qytetarëve mund të shkojë më mirë” (Ashton, 8 Mars 2011).

6.2.3. “Dialogu teknik”

Në marsin e vitit 2011, pas më shumë se tre vjetësh, pasi që Kosova kishte shpallur pavarësinë e saj, BE-ja i solli të dy delegacionet, të Kosovës dhe të Serbisë, në tryezën e negociatave. Do të fillonte kështu një proces negociimi, me qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje mes të dyja palëve, në të cilin BE-ja e kishte pranuar rolin e ndërmjetësuesit, si masë përcjellëse e Rezolutës së AP të OKB-së së 9 shtatorit 2010. Në kuadër të dialogut teknik u zhvilluan nëntë takime, duke filluar në mars 2011 dhe duke përfunduar në shkurt 2012. Takimet u kryesuan nga Robert Cooper, ndërmjetësues kryesor dhe një nga këshilltarët e Përfaqësuesit të Lartë të

BE-së për CFSP-në për Ballkanin dhe Lindjen e Mesme. Delegacioni i Serbisë udhëhiqej nga Borisllav Stefanoviç, Drejtor Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, ndërsa delegacioni i Kosovës udhëhiqej nga Edita Tahiri, Zëvendës Kryeministre e Kosovës (Lista e tabelave 4 - Figura 4.1 Fazat e Dialogut mes Kosovës dhe Serbisë).

Cooper, theksonte se qëllimet e dialogut ishin “të heqin pengesat që kanë ndikim negativ në jetën e përditshme të qytetarëve, të përmirësojnë bashkëpunimin dhe të arrijnë përparim në rrugën drejt BE-së” (Cooper, deklaratë për shtyp, 9 mars 2011). Por, gjatë shtatorit të vitit 2011, kur dukej se dialogu po dështonte, nga arsyeja se Serbia po dështonte në zbatimin e marrëveshjeve, Cooper kërkonte mirëkuptim nga institucionet e Kosovës deri sa BE-ja të vlerësonte performancën e Serbisë në proces. Njëherit, ai e përgëzonte Kosovën për zbatimin korrekt të marrëveshjeve të arritura. Dyshimet se a i kishte përmbushur Kosova kriteret e kërkuara, ishin hequr nga deklarimi i ambasadorit gjerman, Ernst Reichel. Në deklaratën e tij ai theksonte se, “Kemi ardhur në përfundimin se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për fillimin e dialogut për liberalizim të vizave. Ne do mbajmë këtë qëndrim edhe në BE” (Koha Ditore, 24 Shtator 2011). Sipas Abramowitz, Morton dhe James Hooper, Gjermania insistonte që KE të vendoste kushte strikte mbi marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën, në këmbim të marrjes së statusit të kandidatit dhe se këtë e kishte bërë përmes Kancelares së Gjermanisë, Angela Merkel (The National Interest, 29 Shtator 2011). Megjithatë, më 12 tetor 2011, KE-ja e kishte publikuar opinionin e tij mbi statusin e aplikimit për anëtarësim. Opinioni në thelb ishte pozitiv, por me disa kushte. KE-ja kishte rekomanduar që Këshilli i Ministrave t’i jep statusin e kandidatit Serbisë “duke pasur parasysh progresin e arritur gjer më tani dhe se Serbia do të riangazhohet në dialog me Kosovën dhe do të shkojë drejt zbatimit të plotë të marrëveshjeve të arritura gjer më tani” (KE, 12 Tetor 2011). Në fund të shkurtit 2012, pas përfundimit të raundeve të negociatave, Presidenti i Këshillit Evropian, Herman Van Rompuy,

kishte konfirmuar se Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme kishte rekomanduar dhënien e statusit të kandidatit Serbisë (Van Rompuy, Shkurt 2012). Ashton kishte deklaruar, se të dy marrëveshjet e arritura për bashkëpunimin rajonal dhe menaxhimin e bashkëpunimit ishin një hap i madh drejt afrimit e të dyja palëve në BE. Duke rikujtuar se puna e vështirë pritej nga të dyja palët për të vazhduar bashkëpunimin. Ajo gjithashtu kishte shprehur dëshirën për ta parë Kosovën sa më pranë BE-së (Ashton, Mars 2012). Përfundimisht, KE-ja i kishte dhënë Serbisë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, më 1 mars 2012.

Lidhur me statusin e Kosovës, i cili ende ishte i përcaktuar me emërtimin “Kosovo”, duke nënkuptuar epërsinë e Serbisë mbi krahinën, përfaqësuesit e BE-së inkurajonin idenë se çështja e statusit të Kosovës do të trajtohej (Rettman, 2012). Përveç kësaj, BE-ja kishte vënë në dukje se marrëveshja e kishte kthyer Kosovën në një pjesëmarrëse të barabartë në takimet dhe ngjarjet rajonale, duke treguar se mund të pritej përparim i mëtejshëm në marrëdhëniet kontraktuale me BE-në (BE, 24 Shkurt 2012)

Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal, si njëra nga marrëveshjet e arritura në këtë fazë, mundësonte që Kosova në të ardhmen të marrë pjesë dhe të nënshkruajë marrëveshje të reja dhe të flasë për vete në të gjitha mbledhjet rajonale. Deri atëherë, marrëveshjet nënshkrueshin nga UNMIK-u, në emër të Kosovës. Sipas BE-së, marrëveshja siguronte që “Kosovo” të jetë emërtimi që do të përdoret në kornizën e bashkëpunimit rajonal. Ajo më tutje siguron një fusnotë (Kosovo*) e cila nënkupton se emërtimi është “pa paragjykim të pozicioneve ndaj statusit, dhe është në vijë me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë të Kosovës” (BE, 24 Shkurt 2012). Lidhur me këtë, Sir Michael Wood, udhëheqës i ekipit ligjor të Kosovës në GJND, përmes një analize autoriale kishte argumentuar se marrëveshja e arritur në Bruksel, në mes të Kosovës dhe Serbisë, për përfaqësimin rajonal, është e favorshme për Kosovën:

“Përmendja e të dyjave, edhe e Rezolutës 1244 edhe e Mendimit të GjND-së në fusnotë () është e rëndësishme, sepse GjND-ja ishte e qartë se nuk ka asgjë në Rezolutën 1244 që e ndalon shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Fusnota (*) kështu e njëh se Pavarësia e Kosovës është në pajtim të plotë me Rezolutën 1244. Me rëndësi është kur GjND-ja thekson se 1244 është: një “masë e jashtëzakonshme” me qëllim të adresimit të krizës humanitare në Kosovë në vitin 1999” (Wood, 2012).*

BE-ja, si ndërmjetësues, duhej të ishte neutrale ndaj statusit të Kosovës, në të njëjtën kohë edhe palët ishin pajtuar që bisedimet duhej të ishin neutrale ndaj statusit. Ndërmjetësuesit e BE-së mund të mbanin këtë parim, sepse nuk e kishin një mandat të qartë për të zgjidhur çështjen e statusit. Megjithatë, edhe pse neutrale, BE-ja ka luajtur një rol më të fuqishëm formulues në negociata. BE-ja i strukturoi negociatat duke i kryesuar dhe udhëhequr ato, duke paraqitur listën e temave të mundshme për diskutim dhe propozimin e zgjidhjeve potenciale kompromisi mbi çështje të caktuara (Bergmann dhe Niemann, 2015: 967-968).

Duke ofruar një mundësi reale për të ndjekur interesat e ardhshme të Kosovës dhe Serbisë, BE-ja me sukses ka zbatuar një proces dialogu, duke angazhuar të dyja palët me krijimin e kushteve, që është e pamundur për t'i shmangur, nëse Kosova dhe Serbia dëshirojnë t'i ruajnë mundësitë e tyre të ardhshme brenda BE-së. Në konkluzionet e Këshillit, të dhjetorit 2012, duke iu referuar vlerësimit të fazës së parë të dialogut, nga Janari 2011, deri në Shkurt 2012, Këshilli i bën thirrje Kosovës dhe Serbisë “të vazhdojnë zbatimin me mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më sot në dialog dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive mbi një sërë çështjesh me lehtësimin e BE-së” (Këshilli i BE-së, 15 Dhjetor 2012).

Edhe pse nga zyrtarët më të lartë të Republikës së Kosovës, por edhe nga vetë Zonja Edita Tahiri, si kryesuese e delegacionit të Kosovës në bisedimet me palën serbe, fillimisht thuhej se “dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të zhvillohej në cilësinë e dy shteteve sovrane, se “çështjet që kanë të bëjnë me sovranitetin e Kosovës i takojnë institucioneve shtetërore të Kosovës” si dhe “ky dialog është dialog teknik që do të trajtojë vetëm çështjet teknike, siç është zbardhja e fatit të personave të zhdukur, lëvizja e lirë, doganat etj” (intervista E).

Megjithatë, kështu asnjëherë nuk ndodhi. Ashton përgatiti terrenin për raundin e ardhshëm të bisedimeve, në një nivel më të lartë politik, duke përfshirë zyrtarët më të lartë të Kosovës dhe Serbisë.

6.2.4. *“Dialogu politik”*

Pas një viti bisedimesh mujore, thuhej se kishte përfunduar vetëm faza e parë e dialogut dhe se palët kishin rënë dakord të rifillonin procesin, në një dialog të nivelit të lartë politik, mes kryeministrave të tyre, të kryesuar nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për CFSP-në, Catherine Ashton (Bergmann dhe Niemann, 2015: 965). Dialogu, tanimë, ishte emërtuar si “Dialogu politik” ose “Dialogu mbi normalizimin e marrëdhënieve” dhe filloi zyrtarisht më 19 tetor të vitit 2012. (Malazogu dhe Bieber, 2012).

Këto bisedime të filluara si teknike, po kalonin në bisedime politike. Bisedimet do të trajtonin çështje më të ndjeshme, jo vetëm ato teknike, por edhe argumenta në nivel politik. Lidhur me këtë ndryshim, Presidentja Atifete Jahjaga, kishte theksuar se “aspekti se a është teknik apo politik, unë e them se më shumë është një shprehje apo një aspekt i terminologjisë se si përdorët” (intervista F).

Nëse, fillimisht, pushimi mes këtyre dy fazave të negociatave mund të shihej si një ndërprerje apo edhe një hap prapa, ai në të vërtetë mund të kishte punuar në favor të një rezultati të suksesshëm, pasi të dyja palët kishin një shans për të reflektuar mbi marrëveshjet e arritura gjatë “Dialogut teknik” dhe zgjidhja e synimeve të tyre në bisedimet e mëtejme sipas kërkesave të BE-së. Ishte gjithashtu një mundësi për BE-në, që të rishikojë kapacitetet e saja të ndërmjetësimin, të rigrupojë dhe të planifikojë strategjitë e ardhshme. Edhe pse gjatë fazës së dytë vendimet u bënë në nivel politik, përmbajtja e bisedimeve u diskutua, gjithashtu, nga ekspertë të fushës, të cilët u futën nga ana e EEAS-it, si pjesë e dialogut. Në këtë mënyrë,

ekipi i ndërmjetësimit të BE-së dhe zyrtarët nga Kosova dhe Serbia mund të përqëndroheshin në çështjet politike, ndërsa aspektet teknike u kishin lënë ekspertëve në terren.

Nga pikëpamja teorike, fuqia potenciale e BE-së, ishte e orientuar të krijonte një rezultat më të pranueshëm të mundur për të dyja palët, në mënyrë që edhe ajo të bëhej sa më e pranueshme si ndërmjetësues për palët. Kjo, sipas Touval dhe Zartman, tregon se një ndërmjetësim është i mirëpritur, për sa k ohë prodhon rezultate të favorshme. (Touval dhe Zartman, 2008: 57).

Takimi i parë, i nivelit të lartë u konsiderua jashtëzakonisht i suksesshëm pasi rezultoi në një marrëveshje të ashtuquajtur “historike”, për të vazhduar dialogun mbi normalizimin e marrëdhënieve dhe angazhimin e palëve për të bashkëpunuar. Duke u angazhuar në fazën e ardhshme të dialogut si ndërmjetësues, BE-ja shprehu gatishmërinë për të ndërmjetësuar negociatat, duke respektuar mendimet individuale të palëve, edhe nëse ato ishin në kundërshtim me njëra tjetrën, për shembull, lidhur me statusin e Kosovës. Megjithatë, të dyja palët u pajtuan të përfshijnë çështjet politike dhe të përmbushin qëllimin e BE-së për normalizimin e ndërsjellë të marrëdhënieve (Ashton, 19 tetor 2012). Bisedimet në nivel politik, ishin të rëndësishme në dinamikën dhe intensitetin e tyre. Afati kohor, tetor 2012 - prill 2013, ishte mjaft intensiv. Gjithsej dhjetë raunde bisedimesh u zhvilluan brenda një periudhe gjashtë mujore, ndërsa bisedimet në nivel teknik përbëheshin nga nëntë raunde bisedimesh gjatë një periudhe njëvjeçare. Megjithatë, një intensitet i tillë ka provuar të jetë i suksesshëm pasi që i ka mbajtur të gjitha palët e përfshira në një ritëm të qëndrueshëm dhe ka ndikuar në zhvillimin e dialogut. Poashtu edhe roli ndërmjetësues i baroneshës Ashton ishte kontribues dhe u konsiderua i nevojshëm, në mënyrë që të mbahej në vazhdimësi procesi, si dhe, përmes politikës së tipit “karrotë dhe shkop” të BE-së, të sigurohej se çdo gjë që do të dakordësohej përgjatë procesit, të gjejë zbatim në terren.

6.2.5. *Marrëveshja e Brukselit*

Përfundimisht, raundi i dhjetë në dialog, prill 2013, që ngriti dialogun në nivelin e kryeministrave, rezultoi të jetë i suksesshëm, dhe u quajt “historik”, pasi ekipet negociuese nga Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje pas shumë kompromiseve të ofruara nga BE-ja: *“Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Drejtojnë Normalizimin e Marrëdhënieve”*. Kjo marrëveshje 15 pikëshe e Brukselit, e nënshkruar më 19 prill 2013, u konsiderua si një sukses diplomatik për BE-në që zbatoi strategjinë e duhur të ndërmjetësimit dhe një hap të madh në dhënien fund të dhunës në Ballkan (EU Business, 20 Prill 2013). Marrëveshja ishte arritur në fund të qershorit, kur rezultatet e dialogut duhej të raportoheshin në mbledhjen e Këshillit për Çështje të Përgjithshme, duke demonstruar kështu besueshmërinë dhe efikasitetin e BE-së.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, marrëveshjen e kishte cilësuar si historike, duke shprehur bindjen se kjo marrëveshje do të përfaqësonte fillimin e një pajtimi dhe bashkëpunimi ndërshtetëror, me njohje reciproke, si dy shtete të pavarura (intervista G). Derisa, nga pala serbe theksohej se “marrëveshja e veçantë nuk e përcakton statusin e Kosovës dhe nuk nënkupton njohjen e Kosovës” (EU Business, 20 Prill 2013).

Edhe pse delegacioni i Kosovës përjashtonte mundësinë, që në këto bisedime të negociohej çështja e pjesës veriore të Kosovës (Intervista GJ), kjo prapëprap ndodhi kur trajtoi çështjet që ndërlidheshin me themelimin e një Asociacioni/Bashkësie të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, por që thuhej se “do të vepronte nën juridiksionin e ligjeve të Kosovës”.

Marrëveshja e Brukselit u konsiderua si “gurthemel i stabilitetit në BP dhe një hap vendimtar drejt integritimit në BE i të dyja vendeve” (Mehmeti, 2014: 7-9). Rëndësia e marrëveshjes qëndron në faktin se këto dukeshin si shenjat e para pozitive mes palëve për uljen e tensioneve dhe fillimin e përfundimit të armiqësive. Sidoqoftë, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjeve, zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit ka qenë i pjesshëm dhe krijimi i komunave me shumicë serbe ka qenë në vazhdimësi një burim i tensioneve, në vend të zgjidhjes së konfliktit

dhe ndërtimit të paqes (Emini dhe Stakić, 2018). Edhe pse, marrëveshja nuk i dha fund betejave në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivelin politik, që të dyja palët tanimë dukej se ishin të gatshme të bënin kompromise mbi çështjen e rëndësishme të qytetarëve serbë, në veri të Kosovës dhe çfarë ishte po ashtu e qartë se njohja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte pjesë e axhendës së Serbisë, pasi ajo ishte penguese dhe shmangte çdo mundësi që Kosovës t'i lejohej të bëhej pjesë e organizatave ndërkombëtare.

Megjithëse, procesi i krijimit dhe zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit pati ulje dhe ngritje, aktorët pjesëmarrës, të paktën zyrtarisht, nuk hoqën dorë nga vlera e rrugës paqësore drejt marrëdhënieve të qëndrueshme. Çështjet e ngritura në raundet e negociatave gjatë dialogut treguan se zyrtarët nga Kosova dhe Serbia ishin të gatshëm të vepronin në përputhje me qëllimet e BE-së dhe se mbështeteshin në aftësitë e saj për të negociuar një kompromis për çështjet e pazgjidhura, megjithatë, duke shmangur çështjen e statusit të Kosovës (Barlovac, 8 nëntor 2012).

BE-ja jo vetëm që kërkonte perspektivat e zgjidhjes në të ardhmen, por gjithashtu monitoronte zbatimin e marrëveshjeve të arritura më parë gjatë dialogut teknik. Nga të dyja palët u kërkuar të raportojnë progresin e bërë, duke nënkuptuar kështu, që BE-ja po përcjellte nga afër progresin dhe zhvillimin në vazhdim, lidhur me angazhimin e palëve për vendimet e marra. Megjithëse, dialogu ishte ngritur në më shumë aspekte politike, Ashton arriti të monitorojë marrëveshjet e arritura në fazën e mëhershme të bisedimeve (Ashton, 5 Dhjetor 2012), pasi ato mbetën ende një pjesë e rëndësishme e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Rëndësia e domosdoshmërisë për të arritur një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë, u theksua më tej me përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë, duke filluar nga një superfuqi si SHBA-të, tek përfaqësuesit individual të Shteteve Anëtare dhe institucioneve të BE-së

(Clinton, 31 Tetor 2012). Për më tepër, zyrtarët e lartë të BE-së, të kësaj periudhe kohore, gjithashtu shprehnin mbështetjen e tyre për të ardhmen e Kosovës dhe të Serbisë brenda BE-së, por vetëm në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre. Ish Presidenti i Këshillit të Evropës, Herman van Rompuy, kishte shprehur mbështetjen e tij shumë herë gjatë dialogut. Përveç kësaj, Komisioneri i zgjerimit të BE-së, Stefan Fule, konfirmonte se pranimi i Serbisë do të varej nga përparimi në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja (B92, 18 Mars 2013). Në ndërkohë, Kosova e kishte marrë konfirmimin nga Presidenti i KE, Jose Manuel Barroso, se fillimi i negociatave me Komisionin, mbi MSA-në, do të mund të miratohej (UNPO, 13 Mars 2013). Barroso tashmë e kishte konfirmuar mbështetjen e tij për Kosovën, duke theksuar ndikimin e dialogut dhe rezultateve të tij në marrëdhëniet mes BE-së dhe palëve. Sa i përket mundësisë për MSA-në, ai pretendonte se,

“mbështetja për Kosovën, për MSA-në, do të jepet vetëm nëse do të ndodh përparimi i kërkuar, andaj edhe një herë në mënyrë indirekte do të rikujtojë se integrimi brenda BE-së, për Kosovën, do të jetë i mundur (vetëm) nëse të dyja palët do të veprojnë sipas kërkesave të BE-së” (Barroso, 19 Shkurt 2013).

Shtetet Anëtare të BE-së, gjithashtu, kanë luajtur dhe luajnë një rol shumë domethënës në mbështetjen e palëve në dialog. Për shembull, zyrtarët gjermanë ishin kategorik në qëndrimin e tyre ndaj Serbisë, meqë Gjermania fillimisht ishte skeptike rreth Serbisë për t'u bërë anëtare e BE-së. Gjermania priste që shtetet të zgjidhnin çështjet e tyre, veçanërisht atë në lidhje me përfaqësimin e Kosovës në OKB, përpara se Serbia të mund të përfundonte negociatat e pranimit në BE. Ky Shtet Anëtarë, shumë i rëndësishëm, nuk kishte gatishmëri që çështjet e pazgjidhura të barten brenda BE-së së bashku me pranimin e Serbisë (B92, 20 Mars 2013). Po ashtu, një raport i Dhomës së Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar, prerazi deklaronte:

“Kriteret e aplikuara për Shtetet Potenciale Anëtare, duhet marrë shumë seriozisht, për të shmangur problemet e mundshme sapo vendi të bëhet anëtar i BE-së, sikurse në rastin e anëtarësimit në BE të Rumanisë dhe Bullgarisë. Nuk do të barten në BE konflikte të mëdha, siç është mosmarrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë. Pranimi i Qipros në BE, para zgjidhjes së çështjeve mbi Qipron Veriore, ishte një gabim i rëndë dhe në të ardhmen duhet shmangur gabime të tilla” (House of Lords, 2013: 13-24).

Megjithatë, disa Shtete të tjera Anëtare tregonin mbështetjen e tyre për Serbinë në lidhje me negociatat e pranimit. Në fillim të vitit 2012, Austria, Franca dhe Italia kishin lëshuar një kumtesë të përbashkët në favor të dhënies së statusit të kandidatit për Serbinë (Nielsen, 24 Shkurt 2013). Qiproja deklaronte se do të mbante qëndrimin e saj mbi Kosovën dhe nuk do ta njihnte statusin e saj si shtet i pavarur, duke mbështetur fuqimisht negociatat për pranimin e Serbisë (EU Business, 11 Korrik 2012).

Edhe pse dialogu Kosovë-Serbi është ende në vazhdim dhe i përcjellur me shumë paqartësi dhe ngecje të gjatë kohore, megjithatë mund të konstatohet se shkalla e efektivitetit të ndërmjetësimit në drejtim të zgjidhjes së konfliktit duket të jetë më e lartë se sa në rastin e bisedimeve për statusin të udhëhequr nga Ahtisaari. Në periudhën, mars 2011 - gusht 2015, përpjekjet për ndërmjetësim rezultuan me gjashtëmbëdhjetë marrëveshje mbi çështjet e papajtueshme mes palëve (Bergmann, 2017; Deda dhe Qosaj-Mustafa, 2013; Crisis Group, 2013; Malazogu dhe Bieber, 2012).

Nëse fokusohemi në atë, se sa çështje janë zgjidhur formalisht përmes marrëveshjeve, do të arrijmë në përfundimin se përpjekjet e BE-së për ndërmjetësim paraqesin zgjidhjen kryesore të konfliktit, me shumicën e çështjeve për të cilat janë bërë përpjekje për t'i zgjidhur plotësisht ose pjesërisht. Megjithatë, nëse merren parasysh vonesat dhe mospërfillja e qëllimshme e zbatimit të shumë marrëveshjeve (në veçanti nga pala serbe), gjë që tregon paplotinë dhe brishtësinë e tërë procesit, arrihet tek një vlerësim më pak pozitiv mbi përpjekjet ndërmjetësuese të BE-së (Bergmann dhe Niemann, 2017: 7; Bieber, 2015: 311). Në veçanti, Marrëveshja e Prillit 2013, e cila u emërua më vonë si, Marrëveshja e Brukselit, më shumë paraqet “një plan për menaxhimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, se sa një udhërrëfyes të qartë me një sërë pikash dhe objektivash (Seesox, 2014: 4-5).

Duke marrë parasysh të dyja aspektet së bashku, si arritjet, ashtu edhe një varg çështjesh të konfliktit, përfshirë edhe çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës, efektiviteti i ndërmjetësimit të BE-së në këtë rast, vlerësohet si i mesëm, por në të shumtën e rasteve, edhe si shumë i ulët.

6.2.6. Faza përmbyllëse e procesit të dialogut

Pavarësisht arritjeve në dialogun aktual dhe dështimeve nga të dyja palët, për të zbatuar disa nga dispozitat dhe marrëveshjet, për të cilat janë dakorduar, pengesat politike, ngjarjet dhe faktorët tjerë gjeopolitikë, normalizimi i plotë i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet ende primare në agjendën e BE-së. Në korrik të vitit 2017, Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë për CFSP-në, bëri të ditur fillimin e një “fazë të re” në dialog. Kjo fazë e dialogut, sipas udhëheqëses së delegacionit të Kosovës, Edita Tahiri, duhej të fillonte dhe të përfundonte “me njohjen reciproke mes dy shteteve”, që të ketë stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në rajon (intervista I).

Njohësit e çështjes flasin për dështimet e BE-së në politikë të jashtme, sidomos, derisa në krye të saj, si Përfaqësuese e Lartë e BE-së për CFSP-në, ishte Federika Mogherini. Analisti dhe gazetari Augustn Palokaj, në shkrimet e tij thekson se “sa është Mogherini e suksesshme mjafton të kuptojmë se Kosovën dhe dialogun me Serbinë e konsideron si suksesin më të madh”, duke konkluduar se “dialogu Kosovë-Serbi ka sjellë shumë dëme dhe është arritur shumë pak ose asgjë” (Palokaj, 27 shkurt 2019).

6.2.6.1. Qëndrueshmëria e status quo-së

Pa dyshim, qëndrimi dominues në Kosovë është se formati i tanishëm i dialogut i ka arritur limitet e tij dhe si i tillë, i pafrytshëm, ka nevojë të kaloj në një fazë më përmbajtësore, përfundimtare me përmbyllje shumë më efikase, të përshpejtuar të procesit, me marrëveshje

gjithëpërfshirëse, obligative, që ende besohet se do të sjell normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve fqinje.

Në përgatitjet për fazën e re të dialogut, tek disa aktorë vendor, por edhe ata ndërkombëtar hasim në ide dhe propozime të arsyeshme dhe të pranueshme për zgjidhje të mundshme të konfliktit dhe për normalizim të plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Ide dhe propozime për të cilat besonim se i takonin së kaluarës dhe “vijave të kuqe”, siç është ndryshimi i kufijve në baza etnike.

Periodha pas arritjes së Marrëveshjes së Brukselit e deri më sot kur po shkruajmë, karakterizohet nga një fushatë e egër e shtetit të Serbisë, kundër njohjeve dhe interesave të shtetit të Kosovës. Ajo kishte filluar të ashpërsohej më shumë gjatë fushatës së saj kundër pranimit të Kosovës në UNESCO, në vitin 2015 dhe në vitet në vijim, si dhe kundër pranimit në INTERPOL. Pas fillimit të kësaj fushate agresive, e sidomos pas dështimit të pranimit të Kosovës në UNESCO, në vitin 2015, nga përfaqësues politik, analistë dhe njohës të çështjes, dialogu me Serbinë, nuk shihej më si një opsion i duhur për arritjen e normalizimit të marrëdhënieve me shtetin fqinj. Kishte ide dhe propozime se, pala kosovare do të duhej të tërhiqej nga dialogu. Kërkohej pezullimi apo edhe ndërprerja e tërësishme e dialogut me palën serbe, sepse një dialog i tillë, sipas tyre, ishte jo i favorshëm për Kosovën. Në këtë rast, të dyja palët do të qëndronin në pozicione diametralisht të kundërta në çështjet kyçe, që kanë të bëjnë me statusin e Kosovës dhe me ndërhyrjen e Serbisë në Kosovë. Në kuadër të këtyre ideve dhe propozimeve, një opsion tjetër alternativ sugjeronte dialogun, por dialog të brendshëm, me komunitetin serb të Kosovës, dhe jo me shtetin serb. Ilir Deda, deputet në Kuvendin e Kosovës, ishte këmbëngulës se vazhdimi i dialogut me shtetin serb nuk kishte më asnjë kuptim (Intervista J). Ndërprerja e Dialogut kërkohej edhe nga LDK-ja. Kryetari i kësaj partie, Isa Mustafa, kishte theksuar se “është e pakuptimtë të vazhdohet dialogu me Serbinë, derisa

ajo vazhdon fushatën agresive kundër Kosovës, duke u kërkuar shteteve të ndryshme tërheqjen e njohjeve”. Kërkesen e tij për ndërprerje të dialogut, ai e ndërlidhte me ndërprerjen e fushatës serbe (Intervista K). Edhe ish kryenegociatorja në bisedimet Kosovë-Serbi, Edita Tahiri, kishte kërkuar që “në këto rrethana të ndërpritet dialogu, pasi që sipas saj nuk është i favorshëm për Kosovën” (Intervista L).

Megjithatë, konsiderojmë se ndërprerja e dialogut me shtetin serb, do të kishte pasoja të rënda, duke përfshirë izolimin e Kosovës si dhe stagnimin e përgjithshëm. Një pozicionim i tillë do të rikthente status quo-në, dhe do të zbehte pozicionin e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kosova, si e painteresuar për dialog, nuk do të njihej si faktor stabiliteti, por vetëm si eksportuese e problemeve dhe jo bashkëpunuese me faktorin ndërkombëtar. Nuk do të kishte progres në integrimi evropian dhe për pasojë do të ndërpritej implementimi i marrëveshjeve të arritura. Derisa, një dialog i brendshëm me komunitetin serb të Kosovës, edhe pse do të ishte shumë i dobishëm, nuk shihet si një alternativë me vlerë karshi dialogut me shtetin e Serbisë, duke pasur parasysh ndikimin (manipulimin) që shteti serb e ushtron në mesin e tyre. Prandaj, mund të konkludohet se realizimi i ideve të tilla do të sillte stagnim, do të mund të nxiste ndarje edhe më të mëdha etnike dhe për më keq, do të rrezikonte nivelin e stabilitetit dhe komunikimin politik ndëretnik në Kosovë. Prandaj, themi se, edhe pse dialogu Kosovë-Serbi, i ndërmjetësuar nga BE-ja, mbetet një çështje përçarëse dhe e politizuar në Kosovë, prapëseprap nga të gjitha partitë, por edhe nga pjesa dërmuese e popullsisë, ai është i pranueshëm dhe nuk ka alternativë tjetër. Në vend të ndërprerjes, dialogu do të duhej ridefinuar dhe përshtatur me interesat strategjike të Kosovës. Kosova do të duhej ta ndryshonte tërësisht qasjen dhe fazën e re, ta fillonte me një qasje shumë më ndryshe, përmes një platforme nacionale me objektiva të qarta. Rrugëtimi i Kosovës për integrim në BE, është i lidhur ngushtë me dialogun. Duke pasur parasysh këtë, do të ishte në interesin e vetë Kosovës

që të angazhohej me tërë kapacitetet e saja për një marrëveshje përfundimtare me shtetin serb. Një normalizim i plotë i marrëdhënieve Kosovë-Serbi, do të ofronte mundësi të reja për kompletimin e shtetndërtimit dhe të përparimit të Kosovës në proceset integruuese evropiane dhe më gjerë. Një vazhdim i gjendjes së status quo-së, vetëm sa do të rriste ndjenjen e pasigurisë dhe rrezikun që të mbyllë Kosovën në kategorinë e konflikteve të ashtuquajtura “konflikte të ngrira”. Sipas profesorit dhe anlistit, Daniel P. Serwer, Kosova dhe rajoni duhet të dalin, sa më parë, nga gjendja e status quo-së:

“Status quo-ja aktuale është bërë e paqëndrueshme dhe vetëm rrit rrezikun e ripërtëritjes së dhunës dhe paqëndrueshmërisë politike në rajon. Ulja e angazhimit amerikan në Ballkan, i kombinuar me rritjen e ndërhyrjes së Rusisë dhe një BE që është e hutuar, jo unike, dhe hezituese, bëjnë që status quo-ja në Kosovë dhe në rajon të jetë e paqëndrueshme” (Serwer, 8 Nëntor 2017).

Strategjia e zgjerimit të BE-së për BP, përshkruan qartë rrugën për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë: përfundimin me sukses të dialogut, nënshkrimin e një marrëveshjeje gjithpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme, në mënyrë që ato të avancojnë në rrugët e tyre Evropiane (Komisioni i BE-së, 2018: 17). Kjo, do të nënkuptonte normalizimin e plotë, përmes njohjes reciproke, që do të konfirmonte shtetësinë e Kosovës brenda dhe jashtë, mes të dy shteteve dhe jo të ndarjes së Kosovës në baza etnike. Nga pala kosovare do të kërkohej zgjerimi dhe garantimi i të drejtave politike, kulturore dhe fetare për komunitetin serb në Kosovë, por gjithnjë sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës.

6.2.6.2. Pretendimet territoriale të shtetit të Serbisë ndaj shtetit të Kosovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, duke diskutuar mbi nënshkrimin e një marrëveshjeje gjithpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme, ai njëkohësisht e kishte shprehë edhe idenë për ndarjen e Kosovës dhe i kishte siguruar qytetarët e vendit se në marrëveshjen me shtetin e Serbisë, nuk do të ketë ndarje të Kosovës (Intervista Ll). Në anën tjetër, Ilir Deda, deputet në Kuvendin e Kosovës, në diskutimet mbi normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, nuk shpreson në një normalizim të shpejtë të tyre, gjithnjë duke u bazuar në joseriozitetin dhe në

interesat e palës serbe (intervista M). Tanimë, nuk janë sekrete as pretendimet territoriale të shtetit të Serbisë dhe për ndarje të Kosovës. Pas deklaratave të vazhdueshme dhe pas propagandës së shtetit serb se, “popullata serbe në Kosovë është e rrezikuar”, dhe se “shteti serb me çdo mjet do të luftojë për mbrojtjen e komunitetit serb, shtimin e të drejtave të tyre politike, kulturore dhe fetare”, fshihen kryesisht pretendime territoriale. Betejat e shtetit serb, zhvillohen kryesisht për territor të Kosovës dhe jo për mbrojtjen e interesave të popullatës serbe në Kosovë. Ky synim do të arrihej përmes krijimit të një Asociacioni të pjesës veriore të Kosovës, me një nivel të lartë autonomie politike dhe territoriale dhe me kohë të ndarjes së saj nga Kosova. Daniel Serwer, Profesor i Praktikës së Menaxhimit të Konfliktëve, shprehet se “krijimi i një Asociacioni të tillë do të bllokonte funksionimin e shtetit të Kosovës dhe do t’i sillte probleme të madha Kosovës” (Intervista N). Se Asociacioni nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive, karakter ekzekutiv dhe territorial, e thekson edhe nënkryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj (Intervista Nj). Derisa, Enver Hasani, profesor i së Drejtës Ndërkombëtare, ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duke i paraqitur mendimet e tij mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, shpjegon qartë se, përmes Asociacionit, shteti serb synon të arrijë krijimin e një shtrati politiko - territorial për planin e Ahtisaarit. Përsa i përket çështjes së normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, Hasani është i mendimit se “propozimet e tilla të cilat përfshijnë normalizimin e plotë mes dy shteteve, njohjen universale dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB, i kanë edhe përparësitë e veta”, por sipas tij “do të kishte shumë pak gjasa, që kjo të ndodhte vetëm në këmbim të një anëtarësimi të përshpejtuar të shtetit të Serbisë në BE. Ai është i bindur se “shteti i Serbisë ka synime territoriale ndaj Kosovës dhe nuk do të jetë i gatshëm ta njohë zyrtarisht shtetin e Kosovës”. Derisa, për mundësitë e shfrytëzimit të levave nga ana e BE-së, si ndërmjetësuese në Dialog, për të bërë presion mbi shtetin e Serbisë që të njohë pavarësinë e Kosovës, ai

thekson se “BE-ja e përballur me çështjet e saja si të jashtme ashtu edhe të brendshme, me 5 Shtetet e saja Anëtare, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, dhe me statusin e saj të lehtësuesit në Dialog, nuk ka levë ndikimi tek asnjëra palë”. Ai është i bindur se “BE-ja nuk do të jetë në pozitë që të bëjë presion mbi shtetin e Serbisë që të njohë pavarësinë e Kosovës, as de jure dhe mbase as de facto”. Hasani, duke gjykuar jo vetëm në historinë e Kosovës, por edhe në historinë e Evropës gjatë shekullit XX, konkludon se “aty ku ka vetëm lehtësues dhe jo garantues, aty nuk ka levë ndikimi mbi palët”. Ai nuk sheh rrugë tjetër, përveç një veprimi nga të dy anët e Atlantikut (SHBA dhe BE), si mënyrë të zgjidhjes së çështjeve të BP” (Intervista O). Në të njejtën linjë, sa i përket veprimit nga të dyja anët e Atlantikut, është edhe Ilir Deda, i cili nuk e sheh si të mjaftueshëm vetëm BE-në, me rolin e saj si lehtësues në Dialog, ai e sheh si të nevojshme kyçjen e SHBA-ve, si garantues, dhe kërkon unitetin transatlantik për BP (Intervista M).

Marrëveshje mbi normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi ishin propozuar edhe më heret. Qysh në vitin 2007, ish përfaqësuesi i BE-së në bisedimet për statusin, Wolfgang Ischinger, kishte propozuar një marrëveshje mbi normalizimin e marrëdhënieve, të quajtur si “modeli gjerman”, e cila ishte refuzuar (Shkreli, 2013). Kjo marrëveshje nënkuptonte normalizim të plotë të marrëdhënieve, por pa njohje formale nga shteti i Serbisë. Ky propozim përfshinte edhe anëtarësimin eventual të Kosovës në OKB. Por, përse do të ishte e rëndësishme për Kosovën anëtarësimi i saj në këtë organizatë? Konsiderojmë se, anëtarësimi i Kosovës në OKB, do të ishte i rëndësishëm dhe me vlerë, për arritjen e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Marrëveshja në fjalë, nga pala kosovare kërkonte mbrojtje dhe zgjerim të të drejtave politike, kulturore dhe fetare për komunitetin serb në Kosovë edhe përtej planit të Ahtisaarit. Megjithatë, nga hulumtimet e profesorit Daniel Serwer kuptojmë se, koncesionet e mëtejme ndaj shtetit serb, për akomodimin e komunitetit

serb në Kosovë, përtej planit të Ahtisaarit, do ta rrezikonin seriozisht funksionalitetin institucional dhe kushtetues të shtetit të Kosovës (Intervista N).

6.2.6.3. Idetë mbi korrigjimin e kufirit apo shkëmbimin e territoreve

Kohëve të fundit, qarkullojnë ide dhe propozime mbi korrigjime dhe ndryshime kufijsh apo shkëmbimin e territoreve, në baza etnike, mes Kosovës dhe Serbisë, që i tejkalojnë “vijat e kuqe”, të përcaktuara nga pala kosovare (BalkanInsight, 2020). Deklarata e Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, e dhënë më 1 Gusht (Intervista Ll), ku i siguronte qytetarët e vendit se, nuk do të kishte ndryshim kufijsh, kishte ndryshuar brenda muajit. Më 27 Gusht, në një intervistë të rradhës, ai kishte deklaruar: “ideja mbi korrigjimin e kufirit Kosovë-Serbi është propozim dhe ide e imja” (Intervista P). Kjo do të nënkuptonte që komunat me shumicë serbe, në veri të Kosovës, do t’i bashkoheshin shtetit të Serbisë, derisa pjesa jugore e Serbisë, me shumicë shqiptare, do t’i bashkohej shtetit të Kosovës (Lista e tabelave 5 - Figura 5.1 Harta e ndërrimit të territoreve Kosovë-Serbi).

Një këmbim i tillë territorial do të rregullohej përmes një traktati paqeje, që do të nënkuptonte njohjen reciproke, e cila do të garantohej nga BE-ja dhe aktorë të tjerë. Idetë e tilla dhe bisedimet e Presidentit të Kosovës, me homologun e tij serb, për korrigjime dhe ndryshime kufijsh, në baza etnike, sipas publicistit Veton Surroi, janë ide dhe bisedime klandestine, nga arsyeja se “Kosova dhe Serbia, fillimisht do të duhej të bisedonin për njohje reciproke, më pastaj si dy shtete edhe mund të bisedonin për korrigjime kufijsh” (Intervista Q)

Duket se politika e një këmbimi të tillë territorial dhe e ndarjes së Kosovës, si një politikë e vjetër në rrethin elitar serb, kishte qarkulluar gjithmonë, por ishte aktualizuar prej fillimviteve të 90-ta. Mbi këtë çështje ishte pyetur edhe Presidenti historik i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, në vitin 1992. Ai mes tjerash kishte theksuar se “shtetit të Serbisë i interesojnë vetëm pasuritë

natyrore të Kosovës. Serbët shikojnë me këtë 'ndarje', që secila tokë me pasuri natyrore t'i takojë atyre" (Intervista A).

Propozimi për ndarjen territoriale ishte aktualizuar që nga Dhjetori i vitit 2002, derisa inicues i kësaj ideje ishte akademiku serb Dobrica Qosiq, i cili së bashku me Kryeministrin serb Zoran Gjingjiq, e kishin inicuar edhe para udhëheqësve më të lartë ndërkombëtar. Përmes këtij plani, ata parashihnin që, në rast se Kosova e shpall pavarësinë, "Serbia duhet të kërkojë: ndarjen territoriale, garanca efektive nga bashkësia ndërkombëtare për serbët që mbesin në anën shqiptare dhe status të veçantë të objekteve fetare" (Qosiq, 2004: 198).

Duke folur për marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kadri Veseli, ish kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i PDK-së, deklaroi qartë se "marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk nënkupton asnjë kompromis që e paralizojnë shtetin e Kosovës dhe nuk nënkupton asnjë lloj ndarje" (Intervista R). Derisa kryetari i LVV-së, Albin Kurti, mendon se "synimet për korrigjim kufijsh apo shkëmbim terriore, janë të gabuara dhe mund të kenë pasoja të dëmshme" (Intervista Rr). Edhe kryetari i Partisë Nisma Socialdemokrate, Fatmir Limaj, idetë dhe propozimet e tilla i cilëson si të papërgjegjshme dhe të papranueshme. Ai deklaroi se "kemi obligim të respektojmë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe deklarimet për korrigjim të kufijve, nga bartësit e institucioneve, janë të papërgjegjshme dhe të papranueshme" (Intervista S). Një politikë e tillë, vështirë se do të mund të realizohej, duke marrë parasysh edhe politikën e faktorëve relevantë ndërkombëtar, për mosndryshim kufijsh, sidomos në rajonin e trazuar prej vitesh të Ballkanit. David Phillips, ekspert për politikë të jashtme, thekson qartë se,

"ideja e ndarjes apo e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë është alternativa më e keqe për zgjidhjen e problemeve mes dy vendeve. Një ndryshim apo ripërkufizim i ri kufijsh në rajon, do të nxiste "efektin domino" dhe do ta trazonte dhe rrezikonte përsëri rajonin e BP" (Intervista Sh).

Një ndryshim i kufirit Kosovë-Serbi, sipas ish përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar në Bosnje, Paddy Ashdown, “do të pasonte me kërkesa të ngjashme” (Intervista T). Derisa, eksperti për politikën evropiane në Fondin Marshall të Gjermanisë, Michael Leigh, duke diskutuar mbi politikën e BE-së ndaj Kosovës, besonte se “BE-ja nuk i ka ndryshuar politikën që mbështesin integritetin territorial të Kosovës dhe është e pamundur, që të jetë pro ndryshimeve të status quo-së territoriale” (Intervista Th).

Duke u bazuar në intervistat e dhëna, arrihet të kuptohet se një ripërkufizim i ri territorial, mes Kosovës dhe Serbisë, do të nënkuptonte braktisje dhe mosrespektim të një politike ndërkombëtare për mosndryshim kufijsh, mosrespektim dhe minim të integritetit territorial të Kosovës, braktisje të Planit të Ahtisaarit dhe shkelje të Kushtetutës së Kosovës. Se idetë dhe propozimet për ndarjen e Kosovës, në baza etnike, siç u theksua më lartë, nuk janë të reja dhe as të ditëve të sotme, e thotë edhe analisti, Palokaj, në analizën e tij mbi idetë e ndarjes së Kosovës, kur thekson se, “Ideja për ndarjen e Kosovës, pa marrë parasysh se si është mbështjellë ajo, nuk është ide e re. Ajo ekziston që nga koha e Milosheviqit” (Palokaj, 8 Maj 2019).

Analisti i njohur për Ballkanin, James Hooper, sqaron se “rregullimet territoriale janë çështje taktike dhe se SHBA-të po e hedhin vështrimin më larg, në mënyrë që palët të mos mbeten në pozicionet e tyre të vjetra” (Intervista U).

Ideja që Serbia mund të marrë një pjesë të veriut të Kosovës në këmbim të Luginës së Preshevës, është shpërfaqur fillimisht në vitin 2018. Idetë dhe propozimet e tilla mbi korigjimin dhe ndryshimin e kufijve apo shkëmbimin e territoreve, në baza etnike, mes Kosovës dhe Serbisë, që i tejkalojnë “vijat e kuqe”, të përcaktuara nga pala kosovare, mund të marrin dimension rajonal dhe përbëjnë një kërcënim të sigurisë në Evropë. Projekti i shtetndërtimit në Kosovë ka qenë gjithmonë një çështje transatlantike e rrënjësuar në përpjekjet

e integritit rajonal dhe evropian. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja së bashku me unitetin kombëtar përbrenda Kosovës, janë jetike për një rezultat të qëndrueshëm.

Rifillimi i dialogut (Euronews, 2020), i ndërprerë në fund të vitit 2018, me ndërmjetësimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Josep Borrell (RadioFreeEurope, 2020), dhe të dërguarin special për dialogun, Miroslav Lajçak (Euronews, 2021), duhet të jetë i bazuar në parime të shëndosha dhe linja të qarta të kuqe. Roli i BE-së, si ndërmjetësues në dialog është garanci që Kosova dhe Serbia, si vende evropiane, do ta zgjidhin mosmarrëveshjen në përputhje me një perspektivë të anëtarësimit në BE.

Pala e unifikuar kosovare, në fazën e re të dialogut, do të duhej t'i kishte parasysh këto fakte dhe sugjerime dhe të synonte një marrëveshje përfundimtare dhe ligjërish e detyrueshme me shtetin e Serbisë, dhe jo një marrëveshje dykuptimëshe. Ajo marrëveshje do të duhej të nënkuptonte normalizimin e plotë dhe njohjen reciproke mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë. Derisa, me qëllimin e integritit të komuniteteve, në veçanti të komunitetit serb, paralelisht do të duhej zhvilluar një dialog të brenshëm gjithpërfshirës, me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

6.3. Përfundime

Në një vështrim të shkurtër historik, në kapitull, kuptuam situatën aktuale në lidhje me paqëndrueshmërinë gjeopolitike në Ballkan, mosmarrëveshjet mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb dhe dhe në kuadër të saj marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Edhe pse kanë kaluar më shumë se dy dekada, konflikti mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë është ende prezent. Paqartësitë lidhur me statusin ligjor të Kosovës dhe betejat lidhur me zgjidhjen e çështjes, e mbajnë konfliktin pezull.

Dialogu Kosovë-Serbi, është një nga proceset kyçe për avancimin e Kosovës në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Të dy qeveritë, si ajo e Kosovës po ashtu edhe ajo e serbisë, duhet ta

trajtojnë dialogun e tanishëm si një proces historik i cili ka vlerë në vete dhe jo vetëm në funksion të integritimit në BE. Duke u nisur nga fakti se, dialogu është i një rëndësie jetike, si për Republikën e Kosovës dhe të Serbisë, ashtu edhe për stabilitetin e rajonit në përgjithësi, kërkohet qartësim më i mirë karshi opinionit publik për rrjedhën e tij dhe përmbajtjen e marrëveshjeve. Qartësimi duhet të ekzistojë edhe në terma kohor, pasi që tejzgjatja e këtij procesi nuk kontribuon në suksesin e dialogut.

Përfundimisht, sfidat që priten në vazhdimin e këtij procesi janë të shumta, kurse të panjohurat edhe me të mëdha. Prandaj, dialogu në vazhdimësi dhe, sa më parë, duhet të prodhojë rezultate konkrete dhe të pranueshme, në mënyrë që të mos dështojë tërësisht. Përkundër gjithë këtyre shqetësimeve, një e arritur e jashtëzakonshme është, se palët janë pajtuar që problemet dhe mospajtimet t'i zgjidhin përmes dialogut duke përjashtuar çfarëdo përdorimi të forcës. Prosesi është zhvilluar me kundërthënie të mëdha dhe polarizim të skenës politike. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies e kanë karakterizuar këtë proces që nga fillimi. Prandaj, së fundmi është artikulluar nevoja e një konsensusi të përgjithshëm politik mbi këtë çështje. Faza përmbyllëse pritet të kurorëzohet me arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme në mes palëve. BE-ja në strategjinë e fundit të KE ka shprehur qartë qëndrimin se, rruga drejtë BE-së, për të dyja palët, lidhet me këtë proces.

Kapitulli VI: Konkluzione

Përkufizimi përmbajtësor i këtij punimi, është se ai përfshin vetëm një rast studimi, dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo rezulton me përfundime që janë specifike për rastin dhe nuk do të mund të jenë përfaqësuese për raste të tjera studimi dhe vështirë se mund të përgjithësohen.

Punimi është trajtuar në disa pika:

- E para, është evolucioni i procesit të ndërmjetësimit, si mjet diplomatik, i cili ka evoluuar në periudha të njëpasnjëshme të historisë njerëzore. Në menaxhimin e marrëdhënieve komplekse njerëzore, ndërmjetësimi është afirmuar duke filluar nga jeta e përditshme deri në arenat kryesore ndërkombëtare. Në praktikë shpesh ndodh që

